



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 4504/ Prot.

Vau Dejës me 18/06/2026

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (k) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët dhe grupet e interesit në Bashkinë Vau Dejës, të bëhen pjesë me mendimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimet:

- “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2029 NË BASHKINË VAU DEJËS”
- “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË VAU I DEJËS 2026-2028”
- "PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIN TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE BASHKIA VAU I DEJËS 2026-2031"
- "PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BARAZISE GJINORE 2026-2029 NË BASHKINË VAU DEJËS"

Dëgjesa publike do të bëhet me datë **16.07.2026** ora **10.00** ne sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm deri me datë 16.07.2026 , nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

([info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al) , [ardian.celepija@vaudejes.gov.al](mailto:ardian.celepija@vaudejes.gov.al) , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës )

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian CELEPIJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT, RINISË, SPORTIT DHE E ZHVILLIMIT TË**  
**TURIZMIT**  
**SEKTORI I ARSIMIT**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 03 Datë 18 / 06 / 2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2029 NË**  
**BASHKINË VAU DEJËS**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 9936/ 2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 68/ 2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligji Nr. 9632/ 2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsim, Rinisë, Sportit, dhe e Zhvillimit të Turizmit. Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Vau Dejës të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe,

**PROPOZJMË:**


1. Miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026-2029 në Bashkinë Vau Dejës, bashkëlidhur.
  2. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsim, Rinisë, Sportit, dhe e Zhvillimit të Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër

Konceptoi: Melita Vjerdha: Pergjegjës i Sektorit të Arsimit

Miratoi: Devis Peci: Drejtor/ Drejtoria e Ndihmes Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe zhvillimit të Turizmit

**KRYETARI**  
**Kristian Shkreli**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETAR**  
**Aleksandra Gjoni**

Konfirmoi Bazën Ligjore:  Sektori I Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E NDIHMËS EKONOMIKE, ARSIMIT, RINISË, SPORTIT DHE E**  
**ZHVILLIMIT TË TURIZMIT**  
**SEKTORI I ARSIMIT**

**RELACION**

**PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2029” NË**  
**BASHKINË VAU DEJËS**

**Të nderuar,**

Plani i Arsimit Parauniversitar 2026–2028 për Bashkinë Vau i Dejës është një dokument strategjik i domosdoshëm që synon të orientojë zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në territorin e bashkisë për tre vitet e ardhshme. Hartimi i tij është rezultat i një analize të thelluar të situatës aktuale, tendencave demografike, nevojave komunitare dhe sfidave ekzistuese në arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky dokument është një instrument thelbësor planifikimi për strukturat vendimmarrëse dhe administrative për të garantuar një arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Vau i Dejës .

**Kuadri Ligjor dhe Institucional**

Plani mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor kombëtar, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligjet dhe udhëzimet përkatëse për menaxhimin financiar, mbrojtjen e fëmijëve dhe gjithëpërfshirjen në arsim. Në bazë të këtyre akteve, Bashkia Pukë ka detyrimin dhe përgjegjësinë për të hartuar politika zhvillimore në fushën e arsimit dhe për të siguruar infrastrukturë, staf të kualifikuar dhe shërbime të barabarta për të gjithë. Gjithashtu, për referencë janë marrë në konsideratë dhe në shqyrtim edhe baza ligjore si më poshtë:

- **Ligji Nr. 9936/ 2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/ 2017** “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/ 2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

**Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)**

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funkionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së Vlerësimit të Cilësisë së kopshtit”

### **Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve**

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MSHMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

### **Shërbimi psiko-social dhe përfshirja sociale**

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

### **Vizioni dhe Objektivat Strategjike**

Vizioni i planit është të garantojmë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Vau i Dejës, objektivat strategjike përfshijnë:

- Rritja e aksesit në arsimin parauniversitar për të gjithë fëmijët e Bashkisë Vau i Dejës, me fokus në zonat më të pafavorizuara dhe grupet vulnerabël.
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në procesin e mësimdhënies
- Forcimi i kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për të siguruar një menaxhim efikas dhe inovativ.
- Mbështetjen për fëmijët me aftësi ndryshe dhe nga grupe të marginalizuara,
- Forcimin e rolit të shkollës si qendër komunitare.

Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Vau i Dejës është ndërtuar në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026, duke siguruar që objektivat dhe masat e ndërmarra në nivel lokal të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit në nivel kombëtar. Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Vau i Dejës dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parauniversitar.

Kjo përputhje i jep Planit Vendor një qasje të integruar dhe garanton që çdo ndërhyrje në territorin e Bashkisë Vau i Dejës është pjesë e një vizioni më të gjerë kombëtar për një sistem arsimor më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

### **Buxheti dhe Burimet Financiare**

Financimi i planit do të sigurohet përmes të ardhurave vendore, transfertave nga buxheti i shtetit dhe projekteve të bashkëpunimit. Janë përcaktuar nevojat buxhetore vjetore për secilën masë ndërhyrjeje, si dhe është hartuar një planifikim afatmesëm buxhetor për të mbështetur realizimin e objektivave. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimit e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje në arsimin parashkollor të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;]

Në këtë plan është përfshirë listëa e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2029 (në mijë lekë) e cila përfshin projektet që do të financohen nga Buxheti i Bashkisë Vau i Dejës gjatë kësaj periudhe., bashkëlidhur.

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë zbatimi e monitorimi, vlerësimi të progresit si dhe raportim e transparence te pershkuara si me poshte:

### **Mekanizmat e Zbatimit dhe Monitorimit**

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

### **Indikatorët e Performancës**

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktiviteteve në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm

### **Planifikimi i vlerësimit të progresit**

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore

### **Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi**

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

- Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara
- Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Vau i Dejës. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

**Rekomandim për  
Miratim**

Duke pasur parasysh rëndësinë strategjike të këtij dokumenti dhe bazuar në kuadrin ligjor dhe nevojën për ndërhyrje sistematike në arsimin parauniversitar, nëpërmjet këtij relacioni, kërkohet miratimin nga Komisioni i Arsimit dhe dërgimin për votim në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të Vau i Dejës.

Duke ju falenderuar,

Konceptoi: Melita Vjerdha: Përgjegjës i Sektorit të Arsimit  
Miratoi: Devis Peci :Drejtor/ Drejtorja e Ndiemes Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe  
zhvillimit të Turizmit





**Bashkia Vau i Dejës**

# **Plani i Arsimit Parauniversitar në Vau Dejës 2026-2029**

**Plani përbëhet nga 2 pjesë të ndryshme, Planin e Arsimit Parashkollor me vëmendje të veçantë kopshtet dhe Planin e Arsimit Parauniversitar për shkollat 9 vjecare dhe arsimin e mesëm.**

Grupi i punës së Bashkisë Vau i Dejës për hartimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor u koordinua nga Melita Vjerdha, Përgjegjëse e Sektorit të Arsimit Bazë dhe Parashkollor, Bashkia Vau i Dejës.

## Hyrje dhe konteksti

### Konteksti administrativ

Bashkia Vau i Dejës përfshin një numër njësisish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo strukturë e përbërë nga 6 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësisive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Vau i Dejës përfshin gjithsej 6 njësi administrative: Vau i Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Temal dhe Shllak, të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	499.09 km <sup>2</sup>
Popullsia bashkisë	19261 (Cens 2023)
Njësi administrative	Vau i Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Temal dhe Shllak

### Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Vau i Dejës është 19261 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore, nga të cilët 51,5% femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori. Pjesa më e madhe popullsisë, 96 % e popullsisë, është e përqendruar në zonën fushore, në zonën e njësisive administrative Bushat, Vau i dejes dhe Hajmel me 18942 banorë. Në 3 Njësitë Administrative Shllak, Temal dhe Vig Mnelë, njësi me reliev malor banojnë 769 banorë, ose 4% e popullsisë.

Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm. Në shumicën e Njësisive administrative vihet re një diferencë e lehtë në favor të femrave.

Emri i Njesise Administrative	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bushat	9708	4841	4867
Hajmel	3074	1530	1544
Vau i Dejës	5710	2759	2951
Shllak	127	73	54
Vig Mnelë	256	138	118
Temal	386	202	184

Grupmosha	Numri i banoreve	Meshkuj	Femra
0-4 vjeç	911	470	441
5-9 vjeç	1 023	517	506
10-14 vjeç	1 083	562	521
15-19 vjeç	1 178	562	616

Burimi: Instat 2023

### Përshkrim demografik sipas njësive administrative në Bashkinë Vau e Dejës:

Në kuadër të planifikimit të shërbimeve arsimore parauniversitare, është me rëndësi të kuptohet struktura demografike e popullsisë në territorin e Bashkisë Vau i Dejës. Kjo bashki përfshin një përzjerje të zonave urbane dhe rurale, ku dinamika e popullsisë ndryshon në varësi të pozicionit gjeografik, infrastrukturës dhe aksesit ndaj shërbimeve publike.

- **Njësia administrative Vau i Dejës**, që përfshin qendrën urbane të qytetit, ka një popullsi prej 2981 banorësh, me 1 521 femra dhe 1469 meshkuj. Kjo përfaqëson bërthamën e dytë më të madhe urbane demografike të bashkisë dhe ofron infrastrukturën më të zhvilluar arsimore dhe shëndetësore.
- Në njësinë administrative **Bushat**, që ka përqendrimin më të madh të popullsisë, jetojnë gjithsej 9708 banorë, nga të cilët 4867 janë femra dhe 4841 janë meshkuj. Popullsia është e përqendruar në Bushat zone urbane dhe rurale dhe në fshatra të mëdhenj dhe të vegjël, me nevoja të veçanta për akses në shërbime edukimi, të cilat janë shume afer zones urbane të Bushatit dhe pjesen me të madhe të shërbimeve të marrin aty.
- **Hajmel**, një njësi me karakter bujqësor dhe potencial turistik, numëron gjithsej 3074 banorë, prej të cilëve 1544 janë femra dhe 1530 meshkuj. Kjo përfaqëson bërthamën e tretë më të madhe urbane demografike të bashkisë dhe ofron infrastrukturën më të zhvilluar arsimore dhe shëndetësore.
- **Njësitë Administrative Vig Mnelë, Temal dhe Shllak janë njësi** me popullsi të vogël që nuk i kalon 1000 banorët sipas censusit të 2023. Janë njësi që ndodhen në zona të thella malore dhe kanë nevojë për mbështetje në zhvillimin e shërbimeve të integruara për fëmijët e moshës parashkollore.

**Pjesa e parë**  
**Arsimi Parashkollor**  
**2026 - 2028**

# Përmbajtja - Pjesa e parë

## Hyrje

1.1 Qëllimi .....	
1.2 Shtrirja.....	
1.3 Vizioni.....	
1.4 Misioni .....	
1.5 Objektivat.....	
1.6 Përgjegjësitë.....	
2. Proceset e Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	
2.1 Qëllimi i proceseve të menaxhimit .....	
2.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve të menaxhimit .....	
2.3 Regjistrimi i fëmijëve .....	
2.3.1 Regjistrimi i fëmijëve në kopsht .....	
2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor .....	
2.4.1 Këshilli i prindërve, Bordi i kopshtit, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.....	
3. Proceset Kryesore-Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	
3.1 Qëllimi i proceseve kryesore.....	
3.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve kryesore.....	
3.3. Përfshirja sociale .....	
3.3.1 Identifikimi i nevojave për përfshirje .....	
3.4 Mbrojtja e fëmijëve.....	
3.4.1 Mbrojtja e fëmijëve në kopshte.....	
Përshkrimi i Aktiviteteve/Projekteve .....	
3.5 Fëmijët me aftësi të kufizuar.....	
3.5.1 Adresimi i prindërve .....	
4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	
4.1 Qëllimi i proceseve mbështetëse .....	
4.2 Objektiva të përgjithshëm të proceseve mbështetëse .....	
4.3 Burimet Njerëzore.....	
4.3.1 Rekrutimi i stafit .....	
4.4 Menaxhimi i godinave .....	
4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve .....	
4.5 Materialet .....	
4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale .....	
4.6 Ushqimi	
4.6.1 Planifikimi i dietës dhe menysë	
5. Buxheti	



## 1. Hyrje

Në Shqipëri në vazhden e ndryshimeve politike, në 2015, u përfshinë edhe ndryshimet që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me mënyrën e organizimit të Bashkive në Republikën e Shqipërisë. Si rezultat u krijuan 61 Bashki, të cilat përballen me ndryshime të shumta organizative dhe administrative. Në këtë Kuadër për shkak të decentralizimit Bashkive ju shtohen disa detyra, si dhe nevoja për t'ju përgjigjur më mirë nevojave për zhvillim dhe mirëqënie sociale dhe ekonomike.

Ndërkohë në bazë të ligjit 69/2018 të ndryshuar për Arsimin, bashkisë i kalon nën juridiksionin e saj çdo çështje që lidhet ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor.

### 1.1 Qëllimi

Arsimi parashkollor, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Vau Dejës. Bashkia ka nevojë të krijojë në organigramën e saj një sektor përgjegjës për Arsimin Parashkollor, për ofrimin e shërbimit cilësor në Arsimin parashkollor. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

Konkretisht nëpërmjet planit synohet përmirësimi i shërbimit në 3 drejtime:

- Planifikim strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshtit, me qëllim përsimulimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, ose kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë në çështje të arsimit parashkollor, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të përmirësimit;
- Ngritja e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor, sipas të cilës të sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata) si edhe përmirësimin dhe forcimin e këtij kuadri për të parandaluar dhe eliminuar shkeljet;

Në pjesën e parë të dokumentit gjendet një analizë përmbajtësore e cila do të përmbajë Visionin, Misionin, Objektivat Strategjik të Planit, personat përgjegjës për implementimin, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektivave të përgjithshëm dhe specifik për secilin proces. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifik për secilin kriter të përgjithshëm.

Ndërkohë në pjesën e tretë janë zhvilluar projekte konkrete se si bashkia të realizojë ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në arsimin parashkollor.

### 1.3 Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë Vau Dejës. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Vau Dejës. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Personi Përgjegjës për Arsimin Parashkollor, pranë Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë Dhe Sportit në Bashkinë Vau Dejës.

### 1.4 Vizioni

Përmirësimi i shërbimit të Arsimit Parashkollor, nëpërmjet ngritjes së strukturave për arsimin parashkollor, dhe fuqizimin e tyre për t'ju përgjigur nevojave të fëmijëve.

### 1.5 Misioni

Shtimi i ambienteve arsimore për arsimin parashkollor dhe përmirësimi i cilësisë së tyre për të ofruar shërbim cilësor për çdo fëmijë të arsimit Parashkollor.

### 1.6 Objektivat

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve, hapja e një kopshti me drekë;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i prindërve, Komisioni shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.

### 1.7 Përgjegjësitë

1. Koordinator i planit:
  - Personi përgjegjës për arsimin parashkollor, i cili kujdeset për zbatimin e planit nga të gjithë aktorët përgjegjës;
  - Personi përgjegjës për Njësinë e Shërbimit Social.
2. Aktorët zbatues të planit:
  - Drejtues kopshti;
  - Mësues i kopshtit;
  - Komuniteti;
  - PMF;
  - Psikolog;
  - GTN;
  - Grupet e terrenit.
3. Monitorues/vlerësues i planit:
  - Kryetari i Bashkisë;
  - Këshilli i Bashkisë.

## 2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

### 2.1 Qëllimi

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimi parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

### 2.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe rritja e regjistrimeve përmes ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijës;
2. Krijimi i konceptit të kopshtit si komunitet duke organizuar aktivitete në çdo kopsht ku komuniteti mund të marrë pjesë dhe rritja e angazhimit të komunitetit në përmirësimin e shërbimit të arsimit parashkollor;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave si: Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e menaxhimit të kopshteve.

### 2.3 Regjistrimi i fëmijëve

#### 2.3.1 Planifikim dhe parashikim i regjistrimit të fëmijëve

##### *Informacion i përgjithshëm*

Në Bashkinë Vau Dejës kemi gjithsej 20 kopshte publike. Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshtet publike të Bashkisë është 475, prej të cilëve 237 janë vajza. Në këtë bashki numri i fëmijëve të regjistruar është më i ulët se sa kapacitet akomoduese të kopshteve.

Ndërkohë, sipas studimit numri më i madh i kopshteve ndodhet në territorin e Njësisë Administrative Bushat, ndërsa numri më i ulët i kopshteve ndodhet në **Njësinë Administrative Temal dhe Vig Mnelë** tek të cilat ka vetëm grupe të përziera.

**Pothuajse të gjitha kopshtet kanë grupe të përzier ku ka fëmijë të të gjitha moshave.** Nga analiza e të dhënave vihet re që numri i grupeve të përziera është i lartë. Kjo vjen si pasojë e numrit të ulët të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe krijimi i grupeve të përziera është zgjidhja më optimale për të garantuar ofrimin e shërbimit të kopshtit për ata fëmijë që regjistrohen.

Emri i Kopshtit	Njësia Administrative	Godina (me vete/brenda shkolles)	Kapaciteti akomodues	Numri i fëmijëve gjithsej	Numri i fëmijëve gjithsej (vajza)
Lush Kola	Bushat	Me vete	80	57	25
Rifat Zyberi	Bushat	Brenda shkolles	75	61	27
SHMB Hajmel	Hajmel	Brenda shkolles	60	39	17
Dheu I Lehte	Hajmel	Brenda shkolles	20	9	6
Bushat	Bushat	Me vete	60	45	27
Shkjeze	Bushat	Me vete	20	7	5
Rranxa	Bushat	Brenda shkolles	25	17	8
Fshat I Ri	Bushat	Brenda shkolles	20	11	6
Shkolla Nenshat	Hajmel	Brenda shkolles	45	23	10
Shaban Banushi	Bushat	Brenda shkolles	20	15	11
Narac	Vau Dejes	Brenda shkolles	25	29	15
Kac	Vau Dejes	Brenda shkolles	25	11	2
Mnele e Madhe	Vig-Mnele	Brenda shkolles	25	5	3
Dom Martin Trushi	Bushat	Brenda shkolles	40	36	16
Pistull	Hajmel	Brenda shkolles	15	6	4
Pacram	Hajmel	Brenda shkolles	15	10	6
Imzot Lucjan Avgostini	Vau Dejes	Me vete	100	63	35
Mjede	Vau Dejes	Me vete	40	26	14
			710	475	237

Kopshtet brenda godinave të shkollave janë 15, të cilat kanë shpeshherë problematika të cilat lidhen me mënyrën e drejtimit, pasi nuk krijohen strukturat që e kërkon **Udhëzimi Nr. 31, datë 28.01.2020**. Kopshtet që nuk kanë drejtor monitorohen nga mësueset të cilat janë dhe përgjegjëse për këto kopshte.

Në rastet e tjera:

- 1) drejtuesi i shkolles është edhe drejtues i kopshtit, por sërish përgjegjësia për ta administruar është e bashkisë;
- 2) Sipas udhëzimi udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018: njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kopshtet që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë pranë shkollave 9-vjeçare, mund të emërojnë një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe nxënësish.

### Objektiva kryesore:

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetur në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 3-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit për të siguruar një shërbim efikas.

### Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Unifikimi i të dhënave të arsimit parashkollor mes Bashkisë, ZVAP, NJA dhe kopshteve
2	Ulja e numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në këto grupe
3	Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshtet e NJA
4	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti në Bashkinë e Vau Dejës

### Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes
006	Punësimi i një specialisti pranë Sektorit të Arsimit vetëm për arsimin parashkollor	Drejtorja e Burimeve Njerëzore
005	Vlerësimi i brendshëm i kopshteve	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
004	Hartimi i Planit Afatmesëm në çdo Kopsht	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
003	Regjistrimi në kopsht sipas banimit	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
002	Krijimi i platformës digjitale e cila përmban të dhëna analitike për kopshtin	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
001	Identifikimi i fëmijëve në moshë kopshti	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

## 2.4 Organizmat e Institucionit Arsimor

### 2.4.1 Këshilli i Prindërve

#### Informacion i përgjithshëm

Nga 20 kopshte që janë intervistuar, pyetjes mbi themelimin e Këshillit, rezulton se të 12 kopshte kanë themeluar Këshillin e Prindërve, 6 kopshte nuk e kanë themeluar ndërsa 2 kopshte nuk janë përgjigjur. Në Bashkinë Vau Dejës, numri minimal i anëtarëve të Këshillit të Prindërve është 3, numri mesatar i anëtarëve është 4 dhe numri maximal është 8 anëtarë.

Në bashkinë Vau Dejës këshilli i prindërve zhvillon mbledhje 2 here ne vit. Mbledhje të tjera zhvillohen ose me nismën e kryetarit të Këshillit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij.

#### Objektiva kryesore:

Themelimi i Këshillit të Prindërve në çdo kopsht sipas Udhëzimit Nr. 31 dhe rritja e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit të Prindërve përsa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tij

#### Nën-objektivat:

<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi</b>
1	Themelimi i Këshillit të Prindërve në të gjithë Kopshtet sipas Udhëzimit Nr. 31 dhe ndarja e tij nga Këshilli i Shkollës
2	Aktivizimi më i madh i Këshillit të Prindërve në menaxhimin e kopshtit

#### Lista e Aksioneve

<b>Numri</b>	<b>Projekti</b>	<b>Pergjegjes</b>
008	Fuqizimi i Këshillit të Prindërve	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
007	Themelimi i Këshillit të Prindërve	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

## 2.4.2 Bordi i Kopshtit

### Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës, vihet re se një pjesë e kopshteve nuk e kanë themeluar Bordin e kopshtit, por edhe kopshtet të cilat ndodhen brenda shkollave funksionon Bordi i ngritur për Shkollën edhe për kopshtet. Përkatësisht 10 kopshte kanë të themeluar Bordin e kopshtit nga 20 kopshte në total.

Ndërkohë sipas Udhëzimit Nr. 25, bordi përbëhet nga 7 anëtarët, ndërkohë në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës, numri minimal i anëtarëve të Bordit të Kopshteve është 3 në NJA Hajmel, ndërsa numri maksimal i anëtarëve të Bordit të Kopshtit është 6 anëtarë në kopshtin Don Martin Trushi dhe Imzot Luçjan Avgustini në Njësitë Administrative Vau Dejës dhe Bushat.

Bordi duhet të mbledhet jo më pak se tri herë në vit, në bashkinë Vau Dejës një pjesë e kopshteve i përmbahen këtij standarti. Kopshti Lush Kola në NJA Bushat, kopshti Lulet e Jetës dhe Aneksi Paçram në NJA Hajmel zhvillojnë vetëm nga 1 mbledhje.

### Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Bordit të Kopshtit si organizëm që siguron mbarëvajtjen e arsimit parashkollor dhe adreson çështjet problematike për zgjidhjen e tyre.

### Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Bordit të Kopshtit në çdo kopsht
2	Rritja e aktivizimit të Bordit të Kopshtit në adresimin e problematikave të kopshtit
3	Adresimi i çështjeve të diskutuara në organizmat e kopshteve në Bashki

### Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes
011	Ngritja e një strukture lidhëse mes Bashkisë dhe kopshteve	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
010	Fuqizimi i Bordit të Kopshtit	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
009	Themelimi i Bordit të Kopshtit	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

### 2.4.3 Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

#### Informacion i përgjithshëm

Në kopshtet e Bashkisë Vau Dejës, **8 Kopshte** e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, ndërsa **10 Kopshte** nuk e kanë themeluar, dhe 2 kopshte nuk kanë dhënë përgjigje mbi themelimin e Komisionit.

Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ka në përbërje të tij edhe prindër të caktuar nga këshilli i prindërve.

Referuar të dhënave të mbledhura, në të gjitha kopshtet që e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, rezulton se nuk kemi një informacion të qartë se sa prindër pjesë e këtij të fundit janë dhe anëtarë nga Këshilli i Prindërve,

Ndërkohë përse i takon mbledhjeve të komisionit për ti dhënë zgjidhje problematikave të krijuara në kopsht ai duhet të mblidhet për të diskutuar problemet. Sipas analizës së të dhënave komisioni është mbledhur mesatarisht 3 herë në vit.

#### Objektiva kryesore:

Themelimi dhe fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit sipas Udhëzimit nr. 31.

#### Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Themelimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit në çdo kopsht dhe ndarja e Komisionit të Kopshtit nga ai i Shkollës
2	Fuqizimi i Komisionit për të marrë pjesë në identifikimin e nevojave dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të krijuara në kopshte

#### Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes
013	Fuqizimi i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
012	Ngritja i Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit	Drejtorja e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

### 3. Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

#### 3.1 Qëllimi

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto procese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijë etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

#### 3.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesore të planeve të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Përmirësimi i procesit të identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara;
2. Përmirësimi i infrastrukturës me qëllim aksesimin e kopshteve nga fëmijët me aftësi të kufizuara.

#### 3.3 Fëmijët me aftësi të kufizuara

Në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës ka 8 fëmijë me aftësi të kufizuara që frekuentojnë kopshtin. Bashkia ka vetëm 6 mesues mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Një pjesë e kopshteve në Bashkisë Vau Dejës kanë nevojë për vendosjen e rampave në mënyrë që fëmijët me AK të aksesojnë kopshtin.

Emri i Kopshtit	Njësia Administrative	Godina (me vete/brenda shkolles)	Kapaciteti akomodues	Numri i fëmijëve gjithsej	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara te aspektit mendore	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara te aspektit mendor (vajza)
Lush Kola	Bushat	Me vete	80	57	0	0
Rifat Zyberi	Bushat	Brenda shkolles	75	61	0	0
SHMB Hajmel	Hajmel	Brenda shkolles	60	39	1	1
Dheu I Lehte	Hajmel	Brenda shkolles	20	9	0	0
Bushat	Bushat	Me vete	60	45	1	0
Shkjeze	Bushat	Me vete	20	7	0	0
Rranxa	Bushat	Brenda shkolles	25	17	1	0
Fshat I Ri	Bushat	Brenda shkolles	20	11	0	0
Shkolla	Hajmel	Brenda shkolles	45	23	1	0

Nenshat						
Shaban Banushi	Bushat	Brenda shkolles	20	15	0	0
Narac	Vau Dejes	Brenda shkolles	25	29	1	0
Kac	Vau Dejes	Brenda shkolles	25	11	1	0
Mnele e Madhe	Vig-Mnele	Brenda shkolles	25	5	0	0
Dom Martin Trushi	Bushat	Brenda shkolles	40	36	0	0
Pistull	Hajmel	Brenda shkolles	15	6	0	0
Pacram	Hajmel	Brenda shkolles	15	10	0	0
Imzot Lucjan Avgostini	Vau Dejes	Me vete	100	63	0	0
Mjede	Vau Dejes	Me vete	40	26	2	2
Totali			710	475	8	3

### 3.3.1 Kërkesa për fonde shtesë

#### *Informacion i përgjithshëm*

Infrastruktura e kopshteve nuk është e përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në ndërtesat e kopshteve mungojnë rampat. Edhe pse mund të jetë gjetur një zgjidhje provizore, është e nevojshme që në kopshte të vendosen rampat, në përputhje me standardin për infrastrukturën e kopshteve.

#### *Objektiva kryesore:*

Plotësimi i standardeve të aksesueshmërisë të fëmijëve me AK në arsimin parashkollor

#### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Heqja e barrierave që pengojnë aksesueshmërinë e fëmijëve me AK në kopshte
2	Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjatë diagnostikimit të fëmijës
3	Ofrimi shërbimit psikosocial në kopshte

#### *Lista e Aksioneve*

Numri	Projekti	Pergjegjes
015	Vendosja e rampave dhe respektimi i standardeve për infrastrukturën e fëmijëve me AK pranë institucioneve arsimore	Drejtorja e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit
014	Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me AK përmes mbështetjes psiko-sociale të prindërve dhe mësuesve	Sektori i Ndhmes Ekonomike dhe PAK

Numri	Projekti	Pergjegjes
16	Ofrimi i shërbimit psikosocial për fëmijët me AK pranë kopshteve	Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

## 4. Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

### 4.1 Qëllimi

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje për proceset kryesore. Proceset mbështetëse duhet të gjenden brenda ose jashtë institucionit. Në shembullin e kopshtit, një proces mbështetës mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore pranë Bashkisë, për të koordinuar në aktivitetet e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë së tyre, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në trajnimin e stafit të kopshteve, përmirësimin e godinave të kopshteve dhe rritjen e aksesueshmërisë dhe arritjes së kopshtit nga të gjithë fëmijët.

### 4.2 Objektiva të përgjithshëm

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përsa i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike dhe sigurimin e aksesit në kopsht.

### 4.3 Burimet Njerëzore

#### 4.3.1 Rekrutimi i stafit

##### *Informacion i përgjithshëm*

Në kopshtet publike të Bashkisë Vau Dejës janë të punësuar 36 mësues, mesatarisht 1 mësuese për 7 fëmijë në zonat rurale dhe 1 mësuese për 16 fëmijë në zonat urbane.

Gjithashtu në këtë bashki mbetet i vështirë, menaxhimi i burimeve njerëzore veçanërisht në kopshtet në të cilat nuk kemi drejtues kopshti, si dhe i kopshteve që ndodhen brenda godinave të shkollave. Nga 20 kopshte publike në total, vetëm 5 prej tyre janë në godinë më vete, ndërsa pjesa tjetër 15 kopshte janë akomoduar brenda godinave të shkollave.

##### *Objektiva kryesore:*

Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të kopshteve duke siguruar nivelin e duhur të stafit përcaktuar nga aktet ligjore.

##### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Aplikimi i Udhëzimit Nr.14, sipas të cilit kemi një drejtor për 5 grupe nxënësish në kopsht

#### Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes
017	Zbatimi i Udhëzimit Nr. 14 për punësimin e drejtorëve për kopshtet për 5 grupe fëmijësh	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## 4.4 Menaxhimi i godinave

### 4.4.1 Rikonstruksioni i objekteve

#### Informacion i përgjithshëm

Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Vau Dejës u evidentua se një pjesë e kopshteve kanë nevojë për rikonstruksion. Disa nga problemet më shqetësuese kishin të bënin me rikonstruksionin e brendshëm dhe ljerja e godinave. Një pjesë e madhe e kopshteve kanë nevojë për rikonstruksion të tualeteve pasi janë të vjetra dhe jo të pershtatshme për fëmijët.

Më shumë se gjysma e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Vau Dejës ndodhen brenda godinave të shkollave. Po behet rikonstruksion i plotë i shkollës Mjedë dhe gjithashtu kopshti Hajmel është në proces restaurimi. Kopshtet e tjera janë restauruar më parë.

Sistemi i ngrohjes në kopshte është me dru, vetëm në tre kopshte brenda shkollave ka sistem me kaldaje. Sistemi hidraulik ka vetëm probleme në zonat e thella. Duhet parë mundësia e vendosjes së depozitave në kopshtet ku mungon uji i rrjedhshëm

#### Objektiva kryesore:

Rikonstruksioni i godinave duke iu përmbajtur standardeve për hapësirat e kopshteve dhe facilitetet e nevojshme.

#### Nën-objektivat:

Nr	Përshkrimi
1	Rikonstruksioni i godinave të kopshteve të cilat kanë nevojë për rikonstruksion
2	Ofrimi i ujit të rrjedhshëm në kopshtet ku mungon

#### Lista e Aksioneve

Numri	Projekti	Pergjegjes
018	Rikonstruksion i banjove te kopshteve (20 banjo)	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
019	Krijimi i kendeve te lojrave per femije ne kopshte	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Numri	Projekti	Pergjegjes
20	Hapja e Kopshtit me dreke	Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit/ Drejtoria e Arsimit

## 4.5 Materialet

### 4.5.1 Planifikimi i nevojës për materiale

#### *Informacion i përgjithshëm*

Përsa i përket materialeve didaktike, drejtueset e kopshteve kanë raportuar nëse kopshtet disponojnë materiale didaktike për çdo fëmijë dhe 12 prej tyre kanë raportuar pozitivisht. Kopshte që nuk disponojnë materiale didaktike për çdo fëmijë janë 8 dhe ndodhen në NjA Bushat dhe Hajmel. Shpenzimet për materiale didaktike mbulohen nga prindërit, ndaj jo të gjitha kopshtet kanë materiale didaktike për çdo fëmijë sepse jo të gjithë prindërit pranojnë të paguajnë për to. Bashkia nuk i pajis kopshtet me materiale didaktike, ajo mbulon vetëm shpenzimet për materiale kancelarike.

Bashkia Vau Dejës nuk ka një listë të unifikuar të materialeve didaktike për fëmijët e kopshteve.

#### *Objektiva kryesore:*

Sigurimi i materialeve të nevojshme didaktike dhe kancelarike për të siguruar zhvillimin dhe të nxënëit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënëit të fëmijëve 3-6 vjeç”.

#### *Nën-objektivat:*

Nr	Pershkrimi
1	Hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar zhvillimin dhe të nxënëit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënëit të fëmijëve 3-6 vjeç”

#### *Lista e Aksioneve*

Numri	Projekti	Pergjegjes
021	Unifikimi i listës së materialeve didaktike për të gjithë kopshtet e Bashkisë Vau Dejës	Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë dhe Sportit

## 4.6 Ushqimi

### 4.6.1 Planifikimi i dietës dhe menysë

#### *Informacion i përgjithshëm*

Në bashkinë Vau Dejës nuk ka kopshte të cilat ofrojnë ushqim për fëmijët. Gjatë dy viteve të ardhshme 2024-2025 prioritet për bashkinë Vau Dejës është hapja e 2 kopshteve me drekë në Njësinë Administrative Bushat dhe Vau Dejës. Janë zgjedhur këto zona pasi janë më afër dhe më qendrore për tu aksesuar më lehtësisht nga fëmijët dhe ka nje kerkese nga banoret.

#### *Objektiva kryesore:*

Mbulimi i kërkesës për shërbimin e ushqimit në kopshte

#### *Nën-objektivat:*

<b>Nr</b>	<b>Pershkrimi</b>
1	Plotësimi i kërkesës për shërbimin e drekës në qytetin e Bushatit dhe Vau Dejës

## 5. Buxheti

### 5. Buxheti për Arsimin parashkollor

#### Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parashkollor

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parashkollor në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifatat vendore.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

**Për periudhën 2026–2028, buxheti total i planifikuar për Arsimin Parashkollor dhe Arsimin bazë i detajuar më poshtë:**

Arsimi parashkollor dhe arsimit baze				Kod programi 09120
<i>Shpenzimet per Arsimin parashkollor dhe Arsimin baze</i>	Viti 2026 (000 Lekë)	Viti 2027 (000 Lekë)	Viti 2028 (000 Lekë)	Viti 2029 (000 Lekë)
<i>Shpenzime per paga</i>	77,798	78,576	79,354	79,354
<i>Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i>	12,992	13,122	13,252	13,252
<i>Shpenzime operative</i>	17,046	15,946	17,899	17,899
<i>Shpenzime per investime</i>	12,138	13,048	8,443	10,000
<b><i>Shuma në mijë Lekë</i></b>	119,975	120,693	118,949	120,506

## Plani i investimeve kapitale për arsimin parashkollor

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë Lekë)

Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti 2026 (000 Lekë)	Viti 2027 (000 Lekë)	Viti 2028 (000 Lekë)	Viti 2028 (000 Lekë)
1	Rikonstruksion i godines kopesht per femije Vau Dejes+Mbikqyrje+Kolaudim	-	1,100	3,200	5,000
2	Rikonstruksion i godines kopesht per femije Bushat +Mbikqyrje+Kolaudim	-	116	3,322	5,000
3	Investime për rampa në godinat e arsimit parashkollor	200	200	200	300
4	Krijimi i këndeve të lojrave për fëmijë në kopshte		500	500	500
<b>Shuma</b>		<b>200</b>	<b>1,916</b>	<b>7,222</b>	<b>10,800</b>



**Pjesa e dytë**  
**Arsimi Parauniversitar**  
**2026 - 2029**

## Përmbajtja - Pjesa e dytë

1. Analiza e shërbimit në shkollë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025.....  
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit .....
2. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar .....
- Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve.....
- Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor të Bashkisë .....
- Qëllimi 2 (Q2) Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre.....
- Qëllimi 3 (Q3) Zhvillimi i aftësive, talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëkurrikulare dhe bashkëpunimit komunitar.....
3. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar .....
4. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve) .....
5. Plani i investimeve kapitale.....
6. Monitorimi dhe vlerësimi .....
7. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

## Analiza e shërbimit të në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

### Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Në territorin e Bashkisë Vau i Dejës janë të shpërndara gjithsej 16 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto institucione përfaqësojnë një rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar.

Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (3 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (8 gjithsej) dhe shkolla të mesme të bashkuara (3 gjithsej).

- ✚ **Shkollat fillore** u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël. Këto shkolla janë të përqendruara kryesisht në zona rurale dhe kanë një numër të ulët të fëmijëve të regjistruar për arsye të lëvizjeve demografike të popullsisë drejt zonave urbane.
- ✚ **Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 8 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor. Këto shkolla përbëjnë numrin më të madh të shkollave në territorin e bashkisë dhe kanë një shtrirje kapilare të mirë duke ofruar shërbim përfshirës për të gjithë fëmijët. Pavarësisht variacioneve, të dhënat për shkollat nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.
- ✚ **Shkollat e mesme**, në numër prej 3, janë gjimnazet, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona urbane të bashkisë për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë, në Vaun e Dejës, në Hajmel dhe në Bushat. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.

Mëposhtë paraqesim tabelën e shkollave sipas njësive administrative, llojit, kapacitetit dhe numrit të fëmijëve të regjistruar. Nga tabela vërehet se ka një shpërndarje të mirë të shkollave me të gjitha ciklet e arsimit në të gjitha njësitë administrative në territorin e Bashkisë. Të dhënat e mbledhura nga shkollat na tregojnë se në të gjitha shkollat kapacitetet akomoduese janë të mjaftueshme për të ofruar një shërbim cilësor për të gjithë fëmijët në të gjithë territorin dhe nuk ka nevojë për të ndërtuar struktura të reja. Përqëndrimin më të madh të fëmijëve e gjejmë në zonat me një përqëndrim urban me të madh që janë edhe qendrat e njësive administrative si Vau i Dejës, Bushati, Mjeda, dhe Hajmeli ku përqendrohet numri më i lartë i fëmijëve 1087, ose 95% e fëmijëve të regjistruar në të gjithë bashkinë. Shkollat e tjera janë të shpërndara nëpër fshatra në zonat rurale dhe zonat e thella malore kanë një numër më të vogël fëmijësh të regjistruar. Ka shkolla që kanë më pak se 10 fëmijë të regjistruar, për shkak të lëvizjeve demografike të viteve të fundit, për të cilat bashkia do ti kushtojë një vëmendje të veçantë.

Nr	Emri i Shkolles	Njësia Administrative	Qyteti/Fshati	Lloji i Shkolles	Kapaciteti akomodues	Numri total i fëmijëve të regjistruar	Vajza
1	Lush Kola	Bushat		9 vjecare	280	177	78
7	Rifat Zyberi	Bushat		9 vjecare	350	168	80
8	Ashte vartese	Bushat		Fillore	60	4	2
9	ShMB Hajmel	Hajmel		E bashkuar	600	188	0
2	Aneks, Dheu I Lehte	Hajmel		Fillore	40	12	6
3	Gjon Ndoci	Bushat		9 vjecare		232	118
4	Mark Cuni	Bushat				39	16
5	Prek Cali	Bushat				39	12
6	Shkolla 9 vjecare, Nenshat	Hajmel	Nënshat	9 vjecare	300	77	40
10	Shaban Banushi	Bushat		9 vjecare	200	76	39
11	9 vjecare Narac	Vau Dejes	Naraç	9 vjecare	360	127	58
12	9 vjecare, Mnele e Madhe	Vig Mnele	Mnelë	9 vjecare	150	4	2
13	Dom Martin Trushi	Bushat		9 vjecare	120	45	21
14	ShMB Pistull	Hajmel		E mesme e bashkuar	100	45	15
15	Pacram	Hajmel	Paçram	Fillore	40	20	8
16	Imzot Lucjan Avgostini	Vau Dejes		E mesme e bashkuar	500	286	106
	Totali				3350	1649	

Sipas të dhënave të raportuara në tabelën mësipër, nga 1649 fëmijë të regjistruar në shkolla 44% janë vajza. Kjo ndarje ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimit të përpjekjeve për të garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Në shkollat e Bashkisë janë regjistruar 22 fëmijë me aftësi të kufizuara (2 vajza), nga të cilët 21 kanë program edukativ individual dhe janë 16 mësues ndihmës që punojnë. Kjo tregon kujdesin që bashkia tregon dhe do të tregojë për këtë kategori të veçantë. Pjesa më madhe e këtyre fëmijëve janë të përqendruar në Vau i Dejës, 9 fëmijë në Shkollën , pjesa tjetër është në shkollat e tjera në qendrat e Njësisë administrative.

Në shkollat e Bashkisë Vau i Dejës janë 353 fëmijë ( 186 vajza) familjet e të cilëve mbështeten me ndihmë ekonomike të shpërndarë në të gjithë fshatrat, nga zonat urbane te zonat e thella malore.

Në shkollat e Bashkisë Vau i Dejës ofrojnë shërbim arsimor 245 mësues, pjesa më e madhe e të cilëve është me arsim të lartë pedagogjik. Vetëm 14 mësues nuk e kanë arsimin e lartë pedagogjik, pothuajse të gjithë të përqendruar në zona të thella malore dhe në shkolla të frekuentuara nga pak fëmijë. Numrit të mësuesve u shtohen edhe 16 mësues ndihmës që ofrojnë shërbim për fëmijët me aftësi të kufizuara të përqendruar kryesisht në shkollat e zonave urbane.

Nga të dhënat në dispozicion të bashkisë mbi 95% e mësuesve kanë mbi 6 vjet ekperience pune në arsim duke treguar se territori mbulohet nga mësues me përvojë.

## Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar

### Vizioni

**“Të garantojmë akses të barabartë, cilësi të lartë dhe përfshirje të plotë në arsimin parauniversitar për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Vau i Dejës– duke përmirësuar e modernizuar shërbimin në shkolla si qendra komunitare që formësojnë qytetarë të denjë dhe të përgatitur për të ardhmen.”**

### Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastrukturës dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Vau i Dejës ka për synim:

- **Vlerësimin dhe përmirësimin e infrastrukturës arsimore**, për të garantuar kushte dinjitoze mësimi në çdo shkollë;
- **Forcimi i përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta**, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- **Rritjen e cilësisë së mësimdhënies**, përmes investimit në zhvillimin profesional të mësuesve dhe përdorimin e metodologjive bashkëkohore;
- **Forcimin e partneriteteve me komunitetin dhe institucionet arsimore** për të mbështetur suksesin e çdo nxënësi.
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së komunitetit**
  - **Fushata informuese dhe edukative për prindërit**, veçanërisht në lagje ose fshatra ku ka mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.
  - **Bashkëpunim me punonjësit socialë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës** për të identifikuar dhe mbështetur familjet në vështirësi ekonomike ose sociale.
  - **Angazhimi i këshillave të prindërve dhe organizatave lokale**, për të fuqizuar përfshirjen dhe monitorimin e komunitetit.

### Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor të Bashkisë

Bashkia Vau i Dejës synon të garantojë kushte infrastrukturore të qëndrueshme dhe funksionale për çdo institucion arsimor në territorin e saj, përmes mirëmbajtjes së rregullt dhe investimeve që përbushin standardet bashkëkohore të sigurisë, higjienës dhe funksionalitetit.

- **Objektivi 1.1:** Të sigurohet ofrimi i pandërprerë i shërbimeve mbështetëse për institucionet arsimore, duke përfshirë: pagesat për personelin edukativ dhe ndihmës, mirëmbajtjen e ambienteve, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari dhe transport.

- **Objektivi 1.2:** Të realizohen investime prioritare në ndërtimin, rikonstruksionin dhe pajisjen e shkollave, si dhe ngritjen e një sistemi dixhital për menaxhimin dhe transparencën e të dhënave institucionale.

## Qëllimi 2 (Q2) Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre

Përmes një qasjeje të balancuar mes edukimit, përkujdesjes dhe përfshirjes sociale, Bashkia Vau i Dejës synon të nxisë zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve, veçanërisht të atyre që përballen me barriera sociale, ekonomike apo zhvillimore.

- **Objektivi 2.1:** Të përmirësohet cilësia e edukimit në shkollat fillore përmes sigurimit të mjeteve didaktike bashkëkohore dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit pedagogjik.
- **Objektivi 2.2:** Të zgjerohet ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes psiko-sociale dhe të angazhohen mësues ndihmës për të mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta ose në rrezik social.
- **Objektivi 2.3:** Të forcohet ndërveprimi shkollë–familje–komunitet përmes strukturave të përfshirjes (këshillat e prindërve, bordet shkollore) dhe aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin për promovimin e barazisë dhe përfshirjes.

## Qëllimi 3 (Q3) Zhvillimi i aftësive, talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëkurrikulare dhe bashkëpunimit komunitar

Bashkia Vau i Dejës e konsideron edukimin përmes kulturës, artit, sportit dhe përvojave sociale si pjesë të pandashme të zhvillimit të fëmijëve dhe forcimit të lidhjes së tyre me komunitetin lokal.

- **Objektivi 3.1:** Të zhvillohet një kalendar i rregullt aktiviteteve kulturore, sportive dhe sociale për fëmijët në institucionet arsimore, për të nxitur kreativitetin, bashkëpunimin dhe ndjesinë e përkatësisë, në bashkëpunim me institucione kulturore, sportive dhe artistike në qytet për të krijuar sinergji dhe mundësi të reja edukative për fëmijët.

## Planifikimi Afatmesëm Buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

### Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifatat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimit për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë dhe konviktet;
- Funksionimin e Qendrës të fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, duke përfshirë paratë e personelit mësues dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

**Për periudhën 2026–2029, buxheti total i planifikuar për Arsimin Bazë dhe Parashkollor i detajuar më poshtë:**

<i>Shpenzimet per Arsimin parashkollor dhe Arsimin baze</i>	<b>Viti 2026</b> (000 Lekë)	<b>Viti 2027</b> (000 Lekë)	<b>Viti 2028</b> (000 Lekë)	<b>Viti 2029</b> (000 Lekë)
<i>Shpenzime per paga</i>	77,798	78,576	79,354	79,354
<i>Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i>	12,992	13,122	13,252	13,252
<i>Shpenzime operative</i>	17,046	15,946	17,899	17,899
<i>Shpenzime per investime</i>	12,138	13,048	8,443	10,000
<b>Shuma në mijë Lekë</b>	<b>119,975</b>	<b>120,693</b>	<b>118,949</b>	<b>120,506</b>

**Për periudhën 2026–2029, buxheti total i planifikuar për Arsimin e mesëm i detajuar më poshtë:**

<i>Shpenzimet per Arsimin e Mesëm</i>	<b>Viti 2026 (000 Lekë)</b>	<b>Viti 2027 (000 Lekë)</b>	<b>Viti 2028 (000 Lekë)</b>	<b>Viti 2029 (000 Lekë)</b>
<i>Shpenzime per paga</i>	14,538	14,683	14,829	14,829
<i>Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore</i>	2,435	2,459	2,484	2,484
<i>Shpenzime operative</i>	3,037	3,037	3,037	3,037
<i>Shpenzime per investime</i>	0	0	0	1,000
<b><i>Shuma në mijë Lekë</i></b>	<b>20,010</b>	<b>20,180</b>	<b>20,349</b>	<b>21,349</b>

## Plani i investimeve kapitale për arsimin bazë

**Plani i arsimit parauniversitar i Bashkisë Vau i Dejës parashikon ndërhyrje me investime kapitale të rëndësishme, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe forcimin e kapaciteteve teknike e pedagogjike të institucioneve.**

Gjatë periudhës 2026–2028, investimet do të fokusohen në rikonstruksionin e shkollave të arsimit bazë, parashkollor dhe të mesëm, pajisjen e ambienteve me infrastrukturë moderne, si dhe ngritjen e kushteve të përshtatshme për mësimdhënie dhe zhvillim gjithëpërfshirës të nxënësve. Plani synon të garantojë ambiente të sigurta, funksionale dhe të përshtatshme për nevojat e fëmijëve dhe të rinjve në çdo nivel të arsimit parauniversitar. Këto ndërhyrje janë pjesë e një vizioni afatgjatë për transformimin e shkollës në një hapësirë që promovon cilësi, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm arsimor në territorin e Bashkisë.

Këto investime paraqesin një angazhim të qartë të Bashkisë Vau i Dejës për modernizimin e sistemit arsimor lokal dhe për përmirësimin e cilësisë së edukimit në të gjithë territorin e saj, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe nevojat e komunitetit.

### Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2026 -2028 (në mijë Lekë)

Nr.	Emërtimi i Projektit	Viti 2026 (000 Lekë)	Viti 2027 (000 Lekë)	Viti 2028 (000 Lekë)	Viti 2028 (000 Lekë)
1	Rikonstruksion Shkolla 9- vjecare Kosmac+Mbikqyrje+Kolaudim	400	400	1,921	
2	Blerje stufash per ngrohje per shkolla	2,000	2,000	-	2,000
3	Rikostruksion i shkolles 9 vjecare dhe e mesme+shtese 2 kate, Bushat	9,246	8,754	-	
4	Mbikqyrje punimesh ne objektin "Rikostruksion i shkolles 9 vjecare dhe e mesme+shtese 2 kate, Bushat	492	679	-	
<b>Shuma</b>		<b>12,138.38</b>	<b>11,832.33</b>	<b>1,921.31</b>	<b>2,000</b>

## Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

### Qëllimi 1 (Q1) Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, modern dhe gjithëpërfshirës në çdo institucion shkollor të Bashkisë

**Objektivi specific O1.** Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit mësues në arsimin parashkollor dhe personelit ndihmës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, ushqim, dokumentacion dhe transport.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Mbështetja me pagesën dhe sigurimin punonjësve e arsimit bazë dhe atij të mesëm	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transfertë specifike + Buxhet vendor	Nr. i punonjësve të mbështetur financiarisht; Nr. i fëmijëve të regjistruar (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel)
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastruktures arsimore	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Shkollat	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	Nr. ndërhyrjeve të realizuara në godina (Lyerje, ndarje ambientesh, mirëmbajtje kaldajash, elektroshtepiakesh, kompjuterash, printerash, pajisjesh të zyrave)
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Shkollat, operatorë të higjienës	Buxhet vendor, transfertë e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve me sistem funksional ngrohjeje

		për shërbimet publike			
Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit	2027–2029	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor	Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale
Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion
Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat, MAS	Buxhet vendor + donacione, prindërit	Nr. i institucioneve të pajisura me mjete didaktike
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	<b>Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)</b> , operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjence	Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit
Ofrimi dhe sigurimi i shërbimit të transportit për mirëadministrimin dhe shërbimet për institucionet arsimore	Çdo vit	ZVA	Drejtoria e Transporteve, administrata	Buxheti i Bashkisë	Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi për 3 automjete të shërbimit të DA, dhe udhëtime për administratën

**Objektivi specific O1.2 Të realizohen investime prioritare në ndërtimin, rikonstruksionin dhe pajisjen e kopshteve dhe shkollave, si dhe ngritjen e një sistemi dixhital për menaxhimin dhe transparencën e të dhënave institucionale.**

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit baazë  Rikonstruksion i shkollave të arsimit bazë	Çdo vit 2027–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,  Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktura;  Përmirësim i kushteve
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit të mesëm të përgjithshëm  ✚ Rikonstruksion i shkollave të arsimit të mesëm	Çdo vit 2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin,  Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Drejtoria e Arsimit	Buxheti i Bashkisë, Bashkefinancim me Qeverinë Shqiptare	Nr. i infrastukturës shkollore të arsimit të mesëm të përgjithshëm e rikonstruktuar
Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit parauniversitar	Çdo vit 2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin,  Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruktura;  Përmirësim i kushteve
Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për shkollat në kuadër të planit për përmirësim të arsimit	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin,  Njësia përgjegjëse	Kopshtet/ shkollat;  Ekspertë të	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në	Një regjistër i shërbimit për arsimin baze dhe atë të mesëm i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna

parauniversitar

për shërbimet  
publike dhe  
investimet

jashtëm  
për  
mbështetje  
punë)

**Qëllimi 2 (Q2) – Zhvillimi i plotë i fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar në një sistem gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre**

**Objektivi specifik O2.1 Të zgjerohet ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes psiko-sociale dhe të angazhohen mësues ndihmës për të mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta ose në rrezik social.**

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në shkollat.	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin	Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak; Prindërit	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Struktura menaxhuese në shkolla aktive  Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të shkollave
Ofrimi i shërbimit psiko-social në shkolla	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin,  Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore;  Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat  OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin;	Shkollat, Njësitë Administrative,	Buxhet vendor + donacione +	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe

		Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	OJQ	projekte sociale	grupet vulnerabel të mbështetur
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera	2027–2029	Njësia përgjegjëse për arsimin;  Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	MAS, mësues, komuniteti	Buxhet vendor + shpërblime nga MAS	Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkëlqyera të mbështetur

**Objektivi specific O2.3 Të forcohet ndërveprimi shkollë–familje–komunitet përmes strukturave të përfaqësimit (këshillat e prindërve, bordet shkollore) dhe aktiviteve të përbashkëta me komunitetin për promovimin e barazisë dhe përfshirjes.**

Aktivitete	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për prindërit dhe kujdestarët, veçanërisht në lagje dhe fshatra me mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.	2027- 2029	Drejtoria e Arsimit në Bashki	Drejtoria e Shëndetësisë, OJF lokale, Këshillat e Prindërve	Zëri 602 – Mallra dhe shërbime; Donatorë lokalë  OSHC	- Numri i fushatave të realizuara - Numri i prindërve të informuar
Nxitja e përfshirjes së këshillave të prindërve dhe organizatave komunitare lokale në proceset vendimmarrëse, planifikuese dhe monitoruese të shërbimit arsimor, me qëllim rritjen e transparencës dhe bashkëpronësisë	Tremujori I–IV 2027, 2028, 2029 (proces i vazhdueshëm)	Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bordi i Shkollës, Këshillat e Prindërve, Komuniteti lokal	Zëri 600 dhe 606 – Orë pune, mbledhje dhe aktivitete komunitare	- Numri i këshillave funksionale - Frekuentimi i takimeve - Propozime të komunitetit të reflektuara në vendimmarrje

**Qëllimi 3 (Q3)– Zhvillimi i aftësive, talenteve dhe ndjesisë së përkatësisë përmes veprimtarive jashtëkurrikulare dhe bashkëpunimit komunitar**

<b>Objektivi specifik O3.1 Të inkurajohet bashkëpunimi me institucione kulturore, sportive dhe artistike në qytet për të krijuar sinergji dhe mundësi të reja edukative për fëmijët.</b>					
<b>Aktivitete</b>	<b>Periudha zbatimit</b>	<b>Përgjegjës</b>	<b>Partnerë</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Tregues</b>
<b>Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit:</b>	Çdo vit	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Prindër, OJQ	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse
<b>1.</b> Fushata “Dhuro një libër” (me bashkëpunimin e institucioneve kulturore)	Prill	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Qendra Kulturore, Biblioteka, Prindër	Mbështetje donatorësh, Buxhet vendor	Numri i librave të dhuruar; numri i fëmijëve të përfshirë
<b>2.</b> Aktivitet në hapësira publike me mbështetjen e institucioneve vendore ✚ Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera	Maj–Qershor	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bashkia, Drejtorja e Kulturës, Policia Bashkiake	Bashkia, partnerë lokalë	Numri i fëmijëve pjesëmarrës; numri i punimeve ekspozuar
<b>3.</b> Marshim festiv me bashkëpunim ndërsektorial për Festat Kombëtare	Nëntor	Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore	Bashkia, Drejtorja e Arsimit, Policia Bashkiake, MAS	Buxhet vendor, sponsorizime private	Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku

## Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

### Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

### Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore.

Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënit;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

### Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

### Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara
2. Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor

## Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbliidhen në nivel objektivi. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

*Perqindja e realizimit te objektivit = (Pike te realizuara/Piket maksimale) × 100*

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

## Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

*Perqindja e pjesemarrjes = (Numri real i pjesemarrësve/Numri target) × 100*

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

## Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis

objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

### Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2028)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

### Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një **instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale** për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Korçë.

### Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparenca, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

## Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

### Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen 0Vendore”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/2017**, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

### Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

### Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

### Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. 1 Datë 18.06.2026

**PËR**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË VAU I DEJËS 2026-2028**

Në bazë të: Ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore"(i ndryshuar); Ligjit nr. 44/2015," Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Ligjit nr 68/2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" (i ndryshuar); Ligjit nr. 152/2013 "Për Nënpunësin Civil", Ligjit nr 9131, datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike", Ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit"(i ndryshuar); Ligjit nr 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcionit Shtetëror (i ndryshuar); Ligjit nr.146/2014 " Për Njoftimin dhe Konsultimin me Publikun"; Strategjine Ndërsektorale të Reformës në Administratën Publike 2022-2030; Udhëzimet e Ministrisë së Brendshme dhe të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për forcimin e integritetit institucional në nivel lokal dhe sipas relacionit të hartuar nga Grupi i Punës Urdhër nr.340, datë 05.05.2026, i cili përcakton objektivat, masat dhe përgjegjësitë për përmirësimin e qeverisjes lokale, përmes menaxhimit të rreziqeve për integritetin dhe krijimit të një kulture institucionale të ndershmërisë dhe përgjegjshmërisë publike i propozon Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën 2026-2028, i cili synon forcimin e parimeve të etikës, transparencës, llogaridhënies dhe luftës kundër korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes vendore.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe struktura përkatëse përgjegjëse për etikën dhe integritetin që të sigurojnë zbatimin e planit dhe të raportojnë çdo vit në Këshillin Bashkiak për ecurinë e zbatimit të tij.

**KRYETAR  
KRISTIAN SHKRELI**

**NE MUNGESË DHE ME URDHËR,  
ZV/KRYETAR  
Aleksanda GJONI**

Konceptoi: Xhuan Mardoda  
Konfirmoi bazen ligjore: Marinela Deda



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**RELACION**

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU I DEJËS**

**PËR**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË VAU I DEJËS 2026-2028"**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi "Për miratimin e planit të integritetit të Bashkisë Vau Dejës 2026-2028", ka si synim kryesor që të sigurojë funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në nivel bashkie si dhe do të ndihmojë administratën vendore në përpjekjet e saj për forcimin e etikës dhe integritetit.

Objektivat e këtij plani janë:

1. Pasurimin e kuadrit strategjik të institucionit të bashkisë.
2. Promovimin e vlerave të mirëqeverisjes
3. Rritjen e besimit të qytetarëve tek institucioni
4. Sigurimin e shërbimeve cilësore për komunitetin
5. Garantimi i një niveli sa më optimal të transparencës, llogaridhënies si edhe përfshijes e pjesëmarrjes së publikut në vendimarrjen e bashkisë.
6. Bashkepunimin sa më efektiv dhe të shpejtë ndërmjet zyrave, sektorëve dhe drejtorive.

Plani i Integritetit për Bashkinë Vau Dejës ka një rëndësi të madhe për disa arsye thelbësore:

Forcimi i Integritetit Institucional: Ky plan ndihmon në forcimin e integritetit institucional duke vendosur standarde të larta etike dhe profesionale për të gjithë punonjësit dhe drejtuesit e bashkisë.

Parandalimi i Korrupsionit Duke identifikuar dhe vlerësuar risqet e integritetit, plani kontribuon në parandalimin e praktikave korruptive dhe parregullsive të tjera, duke rritur kështu besimin e publikut në administratën lokale.

Rritja e Transparencës dhe Llogaridhënies. Plani promovon transparencën dhe llogaridhënien në të gjitha veprimtaritë e bashkisë, duke siguruar që vendimet dhe veprimet e ndërmarra janë të hapura dhe të arsyetuara mirë.

Menaxhimi Efektiv i Burimeve Njerëzore Plani përfshin zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore me aftësi të nevojshme për identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit, duke siguruar një administratë më të aftë dhe më të përgjegjshme.

Përmirësimi i Shërbimeve për Qytetarët. Duke përmirësuar etikën dhe Integritetin në administratë, plani ndihmon në ofrimin e shërbimeve më cilësore dhe të besueshme për qytetarët e Vau të Dejës.

Ndërveprimi më i Mirë me Publikun. Me rritjen e transparencës dhe ndërveprimin me publikun,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

plani ndihmon në krijimin e një marrëdhënieje më të fortë dhe më të besueshme midis bashkisë dhe qytetarëve.

Menaxhimi i Riskut. Duke përfshirë menaxhimin e riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë, plani siguron një qasje proaktive për identifikimin dhe trajtimin e risqeve të mundshme përpara se ato të bëhen problematike.

Miratimi i planit të Integritetit, pasqyron përkushtimin e Bashkisë për të hedhur themelet e një sistemi më të gjerë, që menaxhon risqet që kërkënojnë integritetin institucional në Bashkinë tonë. Synimet tona të shprehur në këtë dokument, lidhen me krijimin e një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetit në të gjitha fushat përgjegjësisë së institucionit, me fokus ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë transparente, efikase dhe eficiente..

Bashkia është e vendosur të rrisë nivelin e llogaridhënies, transparencës, efektivitetit të burimeve njerëzore, sjelljes dhe komunikimit, brenda dhe jashtë institucionit, duke rritur besimin publik në institucionet. Në këto kushte, ftojme këshilltarët ta miratojnë këtë Projekt-Vendimi.

**DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE**

# PLANI I INTEGRITETIT BASHKIA VAU I DEJES

**2026-2029**

**Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Bashkinë Vau Dejës**

**Sabah Ymeri-Sekretar i Pergjithshëm  
Marinela Deda-Drejtor/Drejtorja Juridike  
Xhuana Mardoda-Drejtor/Drejtorja e Burimeve Njerzore  
Ana Shurdha-Drejtor/Drejtorja Urbanistikes dhe Planifikimit të Territorit  
Arta Paluku-Përgjegjës/Auditi i Brendshëm  
Dorina Lini-Përgjegjës/Prokurimet Publike  
Elsa Tanushi-Drejtor/Drejtorja Ekonomike**

**Ky Plan Integriteti është rezultat i angazhimit të Bashkisë Vau i Dejës për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe etikën në veprimtaritë dhe vendimmarrjen e pushtetit vendor. Përmbajtja e këtij plani pasqyron analizat, vlerësimet dhe rekomandimet profesionale të përgatitura me kujdes dhe përkushtim, me qëllim ngritjen e mekanizmave të brendshëm për mbrojtjen e integritetit institucional dhe parandalimin e praktikave të cenueshme ndaj tij. Ky dokument synon të shërbejë si një udhërrëfyes praktik për organet e qeverisjes vendore.**

### **Deklarata e Integritetit Institucional**

Forcimi i integritetit është thelbësor për të garantuar një mjedis të shëndetshëm me një standart të lartë për menaxhimin e burimeve publike dhe shërbimin ndaj qytetarëve. Me vullnetin për të forcuar kulturën pro-integritet në bashkinë tonë, u hartua dhe u miratua ky dokument strategjik që synon një përgjegjshmëri më të lartë në kryerjen e detyrave funksionale dhe një mekanizëm antikorrupsion. Plani i Integritetit do të udhëheqë punën e Bashkisë Vau i Dejës në tre vitet e ardhshme me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj korrupsionit dhe sigurimin e një cilësie më të lartë shërbimesh publike.

Ky plan është rezultat i një procesi gjithpërfshirës vetëvlerësimi, ndërmjet strukturave të brendshme të bashkisë, të cilat u angazhuan të vlerësojnë dhe trajtojnë risqet e shkeljes së integritetit në të gjitha veprimtaritë e bashkisë. Me miratimin e tij, bashkia angazhohet të ndërmarrë të gjitha masat e parashikuara për të parandaluar apo zvogëluar risqet e integritetit si dhe mundësinë e ndodhjes apo ndikimit të tyre. Më tej, bashkia merr përsipër përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies publike duke nxitur dhe mundësuar përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Implementimi I tij është I domosdoshëm për të përballuar sfidat me të cilat përballet qeverisja vendore, me qëllim kryesor rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve dhe për t'i shërbyer sa më mirë interesave të komunitetit.

**Kristian Shkreli**  
**Kryetar i Bashkisë Vau Dejës**

## **Tabela e përmbajtjes**

<b>1. Rëndësia e Planit të Integritetit .....</b>	<b>5</b>
1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit.....	6
1.2 Qasja metodologjike .....	8
<b>2. Objektivat e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit .....</b>	<b>8</b>
<b>3. Plani i veprimit .....</b>	<b>10</b>

## I. Rëndësia e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një mekanizëm institucional për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit të bashkisë. Ky instrument rrjedh nga objektivat strategjike për zhvillimin dhe miratimin e politikave antikorrupsion në nivel vendor të parashikuara në draft Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planin e Veprimit në zbatim të saj<sup>1</sup>.

Plani i Integritetit për Bashkinë Vau i Dejës do të ketë një rol shumë të rëndësishëm në realizimin e objektivave të tij në Bashki, në Njësi vendore me qëllim funksionimin në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike në ofrimin e shërbimeve eficiente ndaj qytetarëve.

## II. Përkufizimi dhe Vizioni

Integriteti në administratën publike është një parim themelor që garanton besueshmërinë, transparencën, llogaridhënien dhe etikën në veprimtaritë dhe vendimmarrjet institucionale. Integriteti institucional bëhet një nga shtyllat kryesore për ndërtimin e besimit të qytetarëve në institucionet publike. Ai nënkupton jo vetëm përmbushjen e normave ligjore, por edhe adoptimin e vlerave morale dhe etike që garantojnë veprime të drejta, të paanshme dhe transparente. Plani i Integritetit për Bashkinë Vau i Dejës synon të ndërtojë dhe forcojë një mjedis institucional ku integriteti është i garantuar në të gjitha nivelet e organizatës, duke krijuar kështu një standard të lartë për shërbimin publik dhe menaxhimin e burimeve publike. Vizioni ynë është të krijojmë një administratë lokale që është model i qeverisjes së mirë, e cila vepron me përgjegjësi, transparencë dhe respekt për të drejtat dhe interesat e qytetarëve.

## III. Qëllimi i Planit të Integritetit

Qëllimi kryesor i këtij plani është të hartojë dhe zbatojë një strategji të qartë dhe të qëndrueshme për promovimin dhe ruajtjen e integritetit në Vau i Dejës. Ai ka për synim të identifikojë dhe adresojë sfidat dhe rreziqet që mund të cenojnë etikën dhe transparencën në veprimtarinë e përditshme, duke vendosur mekanizma të fortë për parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e shkeljeve. Në këtë kuadër, plani synon të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, rritjen e besimit të qytetarëve dhe krijimin e një mjedisi pune të shëndetshëm dhe profesional për stafin.

---

<sup>1</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 516 datë 1.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 247 datë 20.3.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020" dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatorëve.

Ky plan shërben gjithashtu si një mjet për përputhjen me kërkesat ligjore dhe rekomandimet europiane, duke mbështetur aspiratat e Shqipërisë për integrim në Bashkimin Europian dhe zhvillim demokratik të qëndrueshëm.

Specifikisht bazuar në tre qëllime politikash:

Parandalim - Politika e parë synon konsolidimin dhe zhvillimin e instrumenteve dhe mekanizmave të parandalimit të korrupsionit, duke promovuar integritetin dhe etikën përgjatë të gjitha hallkave të qeverisjes, si në nivel vendor. Parandalimi i korrupsionit ul nevojën për ndëshkim penal dhe ka një impakt më të gjerë në promovimin e besimit të publikut dhe qeverisjes së mirë të zyrtarëve publikë.

(III) Ndërgjegjësim - Nëpërmjet politikës së tretë strategjia synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit kundër korrupsionit, përmes forcimit të edukimit mbi integritetin në sistemin arsimor parauniversitar, përgjatë të gjithë cikleve të tij, si dhe forcimin e edukimit të sektorit publik, me qëllim garantimin e një sektori publik përgjegjës dhe llogaridhënës para shoqërisë.

Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në qeverisjen vendore.

#### IV. Objektivat kryesore për arritjen e këtyre qëllimeve do të jenë:

Objektivi 1. Përmirësimit të mekanizmave rregullatorë dhe strategjikë të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit.

- Përputhshmëria me ligjet kombëtare dhe normat europiane që rregullojnë integritetin, etikën dhe transparencën në administratën publike.
- Përmirësimi i rregulloreve dhe politikave të brendshme që mbështesin këto standarde.

Objektivi 2. Sigurimi një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki.

- Zhvillimi i kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme në fushën e etikës dhe integritetit.
- Implementimi i sistemeve të vlerësimit dhe incentivimit që promovojnë sjellje etike dhe profesionale.

Objektivi 3: Rritja e Transparencës dhe Pjesëmarrjes Publike

- Përmirësimi i komunikimit me qytetarët dhe aksesit në informacionin publik.
- Krijimi dhe forcimi i mekanizmave të pjesëmarrjes dhe konsultimit të qytetarëve në vendimmarrje.

Objektivi 4. Integrimi me Standardet Europiane dhe Praktikrat më të Mira Ndërkombëtare - Harmonizimi i politikave dhe praktikave të Bashkisë Vau i Dejës me kërkesat dhe rekomandimet e Bashkimit Europian.

- Përdorimi i instrumenteve dhe metodologjive bashkëkohore për promovimin e integritetit

Objektivi 5 . Rritja e efektivitetit të veprimtarisë së bashkisë nëpërmjet menaxhimit të riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë.

- Përmirësimi I menaxhimit financiar
- Forcimi I auditit të brendshëm

Bashkia ka zbatuar një proces gjithpërfshirës të planifikimit të integritetit gjatë periudhës dhjetor 2025 – qershor 2026

Plani i Integritetit i miratuar nga Këshilli Bashkiak, është i detyrueshëm për zbatim në Bashkinë Vau i Dejës dhe thelbi i tij është të parandalojë, zvogëlojë dhe eliminojë risqet dhe mundësitë për zhvillimin e korrupsionit dhe parregullsive të tjera, shkeljeve etike dhe sjelljeve joprofesionale në bashki.

### **1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Vau i Dejës**

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit përfshiu fushat e veprimtarisë së bashkisë brenda të cilave u identifikuan dhe u vlerësuan risqe që ndikojnë apo mund të ndikojnë në efikasitetin, cilësinë e punës dhe kryerjen e saj me integritet. Përgjatë procesit të vlerësimit të risqeve të integritetit të identifikuar, , në konsultim me anëtarët e grupit të punës, përcaktuan masat përkatëse për menaxhimin e tyre. Proceset e punës dhe funksionet/pozicionet që u morën në analizë i përkasin shtatë fushave të veprimtarisë së bashkisë, të pasqyruara në dokumentin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore: i) Fusha e menaxhimit financiar; ii) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit; iv) Fusha e shërbimeve publike; v) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave; vi) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit; vii) Fusha e arkivimit, ruajtjes, administrimit të dokumenteve dhe të informacionit, si dhe të dokumenteve elektronike.

Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Vau i Dejës kaloi në fazat e mëposhtme:

#### **Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore**

Procesi filloi me miratimin e Urdhrit të Kryetarit të **Bashkisë nr. 218 datë 05.04.2026** “Për ngritjen e Grupit të Punës për zhvillimin e Planit të Integritetit në Bashkinë Vau i Dejës”. Në grupin e punës u përfshinë drejtues dhe punonjës të drejtorive të bashkisë që mbulojnë fushat përgjegjëse së saj.

#### **Faza 2: Identifikimi dhe analizimi i risqeve të integritetit**

Në këtë fazë Grupi i Punës kryen identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit. Ky proces përfshiu vlerësimin e kuadrit të brendshëm rregullator të bashkisë, realizimin e 7 grupeve të diskutimit (fokus-grupe) me përfaqësues të drejtorive të ndryshme. Grupi i Punës përdori të dhënat e mbledhura dhe analizën cilësore për të vlerësuar situatën aktuale të ekspozimit të bashkisë ndaj korrupsionit dhe parregullsive të tjera.

### **Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit**

Grupi i Punës në bashki, kreu vlerësimin e intensitetit të risqeve të integritetit të identifikuara në fazën e mëparshme, duke marrë në konsideratë mundësinë e ndodhjes apo shfaqjes së risqeve si dhe impaktin e tyre në integritetin e bashkisë. Në këtë fazë u vlerësua cilat risqe janë relevante në kontekstin e bashkisë për tu trajtuar me masat përkatëse. Procesi vijoi me renditjen e risqeve sipas prioritetit dhe u përcaktua se cilat prej tyre do të ndiqen me përparësi duke vënë në dispozicion burimet ekzistuese të bashkisë për trajtimin e tyre.

### **Faza 4: Plani i veprimit për menaxhimin e integritetit dhe miratimi**

Grupi i Punës propozoi masa kontrolli, rekomandime dhe aktivitete për adresimin e risqeve të integritetit me qëllim parandalimin, zvoglimin dhe eliminimin e tyre. Në këtë fazë u përcaktuan strukturat përgjegjëse në bashki për zbatimin e masave të kontrollit si dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.

## **1.2 Qasja metodologjike**

Grupi i Punës, në procesin e zhvillimit të Planit të Integritetit, ka zbatuar dy metoda kryesore për të analizuar dhe vlerësuar cenueshmërinë e integritetit: metoda cilësore dhe ajo sasiore. Metoda cilësore përfshiu analizën e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të bashkisë (shqyrtim literature), përkatësisht: Rregulloren për Organizimin, Funkionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Vau i Dejës; Rregulloren e Këshillit Bashkiak Vau i Dejës; Vendimin për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të tjera 2025; Kodin e Sjelljes dhe Parandalimit të Konfliktit të Interesit të Këshilltarit Bashkiak; Kartën e Auditit të Brendshëm; Kodin e Etikës së Audituesit; Rregulloren për Ankesat, Kërkesat dhe Peticionet; Rregulloren e Këshillit Bashkiak për Marrëdhënien me Publikun dhe Median, raportet e auditimit të brendshëm etj. Përveç dokumenteve politike dhe rregullatore të brendshme, u shqyrtuan raporte të ndryshme të jashtme në lidhje me veprimtarinë e bashkisë duke përfshirë raporte të auditimit të jashtëm (raporte të Kontrollit të Lartë të Shtetit), raporte të Komisionerit për Shërbimin Civil etj. Ky proces përfshiu edhe monitorimin e Programit të Transparencës së Bashkisë me qëllim identifikimin e kategorive të informacionit të bërë publik.

Në vijim, Grupi i Punës kanë analizuar të dhënat e mbledhura nga 3 fokus-grupe (grupe diskutimi) me stafin e drejtorive të ndryshme të bashkisë, për të identifikuar ngjarje negative në realizimin e proceseve të punës, praktika pune dhe funksione të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjellje joetike e joprofesionale dhe parregullsi të tjera.

## **1. Objektivat e Planit të Integritetit**

### *2.1 Përmirësimi i mekanizmave rregullatorë dhe strategjikë të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit*

Në zbatim të objektivit të parë, bashkia do të rishikojë dhe plotësojë kuadrin e brendshëm rregullator në disa fusha të veçanta për të siguruar përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, duke pasqyruar në organigramën disa funksione dhe detyra në bashki që lidhen drejtpërdrejt me mekanizmat rregullatorë të etikës dhe integritetit. Më tej, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive mbi çështje të etikës, parandalimit të konfliktit të interesit dhe sinjalizimit, synohet të shtohet reagimi ndaj shkeljeve të integritetit. Më tej parashikohet hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të veprimit për rregullimin e disa proceseve të veçanta të punës si dhe i disa dokumenteve me natyrë strategjike.

### *2.2 Konsolidimi i një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki*

Në zbatim të objektivit të dytë, bashkia synon konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore. Objektivi përfshin ndërmarrjen e masave/aktiviteteve që synojnë përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të bashkisë, duke adresuar nevojat specifike profesionale të personelit. Më tej masat e përcaktuara synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë së administratës, si dhe komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet njësive të bashkisë.

## **3: Rritja e Transparencës dhe Pjesëmarrjes Publike**

- Përmirësimi i komunikimit me qytetarët dhe aksesit në informacionin publik.
- Krijimi dhe forcimi i mekanizmave të pjesëmarrjes dhe konsultimit të qytetarëve në vendimmarrje.

Publikimi i të dhënave mbi buxhetin në faqen zyrtare të bashkisë dhe zhvillimi i konsultimeve publike për çështje të rëndësishme janë tregues pozitivë për angazhimin në transparencë dhe përfshirje qytetare. Megjithatë, mekanizmat e ndërveprimit dhe matjes së mendimit qytetar janë të kufizuar.

Krijimi i zyrës për marrëdhënie me komunitetin dhe realizimi ndonjë matje sistematike e kënaqësisë së qytetarëve. Ngelet detyre që mekanizmi i ankesave aktualisht formal dhe i kufizuar në adresën postare të institucionit, të funksionojë në një platformë të posaçme apo format të thjeshtuar për qytetarët.

Në përputhje me standardet e qeverisjes së hapur të promovuara nga BE, është e domosdoshme të zhvillohen mekanizma më aktivë për pjesëmarrje, si pyetësorë online, takime komunitare të strukturuar dhe zyrë për marrëdhënie me publikun. Përmirësimi i këtyre aspekteve rrit besimin e qytetarëve dhe ndihmon në ndërtimin e një administrate më të përgjegjshme

4. Integrimi me Standardet Europiane dhe Praktikate më të Mira Ndërkombëtare -  
Harmonizimi i politikave dhe praktikave të Bashkisë Sarandë me kërkesat dhe rekomandimet  
e Bashkimit Europian.

- Përdorimi i instrumenteve dhe metodologjive bashkëkohore për promovimin e integritetit

### *2.3 Rritja e efektivitetit të veprimtarisë së bashkisë nëpërmjet menaxhimit të riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë*

Në zbatim të objektivit të tretë, bashkia synon menaxhimin e riskut të integritetit institucional në fusha të veçanta të përgjegjësisë: menaxhimi financiar; auditimi i brendshëm dhe kontrolli; shërbimet publike; transparencë; administrimi i pronave dhe menaxhimi i territorit; arkivimi i dokumentave. Masat e parashikuara nën këtë objektiv synojnë reduktimin ose eliminimin e risqeve të identifikuara në këto fusha. Ky objektiv përfshin shumicën e masave të këtij Plani Integriteti duke qenë se dhe rëndësia e këtyre fushave është më e madhe, nisur nga misioni i bashkisë.

### **Plani i Veprimit**

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave që synojnë të adresojnë risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit, të vlerësuara sipas fushave të përgjegjësisë së Bashkisë Vau i Dejës. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikente, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimëve për planifikim më të mirë në të ardhmen. Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e masave të Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i bashkisë, i cili është përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmuajore.

## Objektivi 1: Përmirësimi i mekanizmave rregullatorë dhe strategjikë të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i mesatar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1.	Rishikimi i rregullores së brendshme. Rregullorja aktuale është miratuar në vitin 2022	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> <li>Rishikimi i Rregullores së Brendshme të Bashkisë me qëllim përditësimin me strukturën aktuale të institucionit dhe adresimin e masave të tjera të parashikuara në këtë plan.</li> <li>Publikimi i rregullores së rishikuar në Programin e Transparencës së bashkisë.</li> </ol>	<p>Grupi i punës i caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë për rishikimin e rregullores.</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit Gjashtëmujori i dytë i 2026-it</p>

2.	Rregullorja e brendshme nuk parashikon funksionin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatorit për Konsultimin Publik.	Operacionet / Strategjik	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Parashikimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë i funksionit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatorit për Konsultimin Publik. Parashikimi i detyrave dhe përgjegjësi të këtyre koordinatorëve si dhe detyrimeve të drejtorive të bashkisë në raport me koordinatorët, duke parashiku</li> <li>2. ar kërkesat për komunikim dhe shkëmbim informacioni brenda afateve të kërkuara.</li> </ol>	<p>Grupi i punës i caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë për rishikimin e rregullores.</p> <p>Gjashtëmujori i dytë i 2026-it</p>
3.	Rregullorja e brendshme nuk parashikon detyrimet e drejtorive të bashkisë gjatë procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm.	Burimet Njerëzore / Strategjik	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rishikimi i Rregullores së Brendshme të Bashkisë për të përcaktuar detyrimet e secilës drejtori, gjatë procesin të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, rregullat e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre, si dhe detyrimet për respektimin e afateve në këtë proces.</li> </ol>	<p>Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike,</p> <p>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit</p> <p>Grupi i Punës i caktuar me udhër të Kryetarit të Bashkisë për rishikimin e rregullores.</p> <p>Gjashtëmujori i dytë i 2026</p>

4.	Rregullorja e Brendshme e bashkisë është e papërditësuar (Nuka ka një document të vetëm strategjik për Bashkinë Vau i Dejës Ka plane të veçanta sipas fushveprimeve dhe jo për të gjithë sektorët, por nuk ka një document që të koordinojë objektivat dhe aktivitetet e këtyre planeve sektoriale	Operacionet(Procesi) / Strategjik	Po hartohet plani I ri I cili eshte ne process dhe pritet te finalizohet ne vitin 2025.Kemi kerkuar bashkepunim me organizata te ndryshme per te na dhene suportin e tyre pasi kemi mungese fondesh.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rishikimi i Planit Strategjik të Zhvillimit duke përcaktuar aktivite konkrete për çdo drejtori, afate, indikatorë, si dhe mënyrën e monitorimit të planit.</li> <li>2. Konsultimi i Planit Strategjik të Zhvillimit me publikun, sipas parashikimeve të Rregullores së KB-së për marrëdhënien më publikun dhe median.</li> <li>3. Publikimi i planit të rishikuar në Programin e Transparencës.</li> </ol>	<p>Grupi i punës i caktuar me udhër të Kryetarit të Bashkisë</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p> <p>Gjashtëmuji i dytë i 2025-it</p>
5.	Mungesa e një strategjie për administrimin e pronave të bashkisë.	Operacionet(Procesi)/Strategjik	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi, miratimi dhe publikimi i dokumentit të strategjisë për administrimin e pronave të bashkisë, e cila të përkojë me vizionin afatgjatë të bashkisë dhe të ardhurat e pritshme në buxhet.</li> </ol>	<p>Spektori i Pronave Publike dhe Aseteve</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit.</p> <p>Gjashtëmuji i parë i 2027-ës.</p>
6.	Mungesa e rregullave të brendshme për procesin e monitorimit të kontratave publike.	Operacionet(Procesi)/ Ligjor dhe Kontraktual	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Me urdher te Titullarit te Autoritetit Kontraktor jane percaktuar menytrat e funksionimit te mbikqyrjes se kontratave publike.</li> <li>2. Trajnimi I punonjesve do te kryhet sipas kalendarit te percaktuar</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1.</li> <li>2.</li> <li>3. Hartimi dhe miratimi i një PSV-je mbi metodat e monitorimit të kontratave publike.</li> <li>4. Organizimi i trajnimeve të brendshme për stafin e përfshirë në monitorimin e kontratave publike, për të siguruar njohje sa më të mirë të PSV-së së miratuar.</li> </ol>	<p>Spektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Investimeve</p> <p>Gjashtëmuji i dytë i 2027-it</p>

			nga Shkolla shqiptare e Administrases Publike. 3. Aplikimi I trajnimeve behet sipas kalendarit te percaktuar nga ASPA.	3. Përfshirja e këtij trajnimi në Planin Vjetor të Trajnimeve.	
7.	Njohuri të pamjaftueshme të personelit të bashkisë për procedurat e sinjalizimit, funksionin e sinjalizuesit dhe kontaktin e njësisë së sinjalizimit.	Burimet Njerëzore / Strategjik	1. Trajnimi I punonjesve do te kryhet sipas kalendarit te percaktuar nga Shkolla shqiptae e Administrases Publike. 2. Rregullorja e sinjalizuesve eshte bere publike ne faqen online ne faqen e Bashkise Vau i Dejës	1. Organizimi i trajnimeve për personelin e bashkisë në lidhje me procedurat e sinjalizimit. Përfshirja e tyre në Planin Vjetor të Trajnimeve. 2. Informimi i të gjithë punonjësve mbi Rregulloren e Sinjalizuesit dhe vënia në dispozicion e saj. 3. Rikujtesë periodike e punonjësve mbi funksionin dhe kontaktin e sinjalizuesit. 4. Publikimi i informacionit për njësinë e sinjalizimit dhe kontaktet e saj në Programin e Transparencës.	Njësia e Auditit të Brendshëm  Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmuji i dytë i 2027-it
8.	Mungesa e regjistrimit për deklarimin e dhuratave në bashki.	Operacionet / Indicie Korrupsioni	Mesatar	1. Krijimi i regjistrimit për deklarimin e dhuratave në bashki. 2. Informimi i personelit në lidhje me krijimin e regjistrimit dhe detyrimet që lidhen me deklarimin e dhuratave.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Gjashtëmuji i dytë i 2027
9	Mungesa e gjurmës së miratuar të auditimit	Operacionet /ligjor	Mesatar	Titullari I njësisë publike miraton gjurmen e auditimit për procedurat kryesore dhe siguron që të gjitha operacionet e institucionit të dokumentohen në atë formë. Gjurma e auditimit të arkivohet sipas dispozitave ligjore.	Njësia e Auditit të brenshëm  Drejtoria  Ekonomike  Drejtoria Juridike

					Gjashtëmujori i dyte 2026
--	--	--	--	--	------------------------------

## Objektivi 2: Konsolidimi i një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
9.	Mungesa e funksionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si nëpunësi më i lartë civil në administratën e bashkisë cenon procesin e mbikëqyrjes së performancës.	Operacionet(Procesi)/ Strategjik	1. Bashkia Vau i Dejes ka miratura ne strukture pozicionin Sekretari I Pergjithshem, miratimi dt 26.12.2025	1. Përcaktimi i pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm në strukturën e bashkisë. 2. Emërimi i Sekretarit të Përgjithshëm të bashkisë, në përputhje me Rregulloren e Brendshme të institucionit e cila rregullon këtë funksion në bashki.	Kryetari i Bashkisë  Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Gjashtëmujori i dytë i 2026

10.	Mungesa e qëndrueshmërisë së nëpunësve civilë në bashki, si rrjedhojë e ristrukturimeve të shpeshta të institucionit.	Burimet Njerëzore/Operacional	<p>1. Per periudhen janar – dhjetor 2025 nuk ka patur levizje te punonjesve civile.</p> <p>2. Ne rregulloren e Bashkise Vau i Dejës jane percaktuar te gjitha detyrat funksionale te nepunesve.</p>	<p>1. Kryerja e analizës së nevojave si parakusht i ndryshimeve strukturore. (Analiza të përfshijë vlerësimin e funksioneve dhe detyrave ekzistuese referuar strukturës/organikës së bashkisë; vlerësimin e pozicioneve të punës që mund të kenë mbivendosje detyrash).</p> <p>2. Përcaktimi i këtij detyrimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë.</p>	<p>Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike</p> <p>Grupi i punës i caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë për rishikimin e rregullores. Gjashtëmujori i dytë i 2027</p>
11.	Mbingarkesa e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për shkak të përfshirjes së shpeshtë në procedura të prokurimit publik.	Burimet Njerëzore / Operacional	<p>1. Ne strukturen e miratuar te bashkise Vau i Dejës eshte krijuar nje sektor I veçante per prokurimet publike.</p>	<p>1. Përfshirja e punonjësve të drejtorive të tjera të bashkisë në procedurat e prokurimit publik, për të reduktuar mbingarkesën e personelit të Drejtorisë së Financës.</p>	<p>Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike</p> <p>Gjashtëmujori i dytë i 2026</p>

12.	Njohuri të kufizuara të personelit në fushën e komunikimit publik.	Burimet Njerëzore / Reputacional dhe Imazhi	1. Per punonjesit e Administrates po behen trajnime sipas kalendarit te Shkolles Shqiptare te Administrates Publike	1. Organizimi i trajnimeve të brendshme në fushën e komunikimit publik. (me prioritet për: inspektorët tatimorë, punonjësit e monitorimit të kontratave dhe prokurimeve publike, punonjësit e One Stop Shop-it, punonjës të tjerë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët.) 2. Parashikimi i këtyre trajnimeve në Planin Vjetor të Trajnimeve.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Gjashtëmujori i i dytë i 2027
13.	Mungesë aplikimesh për vende pune të shpallura “vakante”.	Burimet Njerëzore/Operacional	1. Per plotesimin e pozicioneve vakante jane bere shpalljet e pozicioneve te punes prane Shërbimit Kombetar të punesimit .	1. Hartimi dhe miratimi i një dokumenti të brendshëm politik në lidhje me zhvillimin profesional dhe promovimin/ngritjen në detyrë për të motivuar punonjësit aktualë dhe ata potencialë të bashkisë. 2. Informimi i personelit të bashkisë mbi këtë dokument të miratuar. 3. 3. Publikimi i këtij dokumenti në Programin e Transparencës së bashkisë.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmujori i dytë i 2026
14.	Komunikimi zyrtar i punonjësve të bashkisë shpesh kryhet nëpërmjet adresave personale të e-mailit.	Teknologjia e Informacionit/ Reputacional dhe Imazhi	Po,jane pajisur te gjithe me adresa zyrtare, sipas AKSHI	1. Pajisja e të gjithë personelit të bashkisë me e-maile zyrtare. 2. Rikujtesa periodike për personelin e bashkisë në lidhje me detyrimin për të përdorur adresën zyrtare të e-mailit gjatë punës.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Specialisti IT-së  (në koordinim me AKSHI-n)

					Gjashtëmuji i i parë i 2027
15.	Burime njerëzore të pamjaftueshme pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.	Burimet Njerëzore / Operacional	1. Nuk plotesohen pozicionet vakante me specialist ne fushen inxhinierike te ndertimit.	1. Kryerja e një analize për të vlerësuar nevojat për personel shtesë në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. (inxhinier ndërtimi) 2. Dorëzimi i kësaj analize te titullari i bashkisë.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Gjashtëmuji i i parë i 2027
16.	Raste punësimi në bashki, në mospërputhje të kualifikimeve profesionale me kriteret e shpallura për vendin e punës.	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	1. Ne lidhje me nepunesit civil eshte bere plotesimi I pozicioneve vakante sipas profesionit te kerkuar ne shpalljen e bere.	1. Publikimi i i kriterëve të sakta për çdo vakancë për pozicionet e punës që shpallen nga bashkia. 2. Realizimi i procedurave rekrutuese të rregullta në përputhje me kriteret dhe përshkrimin e punës.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike Gjashtëmuji i dytë i 2026 dhe në vazhdimësi
17.	Kapacitete teknike të kufizuara në fushën e prokurimeve publike. Ngritja e Njesisë së Prokurimeve Publike	Burimet Njerëzore / Operacional	1. Mungese e theksuar e specialistve inxhinier ndertimi.	1. Organizimi i trajnimeve të brendshme në lidhje me hartimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike për procedurat e prokurimit publik. 2. Organizimi i trajnimeve të brendshme për punonjësit e rinj që përfshihen në procedurat e prokurimeve publike. (p.sh në KVO etj.) 3. Organizimi i trajnimeve të brendshme në lidhje me ndryshimet ligjore përkatëse për punonjësit e përfshirë në procedurat e prokurimeve publike.	Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike  Gjashtëmuji i i dytë i 2027

				4. Përfshirja e këtyre trajnimeve në Planin Vjetor të Trajnimeve.	
18.	<p>1. Procesi i vlerësimit të rezultateve të punonjësve është një proces formal.</p> <p>2. Procesi i vlerësimit të rezultateve për drejtorët kryhet nga titullari i bashkisë.</p> <p>3. Procesi i vlerësimit të rezultateve të punonjësve nuk përfshin vlerësimin për detyrat shtesë të caktuara.</p>	Burimet Njerëzore/ Ligjor dhe Kontraktual	1. Nga ana jone eshte bere vleresimi I punonjesve sipas formularit te vleresimit te percaktuar ne ligjin per statusin e nepunesit civil.	<p>1. Informime periodike të drejtorëve të bashkisë për procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve dhe afatet e vlerësimit.</p> <p>2. Kryerja e vlerësimit të performancës së drejtorëve nga Sekretari i Përgjithshëm, pas rishikimit të strukturës.</p> <p>3. Rishikimi i formularit të vlerësimit të rezultateve në punë, për të shtuar një rubrikë për vlerësimin e detyrave shtesë të ushtruara nga personeli.</p>	<p>Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike</p> <p>Gjashtëmujo ri i parë i 2027-it</p>
19.	Mungesa e një plani vjetor trajnimesh të brendshme, i cili adreson nevojat profesionale të personelit të bashkisë.	Burimet Njerezore/Operacional	Mesatar	<p>1. Përcaktimi në rregulloren e brendshme i detyrimit për hartimin e Planit të Brendshëm Vjetor të Trajnimeve.</p> <p>2. Përcaktimi në rregulloren e brendshme i detyrimit për kryerjen e Analizës Vjetore të Performancës, si bazë për identifikimin e nevojave për trajnim dhe hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve.</p> <p>3. Hartimi i Planit të Brendshëm të Trajnimeve dhe Analizës së Performancës, çdo vit.</p> <p>4. Caktimi i një personi përgjegjës pranë DBNJ-së për trajnimet e personelit.</p>	<p>Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike</p> <p>Grupi i punës i caktuar me urdhër të Kryetarit</p> <p>Gjashtëmujo ri i dytë i 2027 dhe në vazhdimësi.</p>

20.	Njohuri të kufizuara të personelit të bashkisë në lidhje me legjislacionin për të drejtën e informimit, të dhënat personale, konsultimin publik dhe procedurat administrative përkatëse.	Burimet Njerëzore/Operacional	Takimet informuese janë bërë me personelin edhe pse nuk kemi një plan vjetor trajnimesh.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Organizimi i trajnimeve të brendshme me personelin e bashkisë në lidhje me legjislacionin për të drejtën e informimit, të dhënat personale dhe konsultimin publik.</li> <li>2. Parashikimi i këtyre trajnimeve në Planin Vjetor të Trajnimeve.</li> </ol>	<p>Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike</p> <p>Koordinatori për të drejtën e informimit</p> <p>Gjashtëmujori i dytë i 2027</p>
-----	--	-------------------------------	--	---	--

## Objektivi 3: Rritja e transparences dhe pjesmarrjes publike.

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1	Publik i painformuar dhe jo pjesmarrës në konsultimet për planet strategjike të bashkisë		Respektimi I kuadrit ligjor Hartimi I nje protokolliri për procedurat e konsulimeve publike	Platformë për konsultime publike online	Kryetar i Bashkisë Gjashtëmuor i i parë i 2027
2	Përqëndrim I konsultimeve vetëm në qytet dhe njësinë administrative		Organizim I konsultimeve , degjesave ne çdo qendër të banuar	Dëgjesa publike në lagje/fshatra	Burimet Njerëzore dhe Koordinatori per mardheniet me publikun Gjashtëmuor i i pare i 2027-it

3	Mosnjohje e perceptimit qytetar për mbarvajtjen e administrimit të Bashkisë		Përpilim I pyetësorëve	Matje e kënaqësisë së qytetarëve	Burimet Njerëzore dhe Koordinatori për marrëdhëniet me publikun
4	Vonesa e publikimit të projekt-vendimeve në proces shqyrtimi nga Këshilli Bashkiak.	Operacionet (Procesi/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	1. Publikimi i rregullt dhe në kohë të arsyeshme i projekt-vendimeve në proces shqyrtimi nga Këshilli Bashkiak. (para miratimit.)	Koordinatori për të Drejtën e Informimit, Koordinatori për Konsultimin Publik Sekretari i Këshillit Bashkiak Gjashtëmujori i dytë i 2027
5	Publikimi i dokumenteve në Programin e Transparencës në formate të vështira për t'u aksesuar nga publiku. (psh. zip files)	Burimet Njerëzore/ Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	1. Publikimi i dokumenteve në Programin e Transparencës në formate të thjeshta dhe lehtësisht të aksesueshme për publikun. (pdf, ëord)	Koordinatori për të Drejtën e Informimit Specialistit IT Gjashtëmujori i dytë i 2027

6	Mungesa e publikimit të të dhënave për arsimin, kualifikimet, deklarin e pasurisë dhe pagën e titullarit.	Reputacional dhe Imazhi	Mesatar	1. Publikimi në Programin e Transparencës i të dhënave për arsimin, kualifikimet, deklarin e pasurisë dhe pagën e titullarit.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmujori i parë i 2027
7	Mungesa e publikimit të vendimeve, urdhërave dhe urdhrave me karakter normativ të titullarit.	Operacionet / Strategjik	Mesatar	1. Publikimi në Programin e Transparencës i vendimeve, urdhërave dhe urdhrave me karakter normativ të titullarit.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmujori i parë i 2027
8	Informacion i kufizuar për njësitë administrative të bashkisë në Programin e Transparencës.	Operacionet / Strategjik	Mesatar	1. Publikimi i informacionit të plotë në Programin e Transparencës për njësitë administrative të bashkisë, nëndarjet, detyrat dhe organizimin, si dhe kontaktet e tyre.	Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmujori i parë i 2027
9	Informacion i paplotë në Programin e Transparencës për Kontratat Publike.		Mesatar	1. Publikimi në Programin e Transparencës i informacionit të plotë për kontratat publike.	Spektori I Prokurimeve Publike, Spektori për Menaxhimin e Kontratave dhe Investimeve

		Operacionet / Strategjik			Koordinatori për të Drejtën e Informimit Gjashtëmujori i parë i 2027
10	Plani Vjetor për Procesin e Vendimarrjes me pjesëmarrje nuk përcakton mënyrat e konsultimit dhe afatet përkatëse.	Burimet Njerëzore / Ligjor dhe kontraktual	Po eshte hedhur ne faqja e keshillit bashkiak	1. Plotësimi i Planit Vjetor për Procesin e Vendimarrjes me pjesëmarrje me informacion të detajuar duke përcaktuar mënyrat e konsultimit dhe afatet. 2. Publikimi i planit të ri vjetor në Programin e Transparencës në fillim të çdo viti.	Koordinatori për Konsultimin Publik, Koordinatori për të Drejtën e Informimit Sekretari i Këshillit Bashkiak Gjashtëmujori i parë i 2027
11	Mungesa e hartimit të Raportit Vjetor të Transparencës në Procesin e Vendimarrjes.	Burimet Njerëzore / Ligjor dhe kontraktual	Mesatar	1. Hartimi i Raportit Vjetor të Transparencës në Procesin e Vendimarrjes (Raporti i Konsultimit Publik) sipas parashikimeve të Rregullores së KB-së dhe Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. 2. Publikimi i Raportit Vjetor të Transparencës në Procesin e Vendimarrjes në Programin e Transparencës	Koordinatori për Konsultimin Publik, Koordinatori për të Drejtën e Informimit Sekretari i Këshillit Bashkiak Gjashtëmujori i dytë i 2026

<b>3.2 Fusha e kontrollit, auditimit, mekanizmave kundër korrupsionit</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Risku dhe ngjarjet e mundshme</b>	<b>Kategoria e faktorëve të riskut</b>	<b>Niveli i riskut Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët</b>	<b>Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës</b>	<b>Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve</b>
1.	1. Njësia e auditit të brendshëm ka një punonjës pa certifikimin përkatës.	Burimet Njerëzore / Operacional	Mesatar	1. Marrja e masave që sektori i auditit të brendshëm të funksionojë me 3 punonjës të certifikuar.	Njësia e Auditit të Brendshëm  Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore
2.	Administrata e bashkisë paraqet njohuri të kufizuara për rolin dhemisionin e auditit të brendshëm, si dhe detyrimet e njësisë të bashkisë në raport me këtë njësi.	Burimet Njerëzore /Strategjik	Mesatar	1. Kryerja e takimeve informuese me personelin e drejtorive në lidhje me rolin dhe misionin e auditit të brendshëm dhe detyrimet e secilës drejtori.	Njësia e Auditit të Brendshëm Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore  Gjashtëmuajt i i parë i 2027
3..	Mungesa e gjurmëve të auditit për të gjithë njësitë e bashkisë.	Operacional	Mesatar	1. Hartimi i gjurmëve të auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe dokumentimi I të gjitha operacionet e njësisë të bashkisë sipas gjurmës së miratuar .	Njësia e Auditit të Brendshëm  Drejtorët e drejtorive të bashkisë  Gjashtëmuajt i i parë i 2027-ës

4.	Mungesa e formularit të gatshëm për sinjalizimet e brendshme.	Operacional	Mesatar	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i formularit të gatshëm për sinjalizimet e brendshme.</li> <li>2. Informimi i të gjithë punonjësve në lidhje me formularin e sinjalizimit të brendshëm.</li> <li>3. Publikimi i formularit në Programin e Transparencës së bashkisë.</li> </ol>	<p>Njësia e Auditit të Brendshëm</p> <p>Gjashtëmuji i i dytë i 2027</p>
----	---	-------------	---------	---	---

<b>3.3 Fusha e Shërbimeve Publike</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Risku dhe ngjarjet e mundshme</b>	<b>Kategoria e faktorëve të riskut</b>	<b>Niveli i riskut Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët</b>	<b>Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës</b>	<b>Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve</b>
1.	Mungesa e një Plani Veprimi për sinjalistikën e nevojshme për promovimin e pikave turistike dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore.	Operacionet(Procesi)/Reputacion al dhe Imazhi	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për sinjalistikën e nevojshme për promovimin e pikave turistike dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore.	Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe Artit  Gjashtëmujori i parë i 2027-ës

2.	Procedurat e dhënies së lejeve të shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore janë të paqarta.	Burimet Njerëzore/ Reputacional dhe Imazhi	I lartë	<p>1. Hartimi dhe miratimi i një PSV-je në lidhje me procedurat e dhënies së lejeve të shfrytëzimit të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore.</p> <p>2. Informimi i personelit të përfshirë në këto procese, në lidhje me PSV-në e miratuar.</p> <p>2. Publikimi i PSV-së në Programin e Transparencës së Bashkisë.</p>	<p>Drejtorja Pyje-Kullota,</p> <p>Drejtorja Juridike, Burimet Njerëzore dhe Prokurimet Publike</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p> <p>Gjashtëmujori i dytë i 2027-ës</p>
----	---	---	---------	--	--

3.4 Fusha e administrimit të pronave dhe planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
1.	Procesi i riinventarizimit të pronave të bashkisë është i papërfunduar.	Burimet Njerëzore / Informacioni Mungesa e një structure të posacme për asetet publike	I lartë	1. Prioritizimi i përfundimit të procesit të riinventarizimit të pronave të bashkisë brenda afatit të përcaktuar. 2. Publikimi i informacionit të përditësuar për pronat e bashkisë në Programin e Transparencës, pas përfundimit të riinventarizimit. (shitja, dhënia me qira, dhënia në përdorim, kriteret etj.)	Grupi i punës i caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë  Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmuajt i i parë i 2026-ës.
2.	Fondi i dedikuar për hipotekimin e pronave të bashkisë nuk është i mjaftueshëm.	Operacionet(Procesi) / Financiar		1. Alokimi i një fondi të mjaftueshëm të dedikuar për hipotekimin e pronave bashkiake.	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit  Gjashtëmuajt i i parë i 2026
3.	Mungesa e Planeve të		I lartë	1. Hartimi, konsultimi, miratimi dhe	Grupi i punës i

	<p>Detajuara Vendore sipas përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor.</p>	<p>Operacionet(Procesi)/Strategjik</p>		<p>publikimi i Planeve të Detajuara Vendore për zonat e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor duke ruajtur linjën strategjike dhe pritshmëritë nga Plani i Përgjithshëm.</p>	<p>caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë</p> <p>Koordinatori për Konsultimin Publik,</p> <p>Koordinatori për të Drejtën e Informimit</p> <p>Gjashtëmujor i i dytë i 2025-ës</p>
--	---	--	--	--	--



<b>3.6 Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve dhe informacionit, si dhe dokumenteve elektronike</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Risku dhe ngjarjet e mundshme</b>	<b>Kategoria e faktorëve të riskut</b>	<b>Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët</b>	<b>Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës</b>	<b>Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve</b>
1.	Plani strategjik për emergjencat civile nuk është i publikuar.	Operacionet (Procesi)/Strategjik	Mesatar	1. Publikimi i Planit Strategjik për Emergjencat në Programin e Transparencës.	Spektori i Emergjencave Civile  Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmuji i parë i 2027
2.	Informacion i paorganizuar në Programin e Transparencës në lidhje me shërbimet publike dhe shërbimet administrative.  Mungesë e informacionit publik mbi procedurat e ankimit për shërbimet publike.	Operacional / Informacioni	Mesatar	1. Përditësimi i Programit të Transparencës në lidhje me shërbimet publike dhe administrative dhe procedurat e ankesës.	Spektori i Shërbimeve Shoqërore dhe Strehimit,  Çdo drejtori që ofron shërbime administrative/publike.  Koordinatori për të Drejtën e Informimit  Gjashtëmuji i parë i 2028

3.	Mungesa e ambientit të përshtatshëm për ruajtjen e fondit arkivor të bashkisë.	Mjedisi/Informacioni	I lartë	1. Sigurimi i një ambienti të përshtatshëm, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për arkivat, për ruajtjen e fondit arkivor të bashkisë.	Kryetari i Bashkisë  Zyra e Arkivë-Protokollit  Gjashtëmujori i dytë i 2028-ës
4.	Mungesa e digjitalizimit të fondit arkivor të bashkisë.	Operacional/ Informacioni	Mesatar	1. Hartimi i një plani pune për digjitalizimin e Fondit Arkivor të Bashkisë duke përcaktuar ndarjen e përgjegjësi dhe detyrave, si dhe afatet sipas viteve për përfundimin e procesit. 2. Sigurimi i pajisjes së serverit për digjitalizimin e Fondit Arkivor dhe alokimi i burimeve njerëzore të mjaftueshme. 3. Fillimi i procesit të digjitalizimit të Fondit Arkivor në bashki.	Zyra e Arkivë-Protokollit  Gjashtëmujori i dytë i 2028-ës

## Objektivi 4: Integrim me Standartet Europiane dhe Praktikrat më të mira Ndërkombëtare

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Masat prioritare Prioritet i lartë; Prioritet i moderuar; Prioritet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve
1	Krijimi i praktikave dhe protokollove që nuk përputhen me rekomandimet e BE		Harmonizim I politikave dhe praktikave ne bashkinë Vau i Dejës me kërkesat dhe rekomandimet e Bashkimit Europian	Njohje me kuadrin ligjor Europian Trajnime	Kryetar i i Bashkisë  Gjashtëmuji i i parë i 2028
2	Ulje e efikasitetit duke përdorur metoda empirike të pa përditësuara me zhvillimet demografike, sociale dhe teknologjike		Përdorim I instrumentave dhe metodologjive bashkëkohore	Trajnime Shkëmbime eksperiencash Sigurimi I paisjeve , kompjuter , Internet etj	Burimet Njerëzore dhe Koordinatori per mardheniet me publikun  Gjashtëmuji i i pare i 2028-it



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU

DEJËS

DREJTORIA E DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE  
VETERINARISË  
SEKTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE

PROJEKTVENDIM

Nr. 01 Datë 16/06/2026

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIN TË INTEGRUAR TË  
MBETJEVE TË NGURTA URBANE BASHKIA VAU I DEJËS 2026-2031"**

Këshilli Bashkiak Vau i Dejës në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_ 2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.8419, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; Nenet 23, 33, 54 germa k të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar; Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; i ndryshuar; Ligjit Nr.8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave"; nenet 12,13 Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", të ndryshuar; Ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar; Ligjit Nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar; Ligjit nr. 9010 datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"; Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative"; Ligjin Nr.89/2022 "Për policinë Bashkiake"; VKM Nr.452, datë 26.07.2023 "Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake"; VKM Nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte"; VKM Nr.660, datë 31.10.2018 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve"; VKM Nr.608, datë 17.9.2014 "Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"; VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", të ndryshuar; VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura; VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje", të ndryshuar VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";

VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"; VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"; VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"; VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve", të ndryshuar: VKM nr.177, datë 06/03/2012, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", të ndryshuar; VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"; VKM Nr.319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve";

VKM nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035", VKM Nr.447, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"; VKM Nr.652 datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura;

#### PROPOZOJMË:

1. Të miratojë planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane Bashkia Vau i Dejës 2024-2029", sipas materialit bashkëngjitur, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Konceptoi:** Zef Pashuku, Përgjegjës Sektori i Sherbimeve

**Miratoi:** Besmir Lepi :Drejtor/ Drejtoria e Sherbimeve Publike, Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Veterinarisë

**KRYETARI**  
**Kristian Shkreli**

**NË MUNGESË DHE ME ERDHËR**  
**ZV/KRYETAR**  
**Aleksandra Gjoni**



**Konfirmoi Bazen Ligjore:**  Sektori I Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE  
VETERINARISË  
SEKTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

PËR

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË VAU DEJËS 2026-2028"**

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Vau Dejës në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve të saj cakton rregulla për organizimin dhe funksionimin e çeshtjeve vendore brenda juridiksionit të saj, në pajtim me ligjin. Në referim të parimeve kushtetuese dhe ligjeve kemi marrë këtë nisëm për të rishikuar planin lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane për Bashkinë Vau Dejës 2026-2031".

Plani Lokal i Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) 2026-2031, është një dokument planifikimi strategjik, i cili vjen për Bashkinë Vau i Dejës mbas përfundimit të afatit të Planit paraardhës 2020-2025. Plani i përfunduar ka kaluar procesin e rishikimit dhe monitorimit të realizimit të objektivave të aktiviteteve dhe planeve të veprimit. Plani Lokal i Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) 2026-2031, është instrument që mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/udhëzues i rëndësishëm për manaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Vau i Dejës.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për manaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve. Duke u orientuar nga zbatimi i PLMIMNU bashkia ka për qëllim ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia, si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Qeverisje vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga Ligji Nr.10 463, datë 22.09.2011, "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve", ku në nenin 12, pika 2 citohet: Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për

Planin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji. PLMIMNU u hartua në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr339 Datë 05.05.2026 "Për Ngritjen e Grupit të punës për rishikimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Vau i Dejës".

Grupi i punës u trajnua nga projekti në të gjitha elementët e planit, duke studiuar situatën aktuale të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau i Dejës, skenarët e mundshëm për Zonat funksionale dhe skenarët e mbledhjes zonat malore dhe në territoret me destinacion turizmin. Ata ishin pjesë e zhvillimit të planit që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që janë ekonomikisht të mundshme me buxhetin që ka në dispozicion Bashkia, dhe të pranueshme nga ana mjedisore me ndikimet minimale në mjedis dhe në përputhje me politikën dhe legjislativën mjedisore në fuqi. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e bashkisë, vizionin objektivat opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan gjatë takimeve dhe trajnimeve të grupit të punës.

Plani është hartuar duke u bazuar në Instrumentin Kombëtar të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane miratuar me VKM Nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035". Dokumenti i Politikave Strategjike është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, jo-bashkiake dhe të rrezikshme në Shqipëri dhe mbulon periudhën kohore 2020-2035.

Ky dokument strategjik merr parasysh zhvillimet planifikuese dhe infrastrukturore në sektorin e mbetjeve prej vitit 2011, në nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore, përfshirjen e madhe të biznesit privat dhe investimet e shumta të kryera në nivelin e grumbullimit, transferimit dhe veçanërisht të trajtimit të mbetjeve. Dokumenti i Politikave Strategjike e rishikuar e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve zhvillohet mbi vizionin ose perceptimin e konceptit "zero mbetje", që mbetjet të grumbullohen dhe trajtohen si lëndë të para dhe menaxhimi të bëhet në përputhje me konceptin e sistemeve të ekonomive qarkulluese, në shërbim të përdorimit me kriter dhe ruajtjes së burimeve të lëndëve të para.



**Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të  
Ngurta Urbane  
Bashkia Vau Dejës  
2026-2031  
Draft 1**

Qershor, 2026

Ngritjen e grupit të punës për hartimin e "Planit Vendor të Shërbimit të Mbetjeve", në Bashki në Vau Dejës, me përbërje si më poshtë:

- **Elvis Preci** - Zv/Kryetar i Bashkisë Vau Dejës,
- **Armena Zagani** - Përgjegjës (Sektori i Financës),
- **Ersilda Preka** - Jurist (Sektori Ligjor),
- **Besmir Lepi** - Drejtor Shërbimet Publike,
- **Zef Pashuku** - Përgjegjës Shërbimet Publike,
- **Entela Osmani** - Përgjegjës Sektori i Mjedisit,
- **Erjona Kolce** - Administrator Njësia Administrative Bushat,
- **Klodian Daja** - Administrator Njësia Administrative Hajmel,
- **Kristjan Ndoja** - Administrator Njësia Administrative Shllak,
- **Pjeter Delija** - Administrator Njësia Administrative Temal,

## SHKURTIMET

<b>AKM</b>	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
<b>ARM</b>	Agjensia Rajonale e Mjedisit
<b>BE</b>	Bashkimi Europian
<b>ISHMPU</b>	Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave
<b>ISHSH</b>	Inspektoriati Shtetëror i Shëndetësisë
<b>MB</b>	Mbetjet nga Bizneset
<b>MBZHR</b>	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MF</b>	Mbetjet nga Familjet
<b>MIE</b>	Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë
<b>MTM</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>NJQV</b>	Njësi Qëndrore Vendore
<b>OJF</b>	Organizata Jo Fitim prurëse
<b>PLMIMNU</b>	Planin Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane
<b>PKMM</b>	Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
<b>PGM</b>	Pikë Grumbullimi Mbetjesh
<b>PPP</b>	Partneritet Publik Privat
<b>SKM</b>	Strategjia Kombëtare e Mbetjeve
<b>VKM</b>	Vendim i Këshilit të Ministrave
<b>ZAM</b>	Zona e Administrimit të Mbetjeve

## TABELA PËRMBAJTJES

<b>I. HYRJE .....</b>	<b>7</b>
1.1 NEVOJA PËR HARTIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT E INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE .....	7
1.2 HARTIMI I PLMIMNU NË BASHKINË VAU DEJËS .....	7
<b>II. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIT E MBETJEVE.....</b>	<b>8</b>
2.1 POLITIKAT KOMBËTARE DHE PRINCIPET BAZË TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	8
2.2 ASPEKTETE INSTITUCIONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE .....	10
<b>2.2.1 Organizimi në nivel qendror .....</b>	<b>10</b>
<b>2.2.2 Organizimi në nivel lokal.....</b>	<b>11</b>
2.3 INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI LEGJISLACIONIN .....	12
2.4 INSTRUMENTAT PËR MENAXHIMIT E INTEGRUAR TË MBETJEVE NË NIVEL VENDOR .....	14
2.5 KUADRI LIGJOR NË LIDHJE ME KONCEPTIN E STANDARDIT MINIMAL PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE NGA NJËSITË VENDORE .....	15
<b>III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>19</b>
3.1 PROFILI I BASHKISË .....	19
<b>3.1.1 Të dhëna demografike .....</b>	<b>20</b>
<b>3.1.2 Karakteristikat social ekonomike.....</b>	<b>20</b>
3.2 ASPEKTE INSTITUCIONALE NË MENAXHIMIT E MBETJEVE NË BASHKINË VAU DEJËS .....	21
3.3 ASPEKTE TEKNIKE NË MENAXHIMIT E MBETJEVE NË BASHKINË VAU DEJËS .....	22
<b>3.3.1 Të dhëna për sasinë e prodhuar e mbetjeve skema e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Vau Dejës.....</b>	<b>22</b>
<b>3.3.2 Riciklimi dhe kompostimi.....</b>	<b>24</b>
<b>3.3.3 Landfilli i Bushatit.....</b>	<b>24</b>
<b>IV. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIT E MBETURINAVE .....</b>	<b>25</b>
4.1 KOSTO E PLOTË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE .....	25
4.2 SISTEMI I TARIFAVE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE.....	26
<b>V. INDIKATORËT E PERFORMANCËS .....</b>	<b>29</b>
<b>VI. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE .....</b>	<b>33</b>
6.1 VIZIONI .....	33
6.2 OBJEKTIVAT.....	33
<b>6.2.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit .....</b>	<b>36</b>
<b>6.2.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit ....</b>	<b>36</b>
6.3 SHËRBIMET E MENAXHIMIT TË MBETJEVE .....	37
<b>6.3.1 Shërbimet e pastrimit të rrugëve .....</b>	<b>37</b>
<b>6.3.2 Grumbullimi, transporti i mbetjeve.....</b>	<b>37</b>
<b>6.3.3 Trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbetjeve .....</b>	<b>40</b>
<b>6.3.4 Minimizimi i mbetjeve.....</b>	<b>40</b>
6.4 MENAXHIMI I MBETJEVE VOLUMINOZE DHE NDËRTIMORE .....	42
6.5 SKENARËT E PROPOZUAR PËR SHËRBIMIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE .....	43
6.6 KRAHASIMI I KOSTOVE TË SKENARËVE TË PROPOZUAR ME SKENARIN BAZË .....	55
6.7 POLITIKA MBULIMIT TË KOSTOS NGA TË ARDHURAT NGA TARIFAT E PASTRIMIT.....	56
<b>6.7.1 Metodologji për mbulimin e kostos.....</b>	<b>56</b>

6.7.2	<i>Planifikimi i të ardhurava nga tarifa e pastrimit për skenarin I&amp;II të menaxhimit të mbetjeve</i> .....	59
<b>VII.</b>	<b>PLANIFIKIMI I FUSHATAVE TË NDËRGJEGJËSIMIT DHE INFORMIMIT TË KOMUNITETIT.</b>	<b>67</b>
<b>VIII.</b>	<b>RISHIKIMI I PLANIT</b> .....	<b>68</b>
8.1	MONITORIMI I PLANIT .....	68
<b>IX.</b>	<b>KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL</b> .....	<b>71</b>
9.1	RREGULLORJA VENDORE .....	71
9.2	ZBATIMI DHE SANKSIONET.....	72
9.3	LICENCIMI MJEDISOR .....	72
9.4	PJESËMARRJA E SEKTORIT PRIVAT .....	73
9.5	MBËSHTETJA POLITIKE .....	73
<b>X.</b>	<b>PLANI I VEPRIMIT</b> .....	<b>74</b>
	<b>ANEKS I: PLAN I DETAJUAR PËR PROGRAMIN E NDËRGJEGJËSIMIT NË LIDHJE ME PROCESIN E MANAXHIMIT TË MBETJEVE DHE SKEMAVE TË MINIMIZIMIT TË TYRE</b> .....	<b>81</b>
	<b>ANEKSI II – KOSTOT NJËSI SIPAS SISTEMIT TË LLOGARITJES SË KOSTOS PËR SKENARIN I &amp; II</b>	<b>88</b>

## Lista e Figurave

Figura 1	Diskutime me grupin e punës në Bashkinë Vau Dejës gjatë hartimit të planit ....	<b>Error!</b>
	<b>Bookmark not defined.</b>	
Figura 2	Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve.....	9
Figura 3	Njësitë administrative Bashkia Vau Dejës .....	19
Figura 4	NJA Struktura e Bashkisë për menaxhimin e mbetjeve .....	21
Figura 5	Shërbimi i Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës .....	22
Figura 6	Landfilli i Bushatit.....	25
Figura 7	Zërat e kostos të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës.....	26
Figura 8	Mbulimi i kostove nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit.....	29
Figura 9	Skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës.....	39
Figura 10	Pikë grumbullimi me sistem ndarje në burim të rrymave të riciklueshme.....	41
Figura 11	Modeli i kompostimit individual.....	42
Figura 12	Skemat e kompostimit në mjedis të hapur .....	42
Figura 13	Rrugëtimet e mjeteve për skenarin I.....	46
Figura 14	Rrugëtimet e mjeteve për skenarin I.....	50
Figura 15	Krahasimi i kostove për skenarët e propozuar me koston e skenarit bazë .....	55
Figura 16	Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të kostos.....	57
Figura 17	Strategjia për vjeljen e tarifave .....	58
Figura 18	Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Bushat .....	63
Figura 19	Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Vau Dejës-Hajmel.....	63
Figura 20	Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Temal.....	64
Figura 21	Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Vig Mnelë ....	64
Figura 22	Aktorët që mund të përfshihen në operacionet e monitorimit të shërbimit .....	70

**Lista e Tabelave**

Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve.....	13
Tabela 2 Njësitë Administrative të Bashkisë Vau Dejës .....	19
Tabela 3 Popullsia Bashkisë Vau Dejës.....	20
Tabela 4 Numri i bizneseve të vogla dhe të mëdha .....	21
Tabela 5 Situata e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Vau Dejës.....	22
Tabela 6 Të dhëna mbi ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve .....	23
Tabela 7 Kontenierët e shërbimit në zonën e studimit .....	24
Tabela 8 Mjetet për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës .....	24
Tabela 9 Kosto e shërbimit lekë/ton/vit dhe lekë/banor/vit 2024-2025 .....	26
Tabela 10 Kosto e shërbimit lekë/ton/vit për vitin 2026.....	26
Tabela 11 Niveli i tarifave të pastrimit në NJA të Bashkisë Vau Dejës për kategoritë e klientëve .....	27
Tabela 12 Përqindja e konsumatorëve të faturuar dhe arkëtuar në Bashkinë Vau Dejës .....	28
Tabela 13 Të ardhurat e shërbimit viti 2025.....	28
Tabela 14 Mbulimi i kostos nga të ardhurat e tarifave.....	28
Tabela 15 Indikatorët e performancës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës .....	32
Tabela 16 Të dhënat teknike për Skenarin I të menaxhimit të mbetjeve.....	45
Tabela 17 Kalendari i lëvizje të mjeteve teknologjike në Zonën Suburbane – Skenari 1.....	45
Tabela 18 Kalendari i lëvizje të mjeteve teknologjike në Zonën Rurale – Skenari 1 .....	45
Tabela 19 Kosto e shërbimit për Zonën Suburbane (Bushat) për Skenarin 1 .....	51
Tabela 20 Kosto e shërbimit për Zonën Suburbane (Vau Dejës-Hajmel) për Skenarin 1 .....	51
Tabela 21 Kosto e shërbimit për Zonën Rurale (Temal- qendër fshati Koman) për Skenarin I .....	52
Tabela 22 Kosto e shërbimit për Zonën Rurale (Vig Mnelë) për Skenarin I.....	52
Tabela 23 Tabelë përmbledhëse e kostos totale operacionale dhe të investimit për Skenarin I .....	53
Tabela 24 Kosto e shërbimit për Skenarin II .....	54
Tabela 25 Tabelë përmbledhëse e kostos totale operacionale dhe të investimit për Skenarin II .....	55
Tabela 26 Planifikimi i të ardhurave dhe nivelit të tarifave nga rritja e kostos aktuale për në skenarin I.....	61
Tabela 27 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin I .....	63
Tabela 28 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga BV dhe BM për Skenarin I .....	66
Tabela 29 Të ardhurat dhe mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit në Bashkinë Vau Dejës.....	66
Tabela 30 Model të raportimi ditor për gjendjen e PGM .....	71
Tabela 31 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve të ngurta .....	73

## I. HYRJE

### 1.1 Nevoja për hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane (PLMIMNU) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbetjeve në nivel lokal, si një dokument/ udhëzues i rëndësishëm për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Vau Dejës.

Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qendrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. PLMIMNU është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve.

Qëllimi i PLMIMNU konsiston në sfidën e re që ka bashkia për të ofruar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke optimizuar koston e shërbimit kundrejt buxheteve të limituara që ka bashkia si dhe në hartimin e nevojave për investime kapitale për sektorin e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu plani fokusohet edhe në përcaktimin e metodologjisë për zbatimin e sistemit të monitorimit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të brenda bashkisë për zbatimin e planit

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e mbetjeve
- Opsionet e menaxhimit të mbetjeve: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbetjeve
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementeve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbetjet në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e menaxhimit të mbetjeve
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbetjet sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare

Viti 1994 shënoi momentin, kur autoriteteve lokale ju deleguan shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbime të tjera pastrimi, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre dhe njëkohësisht, duke u siguruar financimin nga qeverisja qendrore me anë të “granteve të pakushtëzuara”. Hartimi i planit vendor nga Njësitë e Vet qeverisje vendore është një detyrim ligjor i përcaktuar nga **Ligji i ri nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”**, i amenduar, ku në nenin 12, pika 2 citohet: *Çdo njësi e qeverisjes vendore apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe me kërkesat e nenit 10 të këtij ligji.*

### 1.2 Hartimi i PLMIMNU në Bashkinë Vau Dejës

Në fazën e parë të projektit u themelua grupi i punës me përfaqësues nga stafi i bashkisë dhe ekspertë të jashtëm. Ata ishin pjesë e zhvillimit të Planit që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet

që janë ekonomikisht të mundshme me buxhetin që ka në dispozicion bashkia, dhe të pranueshme nga ana mjedisore me ndikimet minimale në mjedis dhe në përputhje me politikat dhe legjislacionin mjedisor në fuqi. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e bashkisë, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës.

Bashkia Vau Dejës, paraqitet e gatshme të bashkëpunojë në mbarëvajtjen e projektit, duke krijuar edhe grupe pune efikas. Ky i fundit, një proces të cilin bashkia me këmbënguljen dhe rolin e saj, dhe veçanërisht të Kryetarit për ta ngritur dhe zbatuar rigorozisht dhe me sukses në Bashkinë Vau Dejës, ka shërbyer për grumbullimin dhe gjenerimin e të dhënave të nevojshme për bazat e një planifikimi të integruar të shërbimit.

Në hapa të ndryshëm të hartimit të planit, grupi i punës organizoi seanca diskutimi dhe konsultimi me përfaqësuesit kryesorë të bashkisë. Procesi i konsultimit, i cili çoi në punën e ngushtë midis aktorëve, duke rakorduar në ato që i nevojiten bashkisë, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme. Përfaqësuesit e Bashkisë Vau Dejës kanë asistuar gjatë lëvizjeve në terren dhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë së madhe.

## II. POLITIKA KOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETJEVE

### 2.1 Politikat kombëtare dhe principet bazë të menaxhimit të mbetjeve

Qeveria Shqiptare miratoi me VKM nr. 418, datë 27.05.2020 „Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035“. Ky dokument strategjik do t'i mundësojë njësitë të qeverisjes vendore një mjet mjaft frytdhënës për t'i udhëhequr ata në mënyrë të duhur për hartimin e planeve të tyre lokale për menaxhimin e integruar të mbeturinave, duke u bazuar në 4 qëllime strategjike për periudhën 2020-2035:

- **QS1:** Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, duke përmbytur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit
- **QS2:** Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të menaxhimit të mbetjeve
- **QS3:** Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve
- **QS4:** Burimet njerëzore, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e popullatës në menaxhimin e mbetjeve

Ky dokument politik, në vetvete, siguron udhëzime strategjike për menaxhimin e mbetjeve, duke udhëhequr vendimmarrjen lokale drejt marrjes dhe zbatimit të një sistemi të qëndrueshëm të administrimit të mbetjeve. Dokumenti i Politikave Strategjike udhëzon njësitë e qeverisjes vendore për përcaktimin e objektivave të tyre specifike vendorë, të matshëm, realistë, të arritshëm, bazuar në situatën e tyre ekzistuese dhe standardin minimal të miratuar për menaxhimin e mbetjeve.

Strategjia, përmes përcaktimit të rëndësisë së standardit minimal të menaxhimit të mbetjeve në nivelin lokal (*grumbullimi 100% i mbetjeve në zonat urbane, transporti i sigurt dhe depozitimi i mbetjeve venddepozitimet e kontrolluara*), i ndjekur nga standardi ligjor (*mbledhja dhe trajtimi i diferencuar sipas rrymave specifike të mbetjeve, përcaktuar në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ligji nr. 10463 datë 22.09.2011, i ndryshuar*), përcakton trajektoren që duhet të ndjekin njësitë vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Nisur nga kjo, NJQV-të udhëzohen të përmbyshin, së pari, standardin minimal për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe më pas të planifikojnë hapat për të përmbyshur standardin ligjor.

Llogaritja e kostos së menaxhimit të mbetjeve për standardin minimal të shërbimit (modeli dldp), gjatë hartimit të planeve lokale për menaxhimin e mbetjeve, është një hap i detyrueshëm (VKM nr.319, datë 31.05.2018) për NJQV-të. Kjo kosto duhet të jetë e përballueshme nga tarifat e pastrimit, të cilat

përcaktohen për të mbuluar koston e shërbimit të për standardin minimal. Për më tepër, bazuar në konceptin e përbalueshmërisë, të përcaktuar në dokumentin e politikave strategjike dhe në ligjin për vetëqeverisjen lokale (2015), NJQV-të duhet të jenë të afta të përcaktojnë hapa cilësor të saktë për të kaluar nga standardi minimal i ofrimit të shërbimeve drejt një përmirësimi financiar të përbalueshëm dhe të arritshëm të ofrimit të shërbimit.

Një koncept tjetër i prezantuar nga Dokumenti i Politikave Strategjike janë venddepozitimet e kontrolluara. Njësitë vendore duhet të alokojnë në buxhetet e tyre vjetore lokale fonde për masat emergjente për të kontrolluar ndotjen e mjedisit në venddepozitimet ekzistuese të mbetjeve, si:

- Masat për të kontrolluar ndotjen e mjedisit në venddepozitimet e mbetjeve;
- Masat e rehabilitimit për t'i përdorur ato për një kohë kalimtare derisa të vendosen objektet e trajtimit;
- Masat për mbylljen e sigurt të venddepozitimeve.

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

- **Hierarkia e mbetjeve:** Hierarkia e mbetjeve përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në manaxhimin e mbetjeve në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në manaxhimin e mbetjeve duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.




Figura 2 Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve

- **Parimi reduktues:** Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbetjeve. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbetjeve qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre;
- **Parimi parandalues:** Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbetjet;
- **Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:** Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që mbetjet të manaxhohen sa më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me mbetjet e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.
- **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit:** Parimi “Ndotësi paguan” kërkon që prodhuesit e mbetjeve të mbulojnë koston e manaxhimit të mbetjeve që gjenerojnë. Kështu kostot mjedisore dhe kostoja e manaxhimit të mbetjeve në të gjitha proceset duhet të

reflektohen në çmimin e produktit si dhe në tarifat për ofrimin e shërbimit. Objektivi është ofrimi i një sistemi të drejtë dhe dekurajues për prodhimin pa kriter të mbetjeve.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit Shqiptar në përputhje me instrumentet legjislative të BE-së. Progresi më i madh në fushën e mbetjeve është bërë në fushën e legjislacionit. Gjatë periudhës 2011 - 2016, legjislacioni Shqiptar për manaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime dhe rregullore që reflektojnë direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Baselit.

## 2.2 Aspektete institucionale të menaxhimit të mbetjeve

### 2.2.1 Organizimi në nivel qendror

Aktorët kryesorë përgjegjës, në nivel kombëtar, në fushën e menaxhimit të mbetjeve janë Ministria e e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi, **MTM** është institucioni i specializuar dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e politikës së menaxhimit të mbetjeve; hartimin e legjislacionit, udhëzuesve dhe rregulloreve dhe zbatimin në nivel qendror me anë të institucinit që ajo ka në varësi AKM (Agjensinë Kombëtare të Mjedisit dhe 4 Agjensitë Rajonale të Mjedisit në nivel rajonal). Sipas VKM nr. 568, datë 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjensisë Kombëtare të Mjedisit", AKM është institucioni nën varësi të Minsitrisë së Turizmit dhe Mjedisit që ka si objektiv mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendi. Sipas këtij riorganizimi të ri, AKM ka këto katër funksione që duhet t'i ushtrojë: i) Sigurimin e performancës mjedisore në territorin e vendit; ii) Kërkimin dhe dijen mjedisore; iii) Vlerësimin e impaktit mjedisor dhe licensimin; iv) Inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore. Ky organizim i ri i AKM-së parashikon edhe nivelin rajonal, me 4 ARM-të të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, të cilat zbatojnë funksionet përkatëse në territorin ku ato operojnë, dhe më pas raportojnë tek Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së.

**MIE dhe më konkretisht Drejtoria e Politikave të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta** ka për detyrë formulimin dhe zbatimin e politikave kombëtare, normave dhe standardeve për shërbimet publike në fushën e mbetjeve urbane apo mbetjeve të tjera. MIE është autoriteti përgjegjës në nivel kombëtar për planifikimin, financimin, zbatimin dhe monitorimin e investimeve publike në fushën e manaxhimit të mbetjeve, rehabilitimit të fushave të venddepozitimeve, ngritjes së landfill-eve etj. Në zbatim të kuadrit ligjor, ajo duhet të përgatisë rregullore, teknika dhe metoda për të gjitha proceset e menaxhimit të mbetjeve si ndarja dhe grumbullimi i tyre, transporti dhe riciklimi, trajtimi dhe groposja etj. Gjithashtu, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregulloreve për:

- Mbetjet industriale
- Mbetjet minerale
- Rehabilitimin e venddepozitimeve në përputhje me specifikat.

**AKUM (Agjensia Kombëtare për Ujësjellës Kanalizimet dhe Infrastrukturën e Mbetjeve)** – Sipas VKM nr. 431, datë 11.07.2018 "Për Krijimin edhe organizimit dhe të funksionimin e Agjensisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimet dhe Infrastrukturës së Mbetjeve", AKUM është institucioni i ri në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", i cili është përgjegjës për infrastrukturën e mbetjeve, në kuadër të zbatimit të master planit të mbetjeve.

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, miraton lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit për objektet (si rrjedhojë edhe për landfill-et) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha që ndërtohen jashtë kufijve administrative të sipërfaqeve të qytetit/fshatit/zonave të banuara.

**Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale**, në bashkëpunim me MTM dhe në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve harton rregullore për manaxhimin e mbetjeve në nivele të ndryshme të hierarkisë së manaxhimit të tyre dhe gjithashtu harton dhe zbaton rregulloren për mbetjet spitalore (miratuar Udhëzimi Nr. 6, dt. 30.11.2007).

**Inspektorati Shtetëror Shëndetësor** është një autoritet në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i cili ka për detyrë të kontrollojë dhe ndërmarrë veprime për të siguruar kushtet e nevojshme higjieno-sanitare për aktivitetet e ndryshme. Ai bashkëpunon me Inspektoratet Mjedisore dhe në raste të veçanta, edhe me inspektorate të tjera, sikurse edhe me autoritetet lokale për kryerjen e inspektimeve të aktiviteteve që lidhen me mbetjet. Aktiviteti i inspektoratit mbështetet në ligjin 7904 datë 8.3.1995 dhe ka për detyrë të vendosë gjopa për probleme që lidhen me mospastrimin e zonave urbane apo kur grumbullimi dhe depozitimi janë jo të përshtatshëm dhe bëhen të rrezikshëm për popullsinë. Përgjegjësia e inspektoratit shtrihet edhe në përcaktimin e vendgrumbullimit të mbetjeve. Spitalet dhe gjithë prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore si dhe për projektimin e skemave të manaxhimit të mbetjeve të tyre, në përputhje me Planet Kombëtare të Manaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Manaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural** (në bashkëpunim me MTM) është përgjegjëse për hartimin e rregullores për mbetjet bujqësore dhe shtazore.

**Ministria e Financës** (në bashkëpunim me MM) është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit për paraqitjen e taksave të ndryshme mjedisore.

### 2.2.2 Organizimi në nivel lokal

Detyrat dhe përgjegjësitë: Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” dhe ligjin nr.10463 datë 22.09.2011 bashkitë janë përgjegjëse për të organizuar shërbimin e grumbullimit, transportit, trajtimit dhe depozitimit final të mbetjeve, duke i deleguar këto shërbime organeve lokale ose duke kontraktuar një kompani private të specializuar. Bashkia përcakton:

- i. Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të manaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban
- ii. Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për manaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato
- iii. Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë manaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga MTM, MIE dhe MSHÇS
- iv. Harton planet e manaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje
- v. Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit
- vi. Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

- (i) Të kujdesen për higjienën publike kur kjo rrezikohet nga ndotja që shkaktohet prej mbetjeve të gjeneruara apo atyre të braktisura
- (ii) Të zbatojnë projekte dhe investime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit urban në lidhje me ndotjen e mbetjeve
- (iii) Të monitorojnë dhe inspektojë të gjitha proceset e manaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në depozitimin përfundimtar në përputhje me standardet kombëtare mjedisore dhe rregulloret dhe manualet lokale

- (iv) Të inspektojnë “zotëruesin e mbetjeve” për të konfirmuar zbatimin e rregullave dhe standardeve në nivel kombëtar dhe lokal dhe të vendosë sanksione në rast shkeljesh
- (v) Të bashkëpunojë me ARM-të për lëshimin e lejeve mjedisore për persona fizikë dhe juridikë që lidhen edhe me aktivitetin e tyre në raport me proceset e menaxhimit të mbetjeve
- (vi) Të bashkëpunojë me ARM-të si dhe inspektoriate të tjerë për të ndërmarrë inspektime të mbetjeve dhe aktiviteteve që lidhen me to brenda territorit dhe juridiksionit lokal
- (vii) Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoritet kontraktues për koncesionet lidhur me aktivitetet ekonomike nën juridiksionin përkatës dhe, si rrjedhojë, edhe për koncesionin e projekteve mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

**Këshilli Bashkiak:** është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për mbetjet e rrezikshme (Ligjit 9537).

**Policia e bashkiake** është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

### 2.3 Informacion përmbledhës mbi legjislacionin

Në tabelën më poshtë është bërë një përmbledhje e kuadrit ligjor Shqiptar në fushën e Menaxhimit të mbetjeve:

#### **Kuadri Ligjor për Menaxhimin e Mbetjeve**

<b>Ligjet</b>	Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013
	Ligji nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme”
	Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.
<b>VKM-të</b>	VKM nr. 389, datë 27.06.20118 “Për disa ndryshime në dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve”
	VKM nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot menaxhimit të integruar të mbetjeve”
	VKM nr. 232, datë 26.04.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 177, datë 06.03.2012 “Për amabalazhet dhe mbetjet e tyre”
	VKM nr. 428, datë 08.06.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për hartën dixhitale venddeozitimeve të mbetjeve urbane”
	VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"
	VKM nr.575 datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"
	VKM nr.387 datë 06.05.2015 "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, ç'ndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura "

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

	VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura"
	VKM nr.641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte "
	VKM nr.608 datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre"
	VKM nr.579 datë 03.09.2014 "Për një shtesë në vendimin nr.99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave, për miratimin e Katalogut Shqipëtar të Klasifikimit të Mbetjeve"
	VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
	VKM nr.371 datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"
	VKM nr.229 datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"
	VKM nr.52, datë 05/02.2014 për disa ndryshime në Vendimin Nr.117, datë 13/02/2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojnë kur disa tipe të metalit srap pushojnë së qëni mbetje"
	VKM nr.117, datë 13/02/21013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje"
	VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
	VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"
	VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"
	VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për landfill-et e mbetjeve"
	VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
	VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"
	VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
	VKM nr.798, datë 29/09/2010 për miratimin e rregullores "Për administrimin e mbetjeve spitalore"
	VKM nr.99, datë 18/02/2005 "Për miratimin e katalogut Shqipëtar të klasifikimit të mbetjeve"
<b>Udhëzime</b>	Udhëzim nr.1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e Landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane"

Tabela 1 Kuadri ligjor shqiptar për menaxhimin e mbetjeve

[Burimi: Punuar nga autori]

## 2.4 Instrumentat për menaxhimin e integruar të mbetjeve në nivel vendor

Bazuar në ligjin kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i miratuar në vitin 2011 dhe i amenduar përsëri në vitin 2013, NJQV-të (bashkitë) duhet të hartojnë instrumentat vendorë për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e shërbimit të mbetjeve, si:

- **Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane**, si instrumenti kryesorë i planifikimit për përcaktimin e vizionit dhe objektivat specifike, të mundshëm nga ana ekonomike dhe mjedisore, në lidhje me drejtimet që do të ndërmarrë bashkia në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Këto objektiva specifike duhet të reflektojnë orietimet e politikës kombëtare drejt menaxhimit të integruar të mbetjeve, të aktualizuara në gjendjen ekzistuese të bashkisë. Mbi bazën e objektivave specifike të dakordësuar në të gjitha nivelet vendimarrëse dhe me grupet e interesit, plani fillon dhe analizon skenarët e mundshëm të organizimit të shërbimit të shoqëruar me koston përkatëse dhe politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia në mbulimin e plotë të koston. Ai përfundon me një plan veprimi konkret të ndarë në afate kohore, brenda një 5 vjeçari, sipas përgjegjësive përkatëse të aktorëve të përfshirë në zbatimin e planit. Plani është një dokument planifikimi, i cili merr fuqi të plotë me miratimin nga Këshilli Bashiak.
- **Rregulloret bashkiake për menaxhimin e mbetjeve** për çdo rrymë specifike: është përgjegjësi e Bashkisë Vau Dejës të hartojë këto rregullore (duke zbatuar specifikat e ndarjes së re territoriale-administrative), e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimin të mbetjeve për të gjitha rrymat specifike të mbetjeve, brenda territorit administrativ të bashkisë, duke hartuar procedura për ankesat e banorëve, gjithashtu edhe kapitulli për aplikimin e sanksioneve në rast të mos zbatimit të rregullores nga aktorë të ndryshëm. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Bashiak për të marrë fuqi të plotë ligjore.
- **Rregulloret për llogaritjen e koston dhe tarifave mbetjet:** në sajë të asistecës teknike nga programi dldp, Bashkia Vau Dejës ka qënë pjesë e shumë trajnimeve për aplikimin e modelit të llogaritjes së koston dhe tarifave të prezantuar nga programi dldp. Në këtë kuadër, nisur edhe nga fakti që shumë shpejt këto metodologji do të miratohen edhe në nivel kombëtar, për t'u përdorur zyrtarisht nga të 61 bashkitë vendit, bashkia duhet të hartojë rregulloret përkatëse në lidhje me rregullat dhe procedurat për llogaritjen e koston vjetore të shërbimit dhe nivelit të tarifave për konsumatorë të ndryshëm që janë pjesë e skemës, sipas modeleve të dldp-së<sup>1</sup>. Këto rregullore do të qartësojnë punën e stafit të financës dhe tarifave, të cilët në bashkëpunim me stafin teknik të menaxhimit të shërbimit, duhet të llogarisin koston vjetore dhe të përcaktojnë politikën fiskale, e cila i përshtatet më mirë nevojave të bashkisë bazuar në konceptin e përbalueshmërisë nga konsumatori, por edhe në drejtim të mbulimit të plotë të koston nga tarifat e pastrimit. Këto rregullore duhet të miratohen në Këshill Bashiak.
- **Modeli i Sistemit të Monitorimit:** Ky është një instrument të cilin bashkia duhet të fillojë ta ngrejë dhe ta zbatojë, si fillim për pjesën urbane të bashkisë, ku e ka më të lehtë të kontrollojë, dhe më pas me zonat ruralet, ku e ofron shërbimin, apo në zonat që do ta shtrijë. Me hartimin dhe aplikimin e modelit të sistemit të monitorimit në të gjithë territorin e saj, bashkia do të kuptojë më mirë nivelin e ofrimit të shërbimit, elementet ku ajo duhet të ndërhyjë për të përmirësuar situatën, apo edhe të rishikojë objektivat specifike për zona, apo kategori të ndryshme të konsumatorëve. Me anë të këtij sistemi edhe sistemi i sanksioneve kryesisht për firmat private që ofrojnë shërbimin, për bizneset apo edhe për konsumatorët familjarë mund të ekzekutohen lehtësisht.
- **Strategjia e informimit:** një instrument tjetër mjaft i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të planit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane. Bashkia duhet të sigurojë angazhimin e plotë të komunitetit duke i informuar ata në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që po zbaton në territorin e bashkisë dhe me politikën fiskale që ajo po aplikon. Bashkia duhet të hartojë një strategji informimi, që në hapat e parë të hartimit të planit, duke informuar

<sup>1</sup> VKM nr. 319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kosotot menaxhimit të integruar të mbetjeve"

komunitetin në lidhje me iniciativën që ajo ka ndërmarrë, objektivat e përcaktuar, skenarët që kërkon të aplikojë dhe politikën fiskale që bashkia kërkon të ndjekë. Kjo strategji duhet të përcaktojë edhe etapa të tjera që duhet të përsëriten vit pas viti, ku synimi kryesor duhet të jetë informimi i komunitetit në lidhje me proceset që zhvillon bashkia dhe marrja e opinionit të tyre në lidhje me performancën e shërbimit dhe sugjerimeve që ata mund të kenë. Zhvillimi i pyetësorëve të ndryshëm, apo i dëgjësave publike në periudha të ndryshme gjatë zbatimit të planit, janë disa nga elementet që strategjia e informimit duhet të parashikojë, për të matur opinionin qytetar, i cili duhet të reflektohet si në përmirësimin e shërbimit ashtu edhe të strategjisë së informimit.

## 2.5 Kuadri ligjor në lidhje me konceptin e standardit minimal për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga njësitë vendore

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i amenduar me ligjin nr.38, datë 20.06.2019, në nenin 23, pika 10, një ndër funksionet e bashkisë (*fusha e saj e veprimtarisë, ku ajo është përgjegjëse dhe ka autoritetin ligjor për ta ushtruar atë lirisht, tërësisht apo pjesërisht neni 2, pika 3*), në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, u përcaktua ai i *mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake*. Nisur nga përcaktimi që bën ky ligj për *shërbimet publike* (neni 2, pika 13), **shërbimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta është ai shërbim me interes të përgjithshëm publik, i cili duhet t'i ofrohet të gjithë komunitetit në territorin e bashkisë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmim të përbalueshëm, bazuar në standardet minimale kombëtare**. Ky ligj, përveç tre proceseve kryesore të përcaktuar edhe në ligjin bazë për menaxhimin e integruar të mbetjeve për ofrimin e shërbimit, sjell për herë të parë disa nocione apo principe (*të pranuar de facto*) që duhet të plotësojnë njësitë e qeverisjes vendore në proceset e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e tyre, siç janë:

1. **Gjithëpërfshirja** e komunitetit dhe territorit që merr shërbim
2. **Vazhdimësia** e ofrimit të shërbimit
3. **Përbalueshmëria** financiare për ofrimin e shërbimit
4. **Plotësimi i standardeve minimale** kombëtare të përcaktuara nga ligjet sektoriale

Ligji vazhdon me përcaktimin e 5 formave të lejuara për mënyrën e organizimit të shërbimit publik, në këtë rast menaxhimi i mbetjeve, nga ana e pushtetit vendor me anë të: i) Njësive organizative, si pjesë e strukturës administrative të bashkive; ii) Ndërmarrjet e shërbimeve publike; iii) Kontraktimi i palëve të treta; iv) PPP; v) Shoqëritë tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësive vendore.

Pavarësisht formës të administrimit që zgjedhin njësitë vendore për ofrimin e shërbimit të mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake, ato kanë përgjegjësi për vendosjen e **sistemit të administrimit të performancës së shërbimit** (neni 33, pika 2), dhe krijimin e **një strukturë të posaçme** në njësinë e qeverisjes vendore për prezantimin, mbikqyrjen dhe monitorimin e performancës të shërbimit publik.

Ligji vazhdon me përcaktime të reja në lidhje me proceset e ciklit të ofrimit të shërbimeve publike (*menaxhimin e mbetjeve në këtë rast*), ku njësitë vendore duhet të bëjnë transparente shërbimet e menaxhimit të mbetjeve për komunitetin (neni 15, pika 1), **nga koordinatori i transparencës** (neni 15, pika 3), dhe njëkohësisht çdo qytetar i njësisë vendore ka të drejtë të bëjë kërkesa, ankesa apo vërejtje pranë njësisë vendore në lidhje me shërbimet publike që ofrohen në njësinë vendore (neni 19).

Në përfundim mund të themi që ligji për vetëqeverisjes vendore sjell në vëmendje të njërive vendore disa elemente<sup>2</sup> shumë të rëndësishme në lidhje me standardin për ofrimin e shërbimeve publike, duke prezantuar për herë të parë konceptin e vlerësimit të shërbimit publik sipas indikatorëve të performancës dhe detyrimin e ofrimit të shërbimit bazuar në standardin minimal.

Në vitin 2015, kur ligji hyri në fuqi, për njësitë vendore ishte ende e paqartë se kur një shërbim publik (*menaxhimi i mbetjeve në këtë rast*) do të konsiderohej se përmbushte apo jo standardin minimal. Në këtë kontekst, **Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035** bëri përpjekje për përcaktimin e standardit minimal të ofrimit të shërbimit nga njësitë vendore (në rastin konkret atë të menaxhimit të mbetjeve nga njësitë vendore), i cili përkufizohet si:

*“Shtrirja e shërbimit dhe mbledhja e mbetjeve në të gjithë territorin e aksesueshëm të bashkisë, duke siguruar mjetet e nevojshme dhe të mjaftueshme të grumbullimit, transportit dhe depozitimit në një vend të kontrolluar.”*

Nisur nga ky përkufizim për standardin minimal, strategjia ka shkuar përtej duke përcaktuar aktivitetet dhe prioritarizmin e tyre, të cilat bashkitë duhet t'i përqafojnë në kohë, në përmbushje edhe të detyrimeve ligjore sipas ligjit vendor për të ofrura një shërbim sipas standardit minimal. Konkretisht strategjia përcakton si prioritet fillestar për bashkinë, shtrirjen e shërbimit në 100% të territorit urban dhe depozitimin i mbetjeve në një vend-depozitim të kontrolluar dhe të pajisur me leje. Prioriteti i dytë është shtrirja e shërbimit në 90% të territorit rural, dhe prioriteti i fundit është ai i ndarjes së mbetjeve për riciklim të mëtejshëm.

Për të përfunduar të gjitha kërkesat ligjore që njësitë vendore duhet të përmbushin për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve sipas standardit të kërkuar kombëtar, ku përfshihen të gjitha proceset e shërbimit (*grumbullimi, transportimi, riciklimi, trajtimi, monitorimi dhe vlerësimi i shërbimit sipas indikatorëve të performancës, raportimi dhe informimi i komunitetit*), halka e fundit është detyrimi i raportimit nga palët e treta dhe krijimi i databazës së mbetjeve dhe raportimi më tej, nga njësitë vendore. Që nga viti 2011, kur ligji i ri "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar hyri në fuqi, statistikave të mbetjeve iu kaluan Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si një nga detyrat për t'a zhvilluar më tej. Bazuar në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, neni 60 "Për statistikave të mbetjeve", është aprovuar **VKM nr. 687, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mirëmbajtjen, rifreskimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"**, ku jep të drejtën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të mbajë të dhënat e mbetjeve nga njësitë vendore dhe autoritetet e tjera kombëtare përmes mbledhjes së listave të kontrollit të përcaktuara nga VKM. Në këtë pikë, të gjitha njësitë vendore (61 bashki) duhet të plotësojnë listën e kontrollit për 11 rrymat e mbetjeve që gjenerohen në territorin e tyre dhe duhet t'ia dorëzojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit çdo vit, si dhe institucionet e tjera kombëtare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Pas hyrjes në fuqi të ligjit bazë për menaxhimin e integruar të mbetjeve, të gjitha VKM e tjera në vazhdim për rrymat specifike të mbetjeve përcaktuan qartë se të gjithë prodhuesit, përdoruesit, shpërndarësit dhe palët e tretave të rrymave specifike duhet të raportojnë çdo vit në njësinë vendore ku ato operojnë, në lidhje me sasinë e mbetjeve që gjenerojnë dhe trajtojnë gjatë vitit.

<sup>2</sup>Principet bazë në lidhje me domethënien e ofrimit të një shërbimi publik (gjithëpërfshirja, vazhdimësia, përballueshmëri financiare dhe plotësimi i standardit minimal të përcaktuar me ligj)

Format e mundshme ligjore të organizimit dhe administrimit të shërbimit nga njësitë vendore

Krijimi i strukturës së posaçme për monitorimin dhe vlerësimin e shërbimit sipas sistemit të indikatorëve të performancës

Krijimi i strukturës së posaçme dhe procedurave për transparencën me komunitetin në lidhje me shërbimin e mbetjeve dhe aksesibiliteti i vazhdueshëm i komunitetit për të qënë pjesë e sistemit të kontrollit të shërbimit (ankesa, vërejte, sugjerime, etj.,)

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Tabela më poshtë përmbledh të gjitha kërkesat ligjore për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve sipas standardit ligjor kombëtar të kërkuar:

STANDARDI MINIMAL I MENAXHIMIT TE MBETJEVE				
GRUMBULLIM I PERZIER	TRANSPORTI <sup>3</sup>	DEPOZITIMI		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Prioriteti I</b><sup>4</sup> : Grumbullimi i mbetjeve<sup>5</sup> në 100% në zonën urbane. Mënyra e grumbullimit me kontenierë 1.1 m<sup>3</sup> ose derë me derë me kontenierë 120litra/240 litra/ qese plastike</li> <li>• <b>Prioriteti III</b><sup>6</sup> është shtrirja e shërbimit në mbi 90% të zonës rurale. Mënyra e grumbullimit me kontenierë 1.1 m<sup>3</sup> në qendër fshati ose derë me derë me kontenierë 120litra/240 litra/ qese plastike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në zonat urbane me makina teknologjike</li> <li>• Në zonat rurale me makina të vogla të hapura (kamionçina)</li> </ul>	<p>Prioriteti II<sup>7</sup> : Depozitimi i mbetjeve në vendgrumbullimet e kontrolluara të pajisura me leje mjedisore përkatëse dhe me sisteme për kontrollin e ndotjes</p>		
STANDARDI LIGJOR I MENAXHIMIT TË MBETJEVE				
GRUMBULLIM I DIFERENCUAR <sup>8</sup>	TRANSPORT I DIFERENCUAR SIPAS RRYMAVE TE GRUMBULLUARA <sup>9</sup>	TRAJTIMI NE IMPIANTET E GROPOSJES OSE ASGJESIMI <sup>10</sup>		
<p><b>Prioriteti IV</b><sup>11</sup>: Ndarja e mbetjeve për riciklim të mëtejshëm. Mënyra e organizimit të grumbullimit të ndarë mund të përzgjidhet nga njësia vendore, sipas kushteve që ajo<sup>12</sup>, ku mund të zgjedhë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Grumbullimi me dy rryma mbetjesh <ul style="list-style-type: none"> <li>a) të riciklueshme të thata</li> <li>b) të riciklueshme të njoma dhe mbetjet e përziera me kontenierë 1.1m<sup>3</sup>.</li> </ul> </li> <li>• Grumbullim me 4 rryma mbetjesh: <ul style="list-style-type: none"> <li>a) letër,</li> <li>b) metal,</li> <li>c) plastikë</li> </ul> </li> </ul>	<table border="1"> <tr> <td>Transport drejt impianteve primare të trajtimit (rikuperimit të burimeve) për mbetjet e riciklueshme si MRF (Impiantet e e rekuperimit të materialeve), apo MBT (impiantet e trajtimit biologjik)</td> <td>Transporti drejt stacioneve të transferimit të mbetjeve</td> </tr> </table>	Transport drejt impianteve primare të trajtimit (rikuperimit të burimeve) për mbetjet e riciklueshme si MRF (Impiantet e e rekuperimit të materialeve), apo MBT (impiantet e trajtimit biologjik)	Transporti drejt stacioneve të transferimit të mbetjeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Parapërgatitja e mbetjeve për operacionet e rikuperimit të energjisë ose asgjesimit final të tyre</li> <li>• Rikuperimi i energjisë ose asgjesimi i mbetjeve</li> </ul>
Transport drejt impianteve primare të trajtimit (rikuperimit të burimeve) për mbetjet e riciklueshme si MRF (Impiantet e e rekuperimit të materialeve), apo MBT (impiantet e trajtimit biologjik)	Transporti drejt stacioneve të transferimit të mbetjeve			

<sup>3</sup> Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011, i amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, neni pika 48

<sup>4</sup> Përcaktuar në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035 për standardin minimal të ofrimit të shërbimit (Prioriteti I)

<sup>5</sup> Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011, i amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, neni pika 11

<sup>6</sup> Përcaktuar në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035 për standardin minimal të ofrimit të shërbimit (Prioriteti III)

<sup>7</sup> Përcaktuar në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035 për standardin minimal të ofrimit të shërbimit (Prioriteti II)

<sup>8</sup> Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011, i amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, neni pika 10

<sup>9</sup> Sipas Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (Master Plan 2018-2032) për 10 zonat e mbetjeve është propozuar ndërtimi i impianteve primare dhe stacioneve të transferimit

<sup>10</sup> Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011, i amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, neni pika 3

<sup>11</sup> Përcaktuar në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035 për standardin minimal të ofrimit të shërbimit (Prioriteti IV)

<sup>12</sup> Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035 është përcaktuar që njësitë vendore mund ta vendosin vetë cilën skemë të zgjedhin për grumbullimin e ndarë

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

d) qelq dhe të tjera me kontenierë 120litra/240litra.		
<b>FORMAT E PËRCAKTUARA TË ORGANIZIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK<sup>13</sup></b>	<b>SISTEMI I ADMINISTRIMIT TË PERFORMANCËS<sup>14</sup></b>	<b>SISTEMI I DATABAZËS SË MBETJEVE<sup>15</sup></b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>i) Njësitë organizative, pjesë e strukturës administrative të bashkive</li> <li>ii) Ndërmarrjet e shërbimeve publike, në varësi të bashkive</li> <li>iii) Kontraktimi i palëve të treta, kompani private</li> <li>iv) Krijimi i Partneriteteve Publike Private</li> <li>v) Shoqëritë tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njëjive vendore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i strukturës së posaçme në bashki për mbikqyrjen dhe monitorimin e performancës të shërbimit publik</li> <li>• Monitorimi përmes indikatorëve të performancës së shërbimit</li> <li>• Raportimi përmes indikatorëve të performancës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Plotësimi i listës së kontrollit për 11 rrymat e mbetjeve që prodhohen në territorin e bashkisë<sup>16</sup></li> <li>• Raportimi nga ofruesit e shërbimit</li> <li>• Raportimi nga kompanitë tregtare shpërndarëse/ prodhuese / importuese brenda territorit të bashkisë<sup>17</sup></li> </ul>
<b>TRANSPARENCA PËR SHËRBIMIN PUBLIK</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>i) Njësitë vendore duhet të bëjnë transparente shërbimet e menaxhimit të mbetjeve bëhen transparente nga njësia vendore komunitetit<sup>18</sup>, <b>nga koordinatori i transparencës<sup>19</sup></b></li> <li>ii) Çdo qytetar i njësisë vendore ka të drejtë të bëjë kërkesa, ankesa apo vërejtje pranë njësisë vendore në lidhje me shërbimet publike që ofrohen në njësinë vendore (neni 19)</li> </ul>		

<sup>13</sup> Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i amenduar me ligjin nr.38, datë 20.06.2019, neni 33 pika 1

<sup>14</sup> Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i amenduar me ligjin nr.38, datë 20.06.2019, neni 33 pika 2

<sup>15</sup> Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011, i amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, neni pika 60

<sup>16</sup> VKM nr. 687, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mirëmbajtjen, rifreskimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve"

<sup>17</sup> VKM nr. 177. 06.03.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet" kapitulli XII "Monitorimi dhe Raportimi" neni 1,2,3

VKM nr. 765, datë 07.11.2012 "Për miratimin e rregullave për mbledhjen dhe trajtimin e diferencuar të vajrave të përdorur", kapitulli VIII "Monitorimi", neni 6

VKM nr. 866, datë 04.12.2012 "Për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët", kapitulli XI "Përqindjet në mbledhjen dhe monitorimin", neni 7

VKM nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike" kapitulli IX, neni 4

VKM nr. 608, datë 17.09.2014 "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio dhe kritereve dhe afateve për minimizimin e tyre"

VKM nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", neni 20

<sup>18</sup> Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i amenduar me ligjin nr.38, datë 20.06.2019, neni 15 pika 1

<sup>19</sup> Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i amenduar me ligjin nr.38, datë 20.06.2019, neni 15 pika 3

### III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

#### 3.1 Profili i Bashkisë

Bashkia Vau Dejës shtrihet në pjesën veriore të vendit dhe bën pjesë në qarkun Shkodër në një territor prej 468 km<sup>2</sup>, i cili kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë Shkodër dhe Tropojë, në lindje me Bashkitë Fushë-Arrëz dhe Vau Dejës, ndërsa në jug me Bashkinë Lezhë.

Bazuar në reformën e re administrative dhe territoriale, të miratuar në Korrik 2015, Bashkia Vau Dejës përbëhet nga 6 NJA (Vau Dejës, Bushat, Hajmel, Vig Mnelë, Shllak dhe Temal), ku kryeqendra e bashkisë është qyteti i Vau Dejës.




Figura 3 Njësitë administrative Bashkia Vau Dejës

Burimi: [Bashkia Vau Dejës]

NJA	Sipërfaqe	Popullsia (Sipas MNE)	Nr. i familjeve (Sipas MNE)	Njësitë përbërëse
Vau Dejës	99.2 km <sup>2</sup>	9,584	2,576	Vau Dejës, Mjedë, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe
Bushat	91.4 km <sup>2</sup>	17,247	4,378	Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten
Hajmel	29.98 km <sup>2</sup>	5,063	1,260	Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë
Vig Mnelë	71,83 km <sup>2</sup>	1,741	483	Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig
Shllak	73.11 km <sup>2</sup>	1,060	303	Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj
Temal	105.38 km <sup>2</sup>	1,969	506	Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Killogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë

Tabela 2 Njësitë Administrative të Bashkisë Vau Dejës

Burimi: [Bashkia Vau Dejës, punim i autorit]

Territori i bashkisë është i larmishëm, me një reliev kryesisht fushor në pjesën jug-perëndimore dhe malor në pjesën veri-lindore. Maja më e lartë është ajo e Cukalit me lartësinë 1,721 m mbi nivelin e detit. Një rëndësi të madhe në këtë territor ka edhe ultësira e Zadrimës, që shquhet për prodhimet bujqësore dhe të artizanatin. Zhvillimi aktual ka karaktere të ndryshme dhe të paintegruara në pjesë të ndryshme të territorit. Potencialet bujqësore, turizmi dhe artizanati, janë elementet kryesore të promovimit të zhvillimit dhe karakterit të bashkisë. Bujqësia luan rolin kryesor me 65-85% të punësimit

në territorin e bashkisë. Rol të rëndësishëm luan edhe prania e infrastrukturës energjetike (prania e 4 HEC-eve) që punëson mbi 5% të fuqisë punëtore.

Zonat e thella të njësive administrative Shllak, Temal dhe Vig-Mnelë paraqesin prapambetje në zhvillimin urban dhe ekonomik si dhe aksesin në infrastrukturë. Turizmi është një potencial ende i pazbulur, por që paraqet alternativa të shumta për zhvillim, sidomos në raport me trashëgiminë kulturore, natyrën, bujqësinë, veprat energjetike, sportin, lundrimin etj.

### 3.1.1 Të dhëna demografike

Popullsia e regjistruar në Bashkinë Vau i Dejës bazuar në të dhënat e marra nga regjistri i Gjendjes Civile është 51,188 banorë, ndërsa nga të dhënat e marra nga INSTAT Census 2011, popullsia e bashkisë është 30,438 banorë ndërsa popullsia e llogaritur sipas formulës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është llogaritur në 36,663 banorë. Njësitë administrative Bushat dhe Vau Dejës kanë numrin më të lartë të popullsisë rezidente, ku në Bushat banon 49% e popullsisë së bashkisë, ndërsa në Vaun e Dejës banon 27% e popullsisë totale të bashkisë.

Njësitë e tjera administrative kanë një numër më të vogël të popullsisë ku popullsia totale e tyre përbën vetëm 23% të popullsisë totale të bashkisë. Njësitë administrative Bushat dhe Vau i Dejës kanë popullsi më të lartë për fshat që varion respektivisht nga 1,011 dhe 902 banorë për fshat. Raportin më të ulët të këtij treguesi e kanë njësitë administrative Temal (156 banorë/fshat) dhe Shllak (96 banorë/fshat). Popullsia e bashkisë dominohet më shumë nga grupmosha 15-64 vjeç, e cila përbën 65.8% të popullsisë totale të bashkisë. Grupmosha 0-14 vjeç përbën 21.6 % të popullsisë, ndërsa mosha e tretë (+65 vjeç) përfaqëson 12.6% të popullsisë të bashkisë Vau i Dejës. Treguesi për grupmoshën 0-14 vjeç është mbi mesataren e këtij treguesi për vendin tonë. Këto të dhëna tregojnë se Bashkia Vau i Dejës karakterizohet nga popullsia me moshë të re.

Sot në territorin Bashkisë Vau Dejës janë 6 NJA. Në hartimin e këtij planit i jemi referuar numrit të popullsisë të marrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ashtu siç tregohet në tabelën më poshtë:

NJA	Popullsia Census 2023		Popullsia RGJC		Popullsia Formula MFE	
	Popullsia	Familje	Popullsia	Familje	Popullsia	Familje
Vau Dejës	8,117	1,972	13,006	3,985	9,584	2,576
Bushat	14,149	3,566	24,475	6,273	17,247	4,378
Hajmel	4,430	1,001	6,540	1,864	5,063	1,260
Vig-Mnelë	1,509	333	2,281	834	1,741	483
Shllak	671	168	1,966	617	1,060	303
Temal	1,562	426	2,520	693	1,969	506
<b>Totali</b>	<b>30,438</b>	<b>7,466</b>	<b>51,188</b>	<b>14,266</b>	<b>36,663</b>	<b>9,506</b>

Tabela 3 Popullsia Bashkisë Vau Dejës

[Burimi: zhvilluar nga autori]

### 3.1.2 Karakteristikat social ekonomike

Ekonomia e bashkisë është e bazuar kryesisht në aktivitetin bujqësor për shkak të karakterit rural të bashkisë, atë të shërbimeve dhe atë energjetik pasi në territorin e bashkisë ushtrojnë aktivitetin e tyre 4 HEC-e. Në sektorin e bujqësisë janë të përfshirë rreth 65-85% e të punësuarve, ndërsa sektori energjetik punëson më shumë se 5% të forcës punëtore të banorëve të bashkisë. Një vend të rëndësishëm në ekonominë e bashkisë zënë dhe bizneset ku aktualisht janë regjistruar 875 biznese nga të cilat 626 të vogla dhe 236 të mëdha.

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

	2024	2025	2026	2027 (PBA)	2028 (PBA)	2029 (PBA)
<b>BV</b>	170	185	689	231	236	238
<b>BM</b>	20	25	111	626	639	645
<b>Totali</b>	190	210	800	857	875	883

Tabela 4 Numri i bizneseve të vogla dhe të mëdha

Burimi: [Bashkia Vau Dejës]

Turizmi përbën një nga sektorët me potencial zhvillimi të lartë në bashkinë Vau Dejës, por mbetet akoma i pa zhvilluar plotësisht. Aktualisht në territorin e bashkisë ushtrojnë aktivitetin e tyre 5 hotele me një numër rreth 174 shtretërisht dhe 3 bujtina me një numër prej 20 shtretërisht. Zonat e thella të njësisve administrative Shllak, Temal dhe Vig-Mnelë paraqesin prapambetje në zhvillimin urban dhe ekonomik si dhe aksesin në infrastrukturë. Turizmi është një potencial ende i pa eksploruar, por që paraqet alternativa të shumta për zhvillim, sidomos në raport me trashëgiminë kulturore, natyrën, bujqësinë, veprat energjetike, sportin, lundrimin etj.

### 3.2 Aspekte institucionale në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës

Në Bashkinë Vau Dejës shërbimi ofrohet nga vetë bashkia për tre njësi administrative, Vau Dejës, Hajmel dhe Bushat, duke mbuluar 100% të popullsisë që banon në këto njësi. Në diagramën më poshtë tregohet se si funksionon struktura në bashki për menaxhimin e mbetjeve:




Figura 4 NJA Struktura e Bashkisë për menaxhimin e mbetjeve

[Burimi: Bashkia Vau Dejës, zhvilluar nga autori]

Sipas të dhënave të grumbulluara në terren, në Bashkinë Vau Dejës ka 1 përgjegjës për sektorin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane, 5 administratorë në total, ku 2 operojnë në NJA Vau Dejës, 2 në NJA Bushat dhe 1 në NJA Hajmel. Këtyre punonjësve i shtohen edhe 2 supervizorë të shërbimit, të cilët janë për të gjithë territorin e bashkisë ku ofrohet shërbimi. Burimet njerëzore për mbledhjen dhe

transportin janë të përcaktuara, fikse dhe jo të shëndara sipas njësive përkatëse. Bazuar në organigramën e bashkisë numri i punëtorëve për transportin e mbetjeve është 2 dhe numri i punonjësve për grumbullimin e mbetjeve është 5 punëtorë, të cilët operojnë në të gjithë territorin e bashkisë. Bashkia Vau Dejës ka edhe 2 punëtorë të cilët janë të vendosur në lëndfillin e Bushatit për të mbajtur evidencat, si dhe 2 puntorë të tjerë janë për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve.

### 3.3 Aspekte teknike në menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës

#### 3.3.1 Të dhëna për sasinë e prodhuar e mbetjeve skema e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Vau Dejës

Bashkia Vau Dejës e organizon vetë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në territorin e saj, siç tregohet në tabelën dhe figurën më poshtë:

Nr.	NJA	Lloji i shërbimit
1	Vau Dejës	Nga NJA Vau Dejës
2	Bushat	Nga NJA Vau Dejës
3	Hajmel	Nga NJA Vau Dejës
4	Vig Mnelë	Nuk ofrohet shërbim
5	Shllak	Nuk ofrohet shërbim
6	Temal	Nuk ofrohet shërbim

Tabela 5 Situata e ofrimit të shërbimit në Bashkinë Vau Dejës

[Burimi: Bashkia Vau Dejës]




Figura 5 Shërbimi i Menaxhimit të Mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës

[Burimi: Bashkia Vau Dejës]

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Bashkia Vau Dejës është një ndër bashkitë e pakta në vend, e cila dërgon mbetjet urbane në një landfill sanitar (Landfilli i Bushatit), në të cilin mbetjet peshohen në çdo dërgesë të tyre. Pas reformës administrative territoriale, Bashkia Vau Dejës, e përbërë nga 6 NJA i dërgon mbetjet urbane në landfillin e Bushatit. Në landfillin e Bushatit bashkia ka punonjësit e saj, të cilët mbajnë të dhëna në lidhje me të gjitha dërgesat që vijnë në landfill nga të gjitha NJA të Bashkisë Vau Dejës.

Sipas të dhënave të raportuara nga bashkia dhe nga supervizori në landfillin e Bushatit, sasia e mbetjeve që transportohet, nga tre njësitë administrative, në të cilat ofrohet shërbimi (Bushat, Vau Dejës dhe Hajmel), për vitin 2019 është 2,964 ton/vit<sup>20</sup>. Për sasinë e mbetjeve të grumbulluara dhe numrit të banorëve të shërbyer përlogarit një normë gjenerimi prej 0.23 kg mbetje për banorë në ditë.

Tipi i të dhënave	Vlera
<b>Numri total i popullsisë sipas MFE</b>	36,663
<b>Numri i popullsisë që merr shërbim</b>	31,894
<b>% popullsisë që merr shërbim</b>	87%
<b>% e territorit të mbuluar me shërbim</b>	47%
<b>Sasia e mbetjeve të gjeneruara (e vlerësuar)</b>	2,934
<b>Sasia e mbetjeve të mbledhura (ton/vit)</b>	2,552
<b>Mbetje të gjeneruara (kg/banorë/ditë)</b>	0.23 kg/banorë/ditë
<b>Frekuenca e mbledhjes së mbetjeve</b>	
<b>a. Zona 1 (Urbane)</b>	3 herë/javë
<b>b. Zona 2 (Rurale)</b>	2 herë/javë

Tabela 6 Të dhëna mbi ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Burimi: [Bashkia Vau Dejës]

Në lidhje me infrastrukturën për grumbullimin e mbetjeve, Bashkia Vau i Dejës ka në pronësi kontenierë metalikë në pjesën më të madhe dhe kontenierë plastikë me kapacitet 1.1m<sup>3</sup>. Ata janë të vendosur në pika të përcaktuara nga bashkia për grumbullimin e mbetjeve të ngurta urbane, kryesisht me nga një dhe dy kontenierë për një pikë grumbullimi. Në njësitë administrative të shërbyera janë të vendosur 670 kontenierë për një total prej 290 pika grumbullimi mbetjesh.

Referuar të dhënave të Bashkisë rezulton se numri i kontenierëve të dëmtuar është 400, gjë kjo e cila tregon nevojën për riparimin apo rinovimin e flotës së kontenierëve.

Nga po këto të dhëna rezulton se kryhet dezinfektimi dhe larja e kontenierëve në pikat e grumbullimit të mbetjeve. Ky aktivitet kryhet 4 herë në muaj dhe për larjen dhe dezinfektimin e PGM-ve dhe kontenierëve bashkia deklaron se përdor rreth 20 m<sup>3</sup> ujë dhe 70 m<sup>3</sup> klor në muaj. Ky është një komponent i shërbimit, i cili duhet të përmirësohet për të ofruar një shërbim më të mirë dhe me cilësi në Bashkinë e Vau Dejës.

Nga të dhënat e marra nga bashkia rezulton se shpërndarja e kontenierëve është disi e ç'rregullt, pasi në disa raste kemi bateri prej 8 kontenierësh të stacionuar në disa biznese të zonës, dhe në disa raste vetëm dy apo 1 kontenier për pikë, duke sjellë edhe mbingarkimin e pikës së grumbullimit, ku mbetjet gjenden edhe jashtë kontenierit.

<sup>20</sup> Në Njësinë Administrative Vig Mnelë, Shllak dhe Temal Bashkia aktualisht nuk ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Bashkia Vau Dejës	Kontenierë 1.1m <sup>3</sup>	Kontenierë në gjendje të mirë (nr/%)	Kontenierë në gjendje të dëmtuar (nr/%)	PGM me1-2 kontenierë për pikë	Vite pune të kontejnerëve
Bushat, Hajmel, Vau Dejës	670	270 - 41%	400 - 60%	290	...

Tabela 7 Kontenierët e shërbimit në zonën e studimit

[Burimi: Bashkia Vau Dejës, zhvilluar nga autori]

Bashkia ka në pronësi 3 kamionë, 2 teknologjik (kompaktor) dhe 1 vetëshkarkues, për kryerjen e shërbimit të mbledhjes dhe transportit të mbetjeve urbane. Kamionët teknologjik kanë një kapacitet 10 dhe 5 ton ndërsa kamioni vetëshkarkues ka një kapacitet 3 tonësh. Kamioni 10 ton është tejmasë i amortizuar, por është akoma në gjendje pune, ndërsa kamioni 5 tonësh është prodhimi i vitit 2014 dhe është në gjendje të mirë pune. Jeta mesatare e përdorimit të kamionëve është 22 vite, ku kamioni më i ri rezulton me 5 vite pune.

Kamionë/automjet e të tjera	Teknologjia	Tonazhi	Viti i prodhimit	Vite punë
Kamioni 1	Kompaktor	10 ton	NA	NA
Kamioni 2	Kompaktor	5 ton	2014	5
Kamioni 3	Me vetëshkarkim	3 ton	NA	NA

Tabela 8 Mjetet për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës

Burimi: [Bashkia Vau Dejës]

### 3.3.2 Riciklimi dhe kompostimi

Në Bashkinë Vau Dejës nuk kryhet grumbullimi dhe mbledhja e ndarë e mbetjeve sipas rrymave të riciklueshme. Sektori joformal i riciklimit, është i pranishëm në bashki, gjithsesi i kufizuar në një numër të vogël njerëzish, të cilët mbledhin nga kontenierët rrymat e riciklueshme të mbetjeve, kryesisht plastikë dhe metal.

### 3.3.3 Landfilli i Bushatit

Në Bashkinë Vau Dejës mbetjet depozitohen në landfillin sanitar të Bushatit, një sipërfaqe prej 23,000 m<sup>2</sup>. Në landfill depozitohen mbetjet urbane të të gjitha llojeve dhe nuk lejohen të depozitohen mbetjet spitalore, bateri, akumulatorë, vajra industriale dhe mbetje të tjera të përcaktuara si të rrezikshme nga legjislati mjedisor Shqipëtar.

Firma private e cila ushtron aktivitetin teknologjik në impiant bën ngjeshjen dhe mbulimin me dhe' të mbetjeve pasi ato depozitohen. Në këtë impiant është instaluar në hyrje të tij një linjë për ndarjen e mbetjeve, por asnjëherë nuk është vendosur në punë. Sistemi i kullimit të ujrave të shiut mbledh ujrat sipërfaqësorë dhe i devijon ato nga venddepozitimi, por impianti i pastrimit të tyre nuk funksionon. Si pasojë shllami derdhet herë pas here në sistemin e gropave septike, duke krijuar një rrezik potencial për mjedisin. Landfilli aktualisht ka hyrë në zonën e maturimit të sasisë të gazit të metanit (CH<sub>4</sub>), i cili ka filluar të jepet nga dy puse dhe më pas realizohet djegia në natyrë.



Figura 6 Landfilli i Bushatit  
[Burimi: Autori]


#### IV. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

##### 4.1 Kosto e plotë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave

Në financat vendore në Shqipëri, në përgjithësi shpenzimet operative të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve janë planifikuar dhe realizuar vazhdimisht së bashku me shërbimet e tjera publike vendore, dhe veçanërisht të bashkuara me shpenzimet për pastrimin dhe gjelbërimin dhe shërbime të tjera publike. Në Bashkinë e Vaut Dejës është gjetur pikërisht kjo praktikë. Për rrjedhojë, buxheti i veçuar i këtij shërbimi është i përafëruar.

Nga të dhënat e bashkisë marrim kostot e mëposhtme për njësi të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vitin 2024 dhe 2025. Sasia mesatare e vlerësuar e gjenerimit të mbetjeve për banor/ditë e cila përdoret si bazë e përlogaritjes së kostos operative për ton mbetje është 0.3 kg/banor/ditë.

Nga të dhënat e bashkisë marrim kostot e mëposhtme ku tregohet që shpenzimet Lek/vit në bashki kanë një variacion. Përgjatë vitit 2018 kosto operative e shërbimit është në vlerën 12,606 Lek/ton/vit dhe respektivisht 1,009 Lek/banor/vit. Gjatë vitit 2024-2025, bashkia në llogaritjet e kostos së shërbimit ka marrë në konsideratë edhe shërbime të tjera publike, duke mos e ndarë shërbimin e mbetjeve më vete. Gjatë fazës të përgatitjes së buxhetit, në fund të vitit 2025 bashkia ka bërë një ndarje të zërave të kostos, duke e lënë koston për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve më vete, siç tregohet në tabelat më poshtë, së bashku me zërat përkatës të kostos:



**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Figura 7 Zërat e kostos të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës

Burimi: [Bashkia Vau Dejës]

**Kosto e shërbimit 2024 - 2025**

<b>Shpenzimet e realizuara të shërbimit (lekë/vit)</b>	<b>32,171,000</b>
<b>Sasia e mbetjeve e mbledhur (ton/vit)</b>	<b>2,964</b>
<b>Banorë që marrin shërbim</b>	<b>31,894</b>
<b>Kosto operative e shërbimit (lek/ton/vit)</b>	<b>12,606</b>
<b>Kosto operative e shërbimit (lek/banor/vit)</b>	<b>1,009</b>
<b>Norma gjenerimit të mbetjeve</b>	<b>0.23</b>

Tabela 9 Kosto e shërbimit lekë/ton/vit dhe lekë/banor/vit 2024-2025

[Burimi: Bashkia Vau Dejës]

<b>Kosto e shërbimit 2025</b>	
Pagat vjetore (lek/vit)	<b>5,965,000</b>
Sigurimet shoqëror+shëndetësore (lek/vit)	<b>996,000</b>
Shpenzimet operative (lek/vit)	<b>6,726,237</b>
Pagesa në landfill për depozitimin e mbetjeve (lek/vit)	2,594,829
Karburant+lubrikant (lek/vit)	2,421,816
Pjesë këmbimi (lek/vit)	1,709,592
<b>Kosto totale operative + administrative (lek/vit)</b>	<b>13,687,237</b>
<b>Kosto e Investimeve</b>	<b>6,330,000</b>
Blerje kontenerësh	840,000
Ndërtimi bazementi për kontenerët	2,490,017
Blerje mjeti vetëshkarkues	3,000,000
<b>Kosto totale (operative, administrative, investimeve)</b>	<b>20,017,237</b>

Tabela 10 Kosto e shërbimit lekë/ton/vit për vitin 2025

[Burimi: Bashkia Vau Dejës]

#### **4.2 Sistemi i tarifave të menaxhimit të mbetjeve**

Bashkia ka një bazë të dhënash të pjesshme për klientët që përfshijnë një pjesë të familjeve dhe kryesisht bizneset. Mungesa e një databaze të plotë për subjektet familjare është shkaku kryesor për mos faturimin e tyre. Detyrimi vjetor u ngarkohet familjeve përgjithësisht nëpërmjet Zyrës së Gjendjes Civile, kur banorët paraqiten për të marrë një shërbim administrativ. Tarifa e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve u faturon rregullisht bizneseve dhe institucioneve 1 herë në vit. Ajo mbledhet nga bashkia nëpërmjet sporteleve pranë zyrave të bashkisë qendër ose nëpërmjet bankës; bizneset dhe institucionet derdhin tarifën kryesisht nëpërmjet bankës.

Masat shtrënguese janë të parashikuara në Paketën Fiskale të bashkisë, por masat nxitëse në tërësi mungojnë. Gjithashtu, shpesh familjet janë të përjashtuara edhe nga masat shtrënguese.

Niveli i tarifës për familjet është 1,500 lekë/vit/familje, ndërsa për bizneset dhe institucionet jepet si në tabelën më poshtë:

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Kategoria	Niveli I tarifave (lek/vit)	Nr. Vau Dejës	Nr. Bushat
<b>Familjet</b>	1,500		
<b>Bizneset</b>			
<b>Ambulant</b>	5,000	0	0
<b>Subjektet me xhiro 0 – 8 milion lek në vit</b>	120/leke/m <sup>2</sup> /vit	194	272
<b>Profesione të Lira</b>	10,000 - 15,000	9	9
<b>Transport për pasagjerë</b>	4,000 – 10,000	8	6
<b>Transport Mallrash</b>	4,000 – 10,000	2	2
<b>Subjekte Juridike të Mëdha me xhiro 8,01 deri ne 200 milion leke</b>			
Tregtim karburanti me pakicë	35,000	8	8
Tregtim karburanti me shumice	60,000	1	
Subjekte prodhimi asfalto-beton, blloqe, tulla, mermer, etj	50,000	4	2
Subjekte ndërtimi të regjistruar pranë Bashkisë Vau Dejës.	60,000	3	1
Subjekte me aktivitet punime & përpunime duralumini, metalesh, druri etj.	50,000	3	5
Subjekte tregti artikuj të ndryshëm.	60,000	3	50
Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushen e inerteve	100,000	2	1
Subjekte dege të shoqerive së huaj	200.000	1	0
Subjekte shërbimi, agjensi sigurimi, transporti, loto, banka,	40,000	2	4
Subjekte tregtare, shërbime telefoni fikse, mobile, internet.	40,000	6	3
Subjekte të transmetimit të energjisë, OSHE, OST	100 leke/m <sup>2</sup> /vit	2	1
Njësia e prodhimit të gjithë H/C	100 leke/m <sup>2</sup> /vit	2	1
Reparti Ushtarak 1010	100 leke/m <sup>2</sup> /vit	1	0
Subjektet prodhim mishi, peshku, qumështi, stalla derrash, lopesh etj.	60,000	4	1
Subjektet Juridike te Medha me xhiro mbi 200 milion leke	200.000	2	0
<b>OFJ</b>	10,000	0	0
<b>Institucionet</b>	15,000	0	0

Tabela 11 Niveli i tarifave të pastrimit në NJA të Bashkisë Vau Dejës për kategoritë e klientëve

[Burimi: zhvillimi nga autori]

Të ardhurat e planifikuara të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës përfshijnë mbledhjen e tarifës nga familjet, institucionet dhe bizneset tek të cilët faturohet shërbim. Aktualisht nuk ka planifikim të të ardhurave nga familjet për shkak se nuk faturohet rregullisht shërbimi. Për pasojë të ardhurat që mund të mbliidhen gjatë vitit në rastet kur banorët paraqiten përpara bashkisë për shërbime administrative janë një shumë e rastësishme dhe shtesë ndaj planit total të të ardhurave nga bizneset dhe institucionet.

Gjatë vitit të kaluar janë faturuar 11,274 familje ose 67% nga 14,226 familje gjithsej. Ndërsa janë faturuar 100% e institucioneve dhe bizneseve të regjistruara në bashki.

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Kategoria	Totali	Faturuar	Arkëtuar
Familje	14,226	67%	39%
Biznes	594	100%	55%
Institucione	...	100%	100%

Tabela 12 Përqindja e konsumatorëve të faturuar dhe arkëtuar në Bashkinë Vau Dejës

[Burimi: Bashkia Vau Dejës]

Një problem që evidentohet përsa i takon të ardhurave është niveli i ulët i planifikimit të tyre, ku për vitin **2018** planifikimi i të ardhurave ishte vetëm 27,000,000 Lek/vit, duke sjellë një përqindje prej 115% kundrejt atij të planifikuar:

Të ardhurat e shërbimit	Vlerat (lek/vit)
Të ardhurat e planifikuara të shërbimit lekë/vit	27,000,000
Të ardhurat e realizuara të shërbimit lekë/vit	31,049,000
<b>Familje</b>	12,049,000
<b>Biznesi i madh dhe i vogël</b>	17,000,000
<b>Institucione</b>	2,000,000
<b>% e realizimit të të ardhurave gjithsej</b>	<b>115%</b>
<b>% e realizimit të familjeve ndaj totalit</b>	39%
<b>% e realizimit të bizneseve ndaj totalit</b>	55%
<b>% e realizimit të institucioneve ndaj totalit</b>	6%

Tabela 13 Të ardhurat e shërbimit viti 2018

[Burimi: Bashkia Vau Dejës]

Edhe pse planifikimi i faturimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit është i ulët, në tabelën më poshtë tregohet ecuria e realizimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe përqindja e mbulimit të kostos nga të ardhurat. Nga viti 2016 në vitin 2017 ka patur një rënie si të grumbullimit të të ardhurave, ashtu edhe të mbulimit të kostos nga të ardhurat. Ndërkohë viti 2018 shënoi një rritje të grumbullimit të të ardhurave në krahasim me dy vitet e tjera:

	2022	2023	2024	2025
Të ardhurat e realizuara të shërbimit (lek/vit)	26,223,000	23,517,000	31,049,000	25,418,385 <sup>21</sup>
Shpenzimet e realizuara të shërbimit (lek/vit)	30,304,000	32,171,000	32,171,000	50,805,604 <sup>22</sup>
% e mbulimit të kostos nga të ardhurat e tarifave	87%	73%	97%	50%

Tabela 14 Mbulimi i kostos nga të ardhurat e tarifave

[Burimi: Bashkia Vau Dejës]

<sup>21</sup> Të ardhurat e realizuara për vitin 2025, të paraqitura në këtë tabelë, siç argumenton edhe zyra e financës në bashki, përfshijnë edhe shërbime të tjera publike, dhe jo vetëm shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

<sup>22</sup> Shpenzimet e realizuara për vitin 2025, të paraqitura në këtë tabelë, siç argumenton edhe zyra e financës në bashki, përfshijnë edhe shërbime të tjera publike, dhe jo vetëm shërbimin e menaxhimit të mbetjeve




Figura 8 Mbulimi i kostove nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit  
[Burimi: Bashkia Vau Dejës]

Ajo që duhet theksuar në rastin e Bashkisë Vau Dejës, është fakti se të dhënat në lidhje me të ardhurat nga tarifa e pastrimit nuk janë të ndara në databazën e bashkisë. Ato janë të mbledhura së bashku me tarifa të shërbimeve të tjera publike, duke e bërë të pamundur për të kuptuar realisht se sa përqind e kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, mbulohet nga tarifa e pastrimit.

## V. INDIKATORËT E PERFORMANCËS

Në përfundim të procesit për evidentimin e gjendjes ekzistuese të shërbimit në Bashkinë Mirditë, u bë vlerësimi i performancës bazuar në indikatorët e performancës: i) Cilësia e shërbimit; ii) Qendrueshmëria mjedisore; iii) Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare; iv) Qendrueshmëria institucionale. Secili nga indikatorët kryesorë ka indikatorët e tij specifikë, të cilët u përdorën për llogaritjen e indikatorit kryesor, siç shpjegohet më poshtë:

### Cilësia e shërbimit - Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë.

- a. **C1 Mbulimi i zonës me shërbim:** ky indikator tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJA/bashkinë nga firma private e autorizuar ose nga njësi vetë (nëse e kryen ajo shërbimin) kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në njësi. Për këtë indikator u përdor formula për zonat urbane dhe për zonat rurale të Bashkisë Vau Dejës:

$$C1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që gjenerohen në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Në rastin e Bashkisë Vau Dejës për llogaritjen e këtij indikator, janë marrë vlerat e sasisë së mbetjeve që depozitohen në Lendfillin e Bushatit dhe vlerat e llogaritura në sajë të normës së gjenerimit dhe numrit të popullsisë, për të llogaritur përqindjen e mbulimit të zonës me shërbim.

- b. **C2: Pastërtia e bashkisë:** ky është një indikator gjithëpërfshirës, i cili vlerësohet nga këto kritere vlerësimi:
- Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve (prezenca e mbetjeve të akumuluar rreth PGM);
  - Efektiviteti i pastrimit të rrugëve (prezenca e mbetjeve në rrugë);

- k. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve në zonat e largëta (prezenca e mbetjeve të akumuluar/pika ilegale/ djegie të mbetjeve në rrugë).
- l. Efektiviteti në zbatimin e kontrollit dhe supervizimit
- m. Efektiviteti në përdorimin e mjeteve personale mbrojtëse dhe zbatimi i protokollove në rast aksidentesh nga punëtorët e pastrimit

Në përcaktimin e këtij indikator, situata është vlerësuar si nga vëzhgimet në terren në të gjitha NJA-ve të Bashkisë Mirditë, ashtu edhe në bashkëpunim me stafin e Bashkisë dhe të NJA-ve për të na diktuar fenomene të ndryshme në lidhje me pastërtinë e territorit dhe zonat ku duhet të ndërhyhet.

- c. **C3:** Shkalla e kënaqësisë publike: ky është një indikator cilësor për shërbimin që ofron bashkia, dhe vlerësohet në sajë të pyetsorëve të ndryshëm me komunitetin. Zakonisht ky indikator llogaritet në sajë të një pyetje të vetme: **A jeni të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve që ofrohet në njësinë tuaj?**

Për vlerësimin e këtij indikator kanë shërbyer fushatat e pyetësorëve dhe dëgjesa publike të zhvilluara nga bashkia, të cilat nuk janë të shpeshta, duke ndikuar në vërtetësinë e vlerësimit që jep ky indikator.

#### **Qendrueshmëria mjedisore – Ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.**

- a. **D1:** Shkalla e grumbullimit të diferencuar: ky indikator prezanton shkallën e sasisë të mbetjeve që grumbullohen të ndara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

$$D1 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen të ndara në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total në zonë } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Në lidhje me llogaritjen e këtij indikator, për NJA-ve të bashkisë nuk është kryer ndonjë llogaritje pasi nuk ka iniciativa për grumbullimin e ndarë të mbetjeve.

- b. **D2:** Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave: ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohen në impiante të autorizuara. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet si më poshtë:

$$D2 = \frac{\text{Sasia e mbetjeve që trajtohen në impiante } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)}{\text{Sasia e mbetjeve që grumbullohen total } \left(\frac{\text{ton}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Në lidhje me këtë indikator, të gjitha NJA në të cilat ofrohet shërbimi i dërgojnë mbetjet në lëndfillin e Bushatit, ndonëse në territor ka përsëri pika ilegale ku hidhen mbetjet. Megjithatë, territori i kësaj bashkie ka mundësinë për dërgimin e mbetjeve në një impiant inxhinierik dhe jo në venddepozitime të hapura të pakontrolluara.

#### **Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare: Ky indikator përbëhet nga 3 indikatorë specifikë.**

- a. **E1** Mbulimi i Kostos: ky indikator mat sa është kosto e plotë e shërbimit e mbuluar nga grumbullimi i tarifave. Formula më poshtë tregon se si llogaritet ky indikator:

$$E1 = \frac{\text{Të ardhurat nga tarifa e mbetjeve } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Kosto totale e shërbimit } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën e financës dhe të taksave në bashki për të gjitha NJA-ve.

- b. **E2** Shkalla e mbledhjes së tarifës: ky indikator reflekton kapacitetin e popullsisë për të paguar tarifën. Formula për llogaritjen e këtij indikator jepet në formulën më poshtë:

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

$$E2 = \frac{\text{Të ardhurat vjetore nga tarifa e pastrimit } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)}{\text{Totali i të ardhurave të planifikuara } \left(\frac{\text{lek}}{\text{vit}}\right)} \times 100$$

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën e taksave në bashki për të gjitha NJA-ve. Ndonëse ky indikator është i lartë në përqindje, siç deklaron zyra e taksave e Bashkisë Vau Dejës, ai nuk reflekton plotësisht kapacitetin e popullsisë që është rezidente në bashki, pasi jo të gjitha njësitë marrin shërbim dhe paguajnë tarifën. Për këtë arsye në reflektimin e përqindjes së mbledhjes së tarifës kemi zbritur 20%, për t'iu afruar sa më shumë realitetit. Kjo është bërë për arsye se një nga objektivat e bashkisë është shtrirja e shërbimit në të gjithë territorin e saj dhe planifikimi për grumbullimin e tarifës duhet të bëhet në të dhëna sa më reale për numrin e plotë të popullsisë së bashkisë.

c. **E3** Transparenca në sistemin e faturimit: ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:

- i. Ulët: nuk ka një sistem faturimi për tarifën e pastrimit
- ii. Mesatar: ka një sistem faturimi dhe konsumatori merr një faturë
- iii. I lartë: ka një sistem faturimi dhe konsumatori ka informacion dhe kupton tarifën e llogaritur dhe mënyra e llogaritjes është e qartë dhe transparente për të gjithë komunitetin

Edhe pse sistemi i faturimit në Bashkinë Vau Dejës, në ato njësi të cilat e aplikojnë tarifën, shoqërohet me një faturë, e cila kryesisht lëshohet në sportelet e bashkisë, për familjet dhe për bizneset në sistemin e taksave dhe tarifave vendore që ata duhet të paguajnë, niveli i njohurisë së qytetarëve për mënyrën e grumbullimit dhe faturimit është i ulët.

**Qendrueshmëria Institucionale**

- i. **F1:** Transparenca në aspektete institucionale: është një indikator cilësor, i cili vlerësohet nga këto kritere vlerësimi:
  - i. Prania e një strukture organizative në bashki për menaxhimin e mbetjeve
  - ii. Nëse janë të trajnuar punonjësit e bashkisë për aspekte të menaxhimit të mbetjeve
  - iii. Pasja e një Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të miratuar
  - iv. Pasja e një databaze të rifreskuar për të dhëna për mbetjet
  - v. Pasja e një sistemi monitorimi/supervizimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Të gjithë këta indikatorë u përkthyen në një pyetësor praktik, i cili përmbante pyetje sasiore dhe cilësore për secilin nga indikatorët. Pyetësori u nda me grupin e punës të bashkisë dhe u plotësua prej tyre. Nga rezultatet e nxjerra nga plotësimi i pyetësorit në tabelën më poshtë përmbledhet situata e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës, vlerësuar sipas indikatorëve të performancës:

Indikatorët e performancës <b>BASHKIA Vau Dejës</b>		NJA Vau Dejës	NJA Bushat	NJA Hajmel	NJA Vig Mnelë	NJA Temal	NJA Shllak	Bashkia TOTAL
<b>Cilësia e shërbimit</b>	<i>C1 Mbulimi i zonës me shërbim (të dhënat e bashkisë)</i>							60%
	<i>C2 Pastërtia e bashkisë</i>							55%
	<i>C3 Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat</i>							I Panjohur
<b>Qëndrueshmëria mjedisore</b>	<i>D1 Shkalla e grumbullimit të diferencuar</i>							0%
	<i>D2 Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave</i>							100%
<b>Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare</b>	<i>E1 Mbulimi i kostos</i>							39%
	<i>E2 Niveli i grumbullimit të të ardhurave</i>							53%
	<i>E2.1 Kosto e njësi (lek/ton)</i>							16,676

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

	<i>E2.2 Kosto për banorë (lek/banorë)</i>							996
	<i>E3 Transparenca në sistemin e faturimit</i>							Mestar
<b>Qëndrueshmëria institucionale</b>	<i>F1 Transparenca në aspektet institucionale</i>							70%

Tabela 15 Indikatorët e performancës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës [Burimi: Punuar nga autori]

**Indikatori I: Cilësia e shërbimit**

Sipas të dhënave të deklaruar nga Bashkia Vau Dejës, tre njësitë administrative, Bushat, Vau Dejës dhe Hajmel rezultojnë të kenë mbulimin më të madh të territorit dhe banorëve me shërbim, duke kapur vlera pothuajse 100%. Ndërkohë në njësitë e tjera administrative shërbimi nuk ofrohet. Nga kjo panoramë e të gjitha njësiteve, në total Bashkia Vau Dejës është e mbuluar me shërbim në 60%, ndërsa përsa i takon nivelit të pastërtisë ai është në vlerën 55%. Nga kjo situatë kuptojmë qartë që në objektivat afatshkurtër të bashkisë është shtrirja e shërbimit në zonat ku momentalisht ofrohet shërbimi dhe rritja e nivelit të pastërtisë, duke përmirësuar infrastrukturën në terren, si dhe pastrimin e pikave ilegale.

**Indikatori II: Qendrueshmëria Mjedisore**

Në asnjërën nga NJA-ve nuk ofrohet shërbimi për grumbullimin e ndarë të mbetjeve. Ndonëse Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe legjislacioni sektorial parashikon objektiva, të cilat duhet të arrihen deri në vitin 2035 grumbullimin e ndarë të mbetjeve, për Bashkinë Vau Dejës, ky mbetet një objektiv afatmesëm, i cili duhet të testohet si fillim me zona pilot për të parë mundësinë e shtrirjes në të gjithë territorin e bashkisë. Në lidhje me trajtimin e mbetjeve në impiante të kontrolluara, Bashkia Vau Dejës i dërgon mbetjet në landfillin e Bushatit, duke e klasifikuar këtë si bashki me një shkallë 100% të trajtimit të mbetjeve sipas normave.

**Indikatori III: Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare**

Për sa i takon aspekteve ekonomike dhe financiare, ka një nivel të ulët të grumbullimit të tarifave të pastrimit (53%) nga konsumatorët, duke sjellë edhe një mbullim të ulët të kostos së shërbimit (39%). Mungesa e shërbimit në tre njësi administrative, përkatësisht, Vig Mnelë, Temal dhe Shllak ka sjellë që jo të gjithë konsumatorët të jenë në sistemin e pagesës së tarifës së pastrimit, kryesisht familjet. Në lidhje me kostot njësi, kuptojmë që kosto njësi për banorë është sa ¼ e tarifës aktuale që aplikohet nga Bashkia për banorët. Sistemi i faturimit nuk është i rregulluar plotësisht për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, duke sjellë probleme dhe mospagesa të tarifës, kryesisht nga familjarët. Në këto kushte bashkia ka si qëllim llogaritjen e plotë të kostos për një shërbim, i cili do të shtrihet në të gjithë territorin e saj si dhe planifikimin e rritjes së grumbullimit të tarifës brenda 5 vjeçarit të zbatimit të planit, duke parashikuar edhe rritjen e nevojshme të niveleve aktuale të tarifave për mbulimin e plotë të kostos.

**Indikatori IV: Qendrueshmëria Institucionale**

Për sa i takon aspekteve institucionale, si referencë janë marrë të dhënat për tre NJA (Bushat, Vau Dejës dhe Hajmel), të cilat ofrojnë shërbimin dhe të gjitha varen nga qendra e bashkisë në NJA Vau Dejës. Aktualisht, bashkia ka një strukturë në bashki për çështjet e menaxhimit të mbetjeve, e cila përbëhet nga specialistë të fushës për pjesën teknike dhe atë të financave dhe taksave. Për sa i përket pjesës së raportimit nga ana e bizneseve për sasinë e mbetjeve që ata gjenerojnë, sipas kërkesave ligjore në fuqi, nuk kryhet. Nga ana tjetër, bashkia nuk ka një sistem monitorimi dhe kontrolli të rregullt të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Nisur nga kjo situatë bashkia në objektivat e saj afat shkurtër kërkon ngritjen e një sistemi të rregullt monitorimi si dhe hartimin i fushatave ndërgjegjësuese për

aspekte të ndryshme të sistemit të menaxhimit të mbetjeve, si informimi për skemën e menaxhimit të mbetjeve, pagesën e tarifës së pastrimit, informimin e bizneseve për raportimin e detyruar në bashki për sasinë e mbetjeve që gjenerojnë etj.

## VI. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

### 6.1 Vizioni

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Vau Dejës u formëzua në sajë të një procesi të vazhdueshëm diskutimi dhe konsultimi midis palëve të interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit (Grupi i Punës dhe Kryetari i Bashkisë, grupi i ekspertëve, në sajë të analizimit të gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit sipas indikatorëve të performancës dhe propozimit të objektivave afat shkurtër dhe afat mesëm, bazuar në këtë analizë. Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbetjeve, vlerësimit të indikatorëve të performancës, prioritetëve të përgjithshme dhe konkrete në kuadrin e ndarjes së re administrative si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, u ra dakord që vizioni i bashkisë të jetë:

***Bashkia Vau Dejës, një bashki e pastër me zhvillim të qëndrueshëm mjedisor dhe turistik, falë punës së saj dhe kontributit të përbashkët të të gjithë komunitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve.***

### 6.2 Objektivat

Në Dokumentin e Politikave Startegjike dhe Planit Kombëtar për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioritetëve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal, i prezantuar në ligjin e vetëqeverisjes vendore (2015) për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Kjo metodologji propozon 4 hapa në shkallë, duke filluar nga më baziku deri tek ai më optimali, të cilët përcaktojnë standardin minimal të ofrimit të shërbimit:

- i. Mbulimi i 100% të territorit urban me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve
- ii. Depozitimi i mbetjeve në një vend depozitim të kontrolluar të pajisur me lejen përkatëse nga AKM-ja apo në një impiant inxhinierik
- iii. Mbulimi i 90% të territorit rural të bashkisë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve
- iv. Ndarja në burim e mbetjeve dhe rikuperimi i energjisë

Në përcaktimin e objektivave të planit 5 vjeçarë, gjatë konsultimeve me bashkinë, u ra dakord që objektivat do të përcaktohen mbi bazën e vlerësimit të performancës së shërbimit sipas indikatorëve, duke synuar hartimin e skenarëve për të përmbushur standardin minimal të ofrimit të shërbimit.

INDIKATORËT E PERFORMANCËS BASHKIA VAU DEJËS		Bashkia TOTAL GJENDJA EKZISTUESE 2020	OBJEKTIVAT E BASHKISË GJATË ZBATIMIT TË PLANIT 5 -VJEÇAR 2021-2025	AFATI KOHOR
Cilësia e shërbimit	C1 Mbulimi i zonës me shërbim (të dhënat e bashkisë)	60%	Mbulimi i territorit të Bashkisë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe konsolidimi i tij në zonat ku aktualisht ofohet shërbimi <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtrirja e shërbimit në 100% të territorit urban në NJA Vau Dejës, NJA Bushat, NJA Hajmel</li> <li>• Shtrirja e shërbimit në 90% të territorit rural në NJA Vig Mnelë dhe NJA Temal</li> <li>• Shtrirja e shërbimit në 50% të territorit rural në NJA Shllak, (kur të mundësohet rruga automobilistike)</li> <li>• Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për grumbullimin me kontenerë 1.1 m<sup>3</sup> si dhe transportin efektiv të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë Vau Dejës</li> </ul>	2026 – 2027
	C2 Pastërtia e bashkisë	55%	Sigurimi i pastërtisë të pikave të grumbullimit të mbetjeve (evitimi i pikave të tejmbushura) Sigurimi i pastrimit të rregullt të rrugëve të qytetit dhe zonave të urbanizuara nga hedhurinat Reduktimi i depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe atyre inerte në territorin e Bashkisë Vau Dejës	2027
	C3 Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat	I panjohur	Ngritja e një sistemi komunikimi dhe partneriteti me komunitetin për krijimin e mundësisë për akses të vazhdueshëm për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	2026-2027
Qëndrueshmëria mjedisore	D1 Shkalla e grumbullimit të diferencuar	0%	Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre. Promovimi i trajtimit të veçantë të mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, duke instaluar skemat e ndarjes në burim për zona pilot në bashki Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve	2027-2029
	D2 Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave	100%		✓
Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare	E1 Mbulimi i kostos	39%	Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve, marrëveshjeve dhe kontratave. Llogaritja vjetore e kostos sipas modelit të miratuar me VKM dhe rishikimi i nivelit të tarifave, bazuar në koston reale të shërbimit. Rifreskimi i databazës së klientëve për planifikimin e saktë të grumbullimit të tarifës	2027-2030
	E2 Niveli i grumbullimit të të ardhurave	53%	Hartimi i një strategjie për rritjen e nivelit të të ardhurave nga tarifat për të gjitha njësitë administrative <ul style="list-style-type: none"> <li>• Arritja e mbledhjes së tarifës së pastrimit gjatë periudhës 5 vjeçare në masën 100%</li> <li>• Informimi i qytetarëve në lidhje me shërbimet e pastrimit që do të mbuloohen nga tarifa</li> <li>• Aplikimi i fushatave ndërgjegjësuese në lidhje me pagesën e tarifës së pastrimit dhe rritjet progresive në sajë të përmirësimit dhe shtimit të shërbimeve për mbetjet</li> </ul>	2027-2031
	E2.1 Kosto e njësi (lek/ton)	16,676		
	E2.2 Kosto për banorë (lek/banorë)	996		

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

	<i>E3</i> <i>Transparenca në sistemin e faturimit</i>	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i një sistemi të unifikuar për faturimin e tarifës së pastrimit Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për informimin e komitetit	<b>2027-2031</b>
<b>Qëndrueshmëria institucionale</b>	<i>F1</i> <i>Transparenca në aspektet institucionale</i>	55%	<p>Plotësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve</li> <li>• Hartimi i rregulloreve për shërbime të caktuara të mbetjeve</li> <li>• Adoptimi i modelit të dldp-së, miratuar me VKM për llogaritjen e kostos dhe tarifave</li> <li>• Përmirësimi i sistemit të klientëve dhe rifreskimi databases</li> </ul> <p>Ngritja e sistemit të monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë</p> <p>Ngritja e kapaciteteve të stafit teknik të shërbimeve publike për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve</p>	<b>2026-2031</b>

### 6.2.1 Rryma e mbetjeve, objekti i planit

Sipas legjislacionit në fuqi<sup>23</sup>, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbetjeve bashkiake (urbane) për të cilën Bashkia Vau Dejës është drejtpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse:

Sipas përbërjes dhe mënyrës së manaxhimit të mbetjeve, mbetjet bashkiake do të klasifikohen në:

- Mbetje urbane (mbetje shtëpiake, ushqime, bimë, të riciklueshme, të dekompozuar, etj.), dhe
- Mbetje të veçanta urbane (mbetje nga ndërtimet dhe prishjet, voluminoze, pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbetje të rrezikshme që prodhohen brenda territorit të bashkisë nga banorë të përhershëm apo të përkohshëm.

Sipas burimit të gjenerimit mbetjet urbane (bashkiake) klasifikohen në dy rryma:

- Mbetjet e gjeneruara nga familjet (MF)
- Mbetjet e gjeneruara nga bizneset dhe industritë (MB), ku përbërja e mbetjeve nuk ndryshon nga karakteristikat e mbetjeve urbane

Ndërkohë, rryma të tjera të mbetjeve klasifikohen si mbetje masive, mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (inerte), mbetje nga kopshtet që prodhohen në familje dhe që quhen 'mbetje të veçanta' për të cilat njësi vendore duhet t'i ofrojë e vetme ose në bashkëpunim alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

### 6.2.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit

Në funksion të organizimit më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrativë të bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo është e rëndësishme që sistemet dhe metodat që do të identifikohen dhe analizohen në vijim të këtij plani të përshtaten më mirë me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme apo organizimin e programeve për minimizimin e mbetjeve. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

1. **Nën-zona e parë:** Në këtë nën-zonë do të kategorizojmë zonat me dendësi të lartë popullore si dhe zonat me tipare të ngjashme me zonat urbane. Referuar metodologjisë së dldp-së, për këtë zonë do të konsiderojmë kryerjen e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve çdo ditë (7 ditë/javë). PGM do të jenë të shpërndara në mënyrë uniforme kryesisht çdo 50-100m nga njëri-tjetri. Në rastin e Bashkisë Vau Dejës, nuk kemi një zonë të mirëfilltë urbane, ku shërbimi të ofrohet vetëm aty. Ofrimi i shërbimit në Bashkinë Vau Dejës është i përzier midis zonave urbane si NJA Vau Dejës dhe atyre rurale njëkohësisht.
2. **Nën-zona e dytë:** kjo nën-zonë do të kategorizohen nga pjesë të territorit me tipare rurale fushore me numër jo të lartë banorësh, ku shërbimi parashikohet të kryhet mesatarisht 2-3 herë në javë dhe distanca midis PGM do të jetë 150-200m larg njëri-tjetrit. Konkretisht në këtë zonë do të përfshijmë NJA Bushat, NJA Vau Dejës dhe NJA Hajmel. Ndryshe kjo zonë mund të konsiderohet edhe si zonë semi-urbane.
3. **Nën-zona e tretë:** do të kategorizohen zonat malore apo ato të thella dhe me dendësi të ulët popullore. Në këto zona shërbimi do të jetë i rrallë (1 herë në javë ose 2-3 herë në muaj në varësi të sasisë dhe distancave) dhe distanca e PGM do të jetë mbi 300 m, pasi do të jenë pika grumbullimi në distancë të madhe nga njëra tjetra (një për çdo fshat). Parashikohet që në këtë nën-zonë të kemi NJA Temal, NJA Vig Mnelë. Në të ardhmen, kur Bashkia Vau Dejës të ketë

<sup>23</sup> Ligji nr.10463, datë 22.09.2011, amenduar me ligjin nr.156, datë 10.10 2013

infrastrukturë rrugore të përshtatshme për NJA Shllak, ajo do të jetë pjesë e skemës për ofrimin e shërbimit.

### 6.3 Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Vau Dejës parashikon tre shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

- i) Shërbimi i pastrimi, grumbullimit, transportit i mbetjeve;
- ii) Depozitimi i mbetjeve në landfillin e Bushatit;
- iii) Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

Këto shërbime pasi do të shpjegohen shkurtimisht më poshtë, do të përfshihen në dy skenarët e propozuar nga bashkia për organizimin e shërbimit në territorin e saj gjatë viteve 2026-2031.

#### 6.3.1 Shërbimet e pastrimit të rrugëve

**Organizimi i shërbimeve të pastrimit** duhet të marrë në konsideratë nevojat për pastrimin e rrugëve dhe shkallën e ndotjes ditore nga mbetjet dhe hedhurinat, apo brenda një periudhe të caktuar ditësh. Për këtë qëllim propozimi i frekuencave për secilën kategori rrugësh duhet të jetë objekt i një vlerësimi apo testi deri në përcaktimin përfundimtar në specifikime teknike të mundshme në rast se ky shërbim do të kontraktohet në të ardhmen.

Një element shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve është edhe kategorizimi i rrugëve në funksion të rëndësisë si më poshtë:

1. **Kategoria e Parë:** (përfshin rrugët kryesore dhe rrugët tregtare) nevojitet shërbimi ditor i fshirjes; është më i parapëlqyer pastrimi me makinë teknologjike i akseve kryesore (kur është e mundshme dhe ka efektivitet), por dhe mirëmbajtja e tyre gjatë ditës, vendosja dhe pastrimi ditor i koshave rrugore, si dhe shërbimi i larjes gjatë verës, i cili mund të kombinohet me makinën teknologjike që kryen edhe fshirjen edhe larjen;
2. **Kategoria e dytë:** (rrugët kryesore me aktivitet të ulët komercial dhe me densitet të ulët kalimtar) fshirja manuale e rrugëve është e nevojshme të kryhet çdo ditë të javës.
3. **Kategoria e tretë:** (sistem rrugor periferik në zona me dendësi të ulët urbane, apo në zona me infrastrukturë jo të rregullt dhe rrugë të paasfaltuara) është i nevojshëm një shërbim mujor pastrimi (fshirje ose thjesht mbledhje mbetjesh dhe hedhurinash).

#### 6.3.2 Grumbullimi, transporti i mbetjeve

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve Bashkia duhet të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes. Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për manaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullaror në sajë të:

- Hartimit të një rregulloreje vendore për manaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodhë në rast avarish apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjokat përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara. Si parakusht, bashkia duhet të caktojë një grup pune për monitorimin dhe për të vënë në zbatim këto rregulla.
- Parandalimin e hedhjes së paligjshme dhe derdhjen e mbetjeve jashtë kontenierëve. Kjo duhet të sjellë në vëmendje rëndësinë kryesore që kanë fushatat e ndërgjegjësimit dhe programet e edukimit.

- Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, ku rekomandohet vendosja e orareve në ditë dhe orë të caktuara për dorëzimin e mbetjeve nga konsumatori në pikat e caktuara nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.

Ndërkohë elemente të tjerë që kanë të bëjnë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, që bashkia duhet të marrë në konsideratë gjatë planifikimit të shërbimit në territorin e saj, janë si më poshtë:

- Orare pune efektive dhe të përshtatshme:** Për të operuar sipas nevojave të pastërtisë dhe në mënyrë të efektshme dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të hartojë një program efektiv dhe të përshtatshëm pune. Ky program duhet të marrë parasysh ndryshimet ditore, javore dhe mujore në lidhje me numrin e banorëve dhe veprimtarive tregtare.
- Numri i duhur i kontenierëve:** Për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe me kosto të ulët, bashkia duhet të sigurojë numrin e duhur të kontenierëve apo koshave dhe rregullsinë e mbledhjes së mbetjeve.
- Itenerar efektiv për mbledhjen e mbetjeve:** Përcaktimi i saktë i itenerarit për makinat e mbetjeve do të ulë koston duke pakësuar forcat që shpenzohen për mbledhjen e mbetjeve. Rekomandohet verifikimi i përputhshmërisë me parimet e efektshmërisë së itenerarit të grumbullimit të mbetjeve si dhe të kohës efektive me metodën (MTM – Metodës të Matjes së Kohës).
- Rritja e rendimentit në punë:** Bashkia duhet të gjejë mekanizma për të përmirësuar punën duke rritur rendimentin. Masat që mund të ndërmerren për të rritur moralin, përfshijnë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të punës, pajisja me uniformë, stimujt për punë të mirë, trajnimi dhe forcimi i punës në grup.
- Mirëmbajtja e përshtatshme e kontenierëve dhe makinave të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve:** Mirëmbajtja dhe riparimi i specializuar i makinave dhe pajisjeve janë çështje të rëndësishme për shërbimin e mbledhjes së mbetjeve. Pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo kontraktohet një kompani private, bashkia duhet të parashikojë mirëmbajtjen e duhur dhe standardet e riparimit që duhet të vihen në zbatim.

### **Aspektete teknike**

Referuar gjëndjes aktuale të shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve si dhe eksperiencës, arritjeve dhe problematikës të identifikuar në kapitujt e mëparshëm të këtij plani, nënvizojmë se shërbimi i ofruar në Bashkinë Vau Dejës, është më i kompletuar në NJA Bushat. Megjithatë Bashkia Vau Dejës është e motivuar dhe e angazhuar të përmirësojë këtë situatë, duke synuar si përmirësimin e nivelit aktual të ofrimi të shërbimit në lidhje me cilësinë, efikasitetin dhe efektshmërinë, por gjithashtu të krijojë një bazë të qëndrueshme mbi të cilën do të mbështeten iniciativat lokale dhe rajonale për minimizimin e mbetjeve. Për bashkinë është shumë e rëndësishme, jo vetëm konsolidimi i shërbimit në ato njësi të cilat aktualisht marrin shërbim, por gjithashtu edhe në shtrirjen e shërbimit në njësitë, të cilat nuk marrin ende shërbim. Bashkia për të qënë sa më efektive kërkon që shërbimin në zonat e reja ta shtrijë sipas skemës me qendër fshati.

Duke kaluar në një përfaqje teknike, ekzistojnë mënyra të ndryshme për grumbullimin, ruajtjen dhe transportin e mbetjeve në funksion të kategorive të konsumatorëve dhe tipologjisë urbane të zonave të banuara. Sipas legjislacionit aktual dhe tipologjisë së zbatuar më së shumti për mbledhjen e mbetjeve, bashkia është përgjegjëse për të mbledhur vetëm “mbetjet urbane”, sipas përcaktimeve të dokumentave ligjore dhe të këtij plani. Mbetje të tjera që ndryshojnë në përmbajtje (përbërje) nga mbetjet urbane nuk pranohen nga sistemi bashkiak për grumbullimin e mbetjeve.

Për disa mbetje të ashtuquajtura “të veçanta” që prodhohen nga banorët mund të organizohen metoda për grumbullimin e tyre në mënyrë të diferencuar nga sistemi publik (bazë) bashkiak. Ekzistojnë

kufizime të tjera për përdorimin e sistemit bazë bashkiak të grumbullimit të mbetjeve që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Duke iu referuar përcaktimeve ligjore (Neni 12 i Ligjit Nr. 8094, datë 21.3.1996), konsumatorët jo-banorë që prodhojnë mbi ¼ e sasisë që mund të hidhet në një kontenier mbetjesh (zakonisht 1.1m<sup>3</sup>) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve. Autoritetet vendore apo personat përgjegjës për grumbullimin e mbetjeve duhet të ofrojnë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash.

**Infrastruktura për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve**

Në lidhje me përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e skemës së përbashkët për grumbullimin e mbetjeve, duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë sipas formulës të llogaritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe qëllimit për mbulimin e të gjithë territorit të bashkisë më shërbim, u realizua analiza për llogaritjen e infrastrukturës së nevojshme: kontenierë dhe makina teknologjike. Si fillim u përcaktua kapaciteti i përshtatshëm i kontenierëve si dhe frekuenca e dëshirueshme e shërbimit. Kontenierët me volum 1.1m<sup>3</sup>, metalik apo plastik, kjo në varësi të preferencave të bashkisë, rekomandohen si më të përshtatshëm për grumbullimin e mbetjeve në këtë bashki. Gjithashtu rekomandohet që kontenierët të jenë me vaskë (trashësi 1.5-2 mm) dhe me sistem rrotash të qëndrueshëm, me kapakë për të mundësuar qëndrueshmërinë e tyre nga impakti i faktorëve të jashtëm, si dhe me kërkesë të bashkisë, ajo kërkon që kontenierët në shumë PGM të mund të lidhen për të mos u lëvizur nga banorët pa ndonjë arsye. Ndërkohë bazuar në sasinë e mbetjeve të gjeneruara, frekuencës të ofrimit të shërbimit, dhe eksperiencës të ofrimit të shërbimit në Bashkinë Vau Dejës, për territorin e saj Bashkia preferon mjete teknologjike 10ton dhe 5ton, dhe në rastin e zonave rurale, bashkia mund të përdorë mjete më të vogla prej 3ton, kjo në varësi të infrastrukturës rrugore në këto zona. Në figurën më poshtë tregohet skematikisht skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në territorin Bashkisë Vau Dejës:




Figura 9 Skema e përgjithshme e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës [Burimi: Punuar nga autori]

### 6.3.3 Trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbetjeve

Sipas ligjit për vetqeverisjen vendore, njësitë vendore kanë si funksion shërbimet e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim, transport dhe trajtim final të tyre). Në këtë llogjikë, rekomandohet që autoritetet vendore të rehabilitojnë vend-depozitimet e pakontrolluara dhe të parashikojnë depozitimin e mbetjeve në landfilllet rajonale të ardhshme apo ato ekzistuese në qarqet përkatëse. Në Bashkinë Vau Dejës mbetjet depozitohen në landfillin e rajonal të Bushatit, kundrejt një tarife me vlerën 469 lek/ton me TVSH. Në landfill depozitohen mbetjet urbane nga tre NJA që marrin shërbimin (Bushat, Vau Dejës dhe Hajmel). Në këtë landfill nuk lejohen të depozitohen mbetjet spitalore, bateri, akumulatorë, vajra industriale dhe mbetje të tjera të përcaktuara si të rrezikshme nga legjislacioni mjedisor Shqipëtar.

### 6.3.4 Minimizimi i mbetjeve

Dokumenti i Politikave Startegjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (2020) ka përcaktuar disa indikatorë në lidhje me sasinë e mbetjeve që duhet të riciklohen, kompostohen sipas afateve kohore deri në vitin 2035<sup>24</sup>:

Ndërkohë, sipas VKM nr. 48, datë 25.06.2017 “Për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në burim”, janë përcaktuar disa objektiva, të cilat duhet të plotësohen nga NJQV-të deri në vitin 2020, ku konkretisht:

- NJQV-të deri në fund të vitit 2018, duhet të grumbullojnë në mënyrë të diferencuar, të paktën mbetje të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit;
- Brenda vitit 2020, ato duhet të arrijnë normën e riciklimit me 50% të sasisë të mbetjeve të vitit 2014;
- Brenda vitit 2020, sasia e mbetjeve që shkojnë në Landfill do të jetë 45% e sasisë së mbetjeve që prodhohet, dhe pjesa tjetër duhet të shkojë për riciklim, kompostim apo për rekuperim me energji.

Pavarësisht mungesës së eksperiencës së autoriteteve lokale dhe operatorëve të mbetjeve si dhe vetë komunitetit për të ndarë mbetjet, Bashkia ka shprehur interesin e saj se fillimi i skemave të ndarjes së mbetjeve në burim, është një objektiv, të cilin ajo e vlerëson si të rëndësishëm për 5 vjeçarën e ardhshme, kryesisht për kompostimin e mbetjeve.

I gjithë sistemi i ndarjes përbëhet nga dy komponentë: sistemi parësor i ndarjes dhe sistemi dytësor i ndarjes.

- **Sistemi parësor i ndarjes:** Njihet gjerësisht si ndarja në burim dhe jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre.
- **Sistemi dytësor i ndarjes,** nënkupton ndarjen e tyre në PGM publike të grumbullimit të tyre.

**Sistemi parësor – Skema e ndarjes individuale:** Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbetjeve. Duhet theksuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i preferueshëm sesa sistemi i ndarjes së mbetjeve në rrugë. Nga kjo pikëpamje, angazhimi i drejtpërdrejtë i pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët.

<sup>24</sup> Këtu kemi hedhur objektivat kombëtare deri në vitin 2025 (harku kohor i zbatimit të planit)

Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme **për biznesin dhe industrinë**, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbetjeve. Koshat për ndarjen e mbetjeve në burim mund të vendosen në çdo njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror, duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen. Për këtë arsye, sistemi me katër kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Kjo nënkupton caktimin e një kodi me ngjyra për alternativën me katër kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh, kur vendosin të depozitojnë mbetjet aty. Ngjyrat duhet të përcaktohen qartësisht që në fillim:



Figura 10 Pikë grumbullimi me sistem ndarje në burim të rrymave të riciklueshme  
[Burimi: Foto ilustruese nga kërkimi në internet]

#### **Kodi i ngjyrave për katër kontenierët e vegjël nënkupton:**

- Në kontenierin me ngjyrë të kuqe do të depozitohen mbetjet plastike
- Në kontenierin me ngjyrë blu do të depozitohen mbetjet si letër dhe karton
- Në kontenierin me ngjyrë të verdhë do të depozitohen kanaçet metalike
- Në kontenierin me ngjyrë të gjelbërt do të depozitohen mbetje të tjera.

Zakonisht ky është një konfigurim i kontenierëve, i cili rekomandohet që bashkia të mund ta aplikojë në biznese, ose në institucione publike, siç janë shkollat.

**Sistemi dytësor: Skema e përbashkët për ndarjen e mbetjeve (qendrat e riciklimit):** Përdorimi i sistemit aktual të grumbullimit të mbetjeve urbane shërben si një bazë për të vënë në funksionim dhe prezantuar sistemin e mbledhjes së diferencuar të tyre. Kjo mënyrë mund të jetë praktike vetëm kur qytetarët dhe bizneset janë mësuar me këtë lloj sistemi dhe do të mund të përshtaten më mirë. Kjo metodë është e preferueshme kryesisht në qytete të mëdha ku është i pamundur krijimi i sistemeve individuale për ndarjen e mbetjeve dhe blloqet e banimit janë kolektive.

Sektori informal, i cili është krahu kryesor i punës në sektorin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme nuk është plotësisht në vëmendje nga strukturat shtetërore. Ky sektor sjell mjaft dobi në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, si: i) ul mesatarisht deri 15-30% sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill/fushë depozitimi; ii) Ul koston e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve; iii) Është burim të ardhurash për rreth 2% të popullsisë së zonave të varfra; iv) Sipas shifrave nga literatura e huaj llogaritet që çdo ton mbetje e riciklueshme e grumbulluar është e barabartë me një vend pune.

Ashtu si hierarkia e përgjithshme e menaxhimit të mbetjeve, edhe menaxhimi i mbetjeve të riciklueshme duhet të mbështetet në një hierarki të ngjashme, ku objektivi kryesor është parandalimi sa më shumë i gjenerimit të mbetjeve:

- i. Riprodhimi i mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më shumë)
- ii. Grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme nga tregtarët
- iii. Mbledhësit formalë të mbetjeve të riciklueshme
- iv. Grumbulluesit fillestarë të mbetjeve të riciklueshme
- v. Mbledhësit informalë të mbetjeve të riciklueshme (prioritarizohet më pak)

**Kompostimi i mbetjeve:** Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se pothuajse të 6 NJA të Bashkisë Vau Dejës, duke përfshirë qytetin e Vau Dejës, i cili ka karakter urban, pjesa

tjetër ka karakter suburban dhe kryesisht rural, dhe sasia e mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, bujqësia apo blegtoria në zonë, përbëjnë një sasi të konsiderueshme për zhvillimin e kompostimit familjar (individual) dhe kolektiv. Bashkia mund ta përdorë produktin e kompostit në bujqësinë e zonës, apo për lulishtet e qytetit.

**Kompostimi në nivel individual** (në shtëpi) paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të kompostimit që rekomandohet për t'u përdorur në familjet në zonat suburbane apo rurale. Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme sesa transferimi i mbetjeve organike në pikën e mbledhjes dhe më pas transportimi i tyre në landfill, ku përfshihen edhe depozitimi si dhe të gjitha kostot e tjera që shoqërojnë këto procese. Ky proces është mjaft i rëndësishëm nga ana mjedisore, pasi ul ndjeshëm sasinë e mbetjeve që hedhin familjet për trajtim final, duke ulur në këtë mënyrë edhe koston e transportit dhe të trajtimit final të mbetjeve. Në rastin e mbetjeve drusore, të cilat në zonat suburbane/rurale janë të shumta, bashkia mund të ofrojë shërbimin e copëtimit (grires) për familjet që ndërmarrin një nismë të tillë, duke copëtuar mbetjet drusore, disa herë në vit.



Figura 11 Modeli i kompostimit individual  
[Burimi: Foto ilustruese nga kërkimi në internet]

Përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat më të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të ulët që ka, mund të jetë **kompostimi në mjedis të hapur (kolektiv)**. Kjo metodë nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetëm për uljen e sasisë së mbetjeve që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e një sasive të konsiderueshme komposti si pleh organik, që mund të përdoret nga bashkia për qëllime publike.



Figura 12 Skemat e kompostimit në mjedis të hapur  
[Burimi: Foto ilustruese nga kërkimi në internet]

#### 6.4 Menaxhimi i mbetjeve voluminoze dhe ndërtimore

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e mbetjeve (VKM nr.575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte") është përgjegjësia e prodhuesit (familje, biznes apo industri) që të largojë dhe transportojë mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe prishjet), ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen për në vendet e përcaktuara nga pushteti vendor për këtë qëllim. Ndonëse ekziston ky kuadër ligjor, i cili përcakton mjaft mirë detyrat për secilin aktor të përfshirë në këtë fushatë, asnjë nga bashkitë e vendit nuk ka përcaktuar një vend për depozitimin e mbetjeve inerte. Në kuadrin ligjor theksohet se këto vende të përcaktuara për depozitimin e mbetjeve inerte/ ndërtimore/voluminoze duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të posaçme dhe duhet të pranojnë vetëm këto lloj mbetjesh, dhe jo përzierje apo përpunime të këtyre mbetjeve me elemente të tjerë, pasi ato mund të jenë të rrezikshme.

Të gjitha venddepozitimet e mbetjeve inerte kanë të njëjtën mënyrë operimi si landfillet për mbetjet urbane, ku gjeneruesi i mbetjeve duhet të paguajë një tarifë kundrejt sasisë së mbetjeve inerte që

transportohet, e cila mbulon koston e operimit të fushës, trajtimit të tyre dhe mbylljen përfundimtare të saj. Ndërkohë ndalohet ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:

- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujqor;
- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;
- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën e parë.

Landfilllet e mbetjeve inerte mund të jenë landfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose landfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit, ku do të ndërtohet landfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në landfille dhe venddepozitimet e përkohshme të mbetjeve inerte, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë. Në mënyrë të veçantë, ka një treg ripërdorimi për agregatat që rrjedhin nga mbetjet e ndërtimeve në rrugë, kanalizime dhe projekte të tjera ndërtimi. Nëse nuk ndahen që në burim apo nuk transportohen veçmas, ato mund të përmbajnë sasi të vogla të mbetjeve të rrezikshme, përzierja e të cilave mund të paraqesë rrezik të veçantë për mjedisin dhe mund të pengojë riciklimin.

Bashkia Vau Dejës ka marrë iniciativën për fillimin e procedurave për përcaktimin e një zone në afërsi të landfillit të Bushatit për depozitim të mbetjeve inerte. Sipas informacioneve të bashkisë, ajo ka përcaktuar zonën dhe është në proces për hartimin e dokumentacionit për marrjen e lejes së mjedisit për operimin e zonës si venddepozitim për mbetjet inerte. Bashkia argumenton që ky venddepozitim do të funksionojë sipas parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, ku secili gjenerues i mbetjeve inerte duhet t'i sjellë ato në këtë venddepozitim kundrejt një pagese.

## 6.5 Skenarët e propozuar për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve

Hyrja në fuqi e reformës territoriale u shoqërua edhe me një riorganizim të shërbimeve publike, ku njëri prej tyre është edhe ai i menaxhimit të mbetjeve. Kjo ndarje ofron mundësi të mira për përdorimin eficient të burimeve ekzistuese (makina për transportin e mbetjeve, kontenierë, vend-depozitime) ashtu dhe të burimeve njerëzore për këtë qëllim.

Propozimi i skenarëve për organizimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës, do të bëhet bazuar në objektivin kryesorë të bashkisë për të ndërmarrë hapat për arritjen e standardin minimal të ofrimit të shërbimit. Të dy skenarët do të synojnë, në nivele të caktuara, ofrimin e një shërbimi me standarde sa më të larta, me kosto optimale dhe të përballueshme nga taksa pagesit, për të synuar mbulimin e plotë të koston të shërbimit. Qëllimi i bashkisë është të rrisë cilësinë e shërbimit në sajë të përmirësimit të infrastrukturës dhe diversifikimit të shërbimeve që ajo ofron. Për secilin nga skenarët është bërë llogaritja e koston sipas modelit të dldp-së, miratuar me VKM nr. 319, datë 31.5.2018 "Për Miratimin e Masave për Koston e Menaxhimit të IntegrUAR të Mbetjeve". Formulimi i skenarëve është realizuar bazuar në konsideratat më poshtë:

- **Skenari 1** – do të synojë mbulimin e 100% të territorit me shërbim dhe depozitim të mbetjeve në impiante inxhinierike ose në venddepozitime të kontrolluara, të pajisur me leje të posaçme. Në këtë skenar do të analizohet përqindja e territorit për shtrirjen e shërbimit, rritja e koston dhe e nivelit të tarifave kundrejt skenarit bazë si dhe planifikimi i rritjes së nivelit të tarifave gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit si dhe programi i monitorimit dhe informimit të komunitetit.
- **Skenari 2** – do të synojë për të plotësuar maksimalisht arritjen e standardit maksimal të ofrimit të shërbimit, por kjo në varësi të potencialit të bashkisë për të përmbushur këtë skenar.

## Skenari I – Shtrirja e shërbimit

### A. Shërbimet që do të përfshihen në këtë Skenar

Në këtë skenar të parë Bashkia do të synojë të mbulojë 100% zonën urbane në NJA të Vau Dejës dhe Bushatit, si dhe shtrirjen e shërbimit në 90% të territorit rural, në NJA Hajmel, Vig Mnelë dhe NJA Temal. Ndërkohë për NJA Shllak, Bashkia shpreh shqetësimin për infrastrukturën e dobët rrugore, dhe shtrirja e shërbimit në këtë njësi do të kishte kosto shumë të larta dhe nuk do të ishte aspak efiçente si objektiv afatshkurtër. Ndonëse, bashkia nuk e sheh si objektiv afatshkurtër shtrirjen e shërbimit në NJA Shllak, ajo në një të ardhme jo shumë të afërt parashikon që të paktën shërbimin në këtë zonë ta shtrijë deri në masën 50%, kur edhe infrastruktura rrugore të jetë më e përshtatshme. Shtrirja e shërbimit në pothuajse 100% të territorit të bashkisë do të synojë që niveli i pastërtisë nga depozitimet e paligjshme të mbetjeve të reduktohet. Gjithashtu në lidhje me depozitimimin e mbetjeve në impiante të kontrolluara, në Bashkinë Vau Dejës tashmë ky objektiv është i pëmbushur, pasi mbetjet transportohen në një landfill inxhinierik, siç është ai i Bushatit.

**Skenari I** propozon ndarjen në dy zona shërbimi Bashkinë Vau Dejës: Zona suburbane dhe Zona rurale. Kjo ndarje do të bëhet bazuar në tipologjinë urbane, numrin e popullsisë dhe bizneseve që kërkojnë shërbim, infrastrukturës dhe sasisë të mbetjeve të gjeneruara. Duke marrë parasysh këto faktorë, u vlerësua kjo ndarje:

- Zona Sub-urbane ( NJA Bushat, NJA Vau Dejës, NJA Hajmel)
  - Bushat- Landfill i Bushatit
  - Vau Dejës-Hajmel-Landfill i Bushatit
- Zona Rurale (NJA Temal, NJA Vig Mnelë)
  - Qendër fshati Mnelë e Madhe- Qendër fshati Vig- Landfill i Bushatit
  - Qendër fshati Temal (Koman)-Landfill i Bushatit

Duke qënë zona me infrastrukturë pak të zhvilluar, me distanca me të largëta nga landfilli dhe normë gjenerimi më të ulët, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të ofrohet me qendër fshati, përkatësisht, qendër fshati Mnelë e Madhe, qendër fshati Vig dhe qendër fshati Koman.

Ndërkohë shtrirja e shërbimit në NJA Shllak shfaqet më problematike për shkak të rrugës të paaksesueshmërisë nga infrastruktura e dobët rrugore.

### A. Të dhënat teknike në lidhje me ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Riorganizimi i shërbimit, tashmë në 2 zona sjell edhe ndryshime në lidhje me infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit, investimet për kontenerë apo mjete dhe frekuencat e ofrimit të shërbimit. Në tabelën më poshtë jepet një përmbledhje në lidhje me infrastrukturën e nevojshme dhe të dhënat teknike për zonat e këtij skenari:

Përbërja	Infrastruktura		Të dhënat teknike		
	Mjetet	Kontenerë	Norma e gjenerimit	Frekuenca	Sasia vjetore e mbetjeve
<b>Njësitë e Zonës suburban</b>					ton/vit
<i>Bushat</i>	1 mjet 10 ton	Total 47	0.4 kg/banorë/ditë	7 herë/javë	2,014
<i>Vau Dejës, Hajmel</i>	2 mjete 10 ton	Total 35	0.4 kg/banorë/ditë	3 herë/javë	1,497
<b>Njësitë e Zonës rurale</b>					
<i>Vig-Mnelë</i>	1 kamion 5 ton	Total 9	0.3 kg/banorë/ditë	2 herë/javë	108
<i>Temal</i>	1 kamion 5 ton	Total 8	0.3 kg/banorë/ditë	2 herë/javë	95
<b>Totali</b>					<b>3,714</b>

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Tabela 16 Të dhënat teknike për Skenarin I të menaxhimit të mbetjeve<sup>25</sup>  
[Burimi: Punuar nga autori]

**Zona Suburbane:** Siç u përmënd më sipër, kjo zonë përbëhet nga dy nënzona, me një normë gjenerimi 0.4kg/banorë/ditë.

- Në nën-zonën e parë (Bushat-Landfilli i Bushatit) për ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve 7 herë në javë parashikohet të përdoret *1 mjet teknologjik 10 ton*.
- Në nën-zonën e dytë (Vau Dejës-Hajmel-Landfill i Bushatit) nevojitet *1 mjet teknologjike 10 ton* për të ofruar shërbimin 3 herë në javë.

Në tabelën më poshtë propozohet një kalendar i mundshëm në lidhje me ditët e ofrimit të shërbimit në secilën nga njësitë vendore:

ZONA SUBURBANE		E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E dielë
<b>Rrugëtimi I</b>	<i>Bushat-Landfilli Bushatit</i>							
Nisja	Vau Dejës							
Pika fundore	Landfill Bushatit							
Gjatësia e rrugës (1 kah)	54 km							
Kohëzgjatja	4 orë							
Mjeti - I	1 mjet 10ton							
<b>Rrugëtimi II</b>	<i>Vau Dejës-Hajmel-Landfilli Bushatit</i>							
Nisja	Vau Dejës							
Pika fundore	Landfill Bushatit							
Gjatësia e rrugës (1 kah)	42 km							
Kohëzgjatja	4 orë							
Mjeti-II	1 mjete 10ton							

Tabela 17 Kalendar i lëvizje të mjeteve teknologjike në Zonën Suburbane – Skenari 1  
[Burimi: Punuar nga autori]

**Zona Rurale:** Në tabelën më poshtë propozohet një kalendar i mundshëm në lidhje me ditët e ofrimit të shërbimit në secilën nga njësitë vendore:

ZONA RURALE		E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E dielë
<b>Rrugëtimi I</b>	<i>Qender fshati Mnelë e madhe-qender fshati Vig-Landfilli i Bushatit</i>							
Nisja	Vau Dejës							
Pika fundore	Landfill Bushatit							
Gjatësia e rrugës (1 kah)	14 km							
Kohëzgjatja	3 orë							
Mjeti - I	1 mjet 5 ton							
<b>Rrugëtimi II</b>	<i>Temal (qender fshati Koman)-Landfilli i Bushatit</i>							
Nisja	Vau Dejës							
Pika fundore	Landfill Bushatit							
Gjatësia e rrugës (1 kah)	33 km							
Kohëzgjatja	3 orë							
Mjeti-II	1 mjet 5 ton							

Tabela 18 Kalendar i lëvizje të mjeteve teknologjike në Zonën Rurale – Skenari 1  
[Burimi: Punuar nga autori]

## B. Rrugëtimi i mjeteve për Skenarin I

Rrugëtimi i mjeteve për këtë skenar nga pika e nisjet për në pikën fundorë që është landfilli i Bushatit janë kryer me sistemin GPS bazuar në sistemin e rrugëve aktuale dhe në pikat e grumbullimit të

<sup>25</sup> Në këtë skenar nuk është parashikuar ofrimi i shërbimit në NJA Shllak, për shkak të distancës së largët dhe gjendjes jo të mirë të rrugëve

mbetjeve të hedhura në hartë. Bazuar në të dhënat në lidhje me pikën e nisjes, vendndodhjen e PGM, sistemit të rrugëve aktuale dhe pikën fundore (landfilli i Bushatit), sistemi përlogarit gjurmën se ku duhet të kalojë mjete sipas rradhës të grumbullimit të PGM (në hartë kjo rradhë tregohet me numrat rendor në secilën PGM).






Figura 13 Rrugëtimet e mjeteve për skenarin I  
[Burimi: zhvilluar nga autori]


RRUGËTIMI BUSHAT – LANDFILL I BUSHATIT



RRUGËTIMI VAU DEJËS – HAJMEL – LANDFILL I BUSHATIT



RRUGËTIMI VIG MNELE – LANDFILL I BUSHATIT



RRUGËTIMI TEMAL (KOMAN) – LANDFILL I BUSHATIT




Figura 14 Rrugëtimet e mjeteve për skenarin I  
[Burimi: zhvilluar nga autori]

### C. Llogaritja e kostos së shërbimit për Skenarin I

Llogaritjet e kostove të Skenarit I janë kryer në sajë të programit të zhvilluar nga dldp për llogaritjen e kostos, sipas Vendimit nr.319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” duke e përshtatur sistemin në rastin e Bashkisë Vau Dejës. Në sistem janë hedhur të dhënat teknike të përmendura më lart dhe për secilën nga tre zonat e mbetjeve është llogaritur kosto e shërbimit siç tregohet në tabelat përmbledhëse më poshtë për të tre zonat, me zërat përkatëse të shërbimeve të mbetjeve:

#### Kosto për Zonën Sub-Urbane

Zona Suburbane	Kosto e Skenarit I
	12 mujore (LEK/vit)
<b>NJA Bushat</b>	
Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim)	650,000
Nën kosto për grumbullim dhe transport	1,948,188
Nën kosto e personelit (2 shofera)	1,367,520
Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)	<b>3,965,708</b>
Nën kosto e depozitimit në landfill	<b>999,167</b>
Nën kosto e amortizimit të kontenierëve	247,914
Nën kosto e amortizimit të mjeteve	896,550
Nën kosto totale e amortizimit	<b>1,144,464</b>
Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimit)	<b>6,109,339</b>
Kosto administrative (9%) dhe Fitimi nga të radhurat neto (4%)	<b>794,214</b>
<b>KOSTO TOTALE OPERACIONALE</b>	<b>6,903,553</b>
<b>KOSTO TOTALE INVESTIMI</b>	<b>7,629,761</b>

Tabela 19 Kosto e shërbimit për Zonën Suburbane (Bushat) për Skenarin 1  
[Burimi: Punuar nga autori]

Zona Suburbane	Kosto e Skenarit I
	12 mujore (LEK/vit)
<b>NJA Vau Dejës-NJA Hajmel</b>	
Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim)	650,000
Nën kosto për grumbullim dhe transport	1,660,750
Nën kosto e personelit (4 shofera)	1,367,520
Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)	<b>3,678,270</b>
Nën kosto e depozitimit në landfill	<b>742,474</b>
Nën kosto e amortizimit të kontenierëve	184,223
Nën kosto e amortizimit të mjeteve	896,550
Nën kosto totale e amortizimit	<b>1,080,773</b>
Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimit)	<b>495,137</b>
Kosto administrative (9%) dhe Fitimi nga të radhurat neto (4%)	220,061
<b>KOSTO TOTALE OPERACIONALE</b>	<b>6,216,714</b>
<b>KOSTO TOTALE INVESTIMI</b>	<b>7,205,155</b>

Tabela 20 Kosto e shërbimit për Zonën Suburbane (Vau Dejës-Hajmel) për Skenarin 1  
[Burimi: Punuar nga autori]

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

**Kosto për Zonën Rurale**

Zona Rurale	Kosto e Skenarit I
	12 mujore (LEK/vit)
<b>NJA Temal</b>	
Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim)	585,000
Nën kosto për grumbullim dhe transport	879,060
Nën kosto e personelit (1 shofer+1 puntor)	1,367,520
Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)	<b>2,831,580</b>
Nën kosto e depozitimit në landfill	<b>53,470</b>
Nën kosto e amortizimit të kontenierëve	46,435
Nën kosto e amortizimit të mjeteve	538,200
Nën kosto totale e amortizimit	<b>584,635</b>
Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)	<b>3,469,685</b>
Kosto administrative (9%) dhe Fitimi nga të radhurat neto (4%)	<b>451,059</b>
<b>KOSTO TOTALE OPERACIONALE</b>	<b>3,920,744</b>
<b>KOSTO TOTALE INVESTIMI</b>	<b>3,897,565</b>

Tabela 21 Kosto e shërbimit për Zonën Rurale (Temal- qendër fshati Koman) për Skenarin I [Burimi: Punuar nga autori]

Zona Rurale	Kosto e Skenarit I
	12 mujore (LEK/vit)
<b>NJA Vig Mnelë</b>	
Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim)	585,000
Nën kosto për grumbullim dhe transport	631,540
Nën kosto e personelit (1 shofer+1 puntor)	1,367,520
Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)	2,584,060
Nën kosto e depozitimit në landfill	42,279
Nën kosto e amortizimit të kontenierëve	41,058
Nën kosto e amortizimit të mjeteve	538,200
Nën kosto totale e amortizimit	579,258
Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)	<b>3,210,597</b>
Kosto administrative (9%) dhe Fitimi nga të radhurat neto (4%)	417,378
<b>KOSTO TOTALE OPERACIONALE</b>	<b>3,627,975</b>
<b>KOSTO TOTALE INVESTIMI</b>	<b>7,489,154</b>

Tabela 22 Kosto e shërbimit për Zonën Rurale (Vig Mnelë) për Skenarin I [Burimi: Punuar nga autori]

Nën zërat e kostos – SKENARI I	KOSTO (LEK/vit)				
	Bushat	Vau Dejës-Hajmel	Temal	Vig Mnelë	BASHKIA TOTAL
Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)	3,965,708	3,678,270	2,831,580	2,584,060	13,059,618
Nën kosto e depozitimit në landfill	999,167	742,474	53,470	47,279	1,842,390
Nën kosto totale e amortizimit	1,144,464	1,080,773	584,635	579,258	3,389,130
Fitimi nga të radhurat neto (4%)	794,214	715,197	451,059	417,378	2,377,848
Nën Kosto e plotë për fshirje larjen	0	0	0	-	-
<b>KOSTO TOTALE OPERACIONALE - A</b>	<b>6,903,553</b>	<b>6,216,714</b>	<b>3,920,744</b>	<b>3,627,975</b>	<b>20,668,986</b>

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

<b>KOSTO TOTALE INVESTIMI - B</b>	<b>7,629,761</b>	<b>7,205,155</b>	<b>3,897,565</b>	<b>3,861,179</b>	<b>22,593,660</b>
<b>Kosto A +B</b>	<b>14,533,314</b>	<b>13,421,869</b>	<b>7,818,309</b>	<b>7,489,154</b>	<b>43,262,646</b>

Tabela 23 Tabelë përmblledhëse e kostos totale operacionale dhe të investimit për Skenarin I  
[Burimi: Punuar nga autori]

**Skenari II – Parashikimi i skemës pilot për mbetjet e kompostueshme**

**A. Shërbimet që do të përfshihen në këtë Skenar**

Sipas Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta (*Miraturar me VKKT nr.1 datë 13.01.2020*) (Master Plan-2018-2032) në Zonën e Mbetjeve të përcaktuar *Shkodër-Lezhë* janë planifikuar të ndërtohen gjatë fazës së dytë të zbatimit të tij (2023-2027):

*i) Impiant me Trajtim Mekanik Biologjik (MBT) dhe me tharje biologjike (RDF)*

Vendndodhja nuk është përcaktuar ende. Gjithsesi nisur nga fakti që Master Plani parashikon që ky impiant të nisë në fazën e dytë të zbatimit të tij (pra në përfundim me afatin kohor të zbatimit të planit të Bashkisë për mbetjet), ne parashikojmë që bashkia mund të fillojë më iniciativa për trajtimin e mbetjeve të biodegradueshme me impiante me përmasa të vogla, të cilat do t'i shërbejnë bashkisë, kryesisht për mbetjet nga kopshtet dhe një pjesë e atyre organike nga familjet. Sipas Master planit parashikohet që në fazën e dytë (deri në vitin 2027) të grumbullohen të ndarë 15% e mbetjeve organike për të gjithë zonën e mbetjeve (Shkodër -Lezhë). Ne do të parashikojmë për këtë periudhë të zbatimit të planit 5% të mbetjeve organike të largohen nga rryma.

Në zonën rurale (NJA Vig Mnelë, NJA Temal) do të ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve nga qendrat e fshatit për në landfillin e Bushatit.

Në zonën sub-urbane (Bashkia Vau Dejës) përveç shërbimit të grumbullimit të mbetjeve dhe transportit të tyre për në landfillin e Bushatit, bashkia do të parashikojë edhe një shërbim tjetër shtesë:

*i. Ndarjen në burim të mbetjeve në NJA Vau Dejës dhe NJA Bushat për grumbullimin e mbetjeve të kompostueshme.*

Arsyeja pse propozohen këto dy njësi administrative, qendron në faktin se shërbimi është më i konsoliduar në krahasim me NJA të tjera. Kjo do të lehtësojë Bashkinë Vau Dejës edhe nga ana financiare, gjë që e bën më të realizueshëm këtë plan.

**B. Të dhënat teknike në lidhje me ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve**

Konkretisht në rastin e NJA Vau Dejës dhe NJA Bushat bashkia kërkon të pilotojë kompostimin kolektiv, duke parashikuar një infrastrukturë shtesë në sajë të vendosjes së një konteneri shtesë 1.1m<sup>3</sup> me ngjyrë kafe ose të gjelbër në PGM aktuale, në disa lagje të njësive për grumbullimin e mbetjeve organike, që do të shkojnë më pas për kompost. Për këtë arsye kemi parashikuar që rreth 3% e popullsisë aktuale në Bashkinë Vau Dejës do të jetë pjesë e skemës pilot, me një normë gjenerimi për mbetjet organike 0.3 kg/banorë në ditë, ku shërbimi do të zhvillohet rreth 2 herë në javë potencialisht dhe do të duhen rreth 10 kontenerë dhe 1 mjet 5 ton për realizimin e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të tyre.

**Zona Sub-urbane:** Të dhënat teknike për zonën sub-urbane do të jenë të njëjta si për skenarin e parë, por do të shtohen vetëm 10 kontenerë në NJA Vau Dejës dhe NJA Bushat ku do të bëhet grumbullimi i ndarë i mbetjeve të njoma. Mbetjet e njoma do të grumbullohen me një mjet të veçantë 5ton dhe do të dërgohen në pikën kolektive të trajtimit të mbetjeve për kompost. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve të njoma do të zhvillohet mesatarisht dy ditë në javë.

Përveç investimit që Bashkia do të kryejë në skenarin e parë, ajo do të investojë, si projekt pilot kontenerë për grumbullimin e mbetjeve të njoma dhe mjetin e veçantë për grumbullimin e tyre. Kjo praktikë pritet të fillojë në këto NJA, ku më pas do të shtrihet si eksperiencë edhe në njësitë e tjera.

**C. Rrugëtimi i mjeteve për Skenarin II**

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Rrugëtimi i mjeteve për këtë skenar, sipas mjeteve përkatëse të cilat do kryejnë shërbimin në një rrugë të vetme (nga pika e nisjet për në pikën fundorë që është Impianti i trajtimit të mbetjeve organike) do kryhen me sistemin GPS bazuar në sistemin e rrugëve aktuale dhe në pikat e grumbullimit të mbetjeve të hedhura në hartë. Bazuar në të dhënat në lidhje me pikën e nisjes, vendndodhjen e PGM, sistemit të rrugëve aktuale dhe pikën fundore (impianit të trajtimit të mbetjeve organike), sistemi përlogarit gjurmën se ku duhet të kalojë mjeti sipas rradhës të grumbullimit të PGM (në hartë kjo rradhë tregohet me numrat rendor në secilën PGM). Potencialisht do të propozojmë që pika fundore për trajtimin e mbetjeve organike do të jetë në afërsi të landfillit të Bushatit.

### Zona Suburbane

**Rrugëtimi I:** Nisja nga autoparku Vau Dejës-NJA Vau Dejës-NJA Bushat (Kukël)-Impianti i trajtimit të mbetjeve organike (landfilli Bushatit)

#### D. Llogaritja e kostos së shërbimit për Skenarin II

Llogaritjet e kostove të Skenarit II janë kryer në sajë të programit të dldp për llogaritjen e kostos (miratuar me VKM, 2018), duke e përshtatur sistemin në rastin e Bashkisë Vau Dejës. Në sistem janë hedhur të dhënat teknike të përmendura më lart dhe është llogaritur kosto e shërbimit siç tregohet në tabelat përmbledhëse më poshtë, me zërat përkatëse të shërbimeve të mbetjeve. Kostot për skenarin e II janë të njëjta me kostot e skenarit të parë, për pjesën e shtrirjes së shërbimit në të gjithë territorin e bashkisë, ndëkohë janë shtuar kostot për skenarin e dytë për ndarjen në burim të mbetjeve organike:

Zona Sub-Urbane	Kosto e Skenarit II
	12 mujore (LEK/vit)
<b>NJA Vau Dejës, NJA Bushat</b>	
Nën kosto e mirëmbajtjes së mjeteve (Sigurimi kamionit, Vaj+filtra, Goma, Mirëmbajtje mekanike, Parkim)	585,000
Nën kosto për grumbullim dhe transport	325,780
Nën kosto e personelit	1,367,520
Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)	2,278,300
Nën kosto e depozitimit në landfill	39,829
Nën kosto e amortizimit të kontenierëve	34,588
Nën kosto e amortizimit të mjeteve	538,200
Nën kosto totale e amortizimit	572,778
Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)	260,183
Kosto administrative (9%) dhe Fitimi nga të radhurat neto (4%)	115,637
<b>KOSTO TOTALE OPERACIONALE</b>	<b>3,266,736</b>
<b>KOSTO TOTALE INVESTIMI</b>	<b>3,818,588</b>

Tabela 24 Kosto e shërbimit për Skenarin II  
[Burimi: Punuar nga autori]

Nën zërat e kostos – SKENARI II	KOSTO (LEK/vit)						BASHKIA TOTAL
	Bushat		Vau Dejës-Hajmel		Temal	Vig Mnelë	
Nën Kosto Totale (Grumbullim, Transport, Personel, Mirëmbajtje)	3,965,708	1,139,150	3,678,270	1,139,150	2,831,580	2,584,060	15,337,918
Nën kosto e depozitimit në landfill	999,167	29,872	742,474	29,872	53,470	47,279	1,902,134
Nën kosto totale e amortizimit	1,144,464	295,041	1,080,773	295,041	584,635	579,258	3,979,212
Nën kosto administrative/ për grumbullimin e taksave/ fushatë ndërgjegjësimi)	794,214	190,328	715,197	190,328	451,059	417,378	2,758,504
Kosto Administrative (9%) dhe Fitimi nga të radhurat neto (4%)	0	0	0	0	0	-	-

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

<b>KOSTO TOTALE OPERACIONALE - A</b>	<b>6,903,553</b>	<b>1,654,391</b>	<b>6,216,714</b>	<b>1,654,391</b>	<b>3,920,744</b>	<b>3,627,975</b>	<b>23,977,767</b>
<b>KOSTO TOTALE INVESTIMI - B</b>	<b>7,629,761</b>	<b>1,966,941</b>	<b>7,205,155</b>	<b>1,966,941</b>	<b>3,897,565</b>	<b>3,861,179</b>	<b>26,527,542</b>
<b>Kosto A +B</b>	<b>14,533,314</b>	<b>3,621,332</b>	<b>13,421,869</b>	<b>3,621,332</b>	<b>7,818,309</b>	<b>7,489,154</b>	<b>43,262,646</b>

Tabela 25 Tabelë përmblledhëse e kostos totale operacionale dhe të investimit për Skenarin II  
[Burimi: Punuar nga autori]

## 6.6 Krahasimi i kostove të skenarëve të propozuar me skenarin bazë

Skenarët e propozuar për planin e menaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Vau Dejës janë bazuar në përbushjen e parimit për arritjen e standardit minimal për menaxhimin e mbetjeve, duke filluar nga prioritetet më të larta deri tek ato më të ultat. Skenari I është hartuar për të përbushur prioritetin për shtrirjen e shërbimit në të gjithë territorin urban dhe rural të bashkisë dhe dërgimin e mbetjeve në një impiant të kontrolluar, dhe skenari II ka tentuar që të prezantojë tek bashkia masa të cilat përbushin do të tentonin të arrijn standardin ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Në grafikun më poshtë bëhet një krahasim i kostos aktuale të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në tre NJA në Bashkinë Vau Dejës dhe kostot e dy skenarëve të tjerë ku shërbimi është shtrirë në dy njësi të tjera administrative dhe do të prezantohen skema e ndarjes në burim të mbetjeve organike:




Figura 15 Krahasimi i kostove për skenarët e propozuar me koston e skenarit bazë  
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund ta shohim nga grafiku, aplikimi i skenarit të parë në Bashkiën Vau Dejës do të sjellë rritje të kostos së shërbimit me 34% në krahasim me koston e skenarit bazë aktual, dhe me 75% për skenarin e dytë krahasuar me skenarin bazë. Në kushtet, kur bashkia është e limituar në buxhetin e saj për ofrimin e shërbimeve cilësore të menaxhimit të mbetjeve, në kushtet kur edhe niveli i grumbullimit të tarifave dhe mbulimi i kostos nga tarifat është shumë i ulët, zbatimi i këtyre skenarëve do të kërkojë që bashkitë të angazhohen në hartimin e strategjive konkrete për të kapërcyer këtë rritje të kostos nga skenari bazë, si:

- i. Rritja e nivelit të grumbullimit të tarifave
- ii. Planifikimi i rritjes së tarifës, bazuar në koston aktuale të shërbimit për gjatë 5 vjeçarit të planit
- iii. Ngritja e një sistemi faturimi sa më transparent dhe të aksesueshëm për komunitetin
- iv. Ngritja e një sistemi monitorimi të shërbimit sipas indikatorëve të performancës

- v. Informimi i komunitetit në lidhje me skemat e menaxhimit të mbetjeve dhe detyrimit për pagesën e tarifës së pastrimit

## 6.7 Politika mbulimit të kostos nga të ardhurat nga tarifat e pastrimit

### 6.7.1 Metodologji për mbulimin e kostos

**Politika e mbulimit të kostos:** 'Mbulimi i kostos' përfshin një sistem tarifash dhe taksash, të cilat kanë si qëllim specifikisht të mbulojnë disa ose të gjitha kostot e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga përdoruesit e këtij shërbimi, në përputhje me principin "ndotësi – paguan". Avantazhet e sistemit të mbulimit të kostos qëndrojnë në faktin se të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbimit njihen me koston e plotë të tij, janë të përfshirë në mënyrë më të drejtëpërdrejtë me problemet e cilësisë së shërbimit, vlerësojnë peshën që merr pagesa e tarifës së tyre në mbledhjen e të ardhurave si dhe mundësitë reale të bashkive për t'i ofuar konsumatorëve këtë shërbim. Hartimi i politikave të mbulimit të kostos është përgjegjësi e bashkive dhe synon të përcaktojë nivelin e rikuperimit të kostos që duhet të arrihet për një periudhë të caktuar kohore, duke përcaktuar më parë:

- Llogaritjen e kostos së plotë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake;
- Planifikimin e buxhetit të bashkisë mbi këtë kosto;
- Përcaktimin e tarifave për kategoritë e ndryshme që përfitojnë shërbimin bazuar mbi nivelin e rikuperimit të kostos të përcaktuar;
- Procedurat e zbatimit dhe monitorimit.

Konkretisht bashkia duke analizuar gjendjen e saj mund të kuptojë se në cilat nga këto opsione ajo është aktualisht dhe ku ajo kërkon të shkojë, në sajë të objektivave që ajo do të vendosë:

- Kosto të pambuluara, kur të ardhurat janë më të ulta se shpenzimet direkte operative
- Parashikon vetëm mbulimin e kostove operative direkte dhe të mirëmbajtjes (KODM)
- Parashikon vetëm mbulimin e Kostos operative të depozitimit dhe mirëmbajtjes si dhe të interesit të kredisë së marrë për të përmirësuar shërbimin
- Parashikon të mbulojë KODM si dhe pagesën e kredisë dhe të interesave të marrë
- Parashikon mbulimin e KODM, interesin e kredisë, shpenzimet për amortizimin si dhe parashikimet për investime në periudhën afatgjatë
- Parashikon mbulimin e KODM të amortizimit (kosto kapitale dhe kthimin e investimeve) si dhe parashikimin e investimeve në periudhën afatgjatë (ose kosto marxhinale në terma afatgjatë)
- Parashikon mbulimin e kostos marxhinale në terma afatgjatë plus kostot mjedisore (eksternalitetet) të shprehura mundësisht përmes taksës së asgjësimit në Lendfill.

Megjithatë për të ndërtuar një politikë të qëndrueshme dhe mbi të gjitha të zbatueshme të rikuperimit apo mbulimit të plotë të kostos, bashkia ka nevojë për një bashkëpunim me nivelin qëndror të politikë bërjes. Kështu në nivelin qëndror duhet të zhvillohen standartet e ofrimit të shërbimit për të pasur një kuptim të përbashkët për të gjitha bashkitë për nivelin e ofrimit të shërbimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi procedura të standartizuara për monitorimin e shërbimit si dhe nivele të standartizuara (klasa) të krahasueshme në ofrimin e tij. Gjithashtu duhet të hartohen guidat e reja të përgatitjes së buxhetit sipas "qëndrave të buxhetimit apo të kostos" për elemente të veçantë të shërbimit të mbetjeve (grumbullim, transport, riciklim, programe ndërgjegjësimi etj). Vetëm në këtë mënyrë bashkia do të ketë mundësi të njohë koston e plotë të shërbimit që ajo ofron.




Figura 16 Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të kostos

[Burimi: zhvilluar nga autori]

**Strategjia për vjeljen e tarifave:** Bazat për qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve të mbetjeve mund të arrihen nëpërmjet sigurimit të shërbimeve efektive dhe me kosto eficiente, si dhe me sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar të bazuar në një politikë të drejtë dhe efektive të rikuperimit të kostos. Aspektet financiare janë thelbësore për shërbimet dhe për qëndrueshmërinë. Performanca financiare është e lidhur me përmbushjen e objektivave mbi çështjet financiare dhe matet nëpërmjet disa treguesve financiarë që shqyrtohen përmes pyetjeve të mëposhtme:

- Sa i mbulon buxheti vjetor shpenzimet që rezultojnë nga nevojat (përkatësisht kostot kapitale, kostot operative, apo kostot e amortizimit)?
- Sa të ndryshme janë tarifat e miratuara në krahasim me ato që janë parashikuar në procesin e planifikimit?
- Sa mblidhen të ardhurat kundrejt planifikimit të tyre?
- Sa nga buxheti në përqindje mbulohet nga të ardhurat?
- Cili është raporti i mbulimit të shpenzimeve nga tarifat e mbetjeve dhe të ardhurave specifike të bashkisë?
- Sa të gatshëm janë konsumatorët (familjet, bizneset etj.) për të paguar për një shërbim më të mirë?

Bazuar në konstatimet teorike dhe praktike për strategjinë e vjeljes së tarifës dhe politikës për mbulimin e kostos së shërbimit, në figurën më poshtë jepet skematikisht struktura që duhet të ngrihet dhe konsolidohet nga bashkia për grumbullimin e tarifës dhe rritjen e nivelit të grumbullimit:




Figura 17 Strategjia për vjeljen e tarifave

[Burimi: zhvilluar nga autori]

- *Rregjistrimi i konsumatorëve*, që është edhe hapi i parë, përfshin identifikimin e të gjitha subjekteve që përfitojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, kategorizimin e tyre sipas karakteristikave (tipi, madhësia, natyra e mbetjeve që gjenerojnë, sasia, etj.) duke synuar ngritjen dhe mirëmbajtjen e një sistemi të përditësuar të dhënash brenda kufijve të bashkisë. Ky sistem duhet të kontrollohet rregullisht të paktën *një herë në vit* për të reflektuar të gjitha lëvizjet e popullsisë si dhe regjistrimin e të gjitha bizneseve të reja.
- *Komunikimi me konsumatorët* që përfitojnë shërbimin është një moment tjetër shumë i rëndësishëm në ndërtimin e një sistemi efikas në vjeljen e tarifave. Ky hap synon diferencimin e tarifave për konsumatorët e ndryshëm të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve si dhe lidhja e tarifës me nivelin e cilësisë të shërbimit. Marrja e opinionit qytetar përmes pyetësorëve në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar synon jo vetëm evidentimin e problemeve, por ka për qëllim edhe matjen e dëshirës dhe mundësive për të paguar duke kontribuar në krijimin e një sistemi të qartë procedurash për hartimin dhe vjeljen e tarifave. Një pikë tjetër e rëndësishme përse i përket komunikimit me konsumatorët është bërja transparente e tarifave përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit (media e shkruar dhe vizive, ëeb site etj).
- Pjesa më e madhe e autoriteteve vendore e kryejnë vetë procesin e *vjeljes së tarifave* nëpërmjet zyrave të tyre vendore të taksave apo drejtorisë vendore të taksave dhe tarifave. Ndonjëherë tarifat e mbetjeve vendosen së bashku me tarifën e tjera vendore (të tilla si fatura e furnizimit me ujë, ashtu siç e aplikon Bashkia Vau Dejës aktualisht) apo taksa të tjera vendore (tatimi mbi pronën) brenda së njëjtës fature. Për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit është e rëndësishme që të hartohen edhe disa mekanizma të rëndësishëm, duke filluar me mjetet e njoftimit për t'i bërë konsumatorët më të vetëdijshëm për përgjegjësinë ose detyrimin për të paguar, deri në aplikimin e mjeteve të zbatimit të tilla si sanksionet, gjogat, etj.

- Hapi i fundit, por jo më pak i rëndësishëm është edhe *detyrimi*, i cili përfshin ngritjen e një sistemi me struktura adekuate kontrolli, të cilat do të hartojnë masat dhe sanksionet në rastet e mospagimit. Krijimi i strukturave të tilla me detyra dhe përgjegjësi të qarta duhet të jetë subjekt i çdo plani vendor për menaxhimin e mbetjeve. Të gjitha masat dhe sanksionet duhet të hartohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe politikat lokale të menaxhimit të mbetjeve. Gjithësesi shumë e rëndësishme për ekzekutimin efikas është që këto masa dhe sanksione të miratohen me Vendim Këshilli Bashkiak dhe t'i komunikohen të gjithë konsumatorëve të shërbimit përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Bashkia duhet të ndërmarrë një fushatë të fuqishme sensibilizimi për të gjithë konsumatorët, veçanërisht për banorët, duke reklamuar shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, rregullat dhe përgjegjësitë.

#### 6.7.2 Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit për **skenarin I&II** të menaxhimit të mbetjeve

##### **SKENARI I**

Bashkia Vau Dejës është angazhuar në përditësimin e databazës së klientëve (konsumatorët familjarë dhe biznese) për të përmirësuar planifikimin e tarifave vendore, jo vetëm tarifave të pastrimit, për të kuptuar më mirë potencialin fiskal të saj për të përballuar koston e shërbimit. Ky proces, specifikisht kërkon një iniciativë jo vetëm nga qendra e Bashkisë Vau Dejës, por nga të gjithë administratorët e NJA për të regjistruar të gjithë klientët në databazën e bashkisë.

Nga analiza që kemi zhvilluar në lidhje me politikën fiskale që duhet të ndjekë bashkia për të përballuar rritjen e koston me 34%, në tabelën më poshtë kemi parashikuar potencialisht nivelin e mundshëm të të ardhurave nga tarifa ekzistuese dhe sa duhe të shkojë kjo tarifë për të përballuar rritjen e koston për kategorinë familjeve dhe bizneseve. Si përqindje të barrës fiskale, kemi përcaktuar që familjet zënë 55% të barrës fiskale për mbulimin e koston operative, biznesi i vogël 20% dhe biznesi i madh 25%.

Familjet	Tarifa ekzistuese lek/familje/vit	Nr. Familjeve	Të ardhurat e mundshme	Mbulimi i kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat	% e familjeve kundrejt totalit	Rritja e tarifës nga skenari ekzistues (lek)	Tarifa e re sipas Skenarit I të propozuar	Të ardhurat e mundshme	Mbulimi i kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat
Bushat	1,500	4,378	6,567,000		46.06%	403.95	1,900	8,318,200	
Vau Dejës	1,500	2,576	3,864,000		27.10%	403.95	1,900	4,894,400	
Hajmel	1,500	1,260	1,890,000		13.25%	403.95	1,900	2,394,000	
Vig Mnelë	-	483	-		5.08%	403.95	500	241,500	
Temal	-	506	-		5.32%	403.95	-	-	
Shllak	-	303	-		3.19%	403.95	500	151,500	
<b>Totali</b>		<b>9,506</b>	<b>12,321,000</b>	<b>60%</b>				15,999,600	<b>77%</b>

BV	Tarifa ekzistuese (lek/vit)	Nr. BV	Të ardhurat e mundshme	Mbulimi i kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat	% e familjeve kundrejt totalit	Rritja e tarifës nga skenari ekzistues (lek)	Tarifa e re sipas Skenarit I (lek/vit)	Të ardhurat e mundshme nga tarifa e re	Mbulimi i kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat
Subjekte me xhiro 0-8 milion lekë	2,400	466	1,118,400		93%	2,782	4,000	1,864,000	
Profesione të Lira	13,000	18	234,000		4%	2,782	15,000	270,000	
Transport për pasagjerë	8,000	14	112,000		3%	2,782	10,000	140,000	
Transport Mallrash	8,000	4	32,000		1%	2,782	10,000	40,000	
<b>Totali</b>		<b>502</b>	<b>1,496,400</b>	<b>7%</b>				2,314,000	<b>11%</b>

BM	Tarifa ekzistuese (lek/vit)	Nr. BM	Të ardhurat e mundshme	Mbulimi i kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat	% e familjeve kundrejt totalit	Rritja e tarifës nga skenari ekzistues (lek)	Tarifa e re sipas Skenarit I (lek/vit)	Të ardhurat e mundshme nga tarifa e re	Mbulimi i kostos nëse mblidhen të gjitha tarifat
Tregtim karburanti me pakicë	35,000	16	560,000		13.2%	14,425	50,000	800,000	
Tregtim karburanti me shumice	60,000	1	60,000		0.8%	14,425	75,000	75,000	
Subjekte prodhimi asfalto-beton, bloqe, tulla, mermër, etj	50,000	6	300,000		5.0%	14,425	65,000	390,000	
Subjekte ndërtimi të regjistruar pranë Bashkisë Vau Dejës.	60,000	4	240,000		3.3%	14,425	75,000	300,000	
Subjekte me aktivitet punime & përpunime duralumini, metalesh, druri etj.	50,000	8	400,000		6.6%	14,425	65,000	520,000	

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE TË BASHKISË VAU DEJËS  
2026-2031**

Subjekte tregti artikuj të ndryshëm	60,000	53	3,180,000		43.8%	14,425	75,000	3,975,000	
Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushen e inerteve	100,000	3	300,000		2.5%	14,425	115,000	345,000	
Subjekte dege të shoqerive së huaj	200,000	1	200,000		0.8%	14,425	215,000	215,000	
Subjekte shërbimi, agjensi sigurimi, transporti, loto, banka	40,000	6	240,000		5.0%	14,425	55,000	330,000	
Subjekte tregtare, shërbime telefoni fikse, mobile, internet	40,000	9	360,000		7.4%	14,425	55,000	495,000	
Subjekte të transmetimit të energjisë, OSHE, OST	5,000	3	15,000		2.5%	14,425	20,000	60,000	
Njësia e prodhimit të gjithë H/C	5,000	3	15,000		2.5%	14,425	20,000	60,000	
Reparti Ushtarak 1010	5,000	1	5,000		0.8%	14,425	20,000	20,000	
Subjektet prodhim mishi, peshku, qumështi, stalla derrash, lopesh etj	60,000	5	300,000		4.1%	14,425	75,000	375,000	
Subjektet Juridike te Medha me xhiro mbi 200 milion leke	200,000	2	400,000		1.7%	14,425	215,000	430,000	
<b>Total</b>		<b>121</b>	<b>6,575,000</b>	<b>32%</b>				8,390,000	<b>41%</b>

Tabela 26 Planifikimi i të ardhurave dhe nivelit të tarifave nga rritja e kostos aktuale për në skenarin I  
[Burimi: Punuar nga Autori]

Siç mund ta shohim nga tabela, në kushte e nivelit aktual të tarifave të pastrimit, nëse ajo do të grumbullohej 100% nga të gjithë klientët në sistemin e bashkisë, të cilët kanë detyrimin për pagesën e tarifës, familjet do të mbulonin **60%** të kostos operative për skenarin I, BV **7%** dhe BM **32%**. Në total kosto e bashkisë do të mbulohej me 99% dhe ajo do të duhej të sunvenciononte një shumë prej vetëm 206,690 lek/vit. Në kushtet kur niveli i grumbullimit të tarifës nga familjet është shumë i ulët, nëse bashkia do të fillonte me një fushatë komunikimi dhe ndërgjegjësimi për rritjen e nivelit të grumbullimit të tarifës nga komuniteti, performanca e saj fiskale dhe financiare do të përmirësohej mjaftueshëm. Ndërkohë nëse në sistem do të përfshijmë edhe familjet e njësive administrative, të cilat do të hyjnë në sistem kjo performancë do të jetë akoma më e mirë.

Për të përballuar këtë rritje të kostos, në tabelë janë propozuar edhe niveli i tarifave të reja, të cilat bashkia duhet t'i marrë në konsideratë gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit për të parë mundësinë e rritjes graduale të tyre, për të bërë të mundur mbulimin e kostos së re e cila pritet të rritet me 34% nga ajo ekzistuesja.

Në sajë të propozimit të tarifave të reja, duke marrë në konsideratë edhe fuqinë paguese të konsumatorëve, nga zbatimi i skenarit I, që do të sjellë një rritje të kostos me 34%, nëse ato do të mblidheshin 100% tarifat nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve, mbulimi i kostos nga tarifat do të shkonte në masën 100%.

Nisur nga analiza më lart, në tabelën më poshtë kemi parashikuar se sa përqind e kostos operative do të mbulohet nga familjet, në sajë të një rritje prej 1% çdo vit të numrit të familjeve, ku tarifa e pastrimit do të pësojë rritjen e propozuar deri në vitin e pestë të planit për të mbuluar gradualisht përqindjen e rritjes së kostos operative nga zbatimi i **skenarit I**. Si fillim janë marrë si referencë nivelet e grumbullimit të të ardhurave të raportuara nga bashkia për vitin 2019-2020, ku vit pas viti është propozuar një rritje me 5% e nivelit të grumbullimit të të ardhurave dhe një rritje e kostos së shërbimit me 10% vit pas viti.

Në rastin e bizneseve ato janë marrë të përmbledhura në dy tabela (biznesi i madh dhe biznesi i vogël) në ndryshim nga familjet, ku ato janë marrë më vetë për secilën zonë të mbetjeve.

Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Bushat)		2026	2027	2028	2029	2030	2031
1.1	Nr. i familjeve	4,378	4,422	4,466	4,511	4,556	4,601
1.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,500	1,900	1,900	1,900	2,000
1.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	6,567,000	6,632,670	8,485,396	8,570,250	8,655,952	9,202,644
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	35%	40%	45%	55%	60%	65%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	2,298,450	2,653,068	3,818,428	4,713,637	5,193,571	5,981,719
1.6	Pjese e koston operative për familjet	3,796,954	4,366,497	4,746,193	5,125,888	5,505,584	6,075,127
1.7	Përqindja e mbulimit të koston	61%	61%	80%	92%	94%	98%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Vau Dejës-Hajmel)		2026	2027	2028	2029	2030	2031
2.1	Nr. i familjeve	3,836	3,874	3,913	3,952	3,992	4,032
2.2	Tarifa vjetore e familjeve	1,500	1,500	1,900	2,000	2,000	2,000
2.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	5,754,000	5,811,540	7,434,897	7,904,469	7,983,514	8,063,349
2.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	35%	40%	45%	55%	60%	65%
2.5	Të ardhurat e grumbulluara	2,013,900	2,324,616	3,345,704	4,347,458	4,790,108	5,241,177
2.6	Pjese e koston operative për familjet	3,796,954	4,366,497	4,746,193	5,125,888	5,505,584	6,075,127
2.7	Përqindja e mbulimit të koston	53%	53%	70%	85%	87%	86%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Temal)		2026	2027	2028	2029	2030	2031
3.1	Nr. i familjeve	506	511	516	521	527	532
3.2	Tarifa vjetore e familjeve	-	400	500	500	500	1,000
3.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	-	204,424	258,085	260,666	263,273	531,811
3.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	0%	20%	30%	40%	50%	60%
3.5	Të ardhurat e grumbulluara	-	40,885	77,426	104,266	131,636	319,087
3.6	Pjese e koston operative për familjet	2,156,409	2,479,871	2,695,512	2,911,152	3,126,793	3,450,255
3.7	Përqindja e mbulimit të koston	0%	1.65%	3%	4%	4%	9%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Vig Mnelë)		2026	2027	2028	2029	2030	2031
4.1	Nr. i familjeve	438	442	447	451	456	460
4.2	Tarifa vjetore e familjeve	-	400	500	500	500	1,000
4.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	-	176,952	223,402	225,636	227,892	460,342
4.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	0%	20%	30%	40%	50%	60%
4.5	Të ardhurat e grumbulluara	-	35,390	67,021	90,254	113,946	276,205
4.6	Pjese e koston operative për familjet	1,995,386	2,294,694	2,494,233	2,693,771	2,893,310	3,292,387
4.7	Përqindja e mbulimit të koston	0%	2%	3%	3%	4%	8%
Tarifa familjare nga kosto operative e shërbimit (Shllak)		2026	2027	2028	2029	2030	2031
5.1	Nr. i familjeve	303	312	321	331	341	351
5.2	Tarifa vjetore e familjeve	-	-	-	-	-	500

5.3	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	-	-	-	-	-	175,630
5.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	0%	0%	0%	0%	0%	30%
5.5	Të ardhurat e grumbulluara	-	-	-	-	-	52,689
5.6	Pjese e koston operative për familjet						
5.7	Përqindja e mbulimit të koston	0%	0%	0%	0%	0%	0%

Tabela 27 Mbulimi i koston nga tarifa e pastrimit nga familjet për Skenarin I  
[Burimi: Punuar nga Autori]

Në grafikët më poshtë tregohet përqindja e nivelit të të ardhurave që grumbullohen kundrejt përqindjes të mbulimit të koston gjatë 5 viteve të zbatimit të planit, për secilën NJA të Zonës Sub Urbane:




Figura 18 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të koston – NJA Bushat  
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 19 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të koston – NJA Vau Dejës-Hajmel  
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 20 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Temal  
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Figura 21 Niveli i të ardhurave nga familjet kundrejt mbulimit të kostos – NJA Vig Mnelë  
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund ta shohim si nga tabela ashtu edhe nga grafikët, niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet, për njësitë e Zonës Sub-Urbane, ka qënë i ulët gjatë vitit 2020, ku NJA Bushat, Vau Dejës – Hajmel kanë patur një performancë të grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet me 35% dhe dy njësitë e tjera që do të hyjnë në sistem nuk paguanin tarifën e pastrimit.

**Në parashikimin e bërë për 5 vjeçarin e zbatimit të planit, është parashikuar një rritje 5% çdo vit për secilën njësi të nivelit të grumbullimit të tarifës nga familjet dhe 10% të kostos operative çdo vit, duke marrë parasysh edhe nivelin e informimit të qytetarëve.**

Në fund të 5 vjeçarit parashikohet që NJA Bushat, NJA Vau Dejës dhe NJA Hajmel të kenë performancën më të mirë duke arritur nivele të grumbullimit të tarifës deri në 65% dhe nivelin e mbulimit të kostos deri në 98%. Ndërkohë njësitë e tjera, të cilat do të hyjnë në skemën e ofrimit të shërbimit dhe pagesës së tarifës së pastrimit, relativisht do të kenë një performancë më të ulët, ku niveli i grumbullimit të tarifës potencialisht mund të shkojë deri në 60% dhe mbulimi i kostos operative nuk do t'i kalojë 10%. Kjo shifër e ulët e mbulimit të kostos nga NJA Vig-Mnelë dhe Temal lidhet me faktin e nivelit të ulët të tarifës që propozohet t'i prezantohet këtyre njësisve dhe numrit të ulët të familjeve në zonë.

Ndërkohë përsa i takon planifikimit të të ardhurave për bizneset e vogla dhe të mëdha, është parashikuar niveli i grumbullimit të të ardhurave dhe mbulimi i kostos gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit, duke marrë në konsideratë rritjen e kostos dhe rrjedhimisht rritjen e tarifës nga zbatimi i Skenarit I. Në tabelën më poshtë paraqitet planifikimi i të ardhurave, kostove operative dhe mbulimi i kostos, ku potencialisht merret një rritje e numrit të bizneseve me 1% në vit:

Tarifa e biznesit të vogël nga kosto operative e shërbimit		2026	2027	2028	2029	2030	2031
1.1	Nr. i bizneseve të vogla	502	507	512	517	522	528
a.	Subjekte me xhiro 0-8 milion lekë	466	471	475	480	485	490
b.	Profesione të Lira	18	18	18	19	19	19
c.	Transport për pasagjerë	14	14	14	14	15	15
d.	Transport Mallrash	4	4	4	4	4	4
1.2	Tarifa e pastrimit për secilën kategori						

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE TË NGURTA URBANE - BASHKIA VAU DEJËS**

a.	Subjekte me xhiro 0-8 milion lekë	2,400	2,400	3,000	3,000	3,500	4,000
b.	Profesione të Lira	13,000	13,000	13,000	14,000	14,000	15,000
c.	Transport për pasagjerë	8,000	8,000	8,000	8,500	9,000	10,000
d.	Transport Mallrash	8,000	8,000	8,000	8,500	9,000	10,000
1.3	Planiifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	1,496,400	1,511,364	1,811,698	1,857,633	2,128,035	2,432,037
1.4	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	70%	80%	90%	90%	100%	100%
1.5	Të ardhurat e grumbulluara	1,047,480	1,209,091	1,630,528	1,671,869	2,128,035	2,432,037
1.6	Pjesë e kostos operative për bizneset e mëdha	4,547,177	5,229,253	5,683,971	6,138,689	6,593,407	7,502,842
1.7	Përqindja e mbulimit të kostos	23%	23%	29%	27%	32%	32%
<b>Tarifa e biznesit të madh nga kosto operative e shërbimit</b>		<b>2026</b>	<b>2027</b>	<b>2028</b>	<b>2029</b>	<b>2030</b>	<b>2031</b>
2.1	Nr. i bizneseve të mëdha	121	133	146	161	177	195
a.	Tregtim karburanti me pakicë	16	18	19	21	23	26
b.	Tregtim karburanti me shumice	1	1	1	1	1	2
c.	Subjekte prodhimi asfalto-beton, blloqe, tulla, mermer, etj	6	7	7	8	9	10
d.	Subjekte ndërtimi të regjistruar pranë Bashkisë Vau Dejës.	4	4	5	5	6	6
e.	Subjekte me aktivitet punime & përpunime duralumini, metalesh, druri etj.	8	9	10	11	12	13
f.	Subjekte tregti artikuj të ndryshëm	53	58	64	71	78	85
g.	Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushen e inerteve	3	3	4	4	4	5
h.	Subjekte dege të shoqerive së huaj	1	1	1	1	1	2
i.	Subjekte shërbimi, agjensi sigurimi, transporti, loto, banka	6	7	7	8	9	10
j.	Subjekte tregtare, shërbime telefoni fikse, mobile, internet	9	10	11	12	13	14
k.	Subjekte të transmetimit të energjisë, OSHE, OST	3	3	4	4	4	5
l.	Njësia e prodhimit të gjithë H/C	3	3	4	4	4	5
m.	Reparti Ushtarak 1010	1	1	1	1	1	2
n.	Subjektet prodhim mishi, peshku, qumështi, stalla derrash, lopesh etj	5	6	6	7	7	8
o.	Subjektet Juridike të Mëdha me xhiro mbi 200 milion leke	2	2	2	3	3	3
1.2	Tarifa e pastrimit për secilën kategori						
a.	Tregtim karburanti me pakicë	35,000	35,000	35,000	40,000	45,000	50,000
b.	Tregtim karburanti me shumice	60,000	60,000	60,000	60,000	70,000	75,000
c.	Subjekte prodhimi asfalto-beton, blloqe, tulla, mermer, etj	50,000	50,000	50,000	50,000	60,000	65,000
d.	Subjekte ndërtimi të regjistruar pranë Bashkisë Vau Dejës.	60,000	60,000	60,000	60,000	70,000	75,000
e.	Subjekte me aktivitet punime & përpunime duralumini, metalesh, druri etj.	50,000	50,000	50,000	50,000	60,000	65,000
f.	Subjekte tregti artikuj të ndryshëm	60,000	60,000	60,000	60,000	70,000	75,000
g.	Subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushen e inerteve	100,000	100,000	100,000	100,000	110,000	115,000
h.	Subjekte dege të shoqerive së huaj	200,000	200,000	200,000	200,000	210,000	215,000
i.	Subjekte shërbimi, agjensi sigurimi, transporti, loto, banka	40,000	40,000	40,000	40,000	50,000	55,000
j.	Subjekte tregtare, shërbime telefoni fikse, mobile, internet	40,000	40,000	40,000	40,000	50,000	55,000
k.	Subjekte të transmetimit të energjisë, OSHE, OST	5,000	5,000	5,000	10,000	15,000	20,000
l.	Njësia e prodhimit të gjithë H/C	5,000	5,000	5,000	10,000	15,000	20,000
m.	Reparti Ushtarak 1010	5,000	5,000	5,000	10,000	15,000	20,000
n.	Subjektet prodhim mishi, peshku, qumështi, stalla derrash, lopesh etj	60,000	60,000	60,000	60,000	70,000	75,000
o.	Subjektet Juridike te Medha me xhiro mbi 200 milion leke	200,000	200,000	200,000	200,000	210,000	215,000

2.2	Planifikimi i të ardhurave nga tarifa (100% paguajnë)	6,575,000	7,232,500	7,955,750	8,904,390	11,398,019	13,512,179
2.3	Niveli i grumbullimit të të ardhurave	70%	80%	85%	85%	90%	90%
2.4	Të ardhurat e grumbulluara	4,602,500	5,786,000	6,762,388	7,568,732	10,258,217	12,160,961
2.5	Pjesë e kostos operative për bizneset e mëdha	5,167,247	5,942,333	6,459,058	6,975,783	7,518,344	8,525,957
2.6	Përqindja e mbulimit të kostos	89%	97%	105%	109%	136%	143%

Tabela 28 Mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit nga BV dhe BM për Skenarin I  
[Burimi: Punuar nga Autori]

Nga tabela për planifikimin e të ardhurave dhe mbulimin e kostos nga bizneset shohim se ato relativisht performojnë mjaft mirë, duke e tejkaluar edhe mbulimin e kostos të skenarit të ri. Në tabelën më poshtë bëhet një përmbledhje e të ardhurave të grumbulluara dhe përqindja e mbulimit të kostos nga të gjithë konsumatorët e bashkisë përgjatë 5 viteve të zbatimit të planit:

Performanca e grumbullimit të tarifës - Skenari I		2026	2027	2028	2029	2030	2031
I	Të ardhurat e grumbulluara në total nga familjet e bashkisë	4,312,350	5,053,959	7,308,578	9,255,616	10,229,262	11,870,877
II	Pjesë e kostos operative për familjet në total për Bashkinë	11,745,704	13,507,559	14,682,130	15,856,700	17,031,270	18,892,895
III	<b>Përqindja e mbulimit të kostos nga familjet për të gjithë Bashkinë</b>	<b>37%</b>	<b>37%</b>	<b>50%</b>	<b>58%</b>	<b>60%</b>	<b>63%</b>
IV	Të ardhurat e grumbulluara në total nga BV	1,047,480	1,209,091	1,630,528	1,671,869	2,128,035	2,432,037
V	Pjesë e kostos operative për BV në total për Bashkinë	4,547,177	5,229,253	5,683,971	6,138,689	6,593,407	7,502,842
VI	<b>Përqindja e mbulimit të kostos nga BV për të gjithë Bashkinë</b>	<b>23%</b>	<b>23%</b>	<b>29%</b>	<b>27%</b>	<b>32%</b>	<b>32%</b>
VII	Të ardhurat e grumbulluara në total nga BM	4,602,500	5,786,000	6,762,388	7,568,732	10,258,217	12,160,961
VIII	Pjesë e kostos operative për BM në total për Bashkinë	5,167,247	5,942,333	6,459,058	6,975,783	7,518,344	8,525,957
IX	<b>Përqindja e mbulimit të kostos nga BM për të gjithë Bashkinë</b>	<b>89%</b>	<b>97%</b>	<b>105%</b>	<b>109%</b>	<b>136%</b>	<b>143%</b>
VII	<b>Të ardhurat e grumbulluara në total Bashkia</b>	<b>9,962,330</b>	<b>12,049,050</b>	<b>15,701,493</b>	<b>18,496,217</b>	<b>22,615,514</b>	<b>26,463,875</b>
VIII	<b>Kosto Operative e Bashkisë</b>	<b>21,460,127</b>	<b>24,679,146</b>	<b>26,825,159</b>	<b>28,971,172</b>	<b>31,143,021</b>	<b>34,921,694</b>
IX	<b>Përqindja e mbulimit të kostos për të gjithë Bashkinë</b>	<b>46%</b>	<b>49%</b>	<b>59%</b>	<b>64%</b>	<b>73%</b>	<b>76%</b>

Tabela 29 Të ardhurat dhe mbulimi i kostos nga tarifa e pastrimit gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit në Bashkinë Vau Dejës  
[Burimi: Punuar nga Autori]

Nga tabela shohim se Bashkia Vau Dejës gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit, sipas parashikimeve për rritjen e nivelit të grumbullimit të tarifës së pastrimit me 5% çdo vit dhe rritjen e kostos operative me 10% çdo vit, do të arrijë të mbulojë koston e shërbimit deri në masën 76%, nëse të gjithë konsumatorët do të jenë të gatshëm të paguajnë tarifën e pastrimit. Këto shifra mund të jenë më të larta, nëse bashkia ka ambicie dhe përkushtim për të vendosur objektiva më të larta nivelin e grumbullimit të tarifës, në mënyrë të tillë që të ardhurat e grumbulluara të mbulojnë deri në 100% të kostos së shërbimit.

## SKENARI II

Nëse Bashkia Vau Dejës do të marrë përsipër realizimin e skenarit të dytë, është e qartë që niveli i tarifave dhe i kostos për dy njësitë ku planifikohet të shtrihet shërbimi do të rriten. Konkretisht nga Skenari I për në skenarin e dytë kosto për NJA Bushat do të rritet me 23% dhe për NJA Vau Dejës do të rritet me 27%. Megjithatë, nisur nga fakti që Bashkia Vau Dejës duhe të përmbushë standardin minimal për shtrirjen e shërbimit në të gjithë territorin e saj (NJA Shllak është e pambulluar me shërbim dhe rrjeti rrugor krijon vështirësi dhe kosto shumë të lartë në ofrimin e shërbimit në këtë zonë) bashkia mund të zgjedhë që ofrimin e këtij skenari ta mbulojë me koston aktuale, duke rritur nivelin e

grumbullimit të të ardhurave nga familjet, jo më 5% vit, por me 20-30% çdo vit, për të kompesuar koston operative të skemës së re.

## VII. PLANIFIKIMI I FUSHATAVE TË NDËRGJEGJËSIMIT DHE INFORMIMIT TË KOMUNITETIT

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në territorin e bashkisë, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. **Suksesi i çdo skeme bazohet plotësisht nga mbështetja e përdoruesve. Është me rëndësi që të sigurohet zbatueshmëria e planit në 5 vjeçarin e ardhshëm, bashkia duhet të sigurojë një marrëdhënie partneriteti me komunitetin, ku ai:**

- Të ketë aksesueshmëri në shprehjen e mendimit, ankesave, sugjerimeve në lidhje me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (anketa të zhvilluar rregullisht nga bashkia, njoftime të rregullta në stendën e bashkisë dhe në faqet online të saja dhe rrjetet sociale)
- Të informohet rregullisht në lidhje me skemën e menaxhimit të mbetjeve që aplikohet në territorin e bashkisë
- Të mundësohet transparenca e nivelit të tarifave të pastrimit dhe sistemit të faturimit për grumbullimin e saj
- Të njihet me detyrimet fiskale për pagesën e tarifës, detyrime të tjera në lidhje me skemën e menaxhimit dhe detyrimin për mbajtjen pastër të territorit të bashkisë

Konsumatorët si familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushate të fortë ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të mbledhjes, duke zbatuar kërkesat e hedhjes së mbetjeve në vendet e caktuara. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbetjeve, pastërtisë së territorit dhe plotësimin e detyrimeve fiskale, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbetjeve. Ka disa mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbetjeve dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektiv për arritjen e objektivit. Kjo mund të arrihet duke hartuar një plan ndërgjegjësimi i cili do të mundësojë:

- Ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për komunitetin në lidhje me nismat vendore të mbledhjes, riciklimit të mbetjeve, pastërtisë së bashkisë dhe koston së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve;
- Transparenca me komunitetin në lidhje me sistemin e faturimit dhe nivelin e tarifave të pastrimit;
- Ndërgjegjësimin e komunitetit për detyrimet ligjore për pagesën e tarifës së pastrimit, rregullat dhe detyrimet vendore;
- Nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

### Metoda për komunikim dhe informim

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesin në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të koston së ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime, koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informimi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e informimit të komunitetit për sistemin e menaxhimit të mbetjeve që po aplikohet në zonën e tyre metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në njohjen e sistemit të grumbullimit të mbetjeve që aplikohet, në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të

përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbetjeve në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret si dhe informimi për nivelin e tarifës së pastrimit, sistemit të faturimit të përcaktuar dhe detyrimin për pagesën e tarifës.

Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për çështje të ndryshme që lidhen me sistemin menaxhimit të mbetjeve në zonën e tyre, duke filluar që nga frekuenca e shërbimit, niveli i tarifave, sistemi i faturimit për pagesën e tarifës apo llojet e mbetjeve që duhet të ndahen në burim, në varësi të skemës së grumbullimit që janë duke aplikuar.

*Përdorimi i mjeteve teknologjike që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve apo kontenierët për informim:* Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbetjeve duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme (me germa të paktën 10 cm të mëdha) një slogan domethënës për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

### **Marrja e opinionëve të qytetarëve**

*Një tjetër çështje e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t'i japë bashkisë mendime apo opinionë ose komente për shërbimin e mbetjeve?*

Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e komunitetit janë:

- Mundësia e komunitetit për t'u ankuar: Bashkia apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacioni për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.
- Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i "vullnetit për të paguar": Për të vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, del nevoja për të komunikuar me përfutuesit e mundshëm të shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifën. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, mostra që duhet të realizohet është midis 100 dhe 200 të intervistuar. Kjo praktikë duhet të kryhet periodikisht nga bashkia, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

## **VIII. RISHIKIMI I PLANIT**

Ndjekja e zbatimit të planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike (çdo 5 vjet) ose më shpesh nëse është e nevojshme për vlerësimin dhe rishikimin e objektivave dhe masave. Monitorimi dhe vlerësimi mund të funksionojë si një bazë për rishikimin e planit.

Çështje të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë kur të analizohet ky plan janë sigurisht vlerësimi nëse objektivat janë përmbushur, nëse masat e parashikuara kanë qenë efektive apo jo. Një plan duhet të rishikohet gjithashtu, kur politika kombëtare e mbetjeve rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në mënyrën e menaxhimit të mbetjeve apo vendos objektiva të ndryshëm në funksion të obligimeve ndërkombëtare. Në këto raste, plani duhet të përballet me ndryshime të thella ose mund të jetë i nevojshëm hartimi i një plani të ri.

Përgjatë zbatimit të planit, duhen analizuar në mënyrë të vazhdueshme faktorët kryesorë që impaktojnë në parashikimet dhe objektivat e vëna në plan, si zhvillimi i popullsisë, ndryshimet lidhur me konsumin dhe llojin e mbetjeve të gjeneruara nga industritë apo ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

### **8.1 Monitorimi i planit**

Ky plan duhet të parashikojë hapat në vazhdim, indikatorët dhe mjetet për të vlerësuar punën e bërë, për të verifikuar nëse objektivat janë përmbushur dhe të raportojnë tek vendimmarrësit. Qëllimi është që të sigurojë që autoriteteve përgjegjëse u është dhënë mundësia për të ndjekur zhvillimin dhe zbatimin e planit dhe të vendosin mbi masat shtesë, nëse është e nevojshme. Studimi bazë, i kryer për qëllim të këtij plani, do të shërbejë si një status bazë mbi të cilën do të vlerësohen arritja e objektivave dhe targeteve dhe mbi të cilin do të maten ndryshimi i indikatorëve të performancës së planit.

Monitorimi i planit duhet të jetë një proces i vazhdueshëm me vlerësime periodike dhe, nëse është e nevojshme mund të kërkojë rishikimin e objektivave dhe masave të planit. Monitorimi i planit do të shërbejë për:

- Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit, mbi statusin e zbatimit të planit;
- Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara;
- Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo të efektshme;
- Për të mësuar, përditësuar dhe shpërndarë informacion dhe njohuri.

### **Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të shërbimit**

Bashkia duhet të ndjekë këto hapa në kryerjen e procesit të monitorimit dhe të vlerësimit të planit, si më poshtë:

- Rishikimi i situatës: Rishikimi i objektivave dhe synimeve, kontrolli nëse ato i përshtaten kontekstit real dhe vlerësimi i tyre me anë të indikatorëve
- Mbledhja e evidencave sasiore dhe cilësore që lidhen me mbetjet
- Analizimi i evidencave: Analizimi i të dhënave për të matur progresin, krahasimi i rezultateve me objektivat dhe synimet, kontrolli nëse objektivat janë arritur në një afat kohor të dëshiruar
- Dokumentimi i konkluzioneve
- Ndarja dhe diskutimi i konkluzioneve: Gjetjet duhet të ndahen me palët e interesuara dhe domosdoshmërisht me vendimmarrësit.

Kryetari i bashkisë duhet të ngarkojë një grup pune përgjegjës apo zyrtarë të caktuar, brenda stafit të bashkisë, me përgjegjësinë e monitorimit dhe vlerësimit të planit.

- Grupi i punës duhet të përfshijë zyrtarë të administrimit të mbetjeve, administrimi financiar, struktura të mjedisit dhe kontrollit të territorit dhe konsulentëve të jashtë.
- Grupi i punës duhet të evidentojë të gjitha PGM në të gjithë territorin e bashkisë dhe duhet t'i hedhë në hartë.
- Grupi i punës duhet të njihet me qëllimin e zhvillimit të sistemeve të monitorimit të shërbimit, pavarësisht nëse shërbimi ofrohet nga bashkia apo nga privati, ku monitorimi shërben:
  - Për të matur progresin e çdo operacioni më vete në menaxhimin e mbetjeve kundrejt objektivave dhe targeteve të dakortësuar. Në këtë mënyrë bashkia do ta dijë paraprakisht në qoftë se objektivat e shërbimit të MM kanë mundësi që të plotësohen
  - Për të matur efektivitetin e paisjeve dhe stafit të përdorur në çdo operacion të menaxhimit të mbetjeve
  - Për të hartuar dhe adresuar masa korrektuese dhe rregullatore për të përmirësuar shërbimin bazuar mbi informacionin e mbledhur përmes monitorimit
  - Për të vlerësuar shpenzimet dhe për të kontrolluar kostot e çdo operacioni në menaxhimin e mbetjeve, për t'u siguruar që buxheti ekzistues është i shpërndarë në mënyrën e duhur dhe është i mjaftueshëm për të mbuluar kostot
  - Për të vlerësuar sjelljen e përdoruesve si dhe për të matur kënaqësinë e konsumatorit për të parë dhe vlerësuar sesi këto parametra ndikojnë në performancën e shërbimit

- Për të planifikuar më mirë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen dhe për të vlerësuar mundësinë dhe potencialet e zgjerimit dhe riplanifikimit të shërbimit.

Grupi i punës në Bashki mund të zgjedhë që të identifikojë aktorët të cilët duhet të jenë të përfshirë në procesin e monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve siç paraqitet në skemat më poshtë:




Figura 22 Aktorët që mund të përfshihen në operacionet e monitorimit të shërbimit

[Burimi: zhvilluar nga autori]

Ndërkohë për të gjitha njësitë vendore, pas evidentimit të PGM në terren, grupi i punës mund të hartojë modele të raporteve ditore në lidhje me gjendjen e PGM në të gjithë territorin tyre. Këto raporte duhet të plotësohen nga supervzori përpara se të raportohen në Drejtorinë e Shërbimeve Publike në Bashki:

Grumbullimi i mbetjeve dhe transport						Koha e shërbimit			
Raport ditor	Zona	Rajoni	Emri i supervisorit		Data	Ora			
Emri i rrugës/fshati	Koha e monitorimit	PGM	Nr. i kontenierëve	Frekuenca e grumbullimit	Nr. i kontenierëve të grumbulluar	Data e larjes	Nr. i kontenierëve të larë apo jo	Nr. i kontenierëve të dëmtuar	Shënime
1		1	2	2 ditë/javë					
		2	1						
		3	5						
		4	1						
		5	4						
		6	2						
		7	2						
		8	1						
2		9	2	2 ditë/javë					
		10	1						
		11	1						
		12	2						
		13	2						
		14	3						
3		15	2	2 ditë/javë					
		16	1						
		17	2						
		18	1						
4		19	1	2 ditë/javë					
		20	2						
		21	1						
		22	1						
		23	1						
		24	1						
		25	1						
		26	2						
5		27	1	2 ditë/javë					
		28	1						
		29	1						

Tabela 30 Model të raportimi ditor për gjendjen e PGM

[Burimi: Punuar nga Autori]

## IX. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

### 9.1 Rregullorja vendore

Bashkia Vau Dejës duhet të përgatisë dhe miratojë rregulloren lokale për administrimin e shërbimit të mbetjeve, ku të përcaktohet qartë roli dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore duhet të përcaktojë rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbetjeve, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht kjo rregullore duhet të përfshijë:

- a. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;
- b. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;
- c. Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
- d. Marrjen e masave parandaluese për mos-djegjen e mbetjeve në kazanë, për moshedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;
- e. Marrjen e masave parandaluese për mos-hedhjen e mbetjeve voluminoze dhe atyre të rrezikshme, mos-depozitimin e kafshëve të ngordhura dhe mbetjeve të rrezikshme;
- f. Shmangien e parkimit të automjeteve përballë apo pranë pikave të caktuara të grumbullimit të mbetjeve;
- g. Marrjen e masave për pastrimin nga ana e pronarëve të hapësirave rreth dyqaneve dhe pikave ambulate të shitjes;
- h. Marrjen e masave për sigurimin e një pastertie të pranueshme, duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve;
- i. Mbajtja e uniformave gjatë proceseve të punës nga punonjësit e pastrimit;
- j. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve)
  - Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
  - Procedurat administrative për dhënien dhe heqjen e licencave;
  - Pagesa e tarifave dhe taksave të vendosura nga autoriteti vendor;
  - Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm;
  - Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit;
  - Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbim e pastrimi;
  - Mbajtja e të dhënave historike për mbetjet;
  - Parandalimi i problemeve për shëndetin publik.

## 9.2 Zbatimi dhe sanksionet

Rregullorja vendore e administrimit të mbetjeve duhet të përcaktojë një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin “ndotësi paguan”, ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbetjeve, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për shkurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët bashkiakë që janë nën juridiksionin e bashkisë. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbetjeve.

## 9.3 Licencimi mjedisor

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor vendor do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

- Bashkitë duhet të bashkëpunojnë me ARM (Agjencia Rajonale e Mjedisit) kur japim miratime për njerëz që ushtrojnë veprimtari apo projekt për administrimin e mbetjeve;
- Të japin miratimin për vendet e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore (Neni 13 i Ligjit për Mbetjet e Rrezikshme);
- Të kontrollojnë vazhdimisht përmbushjen e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbetjeve (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-

urbane). Në këtë aspekt, ajo duhet të marrë herë pas here raporte nga personat e përfshirë në këto veprimtari.

#### 9.4 Pjesëmarrja e sektorit privat

Ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbetjeve:

- Sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare sesa sektori publik;
- Skemat e minimizimit të mbetjeve që kërkojnë financime në teknologji (makineri dhe kontenierë) mund të jenë shumë të përshatshme për një bashkëpunim PPP;
- Administrata e sektorit privat është më efektive se ajo e sektorit publik;
- Aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve të bashkisë;
- Dukë qënë që është i orientuar drejt fitimit, sektori privat ofron kontroll më të mirë të standardeve operative dhe teknike, etj.

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbetjeve voluminoze, mbetjeve të riciklueshme apo dhënia me koncesion e impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbetjeve (përfshirë edhe Stacionin e Transferimit të Mbetjeve), duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbetjeve. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.

Sektori privat mund të marrë pjesë në secilën nga veprimtaritë e administrimit të mbetjeve të ngurta, siç jepet edhe më poshtë:

Ofrimi i kamionëve apo makinerive të rënda – me qira ose marrëveshje qiraje me pronarët e pajisjeve	Fshirja apo pastrimi i rrugëve dhe zonave të hapura – me kontratë shërbimi
Mbledhja e mbetjeve të përgjithshme urbane nga të gjitha lagjet / i gjithë qyteti – me kontratë shërbimi	Riparimi i makinerive të bashkisë për mbetjet urbane – me kontratë shërbimi sipas nevojave apo me kontratë afatgjatë
Ofrimi i kontenierëve të posaçëm për skemat e minimizimit të mbetjeve	Operimi i ST – me kontratë shërbimi ose koncesion
Mbledhja e mbetjeve komerciale nga hotelet, zyrat, tregjet apo dyqanet	Vjelja e tarifave të përdoruesit apo taksave të mbetjeve – me të drejtë ekskluzive për mbledhjen e tarifave me agentë, si ndërmarrja e ujësjellësit, apo elektriku.

Tabela 31 Pjesëmarrja e sektorit privat në administrimin e mbetjeve të ngurta  
[Burimi: Punuar nga autori]

#### 9.5 Mbështetja politike

Menaxhimi i mbetjeve dhe pastërtia e qytetit duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për qytetin dhe banorët e tij dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Këshilli Bashkiak për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë Këshilli Bashkiak duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori, përmirësimin e buxhetit, investimet dhe përmirësimin e paketës fiskale, dhe nga ana tjetër bashkia duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj këshillit dhe publikut për të gjitha veprimet që ajo ndërmerr. Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit. Mbetet detyrë e stafit të Bashkisë që këtë çështje t'ia argumentojë dhe adresojë në mënyrë sa më profesionale Këshillit Bashkiak me qëllim marrjen e dakordësisë në miratimin e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve si dhe buxhetin përkatës për zbatimin e tij.

**X. PLANI I VEPRIMIT**

Komponenti	Objektivi Strategjik	Veprimi i detajuar	Indikatori matës i performancës	Përgjegjësia	Afati kohor	
<b>I. CILËSIA E SHËRBIMIT</b>						
1.1	<i>Mbulimi i zonës me shërbim (të dhënat e bashkisë)</i>	<p>Mbulimi i territorit të Bashkisë me shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe konsolidimi i tij në zonat ku aktualisht ofohet shërbimi</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtirja e shërbimit në 100% të territorit urban në NJA Vau Dejës, NJA Bushat, NJA Hajmel</li> <li>• Shtirja e shërbimit në 90% të territorit rural në NJA Vig Mnelë dhe NJA Temal</li> <li>• Shtirja e shërbimit në 50% të territorit rural në NJA Shllak, (kur të mundësohet rruga automobilistike)</li> <li>• Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për grumbullimin me kontenierë 1.1 m<sup>3</sup> si dhe transportin efektiv të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë Vau Dejës</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Riorganizimi i zonave të shërbimit të mbetjeve (ndarje e Bashkisë në katër zona shërbimi: Zona Semi- Urbane (NJA Bushat, NJA Vau Dejës, NJA Hajmel); Zona Rurale (NJA Temal, NJA Vig Mnelë),</li> <li>2. Shtirja e shërbimit në NJA në të cilat nuk ofrohej shërbimi i mbetjeve (NJA Temal, NJA Vig Mnelë) dhe konsolidimi i shërbimit në NJA, të cilat kanë patur shërbim. Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në sajë të nevojës të reja që ka Bashkia e re (blerje kontenierë dhe mjete teknologjike)</li> </ol>	<p>Numri i klientëve që marrin shërbim kundrejt atyre që nuk marrin shërbim Sasia e mbetjeve që grumbullohen kundrejt atyre që gjenerohen</p>	<p>Bashkia Vau Dejës; (Kryetari, Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve)</p>	<p>2026-2027</p>
1.2	<i>Pastërtia e bashkisë</i>	<p>Sigurimi i pastërtisë të pikave të grumbullimit të mbetjeve (evitimi i pikave të tejbushura)</p> <p>Sigurimi i pastrimit të rregullt të rrugëve të qytetit dhe zonave të urbanizuara nga hedhurinat</p> <p>Reduktimi i depozitimeve ilegale të mbetjeve urbane dhe atyre inerte në territorin e Bashkisë Vau Dejës</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shtirja e shërbimit në territore të pambuluara me shërbim (NJA Vig Mnelë dhe NJA Temal)</li> <li>2. Konsoolidimi dhe përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në 3 NJA ku aktualisht ofrohet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve</li> <li>3. Zbatimi i sistemit të monitorimit të rregullt ditor të pikave të grumbullimit të mbetjeve dhe nivelit të pastërtisë</li> <li>4. Zbatimi i masave të përcaktuara në studimin e dlpd "Zbutja e Riskut në Vend depozitime – Raporti Final 2018" për rehabilitimin deri në mbylljen përfundimtare të venddepozitimeve në Bashkinë Vau Dejës;</li> <li>5. Sigurimi i financimit për zbatimin e projektit të rehabilitimit</li> <li>6. Hartimi dhe miratimi i një plani mjedisor të monitorimit dhe kujdesi pas mbylljes të venddepozitimeve</li> </ol>	<p>Niveli i pastërtisë të pikave të grumbullimit të mbetjeve (prania e mbetjeve jashtë kontenierëve)</p> <p>Niveli i pastërtisë të rrugëve kryesore të bashkisë</p> <p>Numri i depozitimeve ilegale kundrejt atyre të pastruara</p>	<p>Bashkia Vau Dejës (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i shërbimeve publike)</p>	<p>2026-2027</p>

1.3	Gadishmëria e bashkisë për të adresuar ankesat e komunitetit	Ngritja e një sistemi komunikimi dhe partneriteti me komunitetin për krijimin e mundësisë për akses të vazhdueshëm për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i një strategjie dhe plani veprimi për mundësimin e vazhdueshëm të informacionit për kategoritë e konsumatorëve në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve:             <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Sistemi i menaxhimit të mbetjeve që zbatohet</li> <li>b. Rregullat që duhen zbatuar dhe specifikat në lidhje me orarte e shërbimit</li> <li>c. Kosto e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve</li> <li>d. Nivelet e tarifave të pastrimit për secilën kategori të konsumatorëve</li> <li>e. Detyrimi për pagesën e tarifës dhe format e pagesës</li> </ol> </li> <li>2. Aplikimi i mjeteve të informimit dhe komunikimit si broshura informative, buletinë, postera, rrjete sociale, standat e bashkisë apo anketat periodike për të informuar rregullisht komunitetin</li> <li>3. Krijimi i një faqeje për shërbim klienti nga bashkia ku të adresohen të gjitha ankesat e qytetarëve në kohë reale dhe të regjistrohen sa prej tyre kanë marrë përgjigje nga bashkia dhe niveli i kënaqësisë së komunitetit.</li> </ol>	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit të ndërmarra gjatë një viti Numri i materialeve ndërgjegjësuese të përgatitura dhe shpërndara gjatë vitit me mjetet e komunikimit të bashkisë Numri i ankesave të marra kundrejt atyre të adresuara	Bashkia Vau Dejës, zyra e informimit dhe komunikimit me komunitetin	2026-2027
-----	--	---	---	--	---	-----------

**II. QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE**

2.1	Shkalla e grumbullimit të diferencuar	Promovimi i ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në burim si dhe në të gjitha stadet e gjenerimit të tyre.	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mobilizimi i përfshirjes së komunitetit në skemat pilot</li> <li>2. Zhvillimi i anketimeve paraprake për vlerësimin e vullnetit për t'u përfshirë në skemat e ndarjes në burim</li> <li>3. Përcaktimi i zonës pilot për skemën e ndarjes në burim të mbetjeve në NJA Bushat dhe NJA Vau Dejës</li> <li>4. Hartimi i një plani-pune specifik për zbatimin e skemave të ndarjes së mbetjeve, i cili duhet të koordinohet me sistemin ekzistues të grumbullimit të mbetjeve të tjera urbane</li> <li>5. Organizimi i takimeve në komunitet dhe me biznese, para dhe gjatë fillimit të skemave pilot për të mbështetur përpjekjet/programet e ndërgjegjësimit</li> </ol>	Numri i skemave pilot të aplikuar në Bashkinë Vau Dejës Numri i rrymave të mbetjeve që ndahen në burim nga komuniteti Sasia e mbetjeve vjetore që ndahen në burim kundrejt totalit të mbetjeve	Bashkia Vau Dejës, sektori i shërbimeve publike, komuniteti i përfshirë në ndarjen në burim	2028-2029
-----	---------------------------------------	---	--	--	---	-----------

		<p>dhe edukimit për rritur cilësinë dhe nivelin e përfshirjes së komunitetit</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Organizimi i takimeve me grupet e interesit në rajon dhe më gjerë.</li> <li>Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve</li> <li>Lidhja e marrvëshjeve bashkëpunimi/pjesëmarrje me bizneset e mëdhenj ashtu dhe nëse është e mundur me komunitetin e skemave pilot për detyrimet dhe përfitimet e palëve.</li> </ol>			
	<p>Promovimi i trajtimit të veçantë të mbetjeve organike, kryesisht nga kopshtet, duke instaluar skemat e ndarjes në burim për zona pilot në bashki</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Prezantimi i skemave të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme.</li> <li>Aplikimi i infrastrukturës të përshtatshme për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të biodegradueshme. Investim në kontenierë dhe mjete teknologjike të posaçme për grumbullimin e këtyre mbetjeve</li> <li>Projektimi dhe ndërtimi i pikave të hapura (në zonën Vau Dejës- Bushat) për kompostimin e mbetjeve të biodegradueshme dhe kontrolli i vazhdueshëm i këtyre pikave</li> <li>Kryerja e studimeve të fizibilitetit dhe analiza ekonomike mbi zhvillimin lokal të kompostimit në nivel lokal ose ndër-lokal.</li> <li>Inkurajimi i shtrirjes së skemave të kompostimit në territorin e bashkisë përmes bashkë-financimit me bizneset dhe komunitetin;</li> </ol>		<p>Bashkia Vau Dejës, sektori i shërbimeve publike, komuniteti i përfshirë në ndarjen në burim</p>	<p>2028-2030</p>
	<p>Sensibilizimi i komunitetit dhe bizneseve për t'u bërë pjesë e iniciativave të bashkisë për mbajtjen pastër të territorit si dhe për aplikimin e skemave inovative për minimizimin e mbetjeve</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ofrimi i informacioneve specifike për grupet e interesit (konsumatorët në zonat pilot);</li> <li>Lançimi i nismave të reja (grumbullimi individual i mbetjeve, riciklimi dhe kompostimi) duke përdorur promovimin në TV, radio lokale dhe gazeta</li> <li>Krijimi i grupeve në komunitet për promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimit në zonat pilot dhe konsumatorët pilot</li> <li>Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit sipas grupeve të interesit (qytetarët, bizneset, shkollat, industria, etj)</li> <li>Përdorimi i mjeteve teknologjike dhe kontenierët për të ofruar informacion të përgjithshëm (slogan, numrat e kontaktit, grafikët e shërbimit)</li> </ol>	<p>Numri i konsumatorëve të informuar Numri i fushatave ndërgjegjësuere të realizuara për sensibilizimin e komunitetit</p>	<p>Bashkia Vau Dejës, sektori i shërbimeve publike, komuniteti i përfshirë në ndarjen në burim</p>	<p>2028-2030</p>

		<p>6. Realizimi i fushatës "derë më derë" për të përfshirë popullatën dhe bizneset në mënyrë eficiente mbi aktivitetet e riciklimit dhe ndarjes në burim dhe pagesës së tarifës së pastrimit</p> <p>7. Hartimi i programeve dhe fushatave "vijuese" të riciklimit për të përmirësuar cilësinë e ndarjes në burim përmes programeve të riciklimit të mbetjeve organike</p> <p>8. Hartimi dhe shpërndarja e udhëzuesve dhe ilustrimeve për riciklimin dhe kompostimin, për shkollat, bizneset, banorët.</p>			
2.2	Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave				
<b>III. QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE DHE FINANCIARE</b>					
3.1	<p><i>Mbulimi i kostos</i></p> <p>Forcimi i kuadrit financiar të menaxhimit të mbetjeve, marrëveshjeve dhe kontratave.</p> <p>Llogaritja vjetore e kostos sipas modelit të miratuar me VKM dhe rishikimi i nivelit të tarifave, bazuar në koston reale të shërbimit.</p> <p>Rifreskimi i databazës së klientëve për planifikimin e saktë të grumbullimit të tarifës</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aplikimi çdo vit i metodologjisë së "Llogaritjes së plotë të kostos sipas modelit të DLDP" kur shpenzimet kapitale vlerësohen dhe llogaritet përgjatë gjithë jetës së dobishme të makinave dhe kontenerëve</li> <li>2. Rritje progresive e buxhetit vjetor operacional+mirëmbajtjes drejt mbulimit total të kostove operacionale dhe kostos kapitale</li> <li>3. Kompesime financiare për konsumatorët me pamundësi për të paguar (me asistencë sociale apo me të ardhurave të ulëta) dhe jo për grumbullim inefficent të tarifave</li> <li>4. Hartimi i projekteve konkrete dhe të kërkohet mbështetje financiare për investimet e mëdha nga fondet e qeverisë, donatorë, hua nga institucione financiare apo banka;</li> </ol>	Niveli i mbulimit të kostos nga tarifat e pastrimit	Bashkia Vau Dejës, sektori i shërbimeve publike, zyra e financës dhe e taksave dhe tarifave vendore	2027-2031
3.2	<p><i>Niveli i grumbullimit të të ardhurave</i></p> <p>Hartimi i një strategjie për rritjen e nivelit të të ardhurave nga tarifat për të gjitha njësitë administrative</p> <p>Konsolidimi i infrastrukturës për mbledhjen e plotë të tarifës deri në fund të 5 vjeçarit nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zbatimi i kuadrit ligjor për hartimin e nivelit të tarifave për të gjitha kategoritë e konsumatorëve</li> <li>2. Rifreskimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve, duke synuar rritjen e numrit të tarifë paguesve drejt mbulimit total</li> <li>3. Planifikimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, bazuar në databazën e</li> </ol>	<p>Niveli i realizimit të tarifave kundrejt planifikimit</p> <p>Niveli i mbulimit të kostos së shërbimit nga realizimi i tarifave</p>	Bashkia Vau Dejës (Policia Bashkiake, Përgj. Shërbimesh, publike), Këshilli Bashkiak	2027-2031

	<p>Informimi i qytetarëve në lidhje me shërbimet e pastrimit që do të mbulojnë nga tarifa</p> <p>Aplikimi i fushatave ndërgjegjësuere në lidhje me pagesën e tarifës së pastrimit dhe rritjet progresive në sajë të përmirësimit dhe shtimit të shërbimeve për mbetjet</p>	<p>rifreskuar të klientëve dhe paketës fiskale të vitit aktual</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. Planifikimi dhe aplikimi i penaliteve të qarta efektive, dhe procedurave detyruese për mos pagimin e tarifave të mbetjeve</li> <li>5. Planifikimi i zbritjes të nivelit të tarifave dhe heqja e tyre për konsumatorët e përfshirë në programet pilot të minimizimit të mbetjeve</li> <li>6. Rishikimi dhe përmirësimi i tarifimit të bizneseve, në përputhje të plotë me parimin "ndotësi paguan"</li> <li>7. Kryerja e studimeve periodike (vjetore) mbi "Dëshirën për të paguar" dhe "Mundësinë për të paguar" nga komuniteti</li> <li>8. Rishikimi i strategjisë së mbullimit të kostove dhe nivelit të tarifave, bazuar në analizën e zhvilluar në plan dhe marrja në konsideratë e performancës së grumbullimit, studimin e dëshirës për të paguar, kostove dhe objektive si dhe indikatorët financiar të përcaktuar në këtë plan</li> </ol>				
3.3	<p><i>Transparenca në sistemin e faturimit</i></p>	<p>Hartimi dhe miratimi i një sistemi të unifikuar për faturimin e tarifës së pastrimit</p> <p>Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për informimin e komunitetit</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimin e një sistemi procedurash për mbledhjen e tarifës</li> <li>2. Bërjen transparente të tarifave për çdo grup që përfiton shërbimin në mënyrë të personalizuar</li> <li>3. Përditësimi dhe përmirësimi i mekanizimit që mundëson faturimin e të gjithë klientëve që marrin shërbimin e grumbullimit dhe të transportit të mbetjeve</li> <li>4. Zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimi dhe edukimit të komunitetit në lidhje me nivelin e tarifave të pastrimit dhe detyrimin e tyre për pagesën e tyre</li> </ol>	<p>Aplikimi i një sistemi faturimi transparent për komunitetin</p> <p>% e komunitetit që është i informuar në lidhje me sistemin e faturimit të tarifës së pastrimit</p>	<p>Bashkia Vau Dejës, sektori i shërbimeve publike, zyra e financave dhe taksave &amp; tarifave vendore</p>	<p>2026-2028</p>
<p><b>IV. QËNDRUESHMËRIA INSTITUCIONALE</b></p>						
4.1	<p><i>Transparenca në aspektet institucionale</i></p>	<p>Plotësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Miratimi i planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve</li> <li>• Hartimi i rregulloreve për shërbime të caktuara të mbetjeve</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Miratimi i Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Ngurta Bashkiake</li> <li>2. Përditësimi i Rregullores Lokale të Menaxhimit të Mbetjeve në kushtet e ndarjes së re administrative</li> <li>3. Hartimi i një plani për monitorimin e rregullt të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga sektori i shërbimeve publike në bashki</li> <li>4. Hartimi i formateve ditore dhe mujore për monitorimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve</li> </ol>	<p>Numri i dokumentave ligjorë të miratuar për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve</p> <p>Frekuenca e fushatave të monitorimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve</p> <p>Numri i formateve të monitorimit të hartuar nga bashkia</p> <p>Numri i raportimeve javore dhe mujore për nivelin e ofrimit të shërbimit</p>	<p>Bashkia Vau Dejës, (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik, Drejtoria e menaxhimit financiar) Këshilli i Bashkiak</p>	<p>2027-2028</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Adoptimi i modelit të dldp-së, miratuar me VKM për llogaritjen e kostos dhe tarifave</li> <li>• Përmirësimi i sistemit të klientëve dhe rifreskimi databases</li> </ul> <p>Monitorimi i rregullt i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga bashkia</p> <p>Ngritja e kapaciteteve të stafit lokal në fushën e menaxhimit të mbetjeve</p>	<p>5. Hartimi i një plani për zhvillimin e trajnimeve periodike për stafin lokal në fushën e menaxhimit të mbetjeve</p>			
--	--	---	--	--	--

## **ANEKS I: PLAN I DETAJUAR PËR PROGRAMIN E NDËRGJEGJËSIMIT NË LIDHJE ME PROCESIN E MANAXHIMIT TË MBETJEVE DHE SKEMAVE TË MINIMIZIMIT TË TYRE**

### **Objektivat e projektit dhe të programit të ndërgjegjësimit**

Ky program, do t'iu vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për të zhvilluar procesin e kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambientet e shkollave.

Objektivat e fushatës ndërgjegjësuese dhe informuese do të konsistojë si më poshtë:

1. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me skemat e reja të manaxhimit të mbetjeve, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre;
2. Ndërgjegjësimin dhe rritja e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbetjeve;
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbetjeve në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit;
4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e kompostimit, dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për kompostimin e mbetjeve organike;
5. Ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve në të gjithë zonën e parashikuar në lidhje me procesin se si do të kryhet kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave të kompostimit;
6. Prezantimin e skemave të ndryshme të kompostimit për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë;
7. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të kompostimit të mbetjeve organike;
8. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e kompostimit;
9. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.

Fushata ndërgjegjësuese dhe komunikuese do të jetë pjesë e programit të njësive vendore dhe do të jenë ato, të cilat do të zbatojnë këtë program në territorin e njësive të tyre. Konkretisht me anë të këtij programi stafet lokale të njësive do të synojnë që periodikisht (ashtu siç është përcaktuar edhe në hapat më poshtë) gjatë gjithë vitit, të zhvillojë fushata intensive ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin dhe specifikisht për nxënësit e shkollave. Njësitë vendore duhet të sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar periodikisht gjatë vitit këtë program.

Në lidhje me burimet financiare njësitë vendore duhet të parashikojnë si fillim në buxhetet e tyre një zë të veçantë për programin e ndërgjegjësimit dhe informimit, ku duhet të merret në konsideratë elementet si më poshtë:

1. Përgatitja e materialeve informuese, si kalendari periodik i fushateve ndërgjegjësuese, si broshura, postera apo stenda për në ambientet e njësive vendore dhe shkollave
2. Përgatitja e spotit publicitar informues për fushatat intensive periodike gjatë vitit kalendarik
3. Hedhja e informacioneve informuese në faqen e internetit të njësive lokale dhe shpërndarja e informacionit në rrjete sociale
4. Përfshirja e ekspertëve/ trajnuesve të jashtëm që do të kryejnë sesionet e trajnimit në shkollat dhe në komunitet
5. Përgatitja dhe printimi i materialeve trajnuese për shkollat dhe komunitetin

Si fillim përfaqësuesit e njësive vendore do të jenë pjesë e ëorkshopeve që do të zhvillohen në kuadër të projektit, ku do të njihen fillimisht me skemën e re të manaxhimit të mbetjeve dhe skema specifike e kompostimit të mbetjeve në komunitet të kompostimit të mbetjeve, mundësitë që ka zona për të zhvilluar këto skemë, grupet e interesit që realisht kanë mundësi dhe interes, përfitimet ekonomike të tregut nga

aplikimi i skemës, vendosja e sistemit të tarifave për të përfituar shërbime më të mira mjedisore si dhe paraqitja e një plani informues dhe ndërgjegjësues për komunitetin.

### Programi i fushatës ndërgjegjësuese dhe informuese për manaxhimin e mbetjeve

#### Ritja e njohurive të komunitetit dhe nxënësve në lidhje me skemat ndërvendore të manaxhimit të mbetjeve



#### HAPI 1- VEPRIMTARITË PARAPRAKE TË NDËRGJEGJËSIMIT

Njësia vendore duhet të promovojnë në komunitet apo në zonat pilot, ide dhe mënyra të reja për manaxhimin e mbetjeve, si prezantimi i skemave të reja për grumbullimin e mbetjeve (në burim), ndarjen e mbetjeve, ripërdorimi i mbetjeve, metodat alternative të dorëzimit të mbetjeve, etj., duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, të fokusuara për disa konsumatorë apo në një zonë pilot.

Synimi për këtë fazë është t'i informojë njerëzit se është marrë një vendim për aplikimin e një skeme të re; apo se ekziston një mënyrë tjetër më e preferueshme për manaxhimin e mbetjeve në krahasim me mënyrën tradicionale; dhe se ekzistojnë arsye të mira për të ndërmarrë një ndryshim në praktikat aktuale të manaxhimit të mbetjeve. Shpërndarja e këtij informacioni në publik duhet të vijë jo vetëm si një vendim i marrë në nivel bashkie, por edhe në formën e një kërkese (me anë të një pyetësi, i cili do të vlerësojë nevojat e komunitetit dhe mendimi që ka komuniteti për aplikimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve).

Nisur nga ky fakt, njësitet vendore mund të fillojnë fushatën e ndërgjegjësimit me anë të një pyetësi, i cili mund të përsëritet periodikisht (**1-2 herë në vit**), për të vlerësuar si fillim opinionin e tyre në lidhje me gjendjen ekzistuese të manaxhimit të mbetjeve dhe prezantimit të metodave të reja të manaxhimit të mbetjeve, si ndarja në burim, riciklimi, kompostimi i mbetjeve. Në këtë pyetësor do të parashikohet edhe një pjesë në lidhje me opinionin/sjelljen e banorëve kundrejt tarifës së mbetjeve, a janë ata të informuar në lidhje me shërbimet të cilat ata paguajnë, mendimi i tyre në lidhje me propozimin e tarifave të reja për mbetjet etj.

Metodat më të preferuara të ndërgjegjësimit publik, të cilat mund të përdoren nga njësitet vendore si fazë fillestare e ndërgjegjësimit të komunitetit për manaxhimin e mbetjeve është **metoda derë më derë** duke përfshirë vullnetarë apo studentë të interesuar të bëhen pjesë e fushatave aktive.



#### HAPI 2- RITJA E INTERESIT

**Një një fazë të dytë**, komuniteti që tashmë është informuar dhe ndërgjegjësuar për çështjet e manaxhimit të mbetjeve, si dhe për idetë apo programet e reja, do të kërkojë informacione të tjera shtesë, ose do të jetë në pritje për të kërkuar informacione shtesë, përderisa njësia do të vendosë që të zbatojë këto skema të manaxhimit të mbetjeve në territorin që ata administrojnë.

Qëllimi është që t'i bëjnë ata më shumë me dije psh. **për praktikën e kompostimit dhe riciklimin të mbetjeve ose për praktikën e ndarjes së mbetjeve**. Kryesisht në zonën e përzgjedhur do të zbatohen skemat e kompostimit të mbetjeve në nivel komuniteti dhe shkollash<sup>26</sup>. Gjatë kësaj faze duhet që njësitet vendore të fillojnë të hartojnë një program të detajuar, i cili duhet të ketë si qëllim jo vetëm informimin e komunitetit në lidhje me iniciativat e reja që janë ndërmarrë për manaxhimin e mbetjeve, por edhe

<sup>26</sup> Në pjesën më poshtë ka informacion të zgjeruar në lidhje me programe konkrete ndërgjegjësimi dhe informimi për kompostimin në nivel komuniteti dhe shkollash.

konkretisht ku do të konsistojnë, infrastruktura e nevojshme, cili do të jetë roli i tyre në këto iniciativa, përfitimet konkrete që ata do të kenë, niveli i tarifave dhe metodat nxitëse financiare etj.

Kjo fazë e rritjes së interesit do të propozojë konkretisht hapat që do të ndjekë njësia vendore për të realizuar këtë fushatë ndërgjegjësimi, ku do të parashikohet të organizohen takime, seminare, vizita në terren, në impiantet e mbetjeve apo të riciklimit, etj., me pjesëmarrjen e individëve dhe grupeve të interesit duke përfshirë profesionistë dhe manaxherë të mbetjeve.



### HAPI 3- VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI

Në këtë fazë, drejtuesit e programeve, që janë përfaqësuesit e njësisve vendore, duhet të jenë në gjëndje të vlerësojnë programin dhe rezultatet e tij të për një periudhë **çdo 3 muajore**, për të parë nëse programi **është realizuar sipas parashikimeve, nëse ka rezultuar i suksesshëm, i përshtatshëm dhe financiarisht i përballueshëm për të përmbushur mjaftueshmërisht pritshmëritë dhe objektivat**. Falë vlerësimit mund të

**përmirësohen aktivitetet, grafikët ose rrugët e operimit, të merren vendime nëse do të vazhdohet me programin, apo merren vendime për përmirësimin dhe mbështetjen e tij etj.** Nga ana tjetër, autoritetet vendore synojnë të përfshijnë njerëzit më pranë programit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

Ky vlerësim mund të zhvillohet në fund të çdo fushate aktive (1 herë në muaj ose 1 herë në 3 muaj), ku njësia vendore përcakton disa forma të kontrollit si më poshtë:

1. **Vlerësim vizual** në zonat, të cilat kanë filluar të zbatojnë skemat e reja të manaxhimit të mbetjeve;
2. **Vlerësim sasior**, në lidhje me sasinë e mbetjeve të cilat janë reduktuar nga rryma e përgjithshme e mbetjeve (pra kanë shkuar për riciklim apo kompostim);
3. **Vlerësim cilësor** i zonave në të cilat janë vendosur infrastruktura të posaçme për trajtimin e mbetjeve, si kosha për riciklim apo për kompostimin e mbetjeve, nëse ato janë funksionale apo jo dhe nëse janë të mirëmbajtura apo jo;
4. **Vlerësim i opinionit të qytetarëve**, kryesisht të atyre të cilët kanë filluar zbatimin e skemave të reja të manaxhimit të mbetjeve me anë të një pyetësi të shkurtër, i cili duhet të nxjerrë në pah: i) **A është e përshatshme skema për qytetarët;** ii) **A janë ata të ndërgjegjësuar dhe informuar mjaftueshëm për operimin e suksesshëm të skemës;** iii) **Sistemi i aplikuar i tarifave a justifikon mjaftueshëm skemën e re të manaxhimit të mbetjeve etj.**

Gjatë kësaj faze, si autoritetet ashtu edhe konsumatorët do të kërkojnë prova të qëndrueshmërisë nga partneriteti i tyre i deritanishëm, me qëllim që palët të sigurohen se kontributi i gjithësecilit ka vlerë dhe se pala tjetër tregon përkushtimin e duhur. Në këtë fazë rekomandohen intervistat, takimet publike dhe seminarët për të treguar rezultatet dhe për të prezantuar hapat për të ardhmen.

#### Informimi për Sistemin e ri të tarifave

Njësitë vendore me fillimin e aplikimit të skemave të reja ndërvendore, do të fillojnë të aplikojnë edhe një sistem të ri të tarifave të mbetjeve, për një shërbim i cili do të ofrohet në një territor më të madh, ku në disa raste nuk ekzistonte më parë. Nisur nga ky fakt, njësitë vendore do të duhet të fillojnë një fushatë ndërgjegjësimi për sistemin e ri të tarifave për mbetjet, e cila do të prekë qytetarët në dy nivele: i) ata që e paguanin më parë tashmë tani do të kenë një sistem të ri; ii) ata të cilët nuk kanë patur shërbim do tu duhet së pari të njihen dhe të kuptojnë se si funksionon sistemi, ku ata do të bëhen pjesë. Në fushatën ndërgjegjësuere për sistemin e tarifave, e cila do të jetë pjesë e fushatës për promovimin e skemës së re ndërvendore, njësitë vendore duhet të marrin në konsideratë këto parime:

1. Alokimin eficient të burimeve që ka në dispozicion njësia vendore
2. Ofrimi në mënyrë sa më eficiente të shërbimit - krijimi i incentivave për të ofruar shërbimin me kosto sa më të ulët
3. Përdorimi eficient i burimeve natyrore - përmbushja e objektivave mjedisore, si promovimi i skemave të riciklimit dhe kompostimit
4. Mbulimi i kostos – tarifave e vendosura duhet të reflektojë të gjitha shërbimet që kryhen për shërbimin e manaxhimit të mbetjeve
5. Qëndrueshmëria financiare – tarifave e vendosura duhet të reflektojnë një qëndrueshmëri të sistemit të manaxhimit të mbetjeve
6. Barazi horizontale mes përdoruesve, të cilët duhet të paguajnë të njëjtën shumë për të njëjtin nivel shërbimi të ofruar
7. Zbatimi i parimit “Ndotësi Pagan”
8. Parimi i “Proporcionalitetit” – sasia e tarifës duhet të reflektojë sasinë e shërbimit të ofruar
9. Parimi i “Transparencës” – vendosja e tarifës duhet të jetë e qartë dhe nëse ka incentiva ato duhet të qartësohen për publikun

Procesi i vendosjes së tarifës së mbetjeve duhet të kalojë në 9 hapa kryesorë, të cilat duhet të jenë pjesë e fushatës ndërgjegjësuese për tarifave e mbetjeve:

1. **Njohja me konsumatorët** – njësia vendore duhet të identifikojë kategoritë dhe numrin e konsumatorëve që gjenerojnë mbetje në territorin e saj. Ky informacion duhet të paraqitet në broshurat informuese.
2. **Sasia e mbetjeve që gjenerohen në njësinë vendore** – Pasi janë përcaktuar kategoritë dhe numri i konsumatorëve, njësia vendore duhet të përcaktojë edhe sasinë e mbetjeve që gjenerohen në territorin e saj (sipas kategorive) dhe normat e gjenerimit të mbetjeve për kategoritë e konsumatorëve. Ky informacion që duhet të paraqitet në broshurat informuese do t'i japë mundësi konsumatorëve që të kuptojnë realisht sasinë e mbetjeve që gjenerohen në njësinë e tyre dhe sa e rëndësishme është pagesa e tarifës për të siguruar këtë shërbim.
3. **Vlerësimi i opsioneve teknike** – Skema e re ndërvendore do të parashikojë edhe aspekte të reja teknike për mënyrën e ofrimit të shërbimit. Ky informacion, në lidhje me aspektet e reja teknike të shërbimit (nr. i kontenerëve, lloji i tyre për mbetjet miks apo të diferencuara, numri i makina për transport, stabilimentet për depozitimin e mbetjeve etj) duhet t'i vihet në dispozicion komunitetit, që ai të kuptojë realisht teknologjinë e ofrimit të shërbimit të ri.
4. **Vendosja e marrëdhënies institucionale** – Komuniteti duhet të njihet me ndarjen e përgjegjësie dhe detyrave në skemën e re të ofrimit të shërbimit të mbetjeve. Cila do të jetë përgjegjësia dhe roli i secilit territor administrativ në skemën e re të manaxhimit të mbetjeve? Në këtë mënyrë ai do të kuptojë edhe dinamikën përkatëse në territorin ku ai ndodhet.
5. **Njohja me koston e ofrimit të shërbimit** – Për të vendosur tarifa sa më realiste duhet të përcaktojmë koston e plotë të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve sipas shërbimeve që do të ofrohen: i) për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve; ii) fshirjen dhe larjen e rrugëve; iii) trajtimin e ndërmjetëm të mbetjeve; iv) trajtimin final të mbetjeve; v) kostot operative; vi) kostot kapitale; vii) kostot indirekte etj. Në këtë mënyrë komuniteti e ka më të qartë koston e shërbimeve që ai do të marrë.
6. **Identifikimi i burimit të të ardhurave** – Komuniteti duhet të njihet edhe me burimet financiare të cilat do të sigurojnë ofrimin e shërbimit sipas standardeve.
7. **Përzgjedhja e niveleve të duhura për tarifave dhe llogaritja e tyre** – Pasi njësia vendore ka përcaktuar numrin dhe kategoritë e konsumatorëve, kostot e shërbimit dhe burimet e të ardhura, ajo ka mundësinë që të përcaktojë edhe nivelet e duhura të tarifave për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Ky informacion është mëse i rëndësishëm për t'u ndarë me konsumatorët, ku ata njihen specifikisht se për cilat shërbime, me një kosto të caktuar, ata do të paguajnë.
8. **Vendim-marrja strategjike** – Në sajë të karakteristikave të njësive vendore merren disa vendime strategjike për vendosjen e nivelit të tarifave për kategoritë e konsumatorëve, ku përcaktohet sa përqind e koston pritët që të mbulohet nga mbledhja e tarifave.

9. **Komunikimi i sistemit të ri të tarifave** – Njësitë vendore mund të përcaktojnë mënyrën më të mirë për informimin e publikut në lidhje me 8 hapat më lart, **të cilat mund të realizohen me anë të punëtorive periodike, standave në hyrje të njërive vendore apo edhe me broshura informuese, ku japin rezultatet e 8 hapave më lart.**

## Kompostimi i mbetjeve

### a) Promovimi i kompostimit të mbetjeve në nivel komuniteti

Në njësitë vendore do të aplikohen skema kompostimi, si fillim për të informuar qytetarët në lidhje me këtë iniciativë të re. Për aplikimin e skemave të kompostimit propozohet që njësitë vendore të hartojë një program, ku për një periudhë **3-4 muajore**, dy herë në vit (kryesisht në periudhën e pranverës dhe fundin e verës ku koha është më e thatë dhe më lehtë për të filluar këtë proces), çdo **2-3 javë** të realizohet një fushatë ndërgjegjësimi me titull **“Java lokale e ndërgjegjësimit për kompostimin e mbetjeve në zonën e Vau Dejës”**

Në kuadër të kësaj jave, njësitë vendore mund të përgatisin një leaflets (flyer) informues për ta shpërdarë në komunitetin e gjërë, i cili mund të përmbajë informacionin si më poshtë:

- i) Njoftim për punëtoritë falas për kompostimin për komunitetin në ambientet e përzgjedhura nga njësitë vendore: çfarë është ai, si mund të kryhet, kushtet e përshtatshme për realizimin e tij, llojet e vermi kompostit që duhet të përdoren. Duke qënë që fushata do të përsëritet për disa javë gjatë një periudhe 4 muajore, këto ëorkshope mund të realizohen në zona me komunitete të ndryshme për të mbuluar sa më shumë territorin me informacion;
- ii) Gjatë zhvillimit të punëtorive mund të zhvillohet një sesion i veçantë në lidhje me aplikimin e instrumentave nxitës financiarë për stimulimin e kompostit të mbetjeve (p.sh. kompostit i prodhuar do të blihet nga kompanitë e interesuara ose nga vetë bashkia për përdorimet e saja) etj;
- iii) Njoftim për ofrimin e vermi kompostit në tregun e fermerëve me një çmim të arsyeshëm, gjatë ditës që do të zhvillohet punëtoritë. Nëse nuk ka një treg fermerësh mund të improvisohet nga ana e njësisë vendore një aktivitet, në sheshin kryesor të qytetit apo komunës, ku komuniteti mund të blejë vermi kompost të llojeve të ndryshme me një çmim të arsyeshëm. Të ardhurat e gjeneruara nga këto blerje, njësitë mund t'i përdorë për të blerë kontenierë kompostimi për shkollat e qytetit që duan të zhvillojnë aktivitet kompostimi, si dhe për sigurimin e bazës së parë materiale për fillimin e kompostimit të mbetjeve organike;
- iv) Sipas periudhës kur do të zhvillohet java e ndërgjegjësimit, në ditët mjedisore si **22 Prill (dita e tokës), 5 Qershor (dita botërore e mjedisit), 24 Nëntor (Dita botërore e mbjelljes së pemëve)** të organizohen punëtoritë e mësipërme, apo tregu në sheshin e qytetit për blerjen e vermi kompostit, ose në leaflet informues mund të njoftohet se një nga shkollat “sot” të organizojë një demonstrim konkret të kompostimit të mbetjeve në oborrin e shkollës;
- v) Gjatë zhvillimit të fushatës ndërgjegjësuese përgjatë 1 jave, njësitë vendore me anë të një grupi studentësh vullnetarë mund të realizojë një pyetësor për komunitetin për të vlerësuar njohuritë aktuale dhe gadishmërinë që kanë qytetarët në zhvillimin e kompostimit të mbetjeve organike në nivel komuniteti;
- vi) Në leaflets informues, njësitë vendore mund të vendosë një numër telefoni, ku qytetarët mund të telefonojnë për të marrë informacion më të shpejtë në lidhje me kompostimin, procesin si zhvillohet, aktorët që mund të përfshihen etj. Ky mund të quhet si **“Telefoni i mbetjeve” ose “Numri i gjelbërt për mbetjet”**;
- vii) Në ambientet e njësisë vendore apo edhe në institucionet shtetërore ku do të aplikohen skemat e kompostimit mund të vendoset një kuti e Ankesave/ Sugjerimeve për qytetarët;

- viii) Në stendën kryesore të njësisë vendore në fillim të çdo javë ndërgjegjësimi mund të vendoset informacioni në lidhje me aktivitetet që do të zhvillohen gjatë gjithë javës, ku mund të përfshihen edhe hartat, të cilat tregojnë më qartë vendodhjen e aktiviteteve etj.

### Përgjegjësitë

Përgjegjësia për zhvillimin e fushatës do të jetë e punonjësive të bashkisë si dhe e grupeve të interesit, të cilët paraprakisht duhet të kenë nënshkruar një marrëveshje me njësitë vendore në lidhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në këtë bashkëpunim.

## b) Promovimi i kompostimit të mbetjeve në shkolla

### HAPI 1

Të gjitha shkollat, të cilat do të duan të fillojnë të zbatojnë një program për kompostimin e mbetjeve duhet të **hartojnë një program fillestar njoftimi për këtë iniciativë**, i cili duhet të konsistojë në:

- i) Shpërndarjen e idesë për kompostimin e mbetjeve dhe kërkimin për aktorë, të cilët janë të interesuar të jenë pjesë e kësaj iniciative;
- ii) Rekrutimi i një grup të vogël për të zhvilluar idenë dhe themelimin e Komitetit të Drejtimit të procesit për kompostimin e mbetjeve organike;
- iii) Kërkime fillestare në lidhje me procedurën që duhet ndjekur për zhvillimin e procesit të kompostimit në shkollë;
- iv) Përcaktimi qartë i objektivave të projektit.

### HAPI 2

**Hartimin e një udhëzuesi për nxënësit e shkollave që duan të zhvillojnë kompostimin e mbetjeve organike** në ambientet e tyre. Ky udhëzues mund të bëhet pjesë e lëndëve mësimore, ku **nxënësit 1 herë në javë** mund të kenë dy orë mësimore. Në javët e para (gjatë muajit të parë) do të marrin mësimet në lidhje me procesin e kompostimit, si kryhet, cilat janë karakteristikat, kushtet në të cilat do të kryhet etj. Ndërkohë në javët në vazhdim gjatë dy orëve mësimore ata do të zhvillojnë konkretisht kompostimin e mbetjeve organike në oborrin e shkollës dhe çdo javë do të kujdesen për kompostin deri sa ai të bëhet gati. **Kurrikulat e lëndës mësimore për kompostimin e mbetjeve mund të përmbajë konceptet më poshtë:**

- ii) **Përshkrimi i përfitimeve të aplikimit të këtyre skemave në shkolla:** Aplikimi i skemave të kompostimit në shkolla mund të sjellë një sërë përfitimesh: i) Komposti si një produkt final mund të përmirësojë cilësinë e tokës dhe të bimëve të mbjellta në shkolla apo në parqet e qytetit; ii) Promovimi i mundësive të edukimit për praktikën e zhvillimit të qëndrueshëm; iii) Reduktimin e kostos të transportit të mbetjeve në shkolla
- iii) **Përse duhet të kompostojmë dhe përfitimet që kemi nga kompostimi** – Nxënësit kanë nevojë të dinë nëse procesi që ata do të zhvillojnë do të sjellë njohuri të reja për ta, do të sjellë përfitime për shkollën dhe për komunitetin. Në thelb ata duhet të ndërgjegjësohen me konceptin e kompostimit të mbetjeve organike, si një proces i cili do të kontribuojë në manaxhimin e integruar të mbetjeve në njësinë e tyre vendore, dhe si rezultat reduktimin e mbetjeve për trajtim final dhe uljen e kostos së transportit, duke sjellë përfitime ekonomike dhe përmirësimin e shërbimit të mbetjeve.
- iv) **Propozimi i një skeme të thjeshtë për kompostimin e mbetjeve në shkollë:** i) Llojet e mbetjeve që do të kompostohen; ii) procesi që duhet të zhvillojnë nxënësit; iii) Fazat gjatë të cilave do të zhvillohet komposti; iv) Çfarë do të ndodhë me kompostin e krijuar, si do të veprojnë nxënësit, ku do ta dërgojnë, kush do të përfitojë etj.

### HAPI 3

Kjo skemë ka nevojë edhe për hartimin e **një rregullore të brendshme**, ku **përcaktohen qartë rolet e aktorëve që do të përfshihen në skemën e kompostimit të mbetjeve në shkolla**, puna që do të

kryejnë studentët etj. Kjo rregullore duhet të shoqërohet edhe me një **manual për rregullat e higjenës dhe shëndetit** që duhet të kenë parasysh drejtuesit e shkollave dhe nxënësit gjatë zbatimit të skemës së kompostimit.


#### HAPI 4

##### Planifikimi i detajeve të tjera të fushatës ndërgjegjësuere në shkolla:

- i) **Në ambjentet e shkollës** mund të vendosen **postera promovues**, të cilët promovojnë fillimin e kësaj iniciative, shpjegojnë procesin e kompostimit që do të zhvillojnë nxënësit në shkollë (nëse në ambjentet e shkollës ka një zonë ushqimi është mirë që ato të vendosen edhe në këto ambiente posterat shpjegues). Punonjësit e zonës së ushqimit duhet të jenë të informuar në lidhje me ndarjen e mbetjeve ushqimore që do të shkojnë për kompostim;
- ii) **Ideimi i konkurseve të vogla**, ku nxënësit që ndajnë ashtu siç duhet mbetjet për kompost vlerësohen nga shkolla/promovohen për të udhëhequr procesin për një afat të caktuar deri në zhvillimin e konkursit tjetër;
- iii) Vetë nxënësit në bashkëpunim me stafin pedagogjik që ndjek procesin e kompostimit mund të ndërtojnë **një stendë, ku të paraqesin çdo javë rezultatet në lidhje me sasinë e mbetjeve** që gjenerojnë dhe sasinë e mbetjeve që kompostojnë;
- iv) Në kontenerët që do të hidhet komposti duhet të vendosen **letra që specifikojnë se çfarë konkretisht do të kompostohet**;
- v) **Hartimi i një plani trajnimi për nxënësit, stafin pedagogjik dhe prindërit**, të cilët janë të interesuar të kontribuojnë në këtë proces, i cili mund të shtrihet gjatë gjithë vitit i ndarë në dy pjesë: Gjatë semestrit të parë zhvillimi i seancave të trajnimit për nxënësit 1 herë në 2 javë dhe gjatë semestrit të dytë angazhimi i nxënësve që 1 herë në muaj të zhvillojnë ditë të veçanta në qytet për promovimin e kompostimit;
- vi) **1 herë në muaj mund të zhvillohen vizita në terren nga nxënësit e shkollave pranë fermave të mëdha**, ku ata mund të kërkojnë që fermerët të sjellin një pjesë të lëndës së tyre organike për ta kompostuar në ambjentet e shkollave. Gjithashtu nëse në këto ferma kryhet procesi i kompostimit, nxënësit mund të mësojnë më shumë dhe t'i zbatojnë në stendën e tyre të kompostimit në shkollë.

## ANEKSI II – KOSTOT NJËSI SIPAS SISTEMIT TË LLOGARITJES SË KOSTOS PËR SKENARIN I & II


<b>Zona e shërbimit</b>	<b>Zona 1</b>
<i>Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit]</i>	<b>6,903,552.62</b>



<b>Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor</b>		
<i>Grumbullim</i>	112 Lek	0.89 €
<i>Transport</i>	47 Lek	0.37 €
<i>Mirëmbajtje</i>	53 Lek	0.42 €
<i>Personel</i>	112 Lek	0.89 €
<i>Amortizim</i>	94 Lek	0.74 €
<i>Depozitim</i>	82 Lek	0.65 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>500 Lek</b>	<b>3.97 €</b>

<b>Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit</b>		
<i>Grumbullim</i>	770 Lek	6.11 €
<i>Transport</i>	322 Lek	2.56 €
<i>Mirëmbajtje</i>	365 Lek	2.89 €
<i>Personel</i>	767 Lek	6.09 €
<i>Amortizim</i>	642 Lek	5.10 €
<i>Depozitim</i>	560 Lek	4.45 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>3,427 Lek</b>	<b>27.20 €</b>


<b>Zona e shërbimit</b>	<b>Zona 2</b>
Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit]	<b>6,216,714.48</b>



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
Grumbullim	151 Lek	1.20 €
Transport	32 Lek	0.25 €
Mirëmbajtje	72 Lek	0.57 €
Personel	151 Lek	1.20 €
Amortizim	119 Lek	0.95 €
Depozitim	82 Lek	0.65 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>606 Lek</b>	<b>4.81 €</b>

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
Grumbullim	1,037 Lek	8.23 €
Transport	217 Lek	1.72 €
Mirëmbajtje	491 Lek	3.89 €
Personel	1,032 Lek	8.19 €
Amortizim	816 Lek	6.48 €
Depozitim	560 Lek	4.45 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>4,153 Lek</b>	<b>32.96 €</b>


**Zona e shërbimit** | **Zona 3**  
 Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] **3,920,743.90**



Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
Grumbullim	207 Lek	1.64 €
Transport	802 Lek	6.37 €
Mirëmbajtje	671 Lek	5.33 €
Personel	1,570 Lek	12.46 €
Amortizim	671 Lek	5.33 €
Depozitim	61 Lek	0.49 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>3,982 Lek</b>	<b>31.61 €</b>

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
Grumbullim	1,889 Lek	14.99 €
Transport	7,326 Lek	58.14 €
Mirëmbajtje	6,132 Lek	48.67 €
Personel	14,334 Lek	113.77 €
Amortizim	6,128 Lek	48.64 €
Depozitim	560 Lek	4.45 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>36,370 Lek</b>	<b>288.65 €</b>

**Zona e shërbimit** | **Zona 4**  
 Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit] **3,627,973.94**




Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor		
Grumbullim	234 Lek	1.86 €
Transport	586 Lek	4.65 €
Mirëmbajtje	759 Lek	6.03 €
Personel	1,775 Lek	14.09 €
Amortizim	752 Lek	5.97 €
Depozitim	61 Lek	0.49 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>4,168 Lek</b>	<b>33.08 €</b>

Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit		
Grumbullim	2,136 Lek	16.95 €
Transport	5,351 Lek	42.47 €
Mirëmbajtje	6,935 Lek	55.04 €
Personel	16,212 Lek	128.66 €
Amortizim	6,867 Lek	54.50 €
Depozitim	560 Lek	4.45 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto</b>	<b>38,061 Lek</b>	<b>302.07 €</b>

## Zona e shërbimit Zona 5

Total cost for mamagement [LEK/year] **3,308,781.87**



### Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor

Grumbullim	185 Lek	1.47 €
Transport	150 Lek	1.19 €
Mirëmbajtje	601 Lek	4.77 €
Personel	1,405 Lek	11.15 €
Amortizim	606 Lek	4.81 €
Depozitim	61 Lek	0.49 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative</b>	<b>3,008 Lek</b>	<b>23.87 €</b>

### Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit

Grumbullim	1,690 Lek	13.42 €
Transport	1,366 Lek	10.84 €
Mirëmbajtje	5,488 Lek	43.56 €
Personel	12,829 Lek	101.82 €
Amortizim	5,536 Lek	43.94 €
Depozitim	560 Lek	4.45 €
<b>Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative</b>	<b>27,470 Lek</b>	<b>218.02 €</b>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE

PROJEKTVENDIM

Nr. 05 Datë 18/06/2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BARAZISE GJINORE 2026-2029  
NË BASHKINË VAU DEJËS**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Vendimit nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit" Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji Nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, Ligji Nr. 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, Ligji Nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", Ligji Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e femijës", Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë" i ndryshuar, Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore , i propozoj Këshillit Bashkiak, të

## MIRATOJË:

1. Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2029, bashkangjitur këtij dokumenti
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit dhe Barazisë Gjinore

**Konceptoi:** Çuka Babani. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve

**Miratoi:** Ridvan Luzaku. Drejtor/ Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social



**KRYETARI**  
**Kristian Shkreli**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZV/KRYETAR**  
**Aleksandra Gjoni**



Konfirmoi Bazën Ligjore: Kushnë Shtoty Sektori I Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL**  
**SEKTORI I SHERBIMIT SOCIAL DHE MBROJTJES SË FËMIJËVE**

**RELACION**  
**KËSHILLIT BASHKIAK VAU I DEJËS**  
**PËR**

**MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE 2026-2029**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Vendimit nr. 400, datë 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit" Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji Nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, Ligji Nr. 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, Ligji Nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", Ligji Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e femijës", Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë" i ndryshuar, Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në jetën vendore, bashkangjitur këtij Relacioni ju paraqesim P/Vendimin:

***"Për miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2029"***

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave kanë qenë prej kohësh objektiva të rëndësishëm. Për të avancuar më tej në përmbushjen e tyre në mënyrë sistematike dhe të

qëndrueshme, duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet vendore, kemi hartuar Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2029.

Plani vendor për barazinë gjinore 2026 – 2029 bazohet në analizën e nevojave vendore dhe përvojës nga zbatimi i politikave të mëparshme, duke marrë në konsideratë praktikën më të mira dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Në këtë plan janë parashikuar masa të qarta për promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, promovimin e barazisë gjinore midis grave dhe burrave, përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbime për gratë e burrat, si dhe për adresimin e dhunës me bazë gjinore në komunitetin tonë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cënuara, si gratë në zonat rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara apo ato që kanë përjetuar dhunë.

Bashkia Vau Dejës mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, ku askush nuk mbetet pas dhe ku të drejtat e çdo individi respektohen e garantohen. Ne besojmë se për të arritur këtë vizion, është e nevojshme një përpjekje e përbashkët dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë aktorët e shoqërisë. Prandaj, ftojme të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat të bëhen pjesë aktive e zbatimit të këtij plani.

### **Vizioni**

Bashkia Vau i Dejës synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak.

### **Qëllimet dhe objektivat strategjike**

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë 2026–2029 ndërtohet mbi qëllime strategjike, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ndërhyrjes së bashkisë Vau i Dejës në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal.

#### **Qëllimi Strategjik 1**

Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Ky qëllim fokusohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke garantuar përfaqësim

të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të njëjtë në shërbimet publike.

## **Qëllimi Strategjik 2**

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit.

Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri.

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak Vau i Dejës që të miratojë Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026-2029.

**KRYETAR  
KRISTIAN SHKRELI**

**NE MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV/KRYETAR**

**Aleksanda Gjoni**



**Konceptoi:** Çuka Babani, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve

**Miratoi:** Ridvan Luzaku, Drejtor/ Drejtorja e Mbrojtjes ,Përfshirjes dhe Strehimit Social



## BASHKIA VAU I DEJËS

### ABSTRAKT

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjimore i Bashkisë Vau i Dejës 2026–2029 është një angazhim konkret për të promovuar barazi dhe përfshirje në të gjitha fushat e jetës vendore. I ndërtuar mbi analiza të të dhënave dhe konsultime me komunitetin, plani synon fuqizimin institucional, pjesëmarrjen e grave dhe vajzave, si dhe ofrimin e shërbimeve të ndjeshme ndaj gjinisë. Me objektiva të matshëm dhe veprime konkrete, ky dokument udhëheq për një qeverisje vendore më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

## Përmbajtja

Parathënie .....	2
Falënderime .....	3
Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike.....	4
Profili i bashkisë .....	6
Demografia .....	6
Analfabetizmi .....	7
Niveli Arsimor.....	7
Statusi martesor .....	9
Statusi i nënës .....	11
Frekuentimi i çerdhes .....	12
Frekuentimi i Kopshtit .....	13
Persona me Aftësi të Kufizuar .....	14
Metodologjia.....	16
Vizioni dhe objektivat strategjike.....	17
Qëllimet dhe objektivat strategjike.....	18
Qëllimi Strategjik 1 (Q1):.....	18
Qëllimi Strategjik 2 (Q2):.....	19
5. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve) .....	20
Qëllimi strategjik 1:.....	20
Objektivi Specifik (O1.1) .....	20
Objektivi Specifik (O1.2) .....	22
Objektivi Specifik (O1.3) .....	23
Qëllimi strategjik 2: .....	24
Objektivi Specifik (O2.1) .....	24
Objektivi Specifik (O2.2) .....	26
Objektivi Specifik (O2.3) .....	27
Objektivi Specifik (O2.4) .....	28
6. Monitorimi dhe raportimi .....	29
6.1 Qasja dhe parimet e monitorimit .....	29
6.2 Aktorët përgjegjës .....	29
6.3 Treguesit e progresit.....	29
6.4 Formatet e raportimit.....	29
6.5 Mbledhja e të dhënave, Analiza dhe dixhitalizimi.....	30
6.Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar .....	30

## Parathënie

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave kanë qenë prej kohësh objektiva të rëndësishëm për Bashkinë Vau i Dejës. Për të përparuar më tej në përmbushjen e tyre në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme, duke integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe programet vendore, kemi kënaqësinë t’ju prezantojmë Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2026–2028.

Ky dokument strategjik është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, të zhvilluar me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të drejtuesve e specialistëve të bashkisë dhe njësisive administrative, përfaqësuesve të komunitetit, institucioneve arsimore, shëndetësore, organizatave të shoqërisë civile.

Plani vendor për barazinë gjinore 2026 – 2028 bazohet në analizën e nevojave lokale dhe përvojës nga zbatimi i politikave të mëparshme, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mira dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore.

Në këtë plan janë parashikuar masa të qarta për promovimin e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimmarrje, fuqizimin e tyre ekonomik dhe social, si dhe për adresimin e dhunës me bazë gjinore në komunitetin tonë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar grupeve më të cenuara, si gratë në zonat rurale, vajzat e reja, gratë me aftësi të kufizuara apo ato që kanë përjetuar dhunë.

Bashkia Vau i Dejës mbetet e përkushtuar për të ndërtuar një shoqëri të drejtë, ku askush nuk mbetet pas dhe ku të drejtat e çdo individi respektohen e garantohen. Ne besojmë se për të arritur këtë vizion, është e nevojshme një përpjekje e përbashkët dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjithë aktorët e shoqërisë. Prandaj, ftojme të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat të bëhen pjesë aktive e zbatimit të këtij plani.

Angazhimi ynë, drejt një Bashkie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse!

## Falënderime

Bashkia Vau i Dejës shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.

## **Kuadri ligjor dhe institucional si dhe lidhja me dokumentet strategjike**

Në nivel lokal, kuadri ligjor dhe institucional që udhëheq përpjekjet për barazinë gjinore në Bashkinë Vau i Dejës ndërtohet mbi bazën e parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar.

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 18/2, garanton barazinë para ligjit dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe faktorëve të tjerë.

**Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”**: Ky ligj përcakton parimet themelore të trajtimit të barabartë të grave dhe burrave dhe promovon pjesëmarrjen e tyre në të gjitha fushat e jetës publike. Ai parashikon gjithashtu detyrimin për mbledhjen e statistikave gjinore dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e politikave gjinore në nivel vendor.

**Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**: Ky ligj i njuh bashkive një rol kyç në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore. Neni 6 i këtij ligji përcakton se njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Neni 62 u kërkon bashkive të respektojnë parimin e barazisë gjinore në emërimet në pozita drejtuese si nënkryetarë bashkie dhe administratorë njësisish.

**Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**: Ky ligj krijon bazën për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit buxhetor vendor. Ai kërkon që ndarja dhe përdorimi i fondeve të buxhetit të orientohen drejt garantimit të të drejtave dhe mundësive të barabarta për gra dhe burra, si dhe ofron fleksibilitet për të financuar politika që adresojnë nevojat gjinore.

**Ligji nr. 57/2016 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë**, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një nga parimet e sistemit buxhetor. Kjo mbështet integrimin gjinor në planifikimin dhe menaxhimin financiar vendor.

**Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”**, i cili përcakton detyrimet e bashkive për krijimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave, përfshirë Mekanizmin e Koordinuar të Referimit (MKR).

**Ligji nr. 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”**, që ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë diskriminimin gjinor dhe e obligon pushtetin vendor të marrë masa për promovimin e barazisë.

**Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”**, i cili përcakton ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të margjinalizuara në nivel lokal.

**Ligji nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale”**, i cili krijon mundësi për punësimin e grave në situata të pafavorshme përmes nxitjes së iniciativave lokale.

**Ligji nr. 75/2019 “Për rrinë”**, që sanksionon parimin e barazisë gjinore dhe garanton përfshirjen e vajzave të reja në jetën politike dhe sociale të bashkisë.

**Kodi i Punës**, me ndryshimet e vitit 2015 dhe 2020, që detyron institucionet publike vendore të sigurojnë mjedis pune pa ngacmime dhe diskriminim për shkak të gjinisë.

**Ligji nr. 104/2014 për sigurimet shoqërore**, që përfshin të drejtën e lejes prindërore për burrat dhe nënat që rikthehen në punë.

**Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”**, që siguron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupe të tjera të marginalizuara.

**Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”**, që përcakton mbështetje për gratë viktime të dhunës në familje dhe trafikimit përmes banesave sociale.

**Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030**, e miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021, shërben si dokumenti udhëzues kryesor për këtë plan. Ajo orienton objektivat dhe masat strategjike për promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë (si CEDAW, Konventa e Stambollit, Platforma e Pekinit, Objektivin e Zhvillit të qëndrueshëm 5, etj.). Bashkia Vau i Dejës, nëpërmjet këtij Plani, harmonizon politikat vendore me këtë dokument kombëtar dhe merr përgjegjësi për zbatimin e tij në nivel lokal.

Ky kuadër ligjor dhe strategjik siguron themelin mbi të cilin Bashkia Vau i Dejës ndërton dhe zbaton politika të integruara për barazi gjinore, përfshirje dhe drejtësi sociale. Plani është i harmonizuar me:

- ▮ Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030
- ▮ Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), veçanërisht OZHQ 5 dhe 10
- ▮ Programin Kombëtar të Integritimit Evropian

## Profili i bashkisë

Bashkia Vau i Dejës përfshin një numër njësisish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo strukturë e përbërë nga 6 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukurore dhe financiare.

Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë. Aktualisht, Bashkia Vau i Dejës përfshin gjithsej 6 njësi administrative: Vau i Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Temal dhe Shllak, të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Të dhëna administrative	Vlerë
Sipërfaqja	499.09 km <sup>2</sup>
Popullsi bashkisë	19261 (Cens 2023)
Njësi administrative	Vau i Dejës, Bushat, Hajmel, Vig-Mnelë, Temal dhe Shllak

## Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Vau i Dejës është 19261 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore, nga të cilët 51,5% femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori. Pjesa më e madhe e popullsisë, 96 % e popullsisë, është e përqendruar në zonën fushore, në zonën e njësive administrative Bushat, Vau i dejes dhe Hajmel me 18942 banorë. Në 3 Njësitë Administrative Shllak, Temal dhe Vig Mnelë, njësi me relief malor banojnë 769 banorë, ose 4% e popullsisë. Kjo përbërje demografike tregon nevojën për një planifikim të kujdesshëm të burimeve arsimore, duke marrë parasysh kërkesën e lartë për shërbime edukimi, veçanërisht në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve dhe në arsimin e mesëm. Në shumicën e Njësive administrative vihet re një diferencë e lehtë në favor të femrave.

Emri i Njesise Administrative	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bushat	9708	4841	4867
Hajmel	3074	1530	1544
Vau i Dejës	5710	2759	2951
Shllak	127	73	54
Vig Mnelë	256	138	118
Temal	386	202	184

Burimi: Instat 2023

## Përshkrim demografik sipas njësive administrative në Bashkinë Vau e Dejës:

Në kuadër të planifikimit të shërbimeve arsimore parauniversitare, është me rëndësi të kuptohet struktura demografike e popullsisë në territorin e Bashkisë Vau i Dejës. Kjo bashki përfshin një përzierje të zonave urbane dhe rurale, ku dinamika e popullsisë ndryshon në varësi të pozicionit gjeografik, infrastrukturës dhe aksesit ndaj shërbimeve publike.

- **Njësia administrative Vau i Dejës**, që përfshin qendrën urbane të qytetit, ka një popullsi prej 2981 banorësh, me 1 521 femra dhe 1469 meshkuj. Kjo përfaqëson bërthamën e dytë më të madhe urbane demografike të bashkisë dhe ofron infrastrukturën më të zhvilluar arsimore dhe shëndetësore.
- Në njësinë administrative **Bushat**, që ka përqendrimin më të madh të popullsisë, jetojnë gjithsej 9708 banorë, nga të cilët 4867 janë femra dhe 4841 janë meshkuj. Popullsia është e përqendruar në Bushat zone urbane dhe rurale dhe në fshatra të mëdhenj dhe të vegjël, me nevoja të veçanta për akses në shërbime edukimi, të cilat janë shume afer zones urbane të Bushatit dhe pjesën më të madhe të shërbimeve të marrin aty.
- **Hajmel**, një njësi me karakter bujqësor dhe potencial turistik, numëron gjithsej 3074 banorë, prej të cilëve 1544 janë femra dhe 1530 meshkuj. Kjo përfaqëson bërthamën e tretë më të madhe urbane demografike të bashkisë dhe ofron infrastrukturën më të zhvilluar arsimore dhe shëndetësore.
- **Njësitë Administrative Vig Mnelë, Temal dhe Shllak janë njësi** me popullsi të vogël që nuk i kalon 1000 banorët sipas censusit të 2023. Janë njësi që ndodhen në zona të thella malore dhe kanë nevojë për mbështetje në zhvillimin e shërbimeve të integruara për fëmijët e moshës parashkollore.

## Analfabetizmi

Në tabelën më poshtë paraqitet numri i individëve mbi 10 vjeç që zotërojnë aftësitë bazë të shkrimit dhe leximit.

Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
Banorë që nuk dinë shkrim e këndim	619	919	1538	40.2	59.8
Banorë mbi 10 vjeç	19261	9501	9761	49.7	50.3

Nga gjithsej 19261 banorë mbi 10 vjeç në Bashkinë Vau i Dejes, **1,538 persona** rezultojnë se **nuk dinë shkrim e lexim**, që përbën rreth **2.7% të popullsisë** në këtë grupmoshë. Brenda këtij grupi, **919 janë gra** dhe **619 janë burra**, çka do të thotë se **59.8% e personave që nuk dinë shkrim e lexim janë gra**, ndërsa **40.2% janë burra**.

Nëse krahasojmë këtë shpërndarje me përbërjen gjinore të popullsisë mbi 10 vjeç, ku **49.7% janë burra** dhe **50.3% gra**, vërehet një **disproporcion i qartë në dëm të grave**. Megjithatë femrat përbëjnë pak më shumë se gjysmën e popullsisë në këtë grupmoshë, ato përfaqësojnë një përqindje dukshëm më të lartë ndër personat që nuk kanë aftësi bazë në lexim dhe shkrim.

Kjo tregon se gratë janë më të ekspozuara ndaj analfabetizmit, veçanërisht ato që mund t'i përkasin brezave më të vjetër ose që jetojnë në zona rurale. Ky hendek përfaqëson një **formë të përjashtimit gjinor nga edukimi bazë**, me pasoja të drejtpërdrejta në aftësinë e grave për të marrë pjesë në jetën ekonomike, shoqërore dhe politike. Analfabetizmi kufizon mundësinë e grave për të pasur akses të barabartë në informacion, punësim, shërbime publike dhe për të ushtruar të drejtat e tyre.

Ky tregues nënvizon nevojën për **ndërhyrje të synuara** që promovojnë **arsimim bazë për gratë e papaisura me aftësi lexim-shkrimi**, nëpërmjet programeve të edukimit për të rritur dhe nismave sensibilizuese në nivel komunitar.

## Niveli Arsimit

Tabela me poshte paraqet nivelin arsimor te popullates.

Të dhënat tregojnë një shpërndarje të ndryshme gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit, duke reflektuar tendenca sociale dhe sfida potenciale për barazinë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Asnjë nivel arsimor i përfunduar	143	241	384	37.2	62.8
2	Arsimi Fillor	1626	2221	3847	42.3	57.7
3	Shkollë 7/8/9 vjeçare	10751	12238	22989	46.8	53.2
4	Shkollë e mesme	9560	6940	16500	57.9	42.1
5	Bachelor	797	1055	1852	43.0	57.0
6	Master ose Doktoraturë	1605	2148	3753	42.8	57.2

Të dhënat mbi nivelin arsimor të popullatës së Bashkisë Vau i Dejës tregojnë një shpërndarje gjinore që reflekton tendenca të rëndësishme sociale dhe ekonomike. Kjo analizë është e vlefshme për të kuptuar më mirë sfidat dhe mundësitë për promovimin e barazisë gjinore në fushën e arsimit dhe më gjerë.

**Asnjë nivel arsimor i përfunduar** – Në këtë kategori përfshihen 384 persona, nga të cilët **62.8% janë gra** dhe **37.2% burra**. Gratë përbëjnë shumicën dërrmuese, çka tregon se ato kanë qenë më të ekspozuara ndaj mungesës së aksesit në arsim, veçanërisht në të kaluarën ose në zonat rurale.

**Arsimi fillor** – Me gjithsej 3,847 persona, **57.7% janë gra** dhe **42.3% burra**. Edhe në këtë nivel, gratë janë më të shumta, duke sugjeruar se një numër i madh i tyre ka ndërprerë shkollimin pas fillores. Kjo mund të lidhet me faktorë si varfëria, norma kulturore, apo përgjegjësi familjare të hershme.

**Arsimi 7/8/9-vjeçar** – Ky është niveli më i përhapur në popullatë, me gjithsej 22,989 persona. **53.2% janë gra** dhe **46.8% burra**, një shpërndarje relativisht e balancuar që tregon përmirësim të aksesit në arsimin e detyrueshëm për të dyja gjinitë.

**Arsimi i mesëm** – Nga 16,500 persona që kanë përfunduar arsimin e mesëm, **57.9% janë burra** dhe vetëm **42.1% gra**. Kjo është një rënie e theksuar e pjesëmarrjes së

grave krahasuar me nivelet e mëparshme, duke treguar se vajzat përballen me pengesa për të vazhduar shkollimin pas arsimit të detyrueshëm.

**Bachelor** – Nga 1,852 persona me diplomë bachelor, **57% janë gra**, ndërsa **43% burra**. Kjo përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm: ato gra që arrijnë të ndjekin arsimin e mesëm, kanë më shumë gjasa të vazhdojnë drejt arsimit të lartë krahasuar me burrat.

**Master ose Doktoraturë** – Nga 3,753 persona me këto nivele të larta arsimore, **57.2% janë gra** dhe **42.8% burra**. Gratë përbëjnë shumicën edhe në këtë nivel, duke reflektuar një prani të fortë të tyre në arsimin akademik të avancuar.

**Përmbledhje** – Të dhënat tregojnë dy tendenca të rëndësishme: në nivelet më të ulëta të arsimit, gratë përballen me përjashtim më të madh; ndërsa në nivelet e larta arsimore, ato janë në shumicë. Kjo sugjeron se ndërsa ka përmirësim te brezat më të rinj, ekzistojnë ende boshllëqe serioze në arsimin e mesëm dhe në fazat fillestare të shkollimit. Këto boshllëqe duhet të adresohen përmes masave të synuara që promovojnë mbajtjen e vajzave në shkollë dhe fuqizimin e tyre përmes arsimit.

### Statu si martesor

Tabela me poshtë paraqet popullsinë mbi 10 vjeç sipas statusit martesor

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Beqar(e)	10918	7689	18607	58.7	41.3
2	I/e martuar	18773	19172	37945	49.5	50.5
3	I/e divorcuar ose i/e ndarë	478	586	1064	44.9	55.1
4	I/e ve	882	3734	4616	19.1	80.9

Shpërndarja sipas statusit martesor tregon dallime të dukshme gjinore, që pasqyrojnë norma sociale, jetëgjatësi dhe përjetime të ndryshme të grave dhe burrave në lidhje me martesën dhe familjen.

Në kategorinë “beqar(e)”, ka gjithsej **18,607 persona**, ku **58.7% janë burra** dhe **41.3% gra**. Burrat përfaqësojnë shumicën e beqarëve, gjë që mund të lidhet me faktin se ata priren të martohen më vonë ose të mbeten më gjatë beqarë në krahasim me gratë.

Në kategorinë “i/e martuar”, numri total është **37,945 persona**, me një ndarje thuajse të barabartë: **49.5% burra** dhe **50.5% gra**. Kjo tregon se martesat mbetet një institucion ku të dy gjinitë janë përfshirë në mënyrë të ngjashme, edhe pse mund të ketë dallime sipas moshës ose vendbanimit.

Në kategorinë “i/e divorcuar” ose “i/e ndarë”, nga **1,064 persona**, **55.1% janë gra** dhe **44.9% burra**. Gratë përfaqësojnë një përqindje më të lartë të të divorcuarve ose të ndarëve, çka mund të lidhet me disa faktorë si: mbajtja e kujdestarisë së fëmijëve, mungesa e rimartesës pas divorcit, ose më shumë gatishmëri për të formalizuar ndarjen në mënyrë ligjore.

Në kategorinë “i/e ve”, ka **4,616 persona**, ku **80.9% janë gra** dhe vetëm **19.1% burra**. Ky dallim është shumë i theksuar dhe pasqyron diferencën në jetëgjatësinë mes gjinive: gratë zakonisht jetojnë më gjatë se burrat, si dhe ka më shumë gjasa që të mos rimartohen pas vdekjes së bashkëshortit.

Ky informacion tregon se gratë, sidomos në moshë madhore, përballen më shpesh me vetminë dhe humbjen e partnerit, gjë që mund të ketë pasoja sociale dhe ekonomike. Prania më e madhe e grave në statusin “e ve” ose “e ndarë” tregon gjithashtu nevojën për mbështetje të veçantë për këtë kategori, në veçanti në lidhje me strehimin, shërbimet sociale, përfshirjen në komunitet dhe aksesin në ndihma financiare.

Këto të dhëna ndihmojnë në identifikimin e **grupeve shoqërore më të ndikuara nga gjinia dhe statusi martesor**, duke u bërë bazë për hartimin e politikave sociale të ndjeshme ndaj gjinisë në nivel vendor.

### Statuasi i nënës

Tabela me poshtë tregon numrin e femrave që bëhen nëna sipas grupmoshës

Grupmosha	Kane lindur	Nuk kane lindur	Gjithsej	% kane lindur	% NUK kane lindur
15-24 vjeç	305	2287	2592	11.8	88.2
25-34 vjeç	2373	640	3013	78.8	21.2
35-44 vjeç	3254	284	3538	92.0	8.0
45-54 vjeç	4311	279	4590	93.9	6.1
55-64 vjeç	5522	272	5794	95.3	4.7
65-74 vjeç	4522	203	4725	95.7	4.3
mbi 75 vjeç	2610	81	2691	97.0	3.0

Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e grave mbi 25 vjeç në territorin e Bashkisë Vau i Dejës janë bërë nëna, ndërsa përqindja e grave pa fëmijë është më e lartë tek grupmoshat më të reja.

Në grupmoshën **15–24 vjeç**, vetëm **11.8%** e vajzave dhe grave kanë lindur fëmijë, ndërsa **88.2%** nuk kanë lindur. Kjo është një shifër pozitive dhe në përputhje me tendencat moderne që e shtojnë më tej moshën e parë të lindjes, ndoshta edhe për shkak të ndjekjes së arsimit ose angazhimit në punë.

Në grupmoshën **25–34 vjeç**, **78.8%** e grave kanë lindur dhe **21.2%** nuk kanë lindur. Kjo grupmoshë përfaqëson fazën ku ndodh pjesa më e madhe e lindjeve dhe është koha më aktive e jetës riprodhuese.

Në grupmoshën **35–44 vjeç**, **92%** e grave kanë lindur fëmijë, ndërsa vetëm **8%** nuk kanë lindur. Kjo tregon se pas kësaj moshe, pjesa dërrmuese e grave tashmë e kanë përmbushur funksionin riprodhues në kuptimin tradicional.

Në grupmoshat **45–54 vjeç**, **55–64 vjeç**, **65–74 vjeç** dhe **mbi 75 vjeç**, përqindja e grave që kanë lindur arrin nga **93.9% deri në 97%**. Këto shifra reflektojnë normat e brezave të mëparshëm, kur të pasurit fëmijë ishte normë sociale dhe presioni për t'u bërë nënë ishte shumë më i fortë.

Kjo shpërndarje tregon një **ndryshim të dukshëm brezash**, ku gratë më të reja, veçanërisht ato nën 25 vjeç, kanë më shumë gjasa të mos kenë lindur ende. Kjo mund të interpretohet si një pasojë e rritjes së emigrimit, rritjes së pjesëmarrjes në arsim dhe punësim, si dhe ndryshimit të roleve gjinore dhe strukturave familjare.

Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar **nevojat sociale të grave në faza të ndryshme të jetës së tyre**. Për shembull, gratë e reja mund të kenë nevojë për mbështetje në planifikimin familjar, akses në informacion mbi riprodhimin dhe mbështetje në pajtimin e rolit prindëror me karrierën. Ndërkohë, gratë më të mëdha në moshë, të cilat janë ose kanë qenë nëna, mund të kenë nevojë për mbështetje në kujdesin për fëmijët, përfitime sociale, ose ndihmë në faza të tjera të jetës familjare.

### Frekuentimi i çerdhes

Tabela me poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin çerdhen

#	Emertimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek çerdhen	156	132	278	54.3	45.99
2	NUK ndjek çerdhen	482	307	789	61.1	38.9

Nga gjithsej **1,067 fëmijë të moshës 0–3 vjeç** në territorin e Bashkisë Vau i Dejes, **278 fëmijë (rreth 26 %) ndjekin çerdhen**, ndërsa **789 fëmijë (rreth 73.9%) nuk ndjekin**.

Ndër fëmijët që ndjekin çerdhen, **54.3% janë djem** dhe **45.99% vajza**. Shpërndarja është thuajse e barabartë dhe nuk sugjeron një prirje të fortë gjinore në aksesin në shërbimin e çerdhes.

Po ashtu, edhe tek ata që **nuk ndjekin çerdhen, 61.1% janë djem** dhe **38.9% vajza**, çka e konfirmon se ka diferenca të mëdha gjinore në këtë moshë sa i përket përfshirjes ose mungesës së përfshirjes në çerdhe.

Ajo që bie në sy është se **vetëm rreth 6 në 10 fëmijë të kësaj grupmoshe ndjekin çerdhen**, ndërsa pjesa më e madhe nuk përfitojnë nga ky shërbim. Kjo përqindje e ulët mund të jetë rezultat i mungesës së kapaciteteve, numrit të pamjaftueshëm të institucioneve të çerdhes, kostove për familjet, apo normave kulturore që preferojnë kujdesin në familje – shpesh nga nëna.

Kjo situatë ka **implikime të drejtpërdrejta në barazinë gjinore**, pasi mungesa e aksesit në çerdhe ndikon në aftësinë e prindërve, veçanërisht të grave, për të ndjekur punësimin ose arsimin. Kur shërbimi i çerdhes mungon ose është i pamjaftueshëm, janë zakonisht gratë ato që mbajnë barrën kryesore të kujdesit ndaj fëmijëve të vegjël, duke reduktuar kohën dhe mundësitë për të marrë pjesë aktive në jetën ekonomike dhe publike.

Prandaj, kjo tabelë tregon një **nevojë për zgjerim të shërbimit të çerdheve** dhe për politika që e bëjnë atë më të aksesueshëm për të gjitha familjet, si një **masë e drejtpërdrejtë për të promovuar barazinë gjinore dhe për të mbështetur gratë në angazhimin e tyre profesional**.

### Frekuentimi i Kopshtit

Tabela më poshtë paraqet numrin e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që ndjekin kopshtin ( 1,545 fëmijë të moshës 3-6 vjeç ose 67 %).

#	Frekuentimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Ndjek kopshtin	558	480	1038	53.8	46.2
2	NUK ndjek kopshtin	284	223	507	56	44

Këtu vihet re se një numër fëmijësh i ulët që nuk ndjekin kopshtin (507 gjithsej), dhe ndër ta **djemtë përbëjnë një përqindje pak më të lartë 56 %** krahasuar me përfaqësimin e tyre në kopshte (vetëm 53.8 %). Kjo do të thotë se **vajzat janë pak më të prirura të mbeten jashtë institucioneve parashkollore krahasuar me djemtë**, gjë që është në vetvete një problem gjinor.

Ky fakt ka ndikim të drejtpërdrejtë te **nënat**, sepse në kontekstin e shoqërisë shqiptare, kujdesi për fëmijët e moshës parashkollore bie kryesisht mbi to. Prandaj:

Nënat e fëmijëve që **nuk ndjekin kopshtin**, kanë më pak mundësi të jenë të punësuar me kohë të plotë ose të ndjekin karrierën. Kjo situatë përkeqësohet në rastin kur fëmija është vajzë, për shkak të tendencave kulturore që shpesh nuk i japin përparësi shkollimit të hershëm për vajzat dhe sidomos prindërit nga komuniteti rom të cilët e kanë shumë të vështirë të pranojnë integrimin nën kopësht të fëmijëve vajza.

Në këtë mënyrë, të dhënat e Bashkisë Vau i Dejës **tregojnë një prirje që integron vajzat në kopësht, nuk ka pabarazi gjinore: vajzat shkojnë në kopësht →nënat**

integrohen në tregun e punës → grate nuk kufizohen në mundësitë për punësim dhe zhvillimi → ekonomike dhe social i grave rritet.

Gjithsesi, këto tendenca të identifikuara përmes të dhënave duhet të jenë **një pikë kyçe në planin për barazinë gjinore të Bashkisë Berat**, me ndërhyrje konkrete për të:

- ▮ rritur numrin e fëmijëve, veçanërisht vajzave, që ndjekin kopshte publike,
- ▮ zgjeruar kapacitetet e institucioneve parashkollore,
- ▮ ofruar lehtësira për prindërit që punojnë, dhe
- ▮ promovuar ndarjen e barabartë të përgjegjësive të kujdesit brenda familjes.

### Persona me Aftësi të Kufizuar

Tabelat më poshte tregojne numrin e personave me aftësi të kufizuar ne bashki ne total dhe te ndare sipas llojit te veshtiresise

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
0-6 vjec	24	20	44	55	45
6-18 vjec	88	53	141	62	38
mbi 60 vjec	36	42	78		

Të dhënat për personat me aftësi të kufizuara tregojnë një prirje të qartë gjinore që ka ndikim të drejtpërdrejtë në barazinë dhe përfshirjen sociale të grave. Në grupmoshën 06–18 vjeç, shpërndarja mes djemve dhe vajzave është me thujse e barabartë, por me rritjen e moshës, përqindja e grave me aftësi të kufizuara rritet ndjeshëm. Në grupmoshën 15–64 vjeç, gratë përbëjnë 56% të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, ndërsa në moshën mbi 65 vjeç arrijnë në 58.1%. Kjo prirje reflekton faktorë të tillë si jetëgjatësia më e lartë e grave, mungesa e aksesit në kujdes shëndetësor gjatë

jetës, por edhe ndikimin e barrierave shoqërore dhe ekonomike që i bëjnë gratë më të ekspozuar ndaj problemeve shëndetësore dhe vështirësive funksionale.

Këto dallime gjinore konfirmohen edhe kur të dhënat analizohen sipas llojit të vështirësisë. Për çdo kategori – përveç komunikimit, ku ndarja është e barabartë – gratë përfaqësojnë përqindjen më të lartë. Më e theksuara është në vështirësinë për ecje, ku gratë përbëjnë 61.6% të të prekurve. Ato janë gjithashtu më të shumta në vështirësitë në shikim, dëgjim, kujdes ndaj vetes dhe kujtesë. Kjo tregon se gratë me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të shumfishta: fizike, ekonomike, institucionale dhe kulturore. Në shumë raste, ato përjetojnë një formë të dyfishtë diskriminimi – si gra dhe si persona me aftësi të kufizuara – që i kufizon në aksesin në arsim, punësim, shërbime dhe jetë të pavarur.

Këto të dhëna tregojnë qartë nevojën për politika sociale dhe plane për barazinë gjinore që adresojnë në mënyrë specifike sfidat e grave me aftësi të kufizuara. Bashkia Vau i Dejësduhet të marrë masa për të siguruar infrastrukturë të aksesueshme, mbështetje për kujdesin personal dhe shëndetësor, përfshirje në tregun e punës dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe dhuna. Përfshirja e kësaj kategorie në planifikimin gjinor është thelbësore për të garantuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

#	Lloji i vështirësisë	Meshkuj	Femra	Gjithsej	% Meshkuj	% Femra
1	Në shikim	198	180	378	52	48
2	Në dëgjim	8	6	14	57	43
3	Në ecje	189	134	323	58	42
4	Të shëndetit mendor	92	142	234	39.3	60.7
5	Të kufizuara mendore	152	107	259	58.6	41.4

## Metodologjia

Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 të Bashkisë Vau i Dejës është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikën më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore.

Hapi i parë metodologjik ka qenë shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe politik në të cilin do të mbështetet plani. Ky përfshinte, ndër të tjera, Ligjin nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe dokumente mbështetëse si Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore dhe Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16) Këto dokumente kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore.

Në vijim, u realizua një analizë e thelluar e situatës gjinore në territorin e Bashkisë Berat, e ndarë në dy shtylla: analiza territoriale dhe vlerësimi i kapaciteteve institucionale. Analiza territoriale u mbështet në të dhënat statistikore të përpunuara nga INSTAT dhe burime të tjera administrative, të cilat u ndanë sipas gjinisë dhe u trajtuan sipas tematikave kryesore: popullsia sipas grupmohave, niveli arsimor, normat e analfabetizmit, statusi martesor, lidhja e grave me amësinë, dhe aksesin e fëmijëve në shërbimet e hershme të kujdesit (çerdhe dhe kopshte). U trajtuan edhe çështje që lidhen me personat me aftësi të kufizuara, si shpërndarja gjinore dhe lloji i kufizimit.

Analiza mori gjithashtu në konsideratë diferencat midis zonave urbane dhe rurale të territorit të Bashkisë Vau i Dejës, për të kuptuar nëse sfidat gjinore janë homogjene apo të ndikuara nga konteksti gjeografik dhe social. Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e nevojave të ndryshme në nivel njësie administrative dhe krijoi bazën për përshtatjen e ndërhyrjeve në planin e veprimit.

Në aspektin institucional, u analizua struktura ekzistuese dhe funksionaliteti i mekanizmave për barazinë gjinore brenda bashkisë. Konkretisht, u nëse Komisioni për Barazi Gjinore pranë Këshillit Bashkiak ishte funksional, dhe nëse Aleanca e Grave Këshilltare ishte aktive dhe me mbështetje buxhetore. Po ashtu, u vlerësua ekzistenca dhe roli i punonjësit të barazisë gjinore brenda administratës, pozicionimi i tij në strukturë (veçmas apo i lidhur me dhunën në familje), dhe çfarë roli dhe detyrash janë përcaktuar në përshkrimet e punës apo në rregulloren e brendshme të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë ka qenë edhe vlerësimi i kapacitetit për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe shërbimet publike, përmes ngritjes së një Komisioni të Administratës për Barazi Gjinore. U vlerësua nëse komisioni ekziston, është ngritur me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe nëse ka një rregullore funksionimi për të garantuar përfshirjen gjinore gjatë hartimit të buxhetit dhe planifikimit të shërbimeve.

Në vijim u shqyrtua praktika e mbledhjes së të dhënave me ndarje gjinore për çdo shërbim vendor. U evidentua se për disa shërbime ekziston mbledhje e rregullt e të dhënave, ndërsa për të tjera ka nevojë për përmirësim të kapaciteteve administrative dhe metodave të raportimit. Po ashtu, u vlerësua nëse bashkia ka zbatuar ndonjëherë buxhetim me perspektivë gjinore dhe në çfarë mase janë alokuar fonde për aktivitete që kontribuojnë në barazinë gjinore.

Kjo metodologji ka mundësuar jo vetëm një kuptim të qartë të sfidave gjinore në territorin e Bashkisë Berat, por edhe krijimin e një plani realist, të matshëm dhe të përshtatshëm me burimet dhe kontekstin lokal të qeverisjes vendore.

## Vizioni dhe objektivat strategjike

Në një periudhë trevjeçare, Bashkia Vau i Dejës synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Vizioni i këtij plani është që barazia gjinore të mos mbetet një parim në letër, por të përkthehet në përfitime konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve.

**“Një Vau i Dejës ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, ndihen të vlerësuar, të dëgjuar dhe të barabartë. Një bashki që rritet me dinjitetin e njerëzve të saj, ku barazia gjinore është pjesë e jetës së përditshme — në shkollë, në punë, në familje, në rrugë dhe në vendimmarrje. Një komunitet që ecën përpara bashkë, pa lënë askënd pas.”**

## Qëllimet dhe objektivat strategjike

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkisë Vau i Dejes 2026–2029 ndërtohet mbi **dy qëllime strategjike**, të cilat përfaqësojnë shtyllat themelore të ndërhyrjes së bashkisë në promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal. Këto qëllime janë të përkthyer në objektiva specifike dhe aktivitete konkrete, që mund të zbatohen, monitorohen dhe matën përgjatë një periudhe trevjeçare.

### Qëllimi Strategjik 1 (Q1):

**Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.**

Ky qëllim synon të konsolidojë qeverisjen vendore duke e trajtuar barazinë gjinore jo vetëm si një angazhim politik apo normativ, por si një komponent funksional dhe të domosdoshëm të mënyrës se si organizohen, menaxhohen dhe zhvillohet Bashkia. Në

këtë kuadër, barazia gjinore nuk konceptohet si një qëllim i izoluar, por si një qasje ndërsektoriale që ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e proceseve vendimmarrëse, planifikuese, menaxheriale dhe raportuese të qeverisjes vendore.

Ky qëllim fokusohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke garantuar përfaqësim të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të njëjtë në shërbimet publike.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që parimi i barazisë gjinore të integrohet sistematikisht në të gjitha dokumentet strategjike të bashkisë, në politikat dhe buxhetet vendore, në analizat dhe vlerësimet që zhvillohen nga institucionet publike, si dhe në mënyrën se si komunikohet dhe bashkëpunohet me qytetarët. Kjo përfshin zhvillimin e kapaciteteve institucionale, vendosjen e mekanizmave të brendshëm për monitorim dhe llogaridhënie, si dhe fuqizimin e rolit të aktorëve vendor, përfshirë këshillat bashkiakë, administratën vendore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin, në promovimin e barazisë gjinore si një element i padiskutueshëm i qeverisjes së mirë.

Qëllimi Strategjik 1 përfshin tre objektiva specifike:

- ▮ **1.1.** Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të raportimit publik mbi progresin për barazinë gjinore, duke përdorur të dhëna gjinore dhe platforma digjitale.
- ▮ **1.2.** Fuqizimi i mekanizmave institucionalë lokalë që merren me çështjet gjinore, përmes ngritjes së strukturave përfaqësuese, trajnimeve dhe rregulloreve funksionale.
- ▮ **1.3.** Nxitja dhe zgjerimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse dhe konsultimet me komunitetin.

**Qëllimi Strategjik 2 (Q2):**

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshtatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit. Ai synon që të gjitha shërbimet – si ato në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, infrastrukturë, siguri publike, transport, dhe mbështetje për punësim – të projektohen dhe të zbatohen mbi baza që njohin dhe adresojnë në mënyrë të drejtë dhe efektive dallimet gjinore, ekonomike dhe territoriale mes qytetarëve.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve që janë të aksesueshme, të përballueshme dhe të përshtatshme për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë – përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe grupet në situata të cenueshme. Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri.

Ky qëllim kërkon gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale për të analizuar dhe përdorur të dhënat të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshës në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të tyre mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social.

Qëllimi Strategjik 2 konkretizohet në katër objektiva specifike:

- ▮ **2.1.** Garantimi i aksesit të barabartë dhe të balancuar territorialisht në shërbime publike të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes strukturave vendore dhe mbështetjes ekonomike.
- ▮ **2.2.** Rritja e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.
- ▮ **2.3.** Transformimi i lagjeve në hapësira të sigurta dhe të aksesueshme për të gjitha grupet gjinore, përmes planifikimit urban të ndjeshëm.
- ▮ **2.4.** Promovimi i përfshirjes së barabartë gjinore në jetën kulturore dhe sportive, përmes infrastrukturës, përmbajtjes dhe pjesëmarrjes së barabartë.

## 5. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

### Qëllimi strategjik 1:

**Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.**

<b>Objektivi Specifik (O1.1)</b> Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkisë për barazinë gjinore, përmes përdorimit të të dhënave gjinore, platformave digjitale dhe përfshirjes qytetare.					
<b>Aktivite</b>	<b>Periudha e zbatimit</b>	<b>Përgjegjës</b>	<b>Partnerë</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Tregues</b>
1.1.1 Publikimi i Planit të Veprimit në faqen e internetit të bashkisë	2026	Njësia përgjegjëse për administrimin e faqes zyrtare ëeb të bashkisë; IT i bashkisë	Sekretariati i Këshillit Bashkiak, Komisioni i këshillit bashkiak për barazinë gjinore, aleanca e grave këshilltare	(faqe web, staf teknik)	Plani i publikuar dhe qasja publike në faqen zyrtare
1.1.2 Trajnim për punonjësit mbi mbledhjen e të dhënave me tregues gjinorë.	2026 - 2029	Njësia e Burimeve Njerëzore	INSTAT, donatorë (UN Women)	100,000 lekë (trajnerë + logjistikë)	Numri i punonjësve të trajnuar dhe vlerësimi pas-trajnim
1.1.3 Kalendar Lokal dhe organizim i aktiviteteve për Ditët Ndërkombëtare të të Drejtave të Grave	Viti 2026 (i përsëritshëm çdo vit)	Njësitë përgjegjëse për kulturën dhe shërbimet sociale	Shkolla, OJF lokale, media	50,000 lekë (aktivitete, printime, logjistikë)	Numri i aktiviteteve të organizuara sipas kalendarit

<b>Objektivi Specifik (O1.2)</b> Të forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative të Bashkisë për garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazisë gjinore në të gjitha funksionet vendore.					
<b>Aktivitete</b>	<b>Periudha e zbatimit</b>	<b>Përgjegjës</b>	<b>Partnerë</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Tregues</b>
1.2.1 Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të strukturës përgjegjëse për barazinë gjinore në Bashki (Njësia për barazinë gjinore)	2026	Njësia përgjegjëse për Burimet Njerëzore & Kryetar i Bashkisë	Donatorë	100,000 lekë (strukturim, materiale, orë pune)	Struktura funksionale dhe e pajisur me burime njerëzore
1.2.2 Ngritja e funksionalizimi i Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie.(ekzekutivi)	2026	Kryetari i Bashkisë	Drejtuesit e Drejtorive, Këshilli Bashkiak	50,000 lekë (mbledhje, dokumente, koordinim, orë pune)	Komisioni aktiv dhe mbledhje periodike të dokumentuara
1.2.3 Trajnim për anëtarët e Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel Bashkie. (KBGJ) mbi buxhetimin gjinor.	2026	Nësia përgjegjëse për Barazi Gjinore	UN Women, ekspertë të kontraktuar	100,000 lekë (trajnerë, logjistikë, materiale)	Numri i trajnimeve dhe përfshirja e anëtarëve
1.2.4 Program trajnimi për zyrtarët bashkiakë mbi barazinë gjinore dhe anti-diskriminimin sipas një kalendarit vjetor të miratuar.	2026 - 2029	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Shkolla e Administratës Publike, OJF	200,000 lekë/vit (paketa trajnuese, fasilitatorë, certifikime)	Numri i trajnimeve të zhvilluara sipas kalendarit vjetor

<b>Objektivi Specifik (O1.3)</b> Të nxitet dhe zgjerohet pjesëmarrja aktive e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse, konsultimet publike dhe hapësirat e dialogut me komunitetin, në nivel lokal.					
<b>Aktivitetet</b>	<b>Periudha e zbatimit</b>	<b>Përgjegjës</b>	<b>Partnerë</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Tregues</b>
1.3.1 Takime informuese me administratorët shoqërorë mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjesa .	2026	Njësia përgjegjëse për shërbimet Sociale	Njësia Administrative, Njësia përgjegjëse për Barazinë gjinore në bashki (punonjësi i barazisë gjinore)	5,000 lekë (organizim, materiale, orë pune)	Numri i takimeve dhe pjesëmarrësve përfaqësues
1.3.2 Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rolet gjinore në komunitete rurale dhe lagje urbane	2026 - 2029	Njësia Administrative, Njësia përgjegjëse për Barazinë gjinore në bashki (punonjësi i barazisë gjinore)	OJF lokale, shkolla, grupet e interesit	50,000 lekë (postera, aktivitete, facilitim, orë pune)	Numri i fushatave dhe zonat e mbuluara
1.3.3 Organizimi i fushatave të komunikimit gjinor me media lokale dhe shkolla	2026 - 2029	Drejtoria e Komunikimit dhe Arsimit	Media lokale, ZVA, OJF	80,000 lekë (video, përmbajtje edukative, publikime)	Numri i fushatave të zhvilluara në media dhe shkolla
1.3.4 Organizimi i konsultimeve periodike dhe të rregullta me organizatat e grave dhe grupet në nevojë për probleme dhe sfida në ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike lokale;	2026 e në vijim	Zyra për Marrëdhënie me Komunitetin	OJF, grupime komunitare, përfaqësues të shërbimeve	100,000 lekë/vit (takime, raporte, koordinim, orë pune)	Numri i konsultimeve dhe temat e adresuara në shërbimet publike

## Qëllimi strategjik 2:

Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë Berat.

<b>Objektivi Specifik (O2.1)</b> Të garantohet akses i barabartë dhe territorialisht i balancuar në shërbime publike cilësore dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes zhvillimit të strukturave vendore, mbështetjes ekonomike dhe ndërgjegjësimit komunitar.					
Aktivitete	Periusha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Tregues
2.1.1 Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave të NJVRR (Njësitë Vendore të Referimit dhe Reagimit) për çdo njësi administrative	2026	Njësia përgjegjëse për Shërbimet Sociale	Njësitë Administrative, Njësia përgjegjëse për barazinë gjinore në bashki (Koordinatori i barazisë gjinore)  Policia,  Shërbimi Shëndetësor	300,000 lekë (formim strukturash, trajnime, logjistikë, orë pune)	Numri i strukturave NJVRR të ngritura dhe funksionale në njësi administrative
2.1.2 Krijimi i një programi vjetor të granteve të vogla për nxitjen e nismave sociale dhe bizneseve të vogla të grave (me vëmendje për zonat rurale)	2026-2029	Njësia përgjegjëse për Zhvillimin Ekonomik dhe Bujqësisë	Agjencia e Zhvillimit Rajonal, Donatorë, OJF ekonomike	1,000,000 lekë/3 vite (fond për grante, promocion, ndihmë teknike, lehtësi fiskale)	Numri i granteve të dhëna; % e përfituesve nga zonat rurale

2.1.3 Krijimi i hapësirave komunitare për Gratë dhe Vajzat në çdo njësi administrative	2026-2029	Njësitë përgjegjëse për Infrastrukturën, shërbimet publike, & ndjekjen e investimeve në bashki	Njësitë Administrative, Arkitektë, Shoqata komunitare	700,000 lekë (mobilim, ambiente, mirëmbajtje fillestare)	Numri i hapësirave të hapura dhe frekuentimi i tyre
2.1.4 Zhvillimi i moduleve të ndërgjegjësimit mbi barazinë gjinore në bashkëpunim me ZVA dhe shkollat fillore	2026-2029	Njësia përgjegjëse për Barazinë gjinore në bashki (Koordinator i barazisë gjinore)	ZVA, OJF edukative, mësues të përzgjedhur	180,000 lekë (modulim materialesh, trajnim i mësuesve, monitorim)	Numri i moduleve të zhvilluara dhe numri i shkollave pjesëmarrëse

<b>Objektivi Specifik (O2.2)</b> Të forcohet reagimi institucional shumë-sektorial ndaj dhunës me bazë gjinore, përmes mekanizmave të koordinuar, qasjeve të ndjeshme gjinor dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për viktimat në situata të zakonshme dhe emergjente.					
<b>Aktivitete</b>	<b>Periusha e zbatimit</b>	<b>Përgjegjës</b>	<b>Partnerë</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Tregues</b>
2.2.1 Hartimi dhe miratimi i një protokollit të ndjeshëm gjinor për reagim në raste pandemie, fatkeqësi natyrore ose kriza civile	2027	Njësia përgjegjëse për shërbimet e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Shëndetësisë	Njësia përgjegjëse për Shërbimet Sociale; Qendra Shëndetësore, OJF, Ministria e Shëndetësisë	100,000 lekë (ekspertizë ligjore dhe sociale, konsultime)	Dokument protokollit i miratuar dhe i shpërndarë në strukturat vendore
2.2.2 Konsulencë ligjore falas për çështjet e diskriminimit gjinor;	2026–2029	Njësia përgjegjëse për Shërbimet Sociale	Qendra Ligjore e Ndihmës Falas, OJF për të drejtat e grave	150,000 lekë/vit (pagesa për ekspertë, zyra këshillimi, informim publik)	Numri i rasteve të trajtuara dhe këshillimeve të ofruara

<b>Objektivi Specifik (O2.3)</b> Të përmirësohet siguria dhe cilësia e jetës në hapësirat publike urbane dhe rurale, përmes dizajnit të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe krijimit të mjediseve të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për gratë, vajzat dhe grupet në nevojë.					
<b>Aktivitete</b>	<b>Periusha e zbatimit</b>	<b>Përgjegjës</b>	<b>Partnerë</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Tregues</b>
2.3.1 Zbatimi i nismes ‘Qytete të sigurta për grate, vajzat dhe grupet në nevojë’ në 3 lagje pilot përmes ndriçimit, sinjalistikës dhe shenjimit të hapësirave publike të sigurta	2026 - 2029	Njësia përgjegjëse për projektet e Urbanistikës dhe Infrastrukturës	Policia Bashkiake, OJF për të drejtat e grave	1,000,000 lekë (projekt teknik, ndriçim, sinjalistikë, promovim, orë pune)	Numri i lagjeve të përfshira dhe ndërhyrjet infrastrukturore të realizuara

<b>Objektivi Specifik (O2.4)</b> Të sigurohet përfshirja e barabartë gjinore në jetën kulturore, letrare dhe sportive të komunitetit, përmes aksesit të drejtë në infrastrukturë, përmbytje promovuese dhe programe pjesëmarrëse për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë.					
<b>Aktivitetet</b>	<b>Periusha e zbatimit</b>	<b>Përgjegjës</b>	<b>Partnerë</b>	<b>Burimet financiare</b>	<b>Tregues</b>
2.4.1 Pasurimi i fondit të bibliotekës me libra që theksojnë rolin pozitiv të grave dhe burrave në fusha të ndryshme, si dhe promovimi i leximit të barabartë gjinor përmes klubeve të leximit	2026 – 2029	Njësia përgjegjëse Kulturën dhe Arsimin	Biblioteka e qytetit, ZVA, OJF kulturore	100,000 lekë (blerje librash, promovim, aktivitete, orë pune)	Numri i librave të blerë; numri i aktiviteteve të leximit
2.4.2 Promovimi i klubeve të leximit për barazi gjinore	2026 – 2029	Biblioteka dhe Njësia përgjegjëse Barazinë Gjinore (Koordinator)	Shkolla, OJF, klube rinore	50,000 lekë (materiale, lexim i drejtuar, takime diskutimi, orë pune)	Numri i klubeve funksionale dhe pjesëmarrësve (sipas gjinisë)
2.4.3 Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në veprimtari kulturore e sportive përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe programeve të përshtatura të ndjeshme ndaj gjinisë	2026 -2029	Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	Klube sportive, Njësiti Administrative, komuniteti	500,000 lekë (rindërtime të vogla, programe, trajnime)	% e grave dhe burrave që marrin pjesë në aktivitete; numri i ambienteve të përshtatura

## 6. Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2029 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

### 6.1 Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- ‡ **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- ‡ **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- ‡ **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

### 6.2 Aktorët përgjegjës

- ‡ **Koordinatori për barazinë gjinore** do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave.
- ‡ **Komisioni për Barazinë Gjinore në Bashki (KBGJ)** do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- ‡ **Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

### 6.3 Treguesit e progresit

Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, pjesëmarrja gjinore në aktivitete, numri i strukturave të ngritura, përfshirja e komunitetit në konsultime, etj. Treguesit janë ndarë sipas gjinisë dhe, aty ku është e mundur, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale).

### 6.4 Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- ‡ **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.
- ‡ **Çdo vit**, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- ‡ Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

### **6.5 Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi**

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave gjinore dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

### **6.Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar**

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2029, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.